

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I TETË



PRISHTINË, 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS

Ali Podrimja

WORKS

VIII

Editorial board:

Ali Aliu, editor
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I TETË

Redaksia:

Ali Aliu, redaktor përgjegjës
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013



TKURRJA E ATDHEUT
(ESE DHE TË PAHARRUARAT)

Konica '95, Tetovë, 1996

ATDHEU PREJ 5x5 m

Udha më qiti në Lenggris. Por unë isha vonuar gati një vjet për të dëgjuar nga goja e Poetit edhe mrekullitë e fundit për *Atdheun* e tij, që kap një hapësirë 5x5 m. Oda tipike dukagjinase në një ngrëhinë dykatëshe në truallin gjerman, të kthen atje larg në Jug të gojëdhënave, fateve e tmerreve. Frengjitë aty dhe mureve të varura: lahuta, fyelli, çiftelia, tirqit e bardhë me gajtanë të zezë apo, siç thotë një vëlla prej pene i Poetit: me *vetëtime të fikura*, ndonjë kobure trimërie nga kohë të sërta, djepi i brezave, tfurka, gërhanët; ndonjë kuti duhani e orë me qostek të rëndë dhe diku, në skaj të odës të veshur me qilim Peje – sofra, lugë druri e arka me gjëra të çmuara nga *Arbëria*.

Ndërkaq, në oborrin e blertë, pranë një vije uji: Dranja, ajo krijesë e durimit, e thatësisë, e varfërisë – mikeshë e vjetër e Poetit, me kalamaj të shkapërderdhur, të punuar nga bronxi prej dorës së një artisti verior. Mungonin vetëm Temali, Drini i Bardhë, ai i Ziu, buajt e Drinisë e malësorët shkrepave se gjithçka të kthen në një lashtësi të thellë të etnisë. Por *Atdheu* i tij shtrihej *vetëm* në 5x5m. Në të vërtetë, unë sapo kapërceja pragun e odës, kisha hyrë në botën e imagjinatave të Martin Camaj, i cili para mysafirit të rastit kishte renditur me shije gati të gjitha rikvizitat e mundshme të poetikës së tij. Dhe, para se të ikte, kishte varur *çelësin* aty diku nën çati, që pikon edhe mallëngjim.

Lë Martinin me amshueshmëri. Dita e re më çeli në Augsburg, në Atelenë e piktorit Gjesh Gjokajt. Në mes ngjyrave dhe erërave të rënda, përpiqem të vjel mesazhet e brushës së mjeshtrit të madh. Dhe vërej se në atë dinamikë të tmerrshme të Perëndimit, prapë kokë nxjerr ndonjë detaj nga fshatrat e Mbishkodrës: shtëpitë e braktisura, kurbeti, varfëria; ndonjë gardh i rrënuar me tokë dhe gur varri të paemër, shenja këto që paralajmëruan shpesh dramën shqiptare. Nga punimet e vonshme të piktorit gjallëron ende *kujtesa historike* edhe pse përmbajtjet kanë një dekor të ri; rëndojnë me të madhe fatet e

bashkëkohësisë: nga ato teknologjike deri te katastrofat njerëzore. Më vonë Gjeloshi thotë: Megjithatë nga Mbishkodra nuk mund të shkëputem. Gjë e shenjtë është *identiteti yt*. Në këtë grumbull të madh njerëzish e hekurishtesh *vetëm* shenji yt të dallon dhe të bën të madh. Piktura ime do të ishte një tablo malco po qe se diku aty nuk do të frymonte edhe një detaj sado i vogël nga *imja*. E sheh, kudo që shkoj vendlindjen e marr me vete, me teshekoteshë. Kujtoj vargun domethënës e të paharruar të nobelistit grek Jorgo Seferisit: *Kudo që shkoj Greqinë me vete e bart* (Përkth. Kadare). Dhe për të satën herë bindem se krijuesit e mirëfilltë diçka magjike i vëllazëron në krijimtarinë e tyre, edhe pse kurrë nuk janë parë as dëgjuar. Mund të kujtohen ata edhe për një varg, ose detaj të vetëm.

Përkundër përpjekjeve për të mbajtur gjallë identitetin kombëtar e që tek krijuesit e popujve të vegjël është më i theksuar se të të mëdhenjtë, *Atdheu* ka nisur të mos zgjohet më vetëm aty ku i thonë *bukës bukë e ujit ujë*. (Çabej). Zgjimi i tij është i pikëllueshëm, me copa ëndrrash formohet fytyrë e tij. E jeta brendh vazhdimisht diku në periferi. Ai po i ngjan një zogut të hutuar në kafaz, në mungesë të fluturimit, të hapësirës. Çdo gjëje ka nisur t'i vijë erë mallëngjimi. Se, kur del Atdheu në kurbet, nuk ka gjë më të tmerrshme: fillon të mbretërojë harrimi i ngadalshëm, rrënues; të humbet edhe nëpër fjalë..

Ruajna Zot, nga më e keqja.

PA ATDHE NUK KA EMËR

PËR KË SHKRUAJMË?

Iracionalja

Në një qytet të Bavarisë, rastësisht më ra në dorë një gazetë e Zagrebit. Duke e shfletuar, hasë një tekst të mikut tim Mirko Kovaç. Me kënaqësi fillova ta lexoj. Vazhdimi ishte dramatik. Plotë gërçe. Ajo që e thoshte shkrimtari i nderuar serb, nuk dëshiroja të ishte e vërtetë. Ishte diçka monstruoze.

Diku në Bosnje, në qytetin Foça, kryesisht i banuar me myslimanë, jeta kishte marrë tatëpjetën. Iracionalja mbisundonte arsyen. E kuptoja revoltën e mikut tim. Por nuk mund ta merrja me mend se njeriu ishte shndërruar në një gjësend pa vlerë; se në mbarim të shekullit XX urrejtja ndërnacionale ishte thjesht instinkt dhe Evropa spektatore në një teatër të absurdit.

Sipas shkrimtarit të nderuar, një farë Vojislav Maksimović, profesor serb i Universitetit të Sarajevës, rrugëve të përgjakura të Foçës qenka parë duke luajtur futboll me koka të myslimanëve të masakruar.

Nga ato viktima disa, ndoshta, kanë mundur të jenë edhe studentë të tij, të cilët atje buzë Milackës piktoreske, kanë përcjellë ligjëratat e tij mbi të bukurën në art. Por Vojislavi kishte harruar se ishte profesor i Universiteti, që merrej herë pas here edhe me mjeshtrinë e shkrimit. Ai ishte shndërruar në një fantom dhe me gradën e majorit ushtarak kishte marrë pjesë në vrasje të shumta dhe pastrime etnike. Rrënimi i Vukovarit, i Mostarit, i Dubrovnikut, i Sarajevës dhe i shumë fshatrave e qyteteve të tjera më pak të njohura flitnin bindshëm se nuk ishte fjala për psikoetikën e individit.

Paranoja, pra, nga dita më ditë zbulonte fytyrën e vet të shëmtuar jo vetëm në shkrime bulevardeske, por edhe në etnosin, ideologjinë dhe filozofinë e një populli që i afrohej katastrofës. Në krye të asaj të keqeje qëndronin shkrimtarë, gjysmëshkrimtarë, intelektualë, kuaziintelektualë, politikanë të dyshimtë e kriminelë në zë, që i gurmonte policia ndërkombëtare. Me programe nacionaliste dhe elaborate fashistoide mbusheshin bibliotekat, ose krijoheshin të reja, - sipas skenarëve.

Eklipsi

E kë nuk e shqetëson kjo? Në vetëdijen e krijuesit kishte ndodhur një eklips i tmerrshëm, humaniteti as dinjiteti nuk ekzistonte më. Sipas kokave nacionaliste një “popull qiellor” nuk mund të gabojë. Atij i lejohet çdo gjë. Edhe krimi. Toka serbe shpallehin brenda nate edhe ato vende ku një qorr apo topall i sojit të tyre kishte kaluar ndonjëherë. Ose, ekspeditat ndëshkuese shpejtonin të shlyenin çdo gjurmë nga trashëgimia kulturore e identitetit të të tjerëve në trojet e pushtuara me dhunë. Nga një filozofi primitive nuk mund të lindte diçka njerëzore, pos një krijesë qiç, pikëlluese, pa vlerë – me një mjerim të thellë shpirtëror. Sepse, dihet, nacionalizmi është **qiç**. Kështu thoshte dhe Danilo Kishi. Por mu nacionalizmi na u bë ushqim kryesor për mediokër, që shtoheshin rreth tryezës nacionale. Ata krijues të paktë, të cilët kishin guxim intelektual t’i kundërvihen kësaj paranoje kolektive, shpallehin tradhtarë të interesave

kombëtare; botuesit ua mbyllnin dyert, ose detyroheshin ta marrin udhën e ekzilit.

Guximi i Mirko Kovaçit ma kujtonte fatin edhe të një poeti serb i cili, duke parë në ekranin TV se ç'po ndodhte me fëmijët shqiptarë, në demonstrata paqësore dhe masakra të policisë serbe kishte qarë për shkak të turpfit dhe mjerimit të popullit të vet. Dorë pas dore, pas sa ditësh, më kishte arritur një poezi e tij për fëmijët, që kishin rënë nga breshëri i plumbave dumdum. E kishte shkruar atë natë të kobshme. “Ti mund ta botosh. Unë do të të jem mirënjohës tërë jetën se më ndihmon ta pështyj në fytyrë nacionalizmin e popullit tim”, kaq më kishte thënë në telefon, por edhe në një letër që kisha marrë pas një gjysmë viti udhe. Poeti që e thoshte këtë, e kishte kundërshtuar regjimin totalitar një gjysmë jete dhe poezia për fëmijët shqiptarë, as mllëfi i tij nuk ishte një gjest. Ai besonte në vlerën dhe lirinë e njeriut, para se gjithash, ai mbronte etikën e shkrimtarit në një kohë të ligë kur euforia nacionaliste u bë metaforë e së keqës, eklips, më e fortë se fjala e tij prej humanisti.

Në mes nacionalizmit e kombëtares: udha e krimeve

Devavlimin shpirtëror të krijuesit, që e mundonte jo vetëm Mirko Kovaçin, e theksonte edhe më rëndë disidenti dhe bardhi malazias, Jevrem Bërkoviç, në një tubim ndërkombëtar të shkrimtarëve të mbajtur në Bled. Por tmerrri e agresiviteti i një diktature nacionaliste-staliniste ishte diçka e rëndomtë për ne shqiptarët. Vrasjet e eksodet, ndjekjet dhe tmerrin e bardhë ne e kishim përjetuar me dhjetra herë gjatë historisë sonë mijëvjeçare.

Nëse Evropës nuk i kujtohet tragjedia e Çamërisë, pastaj ajo e Toplicës; nëse Evropa u mbyll në hipokriziminë e vet edhe pas vrasjeve e eksodeve të mëdha të viteve '50, '60, '80 dhe '90, duke *konstatuar* vetëm se atje në Ballkan po ndodh diçka e tmerrshme, kujtesa jonë nuk mund t'i shlyejë vajet e britmat mbi të vrarët e fëmijët e masakruar. Mjafton ta lexoni librin “*Luftëtarat e Toplicës*” të Dimitrije Petroviqit e të bindeni nëpër çfarë golgote kaloi populli shqiptar, të

shikoni deri ku ishin trojet e tij, apo të shfletoni dokumentet e fshehta të ortodoksizmit ekstrem në relacion Beograd - Athinë...

T'i kthehemi më mirë të tashmes, që na është bërë shqetësimi ynë i përbashkët. Para katër vjetësh në Beograd u mbajt takimi i parë dhe i fundit i shkrimtarëve serbë dhe shqiptarë. Midis fqinjëve shekullorë kërkoheshin shtigje për një mirëkuptim e dinjitet. Por ç'ndodhi? Shkrimtarët serbë, në vend që të përkrahnin kërkesat e arsyeshme të shqiptarëve rreth thellimit të bashkëjetesës në këtë pjesë të Ballkanit të shqetësuar, ata i shpallën luftë, dhe për çudi, nxitonin këtë ta bënin para Sheshelit, Arkanit, policisë dhe ushtrisë serbe. Gjeniun krijues të popullit serb nuk dua ta fyej, por atë nuk mund ta shoh si kreator të një ideologjie nacionaliste e antihumane.

Emrat që i përmendte Bërkoviç në tekstin e vet fatkeqësisht i njihja. Ata ishin shkrimtarë të cilët zjarri i brendshëm demonian i kishte mundur. Tashti ata gjendeshin në krye të ekspeditave të vdekjes, në krye të pastrimeve etnike. Udha e krimeve është përgatitur me vite, në kontinuitet: nga poetika e viktimit si popull i shtypur, i persekutuar, i keqtrajtuar dhe i vrarë nga të tjerët deri te mistifikimi i një patosi e folklorike të çoroditur. Nëse një novelist, siç ishte Ivo Andriç, ose një akademik, siç ishte Vasa Çubriloviç, njëri nga atentatorët e Sarajevës të vitit 1914, pas të cilit shpërtheu Lufta e Parë Botërore – patën guxim që, sy e faqe Evropës, të shkruanin elaboratet fashistoide të viteve 1937, '39 në stilin e Gebelsit për zhdukjen e qenies kombëtare të popullit dhe të shtetit shqiptar nga faqja e dheut, pse të mos vepronin kështu pasardhësit e tyre mediokër që për virtyt e pranojnë rrenën dhe filozofinë e tyre nacionale e ngrisin mbi të. Apo, siç thotë kryearkitekti i ideologjisë nacionaliste serbe, Dobrica Qosiç: "Rrejmë në mënyrë kreative... të paramenduar!". E kjo nuk bëhet për shkak të ekzistencës, siç mendon Qosiç, por për të fshehur dhunën, krimet dhe frikën e fajësisë. Ndërkaq, për një popull dinjitoz, civilizues – vrasjet, rrënimet e plaçkitjet nuk janë cilësi krenuese.

Shkaktar për një rënie kaq të madhe, para se gjithash, është euforia nacionaliste e cila ka krah të fortë pseudoshkencën dhe propagandën e saj shoviniste e cila, brenda e jashtë trevës gjuhësore sllave bën çmos ta mohojë autoktoninë e të tjerëve, pra edhe të

shqiptarëve. E kjo të shtyn të besosh se popullin serb ka zënë ta kaplojë ndjenja e inferioritetit ndaj vlerave e të vërtetave të tjerëve. Bota e ka të qartë se kush nga ka ardhur, po ashtu për popull autokton askund në botë nuk mund të shpallën ardhacakët. E vërteta për shqiptarët si pasardhës të ilirëve dhe popull autokton në etninë e tyre, nga dita më ditë vjen e forcohet me dëshmi e vepra jo vetëm të shkencës shqiptare.

Pjesëmarrjen e shkrimtarëve në euforinë nacionaliste, e kuptoj edhe si një fatkeqësi për artin e lirinë e njeriut. Nëpër veprat e shkrimtarëve, që i përmendte Bërkoviç me një shqetësim të thellë, nëpër fjalët e simbolet e tyre bridhte e keqja, e akumuluar me vjet dhe e mbështjellë me një gjak të zi. Ishin ato imazhe të errëta e përmbajtje të vdekura. Në to dorë e artistit më së pakti hetohej. Theksimi i tepërt e arrogancë i krenarisë dhe i ndjenjës nacionale kishte arritur të zhdukë çdo dallim të mundshëm në mes nacionalizmit dhe kombëtares.

Shturja. Fotografia

Ishte fillimi i verës në Bavari kur i mblodha copat e verdha të gazetave që më vinin nga Jugosllavia e mbeturinave. Aty në fund të kopshtit ua vura zjarrin. Njëherë e përgjithmonë dëshiroja të lirohem nga ankthi i tmerrshëm që njeriun e kishte poshtëruar atje në Ballkanin tragjik. Nga leximi i shtypit të verdhë hoqa dorë dhe më rrallë ndizja TV. Në bibliotekën familjare fillova ta kaloj kohën më shumë duke lexuar vepra nga autorët antikë. Më mundonin fjalët: *gjak, eksod, vaj, bukë*. Fundshekullin e shihja si hynte në oborrin tim mjaft i lodhur dhe i leckosur. Përpiqesha të vë dialog me njerëzoren, me të bukurën dhe me të gjallën që ende frymonte rreth meje. Por bota vazhdonte të sillej rreth meje sipas ligjit të dhunës apo si e quaja në shaka me miqtë e mi: *pendrek demokracia serbe* ishte në lulëzim të plotë. Njeriu nuk vlente më as për pesë para.

Kthehesha në shtëpi. Në një vitrinë gazetash, aty ku para dy vitesh, në demonstrata të mëdha paqësore të shqiptarëve ishte qëlluar për vdekje një fëmijë, ma tërhoq vëmendjen një fotografi

karakteristike që kishte zënë të zbehej më tepër nga turpi. Ishte një luftëtar serb i cili kthehej “triumfalisht” nga një fushëbetejë në Kroaci. Duke i “falur” botës një buzëqeshje karakteristike me një varg plot gishtërinj njerëzish, që e kishte varur rreth qafës së shkurtur e të trashë. Fotografia fliste më shumë se çdo libër i tmerrit. Ai luftëtar serb, me atë pozën karakteristike të ngadhënyesit, i cili mendonte, ndoshta, se ata gishtërinj njerëzish rreth qafës së shtypur ishin specia të vjelur në ndonjë kopsht të Shumadisë apo të Vojvodinës, dëshmonte për një shthurje të madhe në hapësirën ballkanike. Ai ishte me siguri një prototip që e kishte paralajmëruar nga studioja e vet krijuese zoti Orwell.

Ditët më shkonin ters. Gishtërinjtë e njerëzve rreth qafe dhe ajo pozë karakteristike e luftëtarit serb më rrinin parasysh e posaçërisht më tmerronte qetësia e akullt e Evropës që nuk i lëvizte as qerpiku i syrit edhe kur ia dërgonin peshqesh kokat e prera të njerëzve. Një ditë, kur edhe nëpër gjësendet e mia kishte filluar të shtrihet hija e vdekjes, i shkrova një miku të pendës: “Të lutem, më thuaj për kë shkruajmë?” Përgjigja e tij ishte e shpejtë dhe ekuivoke: Për Ballkanin e di ku bie, por Serbia me siguri nuk gjendet në Evropë...” Ai ishte intelektual i një metropole.

Miti mbi Kosovën

Duke lexuar librin “*Mbretëria e Osmanlinjë*” të turkologut të mirënjohur austriak Joseph von Hamerit, nga kapitulli në kapitull, zbuloja mistifikime të mëdha në shumë vepra që i kisha lexuar më parë, në vërtetësinë dhe vlerat e të cilave kisha dyshuar. Koha e humbur më dhimbsej dhe më mundonte mjerimi shpirtëror i autorëve që kishin helmuar breza lexuesish e përçarë popuj. Me këtë rast duhet zënë ngojë, para se gjithash Mitin për Kosovën (Dardaninë), shfaqjen e tij, që ishte ngritur mbi gërmadhat shpirtërore e për të cilin bëhet fjalë aq shumë në historiografinë dhe letërsinë e dy fqinjve shekullorë – serbëve dhe shqiptarëve.

Përderisa serbët Betejën e Kosovës e pranojnë vetëm si luftë të drejtë të tyre, shqiptarët e konsiderojnë si luftë të koalicionit ku ballkanasit për herë të parë i kishte bashkuar një e keqe e madhe. Derisa serbët Mitin e Kosovës e ngritin si çështje ekzistenciale të serbizimit dhe me zjarmi duan të dëshmojnë autoktoninë në një tokë të huaj, shqiptarët nuk vuajnë nga ky kompleks; përmes Mitit të Kosovës ata përkujtojnë sa herë i kanoset Ballkanit ndonjë fatkeqësi, popujt e këtij rajoni i kanë harruar hasmëritë. Pra, Miti i Kosovës tek shqiptarët shpie nga mirëkuptimi, bashkëjetesa e paqja. Për qëllime hegjemoniste këtë nuk e pranon pala serbe.

“Mbretëria e Osmanlijeve”, një çelës i artë, ma hapte derën e rëndë të vilajetit të errët dhe më nxiste të rilexoj shumë vepra, që i kisha hedhur në një qoshk të bibliotekës familjare. Mallkoja shumëçka. Krijuesit ballkanas kishin lëshuar një shans jetik. Përmes Mitit të Kosovës ta madhëronin dhe ta forconin bashkëjetesën në rajon. Këtë, si duket, bëri përpjekje ta korrigjojë shkrimtari me famë botërore, Ismail Kadare; duke iu qasur të kaluarës me një sensibilitet të ri e vërtetësi historie dhe duke respektuar e çmuar edhe përpjekjet e të tjerëve në shtegtimin nga drita e largët e vilajetit të errët.

Kështu kishte vepruar edhe historiani i nderuar austriak Joseph von Hamer, i cili njëzet vjet kishte kaluar nëpër arkivat e osmanlinjve, për të kërkuar të vërtetën për atë se ç’kishte ndodhur në Ballkan në kohë të shkuara. Sepse nuk ka gjë më të tmerrshme se kur krijuesi rren lexuesin. Mistifikimi është shkalla e parë e nacionalizmit, ndoshta edhe më e pasigurta.

Bizariteti. Qetësia falso e Evropës

Përkundër përpjekjeve të krijuesve dhe intelektualëve shqiptarë për të vënë një dialog paqësor me palën serbe, gjenocidi kulturor e fizik në hapësirën shqiptare brenda Jugosllavisë së mbeturinave vazhdon të marrë përmasa katastrofike edhe për vetë rajonin.

Se deri ku ka arritur paranoja dhe radikalizmi i një politike mesjetare serbe, e ilustron mjaft mirë një barcoletë e cila ka kohë që

qarkullon: *Ç'bën serbi kur nuk ka para? Shkon në Kosovë, vret ndonjë shqiptar dhe pret Sheshelin t'ia dërgoj 50 markat gjermane të marra nga shqiptari i vrarë!* Kjo e vërtetë e hidhur, më tepër tragjike për vetë politikën shtetërore serbe, ta kujton edhe një këshillë bizare të kohës së Pashiqit: Të lindni fëmijë sa vritni shqiptarë! Unë nuk kam kurrfarë komenti për këtë marrëzi njerëzore. Dhuna e krimi u zhvilluan në kontinuitet, në mënyrë të paramenduar.

Siç thashë diku më lartë, shkaktarë të një gjendjeje të tensionuar jo vetëm në hapësirën shqiptare, para së gjithash, janë pjesa dërrmuese e shkrimtarëve serbë, të cilët me energjinë e tyre krijuese ushqyen *dhunën*. Kjo është e tmerrshme, posaçërisht në momentin e pikërishtëm kur qetësia e Evropës është një qetësi falso. Ta duash popullin dhe kulturën tënde është gjë e shenjtë. Nuk jam as kundër atyre që bëjnë programe nacionale dhe merren me historicizëm. Jam kundër atyre që rrënojnë qetësinë e të tjerëve. Populli im nuk e pranon dhunën si mjet për zgjidhjen e konflikteve jo vetëm në rajonin tonë të shqetësuar. Fqinjët e mi shekullorë, po qe se i urrej, para etikës së popullit tim do të turpërohesh. Brengos fati i popullit serb, nëse vazhdon të identifikohet me një ideologji neofashiste. E ardhmja e tij mund të jetë më e zymtë.

Shtrohet pyetja: A mund t'i ikim një katastrofe të mundshme dhe të na kthehet paqja në trojet tona? Besoj se po. Vetëm kokat e fjalët tona t'i shkundim nga demonët. Atdheu ynë i vetëm e më i sigurt mbetet Njeriu.

(Janar, 1993)

(Kumtesë e lexuar në Simpoziumin ndërkombëtar "Shkrimtarët dhe nacionalizmi", mbajtur në Vjenë më 30 dhe 31 janar 93. Botuar, po ashtu, në librin "Zwischen Feder und Fabne", Picus, Vjenë 1993)

A PO I KTHEHEMI MESJETËS

Gati më kishte zënë gjumi në një kanape në hotelin “Marriot” të Frankfurtit kur më trandi një fotografi në ekranin televiziv. Ishte një pamje më se monstruoze nga luftërat e përgjakura në Bosnjë: një arkë e punuar nga druri i Ballkanit me plot koka njerëzish, që i vinin peshqesh Evropës së fjetur. Buzëqeshja e ngrirë në skajet e buzëve të përgjakura të viktimave, e lexoja, para së gjithash, si një primitivizëm të fiseve sllave që me barbari e dhunë ende e shqetësonin njerëzimin. Ajo buzëqeshje ishte dhe një protestë e hapët hipokrizisë së Evropës. Reagimet e akullta rreth meje dhe pamjes rrëqethëse në TV, që gati ishte ngrirë për xhamin e lëmuar të ekranit, ishin befasuese: Evropa bënte një gjumë të këndshëm, gati përrallor! Në hotelin “Marriot” nata ishte shtrirë gjerë e gjatë kur rrugëve të ftohta të Frankfurtit tërhiqja zvarr dhembjen për njeriun dhe mezi orientohesha në hapësirën e panjohur.

Zoti im, Zoti im, po ato nuk ishin koka minjsh.

Përçarjet ballkanase – përçarje evropiane

Përçarjet e ballkanasve, në një farë mënyrë janë edhe përçarje në mes evropianëve. Ato nuk janë vetëm të ditëve të sotme, as nuk bën të shikohen nga një rrafsh. Me zbritjen e fiseve sllave nga Karpatet dhe me kthimin e Greqisë nga Bizanti (Kadare), pra kur feja u bë nocion i parë në ekzistencës e popullit dhe të shtetit grek dhe kur demokracia helene si shkalla më e lartë e qytetërimit të atëhershëm, mbeti lavd i kohëve të lashta, ballkanasit pësuan një nokdaun të rëndë: përgjakjen, hasmeritë. Në shesh dolën aspiratat nga më të errëtat: nga besimi fetar deri te dominimi me dhunë.

Në vend se popujt të fisnikëronin njëri-tjetrin me kulturë e frymë të re, ballafaqimi i tyre mori përmasa dramatike. Nga fqinjë e rinj e të vjetër gjymtimi i shpirtit e i trojeve shqiptare vazhdon edhe në kohë të sotme. Dhuna serbe u bë shkatërruese. Reagimin ironik të akademikut serb Miqa Popoviçit, duhet kuptuar edhe si një qortim turpitar nacional: “Serbët nuk janë njerëz të mësuar me demokraci, kështu që kanë nevojë të shkollohen në këtë fushë...” Këtë më së miri e dëshmon mosgatishmëria e tyre për një fqinjësi të mirë me shqiptarët edhe pse këta kurrë nuk ua mohuan ekzistencën e tyre si popull. Në shkallëzimin e dhunës ndaj identitetit e hapësirës shqiptare kontribut të dukshëm dha aleanca e fshehtë ruso-greke në koalicionin me francezë-anglezët. Përgjegjësia, megjithatë, i mbetet Evropës, e cila më shumë mendon për tregje të reja sesa për mbrojtjen e popujve dhe të kulturave të kërcënuara.

Gabimi i parë, e ndoshta më tragjik ndodhi në vitin 1878 në Kongresin e Berlinit. Fuqitë e Mëdha të Evropës së atëhershme politike, (ata e dinë si ranë në dakord!), Pashallëkun e Beogradit e shpërblyen me trojet shqiptare. De facto: Fuqitë e Mëdha u bënë ekzekutorë të fatit të një populli antik dhe legjitimuan dhunën - pastrimin e Toplicës, e Kosanicës dhe të trojeve të tjera shqiptare. Në vilajetin e errët Evropa ende nuk kishte depërtuar, as mjetet e informimit thuajse nuk ekzistonin fare, por sipas të gjitha gjasave ka pasur arka të shumta me plot koka të shqiptarëve, varre masive...

Vërtet, ç’ndodhi në Toplicën shqiptare, dëshmojnë ca shkrime që për autorë kanë serbët që, duke madhëruar “krenarinë” kombëtare, tregojnë për barbarinë serbe të ushtruar ndaj shqiptarëve të pambrojtur e të harruar edhe nga zoti. Një dhunë e tillë, me tërë ashpërsinë e saj, ndodh tashti në Bosnje, pas njëqind vjetësh. Serbët, fatkeqësisht, mbetën soj më vete dhe në mënyrën e tyre i kuptuan ligjet e qytetërimit. Luftërat në Toplicë Serbia i kishte shpallur para Evropës si luftëra çlirimtare. Në të vërtetë ajo ushtronte gjenocid të paparë. Si relikte të një qytetërimi të vjetër nga ai ferr shqiptar brenda Serbisë së ngushtë mbetën gjallë mbi 500 toponime shqiptare.

Gabimi i dytë, në vitin 1913 prapë Evropa e pranoi lojën e fshehtë të aleancës sllavo-ortodokse - shpërbërjen e hapësirës

shqiptare: Çamërinë duke ia dhënë Greqisë, ndërkaq Kosovën Serbisë. Definitivisht Evropa çoi dorë nga Ballkani, çelësat ua dorëzoi aleancave të errëta të sllavoortodoksizmit. Më bëhet se Evropa e humbi edhe qetësinë e vet. Dardani e dikurshme ilire, e emërtuar shumë më vonë si Kosova nga një zog i quajtur *kos* i fisit të shqiptonjave, mbeti plagë e hapur jo vetëm në trupin shqiptar. Muri i Berlinit, simboli i fatkeqësisë njerëzore, nuk ishte muri i parë që ndante një kulturë e një popull. Shumë më herët kishte ekzistuar Muri i Arbërit, i cili ende lëviz mu si ato gardhiqet lëvizëse në romanet e Skorçës dhe vazhdon të bëhet më i tmerrshëm pas çdo kongresi e interesi, duke tkurrur hapësirën shqiptare, në Veri apo Jug, Kongresi i Londrës (1913) dhe Konferenca e Versajës (Paris, 1919) tragjedisë shqiptare i dhanë një tegel të ri por apetitet ekspansioniste të të tjerëve nuk pran. Shtrohet pyetja: Deri kur Evropa të vë në pyetje ekzistencën shqiptare?

Gabimi i tretë do të jetë më se katastrofal: As serbët as shqiptarët nuk do ta tolerojnë njëri-tjetrin, sepse “nëse fillimi i mosbarazisë, shtypjes dhe luftës ishte sundimi i pakicës mbi shumicën, si mund të mos shihet te pushteti origjina dhe shkaku i padrejtësive historike” (Octavio Paz). Ka edhe arsye të tjera. Por përpjekjet e shqiptarëve për të rujtur qetësinë e pragun e vet gati shkuan huq, mbetën mjet për kusuritje në mes të të mëdhenjve.

Intelektuali i rebeluar beogradas Bogdan Bogdanoviq, duke parë me realizëm atë që po ndodh në hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe se Kosova mund të jetë një kasaphane e re në Ballkan, në një intervistë dhënë një gazete të Zagrebit, theksoi se do të ishte mirë që serbët dhe shqiptarët të ndahen si miq. Ky mendim i guximshëm në kohën kur u tha ishte një akull për kokat e nxehta, por unë do e forcoja: serbët dhe shqiptarët duhet të mbesin të hapur njëri ndaj tjetrit: përmes tyre të hyjë Evropa në Ballkan, jo ajo të ballkanizohet.

Mirëpo megalomania serbe, që u bë edhe mënyrë jetese: Askush nuk mund të na bëjë gjë mbasi edhe “Zoti na qenka serb” (Miqa Popoviq) dhe përçarjet brenda komunitetit evropian më tepër për shkak të interesave të tyre në Ballkan bëjnë që sllavo-ortodoksizmi të ngrejë kokë nga Urali deri në Athinë. A do të ndodhë ajo më e

keqja, serbët e shqiptarët t'i varrosë një i tretë, varet edhe nga gjumi që na e ka zënë Evropën. Por, duke parë se në lojë kanë filluar të shfaqen interesat nga më morbidet dhe duke parë indiferencën e hamendjen e Evropës për atë ç'ndodh në Ballkan, kam frikë se varri ynë i përbashkët do të jetë vërtet i madh.

Nuk e përmend Kosovën për shumë arsye. Por shikojeni Bosnjën! A nuk ju rrënoqeth ajo tragjedi njerëzore, ato arka me plot koka njerëzish, që në ekranet televizive të Evropës jepen si sekuenca të një teatri të quajtur *Ballkan*? Duke pritur bukë, duke marrë një kantë ujë, duke varrosur të afërmit, duke marrë pjesë në ndonjë gazmend të rrallë apo në ndonjë stadion futbollistik vriten me dhjetëra njerëz në ditë... A nuk është një turp për ne që bashkarisht marrim pjesë në shfarosjen e kulturave, e popujve? Ndoshta ne nuk pajtohemi, por me armët e Evropës (Orwell) fshihen nga faqja e dheut kultura e popuj. Në njërin anë ndodhen forcat serbe, deri në dhëmbë të armatosura me prodhime më të reja të Evropës, në anën tjetër boshnjakët të lodhur, të uritur, të lekosur presin në rend *vdekjes*. A nuk ju kujton arenat e Romës së Vjetër: në një anë gladiatorët e në anën tjetër skllëverit?... Paradoksi: një shtet i pranuar nga të gjitha institucionet ndërkombëtare, siç është Bosnja, bëhet rrafshë me tokë nga egërsia e hordhive serbe.

Tmerrin e padrejtësitë, para se gjithash, i shikoj nga këndi im personal se ato i ndiej përditë në lëkurën time. Por shuarja e një populli, e një kulture, nuk bën të jetë dhembje vetëm e individit. Letra e ministrit të punëve të jashtëm të Anglisë, Daglas Hërd, dërguar zotit Mejxher, të cilën e publikoi dhe *Di Wellt*: Bosnjën duhet shpërbërë!, është turpi i Evropës. Nëse ajo është e vërtetë, ultimatium më të zi nuk kam lexuar nga historia më e re e njerëzimit. Ajo, po ashtu, është mjaft indikative se në Evropën e ashtuquajtur demokratike qarkullojnë edhe shumë letra të fshehta e me kobzeze për kontinentin tonë. Tragjedia ballkanase të bind se Evropa më së pakti merret me lirinë e njeriut dhe proceset demokratike. Ajo nuk mundet të shkëputet nga "interesat" e veta që vetëm ajo i di. Ka shenja se ajo nuk ecën nga bashkimi por nga copëtimi në minishtete me tipare të etnisë. Çekët e sllovakët, duke parë se ç'ndodhi në ish-Jugosllavinë, bënë shkurorëzimin në mënyrë më të

civilizuar. Këtë e paralajmëruan edhe flamanët e valonit. Por ç'do të ndodhë nesër kur edhe rusët e popujt e tjerë të Lindjes do të zgjojnë kujtesën e tyre historike? Me siguri se Evropa nuk do të bëjë më sehir. Do të hapë syrin e madh e të errët.

Çështja shqiptare dhe psikiatria serbe

Tani për tani, problem është çështja ime ekzistenciale. Më mungon liria ime personale dhe libri im, më mungon hapësira ime kulturore dhe historike, më mungon Itaka ime. Jo vetëm para meje, shtrohet një pyetje më se ekzistenciale: A erdhi fundi? Konflikti i mundshëm në mes aleancës serbo-greke me shqiptarët e bërë pikë e pesë sa vjen e qartësohet në horizont. Në një luftë të heshtur e tinzare vazhdon agresiviteti i sllavo - ortodoksizmit, dominimi i tij në Ballkan dhe zhdukja e një populli e kulture me të gjitha tiparet iliro-shqiptare. Evropa merr pjesë vetëm si spektatore. Shkenca serbe dhe ajo greke vazhdon avazin e vjetër, metropolet t'i bombardojnë me të pavërteta për shqiptarët, duke i paraqitur si popull amorf dhe element destabilizues në Ballkan. Paranoja serbe shkoi aq larg sa Evropën e kishte paralajmëruar qysh në shekullin XIX se në Ballkan po na jetuakan do njerëz me bishta, të cilët quhen shifter.

Për fat të mirë, Evropa intelektuale nuk mund e gëlltiti edhe këtë e të mendojë në mënyrën serbe, apo të bënte pazarllëqe si Evropa politike. Ajo nuk ishte miope: nga një rrafsh real përcillte me vëmendje e guxim lëvizjet shpirtërore e politike në Ballkan. E kishte të qartë se kush nga kishte ardhur. Rreth çështjes shqiptare edhe pse nuk dispononte materiale të bollshme, kishte shenja se njëri nga dy popujt më të vjetër në Ballkan ishin shqiptarët, po ashtu nga shumë dokumente e dinte se serbët ishin vetëm ardhacakë dhe se mjaft pak edhe grekët t'i kujtonin helenët e devotshëm.

Sllavët, kur na paskan ardhur, gjithnjë sipas shkencës serbe, në Dardaninë ilire, të quajtur shumë më vonë Kosova, paska ekzistuar një hapësirë vakuum dhe gjithçka paska filluar nga fillimi e me befasi si në filmat fantastikë. Aty na paskan jetuar vetëm gjarpërinj, minj, gurë e

bar vdekteprurës... Në saje të “aftësisë” mendore dhe parmendës serbe, ai vakuum i tmerrshëm na qenka shndërruar në një tokë të begatshme e harmonie. Por një natë të kobshme, nuk dihet as viti as shekulli, nga drunjtë e zhveshur e malet e larta, na paskan zbritur dofarë njerëz me “bishta” dhe nga atëherë nga qenka bërë shqetësim i përhershëm i sllavo-ortodoksizmit nga Athina në Ural; pra edhe serbëve të urtë e të kulturuar u paskan rënë në qafë. Si duket, nga atëherë serbët na qenkan shpërngulur e bërë “popull qiellor”... Ka edhe shumë sihariqe nga shkencëtarët “seriozë” serbë shkrimet e të cilëve mund të merren lirisht edhe si shkrime të para të fantastikës.

Revolta dhe fatkeqësia greke

Ndaj një absurditeti rreth teje që gati të lë pa frymë, nuk mund të rish indiferent e sidomos kur lexon tekste të tilla që u vjen era gjak. Shpesh mbyllem në bibliotekën time. Aty në një kënd të errët kujtoj një kishë atje në Majnc dhe qiriun, që e kisha ndezur pas një udhëtimi të gjatë për t’u takuar me Shën Albanin nga Iliria, i cili që në shekullin e tretë (286) në hapësirën gjermane kishte përhapur kristianizmin e që Kisha Gjermane e kishte shpallur për të shenjtë, duke ia ngritur edhe tempullin si shenjë nderimi. Atë ditë kur kisha shkelur në Majnc, një grua e panjohur kishte rënë në gjunj e m’i kishte fshirë lotët. Apo një verë të largët në njërën nga bibliotekat e shumta të Vatikanit shfletoja me kujdes *Biblen*, (Vulgatën) përkthimin e të cilës e kishte bërë Shën Jeronimi ilir nga dalmatët që në shekullin e katërt. Dhe, kur dilja nga biblioteka, korridoreve të pafundja më bëhej se dëgjoja zërin e Papës shqiptar, Klementin XI. Nuk di, Evropa a mund ta harrojë edhe Nënë Terezë nga kohët moderne, simbol i mirësisë njerëzore si dhe shumë fytyra madhore të kulturës e historisë shqiptare që qytetërimi evropian i pranoi edhe si vlera të veta të pakontestueshme. I përmenda ca emra për të provokuar në më ka lënë kujtesa dhe për të dëshmuar se kur ne shqiptarët ndanim gëzimin dhe pikëllimin me Evropën, fiset sllave, pra edhe serbët, zbritnin nga Karpatet, ose

gjendeshin diku në brigjet veriore të Danubit. Këtë nëse nuk duan ta pranojnë serbët, atëherë turpi i tyre.

Është rast i rrallë që heronjtë e një populli të jenë heronj kombëtarë edhe të një populli tjetër. Edhe pse kjo është çështje e ndjeshme. Shumë prijës, luftëtarë, njerëz të kulturës e të historisë shqiptare me origjinë nga Epiri, nderohen e çmohen edhe sot nga populli e shkenca greke. Viti 1821 ishte vendimtar për krijimin e shtetit grek. Shkencëtari grek K. Biri, në mes të tjerash, theksonte: “Të kujtojmë se fara e tyre (shqiptare, Ap.) dhe figura më të shquara në Kryengritjen Greke... një Xhavellë, një Bubulinë... një Ali Pashë... Përsa i takon trimërisë, kryelartësisë, karakterit... Këto janë cilësi të njohura për shqiptarët, të njohura edhe nga ata, të cilët nuk ushqenin simpati për ta”. Ndërkaq, studjuesi tjetër, Panjot Kopitari forcon edhe më mendimin e lartpërmendur: “Greqia kishte mbrojtës, madje edhe ministra, të cilët mezi e flisnin greqishten”. Shembujt e tillë vetëm mund t’i afrojnë popujt dhe të vjen keq kur këto virtyte të larta njerëzore zënë e shemben nga mendjet e errëta.

Milefi është më i madh kur sheh se Komuniteti Evropian nuk mundi të ndikojë asgjë në Greqinë e sotme, regjimi i të cilës nuk dallon fare nga regjimet totalitare; për të nuk ekzistojnë asnjë normë ndërkombëtare kur është çështje për jogrekët. Jo vetëm për Çamërinë, arvanitët, për ata heronj të *Carl Haroldit* të Bajronit e tragjedinë e tyre, për ndjekjet e vrasjet e çamëve gjatë viteve 1943-44, për asimilimin e hershëm e të vonë të shqiptarëve ortodoks, që shtrihen edhe sot nga Epiri deri thellë në Atikë me “tiparet dhe karakteristikat shqiptare” si e shënon edhe shkenca greke, por edhe për gjenocidin ndaj pakicave turke e maqedone. Nëse Greqia tolerohet për shkak të famës së dikurshme helene, unë mbaj anën e njerëzve të revoltuar. Asgjë nuk ka mbetur nga e kaluara helene dhe kjo është, para së gjithash, fatkeqësi greke.

Ankthi gjithëballkanik

Vazhdimi i përçarjeve në Evropë do të thotë vazhdimi i tensioneve nacionale, sociale e kulturore jo vetëm në Ballkanin e

trazuar. Ëndrra se duhet të ekzistojë patjetër një shtet i madh sllavo-ortodoks nga Urali deri në Athinë, bëhet një anktë gjithëballkanik. Kori i shqerrijeve serbo-greke tregon se luftë do të ketë. Por kur? Varet nga shumë faktorë. Shenjat janë mjaft ogurzeza. Asnjë mjedis nuk është kaq i ngarkuar me të kaluarën historike e më botëkuptime nga më të ndryshmet deri te lufta e feve dhe rivaliteti i moçëm për të dominuar në këtë pjesë të Evropës. Aleanca serbo-greke, posaçërisht u egërsua ato ditë prilli kur Papa i Kishës së Shenjtë, Gjon Pali i Dytë, zbriti në Shqipëri dhe puthi tokën shqiptare. Sllavoortodoksizmi e kuptoi këtë si njëfarë kërcënimi, sepse ishte hera e parë në historinë e krishterimit që një Papë zbriste në Ballkan e që e kishte zgjedhur mu vendin e shqiponjave. Disa herë ortodoksizmi ishte kundër pranisë së Evropës në Ballkan dhe atij i konvenon një gjendje kaotike çfarë ekziston momentalisht në rajonin tonë, duke shpresuar se do t'i realizojë më lehtë aspiratat e errëta ndaj çështjes e hapësirës shqiptare.

Një gjë është më se bindëse; nga të gjitha lëvizjet demokratike deri tek ato neofashiste, që ndodhen e veprojnë në kontinentin tonë, Evropa, megjithatë, fitoi atë që e humbi Afrika e Jugut: *apartheidin* e vet të quajtur *Kosovë*.

Në vend të akademive të arteve të bukura, lejoi të hapen akademi police e të veprojnë taman si eskadronet e vdekjes në Amerikën e Jugut; në vend që të ndihmonte në shfarosjen e minjve të arave, helmimet e 7000 nxënësve shqiptarë gati nuk e shqetësuan; në vend që të ndihmonte hapjen e çerdheve për fëmijë e të varfër, lejoi të hapen kampe përqendrimi dhe ligjin ta bëjë pakica në Kosovë, ku, sipas akademikut serb ultranacionalist Jovan Cvijiqit (1910), serbët gjithmonë ishin pakicë, mezi arrinin 5% edhe pse eksodet shqiptare nuk kanë të ndalur.

Për hir të lirisë së individit dhe të popujve, për hir të humanitetit e demokracisë dhe për hir të qetësisë së përbashkët, Evropa duhet të lirohet nga paragjykimet. Njeriun ta ketë dhe ta pranojë si të vetmin koncept të lirisë dhe të mirëqenies njerëzore. Përndryshe, ne po i kthehemi Mesjetës. Arka me plotë koka njerëzish do t'i shohim në ekranet tona edhe në të ardhmen. Umberto Eko ka të drejtë që e

shqetëson bashkëkohësia. Pa kujdesin tonë rrëshqasim nga kohët e errta. Dinjiteti njerëzor është në pyetje, morali.

A do të ketë arka të reja?

Kur ra Iliria, në Letrat e tij të famshme Shën Jeronimi im, pat shënuar edhe këtë: “Gjithkund vetëm pikëllim e tmerr dhe shumë pamje vdekjeje”. Me fqinun tim të urtë, Konstandin Kavafis, megjithatë, duhet të pajtohemi: Ç’do të bëjmë ne pa barbarët?” Do ta kishim mall edhe teatrin e absurdit. Me siguri as ëndrrat nuk do t’i shihnim në kolor.

Hotelin “Marriot” kur e lashë, kisha humbur thellë në natë. Dëgjoja pas një zë të shtjerrur. Në fillim ishte vetëm një. Më vonë u bënë shumë. Më kishte bërë shoshë shurdhima. Ndoshta ma kërkonin edhe kokën time për ndonjë arkë të re. Apo...kush e di?

(Prishtinë, korrik 1993)

*(Kumtesë nga Simpoziumi ndërkombëtar **Përçarjet e Evropës**, mbajtur në Schwalenberg të Gjermanisë, më 2 tetor 1993.)*

FËMIJËT DHE MINISTRAT

Pranë një ngrehine azilantësh, tre voglushë kosovarë kishin zgurdulluar sytë thuaj se donin të më gëllitnin të tërin. Diçka e pabesueshme: para meje qëndronin tre miq të mi të vegjël fytyrëzbehur, me sy të mjegulluar, të cilët i kisha takuar para se të udhëtoja. Çdo ditë shiheshin në oborrin e Shkollës fillore “Hasan Prishtina”, duke luajtur me Petritin tim. E tani? E tani qëndronin nën çatinë e ftohtë gjermane. Djersët e ftohta më kapluan nuk di sa kohë, por shikimi i tyre pikllues gjatë do të më ndjekë në jetën time. Shikimi i tyre ishte një akuzë e rëndë, i cili u përzie edhe nëpër fjalët e Simpoziumit “*Përçarjet e Evropës*”, ku merrnin pjesë emra eminentë të kontinentit tonë dhe ku u fol për çështjen shqiptare më shumë se në shumë simpoziume të mbajtura deri më tani. Në një kohë pis, njeriu ç’mund të bëjë para krijesave të pambrojtura pos të nxjerrë mllëfin nga fundi i vetvetes. Derisa Hansi (H.J.L.) përfundonte përkthimin e një vepre të Trebeshinës, unë kacafytesha me fjalë e dhembje, gërvishitja ndërgjegjien e Evropës së fjetur dhe të shumë intelektualëve shqiptarë që çajxhijaneve tona merren me zënka e me vetveten. Letrat që u dërgova ministrave Klaus Kinkel dhe Alojz Mokut, para se gjithash, duhet t’i lexoni si dhembje të mijëra fëmijëve shqiptarë, që sot treten në labirinthet e Evropës.

JU LUTEM, MBRRONI POPUJT E RREZIKUAR!

Klaus Kinkelit,

Ministër i Punëve të Jashtme të Gjermanisë

I nderuari zoti Ministër,

Shkas u bë prapë një libër që t’ju falënderoj për përpjekjet Tuaja rreth zgjedhjes së çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi. Dardani e

dikurshme, pagëzuar më vonë Kosova, sipas logjikës e zakoneve sllave, ishte element konstituiv i ish-federatës. Por ne shqiptarët edhe pse ishim populli i tretë për nga numri, mbetëm qytetarë të rendit të fundit. Tani Kosova nuk dallon me asgjë nga apartheidi i Afrikës së Jugut.

Që të kthehet paqja jo vetëm në Ballkan, Kosova (Dardania) duhet të jetë neutrale dhe e pavarur – e hapët si për serbët, ashtu edhe shqiptarët, diskriminimi nacional i njerëzve të marrë fund. Përndryshe, zoti Ministër, kam frikë se Evropa e ashtuquajtur demokratike do të sakrifikojë edhe një herë një popull antik për një fis sllav, i cili po shqetëson opinionin botëror me primitivizmin e vet. Kam frikë, zoti Ministër, se Evropa, më në fund, po legjitimon dhunën. Në këtë turp të fundshekullit tonë, sipas të gjitha gjasave, ndikim të dukshëm ka politika dinake franceze dhe ajo angleze. Më shqetësuese po bëhet kjo politikë, se Evropa e ashtuquajtur demokratike më së pakti mendon për rendin e ri – demokracinë dhe lirinë e individit. Evropa e ardhshme, ajo e bashkuara, nëse vazhdon me një politikë të tillë, do të jetë Evropë naziste: Bosnja, Kroacia, Kosova nuk i shqetëson vetëm vrasësit.

Dhunën serbe ne shqiptarët e njohim që nga viti 1878, kur në Kongresin e Berlinit, të mëdhenjtë shpërblyen Pashallëkun e Beogradit me Toplicën e trojet e tjera shqiptare. Diplomacia evropiane, fatkeqësisht, nuk u kënaq me kaq. Në Konferencën e Versajës (1919), të mëdhenjtë prapë shpërblyen Serbinë. Këtë herë duke ia dhënë edhe Kosovën. Nga atëherë trojet tona u ndanë me mure dhe trupi ynë na u shndërrua në një lëkurë leopardi: me plot kufij e varre... Kam frikë, zoti Ministër, se tragjedia jonë do të marrë përmasa të reja dhe nuk do të përfundojë vetëm si tragjedi shqiptare.

Zoti Ministër, ne shqiptarët kurrë nuk ishim as do të jemi kundër popullit serb. Në antikë ishim shtet i fortë dhe etika jonë nuk lejoi të përdornim dhunën ndaj të tjerëve. Për këtë më së miri dëshmojnë trojet tona, që na i gëlltiten fqinjët. Në momentin e pikërishtëm nuk di a mund të pranohet *dhuna* si akt i kryer, nëse Evropa e legjitimon atë. Vrasjet, urrejtjen e elemente të tjera, që nuk përkojnë me norma të qytetërimit, ne nuk i kemi traditë. Po ashtu ne

nuk kërkojmë që t'i ndëshkoni serbët, por t'i lironi nga paranoja dhe krimet e mundshme.

Apeloj në ndërgjegjen Tuaj dhe në shpirtin fisnik të popullit Tuaj – që gëzimi dhe qetësia të kthehen edhe në vatrat tona dhe me serbët të mbesim *vetëm* fqinjë të mirë. Ju lutem, të mbroni të vërtetën, të mbroni popujt dhe kulturat e rrezikuara, se mbroni, para se gjithash, edhe dinjitetin e lirinë e popullit Tuaj!

Më 12.10.1993,

Schwalenberg

me nderime

Ali Podrimja

II. GJENOCIDI KULTUROR MË I RËNDË SE AI FIZIK

Alojz Mokat,

Ministër i Punëve të Jashtme i Austrisë

I nderuari zoti Ministër,

T'i shkruash një personaliteti çfarë jeni Ju, njeriu e ka vështirë. Nuk di nga t'ia nis, çfarë fjalësh të zgjedhë. Nuk di, sidomos, në momentin e pikërishtëm të të ashtuquajturës Evropë demokratike kur *dhuna* po bëhet *ligj*. Do të thotë, kur popujt duhet të mësohen me dhunë dhe t'i binden asaj dhe vetëm asaj. Ky është humor i zi, zoti Ministër. Fundshekulli ynë po nxit nacionalizmat dhe se Evropa shkon nga bashkimi, është iluzion i bukur. Trimërimi i nacionalizmit serb, trimëroi nacionalizmin rus. Por, Evropa ç'do të bëjë, zoti Ministër, nëse kthehen prapë ekstremistët rusë? Fajtorë me siguri nuk do të jenë të rinjtë shqiptarë, që të parët në Evropën e Lindjes filluan rrënimin e diktaturës; fajtorë do të jetë politika e mjerë evropiane, e cila lejoi dhunën dhe konceptin e lirisë e përkufizoi: *vetëm të bash je i lirë* (!)... Varrë të reja mund të ketë dhe popuj e kultura të zhdukura. Unë kam frikë nga kasaphanet dhe bodrumet mesjetare...

Zoti Ministër, fjalën *liri* nuk dua ta gëzoj vetëm unë, as nuk e pranoj që fqinji im të heqë shpirt në litar. Do të isha një krijesë monstruoze po qe se fqinjit tim ia mohoj ekzistencës, identitetin, mirëqenien. Por politika neofashiste e Millosheviqit, me një logjikë të kasapit nuk mund të pranohet edhe pse Evropa bën sehir para saj.

Turp është për demokracinë evropiane që në fund të shek. XX, diku në Evropë, më konkretisht në Kosovë (Dardani është quajtur para ardhjes së sllavëve) të ndiqen fëmijët, të helmohen, të vriten; të mbyllen shkollat e institucionet e kulturës; të shuhen me dhunë mjetet e informimit e shtëpitë botuese, të mos kesh ku të shërohesh; nga xhepi i të papunëve të plaçkitet edhe paraja e fundit, ndonjëri edhe të vritet para familjes... Derisa fëmijët serbë dhe të Evropës mësimet i ndjekin përmes kompjuterëve dhe bëjnë gara me aparate të reja e më

të reja, fëmijët shqiptarë – të uritur, të leckosur, të sëmurë zbresin nëpër bodrumet e shtëpive private si në *Ferrin* e Dante Aligerit dhe, nën kujdesin e automatikëve të policisë serbe, përcjellin mësimet në mënyrë më primitive. Voccrakët dhe mësuesit e bëjnë këtë se duan ta ruajnë identitetin e tyre kombëtar dhe të jenë dinjitozë edhe para dhunës, me mjerimin e tyre nuk pranojnë t'u shkaktojnë asnjë të keqe mocanikëve të tyre serbë.

Pse ndodh kjo, zoti Ministër? Ndodh vetëm pse janë shqiptarë. Falënderoj punën Tuaj të çmuar që bëni për çështjen shqiptare, Falënderoj edhe Evropën Demokratike, por kam frikë, zoti Ministër, se në shekullin e ri Evropa do të hyjë në petkun e Mesjetës... Dhe, kur ta kujtoni Kosovën (Dardaninë) dhe fëmijët shqiptarë, ju lutemi t'i kujtoni nganjëherë edhe Karl von Gëgen, Aleksandër Moisiun... Shumë talentë të tillë dhuna serbe po i shuan në Kosovë. Ky gjenocid kulturor, që është më i rëndë se ai fizik, nuk bën të jetë vetëm shqetësim shqiptar. Për shkak të një politike joefikase të Evropës, një popull antik u deshka të vdesë siç po vdes edhe Bosnja!

Edhe një herë ju falënderoj për kujdesin Tuaj.

Më 12.10.1993

me nderime

Schwalenberg

Ali Podrimja

P.S.

Dhe derisa i shkruaja letrat, lajme të zeza informonin masmediumet evropiane për atë që ndodhte diku në Ballkanin e mallkuar dhe fytyrat e miqve të mi të vegjël vijëzoheshin rëndë në xhamin e errët të dritares sime...

Minjtë kushedi se deri ku e kishin bartur kokën e Luanit atje në Kosovë.

DEMAÇI DHE REZISTENCA PAQËSORE SHQIPTARE

Është thënë! Demaçi figurë poliedrike. U paraqit në vitet '50. Udhë e tij nis nga krijuesi i mirëfilltë deri te disidenti i pakompromis. Kur flitet për të, flitet edhe për rezistencën shqiptare, e cila nga miopia serbomadhe dhe interpretohet si lëvizje nacionaliste. Në të vërtetë, lirinë e fjalës, të mendimit dhe të individit, politika serbe nuk mund e pranoi si të drejtë njerëzore edhe për shqiptarët. Prandaj terrori dhe ndëshkimet janë drakonike. Të shpeshta.

Që në vitet '50 u pa qartë se në qenien shqiptare ishte akumuluar një revoltë gjithëkombëtare. Për shkak të gjendjes së rëndë sociale dhe dhunës çnjerëzore, me mijëra familje linin trojet dhe merrnin udhën e kurbetit. E njëjta tragedi ndodh edhe tani. Qëllimi është i qartë: Sa më shpejt të përfundojë pastrimi i heshtur etnik i Kosovës. Ndër të parët Demaçi e kishte provuar kamxhikun e kësaj dhune. Pastrimet etnike, që po bëhen shqetësim edhe për Evropën intelektuale, në trojet shqiptare kishin filluar shumë më herët se në Bosnjë e Kroaci. Por regjimi totalitar serb, me një mjeshtëri të rrallë, i kishte fshehur para opinionit botëror, megjithëse reagimet e Demaçit dhe të intelektualëve të tjerë ishin të hapta e të ashpra.

Mirëpo turpi nacional serb nuk mbeti pa u dëshmuar edhe nga vetë shkencëtarët serbë. Dr. Milan Obradović, fëmijë kolonisti, në doktoranturën e vet për reformat agrare të paraluftës në Kosovë, thekson se në mes dy luftërave botërore, padrejtësitë sociale-kombëtare nga Kosova kishin larguar 255.878 shqiptarë. As pas të ashtuquajturës Luftë Nacionalçlirimtare ato nuk u ndalën. Në ditën e sotme pastrimet kanë marrë përmasa alarmuese. E përditshmja e Beogradit "Borba" në muajin korrik të këtij viti, sjell shënimet zyrtare serbe se Kosovën vetëm viteve të fundit e kanë lëshuar afro një gjysmë milioni shqiptarë. Pse ndodh kjo? Së pari, shqiptarët nuk i mbron ligji dhe së dyti, ata nuk

kanë kujt t'i ankohen. Kështu, një popull të lashtë, me një kulturë e histori të veçantë, po e kërcënon edhe zhdukja fizike.

Shkaktar për një albanofobi kaq të rëndë është pa dyshim pseudoshkenca serbe, e cila vazhdimisht mbolli farën e urrejtjes në mes dy fqinjëve shekullorë. Vaso Çubrilloviqi deri te novelisti Ivo Andriq, pa e nënçmuar veprimtarinë e tij letrare, u bënë lektyrë e përditshmërisë serbe. Në të vërtetë, glorifikimet dhe mitomania tek serbët, në mënyrë të pavetëdijshme, kërcënon edhe qetësinë e qenien serbe. Shqiptarët, sipas mendjes së tyre, na qenkan fatkeqësia në Ballkan dhe si të tillë duhet përzënë edhe nga jeta. Paranoja serbe, që u ngrit rreth çështjes shqiptare, duhet të lexohet, para se gjithash, edhe si frikë serbe: Në rajon arriti barazimi i popujve. As grekëve as serbëve shqiptarët nuk u dalin sa dëshirojnë ata, ndërkaq dominimi ortodoks, e sidomos ai sllav nisi të bjerë dukshëm, me të edhe ëndrra serbe për të dalë në ujëra të nxehta të Detit Adriatik.

Në vitin 1981 demonstratat e studentëve të Kosovës ishin marshime të përgjakshme dhe ndër të parat që paralajmëronin se në kështjellën e diktaturës ndodhnin gjërat më makabre. Shembja e komunizmit për zyrtarët serbë ishte e tmerrshme. Hapeshin probleme të reja dhe fillonin kalkulimet. Pos opozitës sllovene, në ish-Jugosllavi, kërkesat paqësore të studentëve nuk i përkrahu askush. Me lëvizjet shqiptare dhe trandjet e diktaturës, inteligjencia sllovene e shihte veten më afër Evropës.

Ndërkaq, zyrtarët e Beogradit nxitonin t'i shpallnin demonstratat lëvizje nacionaliste, që mund ta kërcënonin edhe rahatën e vetë Evropës. Diç tjetër ishte e vërteta: protestat ishin drejtuar kundër shfaqjes së apartheidit që po lindte mu në Evropë, pra kundër getoizmit, izolimit të tmerrshëm shqiptar nga diktatura pansllave. Ç'ndodhi pastaj, e di çdo njeri i arsyeshëm: terrori serb rrënoi çdo gjë shqiptare – nga mbyllja e institucioneve deri tek e drejta për të jetuar. Në Kosovë filloi jeta e standardeve të dyfishta; ndoshta edhe ilegale. Absurdi serb na u bë përditshmëri. Shqiptarët sot janë i vetmi popull që nuk kanë të drejtë të kultivojnë as të mbrojnë identitetin kombëtar. Në ish-Jugosllavi, edhe pse ishin populli gati dominues ata mbetën të nënçmuar dhe qytetarë të

rendit të fundit. Ky nuk është turp vetëm për politikën zyrtare serbe. Kosova po shndërrohet në një njollë të errët të demokracisë evropiane.

Dalja e Demaçit nga burgu u prit me kërshtëri të veçantë edhe nga zyrtarët e Beogradit. Pas 28 vjet vuajtjeje nëpër kazmatet e diktaturës lirohej një krijues, i cili nocionin liri e kuptoi si të drejtë njerëzore dhe ekzistenciale jo vetëm për popullin e vet. Demaçi që në vitet '50, në romanin “Gjarprinjtë e gjakut” me moto: *Jo atyre që ngrehin gishtin e kerimit, por atyre që shtrijnë dorën e pajtimit* shihet qartë mesazhi se shkrimtari ynë ishte përcaktuar për një udhë të mundimshme, por dinjitoze: larg forcës. Apeli kundër gjakderdhjes dhe pajtimit që ofronte ai, mund të kapet edhe nga këndi i të sotmes, i pajtimit gjithënjëzësor dhe të lexohet si metaforë universale: të ketë sa më pak gjak e varre... Pra, një gjest të një humanisti e intelektualit shqiptar, fatkeqësisht, politika miope serbe e kuptoi në mënyrën serbe.

Pak ka nga intelektualët serbë, që e kanë të qartë se shqiptarët nuk dëshirojnë të luajnë në letren e nacionalizmit serb jo pse frikësohen, por rreth autoktonisë dhe të drejtës historike-shqiptarët nuk vuajnë nga ndjenja e kompleksit, janë autoktonë. Pra shqiptarët nuk zbriten nga Karpatet, as fqinjëve të vet kurrë nuk ua bënë një të keqe. Çjerrjet e nacionalizmit serb se Kosova na qenka djep i serbizimit, sa vijnë e bëhen jobindëse: Së pari, Beteja e Kosovës ishte betejë e të gjithë ballkanasve (Josef von Hamer) jo vetëm luftë e Car Lazarit. Aty ka mund të vritet edhe njëri nga katër prijësit shqiptarë, pra edhe babai i Skënderbeut. Së dyti, Car Dushani, nëse mbretërinë e vet kishte shtrirë thellë në trojet shqiptare, nuk do të thotë se populli serb na është pronari i atyre trojeve. *Dardania* e dikurshme ilire, pagëzuar më vonë Kosovë, nuk ishte një vakuum hapësinor. Aty dikush kishte ekzistuar para serbëve dhe së treti - serbët e mençëm e dinë se në Konferencën e Versajës (1919) Serbisë ia kishin dhuruar Kosovën Fuqitë e Mëdha se e vërteta historike mbi të cilën është ngritur edhe iluzioni serb për Kosovën, nuk qëndron në anën e tyre.

Krerët serbë pse kanë zjarmi dhe pse nuk e pranojnë dialogun me shqiptarët? Këtë nuk e bëjnë vetëm nga megalomania e tyre, por për arsye: Se shqiptarët assesi nuk e pranojnë luftën. Etika jonë nuk e lejon dhunën. Këtë e kishte paralajmëruar Demaçi që në vitet '50 të shek.

XX. Po ashtu, vrasjet, pastrimet etnike, dhunimet, plaçkitjet, rrënimet e kulturave – shqiptarët i konsiderojnë veti të një populli të pacivilizuar dhe frikacak. Tek ne thonë: vetëm frikacaku vret.

Përkundër thellimit të hasmërive në mes dy fqinjëve shekullorë, shqiptarët megjithatë mbetën më tolerantë se serbët. Motoja në romanin “Gjarpinjtë e gjakut” nuk ishte apel vetëm për shqiptarët, por edhe për kokat e ndezura të të tjerëve, pra edhe për ato serbe – gjak e varre të ketë sa më pak. Shtrohet çështja e dialogut jo vetëm brenda kombit.

Zgjidhja e mundshme dhe e vetme – shqiptarët dhe serbët të mbesin fqinjë të mirë, qetësia e gëzimi të kthehet edhe në vatra të tyre, është pavarësia dhe neutraliteti i Kosovës – e hapët për shqiptarët dhe për serbët. Evropa politike këtë duhet ta shikojë si realitet dhe të përkrahë të drejtën e vetëvendosjes. Por tmerron pasiviteti dhe qetësia e saj. Ballkani po shndërrohet në një varr të gjall. Njeriu aty gati nuk ka asnjë vlerë: vritet si qen. Mjafton të ndizni TV e të merrni pjesë në teatrin e absurdit të quajtur Bosnjë, Kroaci apo Kosovë.

Duke mbyllur këtë tekst të rastit për mandelën e Evropës, në këtë tempull të librit dhe urtisë njerëzore, apeloj në lirinë e Kosovës, por edhe të fqinjëve të mi shekullorë, pra edhe për lirinë e serbëve nga krimet e mundshme dhe paranoja.

(Në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Frankfurt më 9 tetor 1993 në orën 11, në Holin nr. 111, në Qendrën informative, ku merrnin pjesë një numër gazetarësh dhe vizitorësh, u mbajt Tryeza rreth personalitetit të fituesit të Çmimit “Sabarov” dhe Çmimit të Rektorëve të Universiteteve të Evropës, që iu dha Adem Demaçit dhe ku pritej pjesëmarrja e tij. Me atë rast folën: Klaus Hensel nga Frankfurti, Ludwig Hartinger nga Salzburgu, Dr. Ardian Klosi nga Tirana dhe Ali Podrimja).

JETA NËPËR GRACKA

E kisha shpallur mendim marroç një konstatim të një miku, i cili ma thotë qe tri dekada: *Ne të gjithë jemi ngapak të përhyer*. Këtë që e thotë ai, e ilustron me shumë fakte, të cilat unë bëj çmos t'ia shkul nga mendja. Secili njeri a popull, i thashë një ditë, në horizontin e vet ka disa maja të cilat e tërheqin përpara, ose për të cilat kombi lidh fatin, idealin. Si zakonisht miku i bie tavolinës me forcë kur dëgjon argumentet e mia. Tërë vrer brof në këmbë. Murmuron diç nëpër dhëmbë dhe ik vrap. Me ditë nuk shihemi...

Në një kafene të mjerimit tonë tipik aparteidik, një mëngjes derisa rrija kallj vetëm dhe me një sy kritik shikoja atë ç'ndodh me ne, ia behu miku im me një grumbull gazetash nën sjetull, të cilat me një buzëqeshje të hidhur m'i hodhi mbi tavolinë. Më vonë kuptova se ku e kishte kapur dhembja. Në këto ditë të nxehta, plot varfëri shpirtërore e ndjekjeje policore, rrahje e burgime të reja, polemika ndërmjet historianëve tanë rreth të kaluarës së shkrimtarit të nderuar *Hivzi Sulejmani*, m'u duk pak e tepërt dhe një gacë në turrën e fjalëve tona. Në çdo vagë ta peshoja, disi ajo forconte konstatimin e mikut tim, të cilin e konsideroja për mendim marroç.

Me shkrimtarin tonë kisha pirë ca kafe atje në shtëpinë e tij në Grykë të Gërmisë. Kishim ndërruar fjalë e fjalë rreth asaj që krijohet tek ne, por edhe për shkaqet e eksodeve tona gjatë viteve 1955 për në Anadoll. Nëpër fjalët e lëvizjet e tij, asnjëherë nuk kisha hetuar një shenjë dyshimi as nuk mund ta merrja me mend në një dritë tjetër, siç kanë zënë ta shohin pseudohistorianët. Ai ishte prej atyre majave që ne të rinjtë synonim të hipnim.

Prapë i thashë mikut: Hivziun nuk mund e shoh jashtë kornizave të ekzistencës sonë: Çdo veprim të Hivziut e shoh në kontekstin kohor-historik. Kur nguli këmbë në këtë, më

parafytyrohen personazhet e tregimeve të tij, fjalët plot miradi për të që kisha dëgjuar nga miqtë më të ngushtë të tij.

Biseda me të nuk kishte shtrirje vetëm horizontale; kishim pasur zënka, njëherë edhe rreth “*Vox clamantis in deserto*” (Zëri i të vetmuarve në shkretëtirë). Artikulli ky që kishte prishur rahatën e mjedisit tonë mediokër dhe që ishte shkruar në fillim të viteve shtatëdhjeta nga një grup krijuesish, që e kishin veneruar ikonografinë e realizimit socialist në letrat shqipe.

Po ashtu “Voxi” nuk ishte as pro integriteteve jugosllave (!) as kundër integritetit shqiptar, ishte për vlerë dhe nuk pranonte vepra apologjike për sistemin, që ishte një hata në të dy anët e Murit. “Voxi” ishte një tekst thjeshtë nacionalist, jo i shkruar nga nacionalistët e verbër; një proces që duhej të ndodhte herdokur... Ishte guxim edhe qytetari. Pa pardon.

Dhe për çudi të zotit, artikulli ishte kundërshtuar gati nga tërë inteligjencia, esnafit krijues e deri te udbashët më famëkeq. Ishte hera e parë që kisha vërejtur se *ideologjia* është gjë e tmerrshme kur bashkohen *topuzi* dhe *mendja*. Ishin anatemuar nënshkruarit dhe shpallur armiq jo vetëm të popullit shqiptar. Shumë nga ata “trima” gjenden tani nëpër partitë tona dhe kur i dëgjoj duke mbrojtur lirinë e krijuesit-individit, më rrëshqet buza në gaz. Pa dashje e zura ngoje këtë se për herë të parë kisha ndërë dhembje edhe për Hivziun, i cili me qëndrimin e tij binte ndesh me atë që thuhej në artikullin e guximtarëve të paktë në mes të lukunisë së tmerrshme.

E shikoj mikun. Ai fillon të qajë. Pëshpërit emrat: Ilir, Alban, Shqipe. E di pse e bën këtë. Me dy gishtërinjtë lart ngritet, duke e dridhur nga maja e këmbës deri te thembra. I mbledh gazetën dhe i fut në shportën e parë të kthesës së parë të Rrugës Mendermethënë.

Çu desh të merremi me Hivziun, Xheladinin kur litari i robërisë gati na ka këputur qafën dhe nga dita më ditë po i ngjajmë asaj *Kumrisë* së dibranit tim? Të pakta na ishin rasti i Fishtës, i Faikut, i Skiros dhe tani kërkojmë raste të reja. Apo duam të dëshmojmë për të satën herë se ne kur kemi kaçik të rrokemi me të tjerët, merremi me vetveten se

kush është më... Krijojmë raste kaotike që mund të lexohen jo vetëm nga ne si intrigë, si bajraktarllëk, si luftë nahish. Ku ta di unë.

Shtrohet pyetja: Tregimet “Re e mllëfur”, “Hijet në kuvertë”, “Miku im Xho” e ca të tjera, t’i lexoj prapë si konflikt në mes individit dhe shoqërisë totalitare, apo si konflikt me vetveten, brenda vetvetes, me ndërjegjen e individit, konkretisht të shkrimtarit?

Është mirë të gjendet *çelësi*. Brendajashtë të hapen gjërat. Por më burrëri është t’i gjendet vendi secilit guri në *Kullë*. Thashethemat kur dëgjoj jo vetëm për Hivziun, më bëhet se minjtë kanë filluar të na hyjnë edhe nëpër baxhën e oxhakut. Ik në qoshkun tim dhe pres kur do të pikë aty ndonjë mullacak. Dikur kërkoj Erza Paundin, poetin më enigmatik amerikan. U deshën forca të mëdha ushtarake ta bartnin atë në kafaz nga Italia deri në Amerikë dhe t’ia falin të gjitha mëkatet, edhe për lavdimin e fashizmit të Musolinit që kishte bërë ai. Kështu, Paundi fashist e kaloi Atlantikun në kafaz pa një therrë në këmbë. Gati i njëjti fat e ndoq edhe Borhesin kur mori anën e Pinoçetit. Pse vepruan kështu, nuk na intereson në këtë moment. Por të dy shembujt ilustrjnë një të vërtetë se popujt që dinë të vlerësojnë dinë edhe të falin. Ndërkaq, me të vegjlit ndodh diç krejt tjetër, duan të jenë ekzemplarë të pastërtisë, të racës. Në të vërtetë ata kultivojnë vetëm ndjenjën e vogëlsisë; secili e sheh veten në *Majë*, edhe pse nuk e ka vendin. Por për t’u ngjitur në *Majë* nuk duhen bërërryat, të rrënosh as të shkelësh nëpër kufoma. Disi na është bërë shkollë ndëshkimi i vetvetes dhe interesin vetjak e vemi para atij kombëtar. Më së miri këtë e dëshmon situata ku po përbirohemi.

Hivziu nuk ishte i vetmi shqiptar që ishte mashtruar nga premtimet e njëfarë vëllazërim-bashkimi, as unë nuk jam i pari poet shqiptar që shkarazi kam thurur ca vargje për Titon. Idealizmi, besimi në sistemin e ri, se pas LNÇ-së shqiptarët do t’i kenë të gjitha, bile-bile do të kenë më shumë se kanë pasur ndonjëherë, me siguri ka hamendur edhe Hivziun kur ka qitur nënshkrimin në aktakuzë ndaj anëtarëve të NDSH-së.

Se aktakuza ishte qëndrim nga lart, në një farë mënyre, na bind edhe Mulla Maliq Bali Gashi, anëtar i NDSH-së (Fjala, nr. 6, qershor,

1994), i cili, në mes të tjerash, shton se Hivziu “vazhdimisht i fshinte ndjersët me shami dhe fliste rrallë”. Shenjë kjo se Hivziu nuk është pajtuar intimisht me atë që është komunikuar. Tekefundit, edhe trimi mund të ketë çaste ligësie. Finalja e një jete është mbyllja e një udhëtimi. A ju kujtohet Moisi Golemi? Pse, pra, ta traumatizojmë vetveten dhe të harrojmë gjëra më kapitale për të cilat duhet shurdhuar Evropën? T’i lëmë të qetë Hivziun e të tjerët. Asgjë më nuk na pengojnë.

Sintagma njeri i revoltuar (Kamy), nuk di sa vlen më për një mjedis në shthurje e sipër. Dhe konstatimin e mikut tim, që e kisha shpallur për mendim marroç, do i shtoja edhe një plotësim: Ne jemi popull adapt. Mu për këtë jemi ku gjendemi tani: pa atdhe e liri. Kësaj disi nuk i vjen era pastërti. Ka të drejtë miku im që thotë: Ne të gjithë jemi ngapak të përlyer.

SHQIPTARËT NË MOZAIKUN EUROPIAN

Vetë fakti që u bë fjalë në Arne rreth njohjes së popujve dhe kulturave të mëdha e të vogla, siç është i mendimit edhe Umberto Eko, do të thotë Evropa formon mozaikun e vet kulturor. Shënimi i tij trimëron se aty u fol edhe për përkthimin e letërsisë shqipe, si dhe përkthimin e letërsive të tjera në gjuhën shqipe. Në momentin e tashëm, kjo do të thotë mirënjohje për gjeniun tonë krijues. 1) Evropa ka zënë të sensibilizohet rreth çështjes shqiptare. Dhe kjo nuk bëhet vetëm përmes politikës. 2) Gjuha shqipe as vlerat tona nuk janë më pengesë për të dalë në Evropë dhe 3) Mjediset intelektuale kanë njohuri për atë që krijohet në hapësirën gjithëshqiptare. Gjuha dhe historia jonë, po ashtu, në disa universitete të Evropës mësohet nga një numër i konsiderueshëm të interesuarësh.

Shënimi i Umberto Ekos, në një farë mënyrë, ma kujton kolosin frëng Lamartinin dhe mendimin e tij për “Këngët e Milosaos” të De Radës, i cili po të kishte gjetur mbështetje qysh në vitin 1834, një fat të mirë do të kishte çështja dhe kultura jonë. Lamartini ishte mahnitur me verbin poetik të plakut të Kalabrisë, por fjalët e frëngut të urtë kishin shkuar huq. Evropa dinte pak për historinë e gjuhën shqipe: në mënyrë fragmentare ose mbrapsht na shikonin. Se në tryezë kishte Evropa atë që ia servonin fqinjët tanë grabitës, ose ndonjë entuziast i rrallë rreth çështjes shqiptare, i cili kishte pasur guxim të zdirgjet deri në “Vilajetin e errët”.

Fati i gjuhës së vogël

Në kohën kur “Këngët e Milosaos” bënin jetën e tyre, në një cep të shkurrës ruse fillonte “Evgjeni Onegin” i Pushkinit, i cili reklamohej si poet i ardhshëm i Ruisë (Derzhavini). E ndaj mendimin

se poema jonë në çdo pikëpamje qëndron më lart se poema ruse. Por fati ishte në anën e Pushkinit. Evropën e atëhershme e pushtoi mu për shkak se vinte nga një popull e gjuhë e madhe. Fati i gjuhës së vogël dhe e shtrembërimit të vërtetës për ne deri vonë ndoq shumë vepra tona madhore.

Qëndrimi i Umberto Ekos nuk bën të na çudisë. Shpirti krijues dhe dinjiteti ynë filloi të çelë udhë qysh heret. Më heret, ndoshta, seç flitet. Evropizimi ynë, pra, nuk ka datë të re. Paraqitja e Kadaresë paralajmëron marshimin e gjenit shqiptar; ngjiten shkallëve të lavdisë nga një vend i lashtë, ku gjuha, historia e dinjitetit njerëzor kanë rrënjë mitike. Shfaqja e Kadaresë nuk është as i rastit. Udhë e gjenit ishte përgatitur. Në një shkrim të vetin e kishte sinjalizuar këtë Ernest Koliqi.

Këtë që e shënon Umberto Eko, ka edhe njohuri të tjera. Domeniko Mauri deri vonë merrej si njohës i madh i veprës së Aligerit. Dhe shumë arbëreshë të tjerë bënë emër edhe në kulturën italiane. Ndaj punës dhe pranisë së bashkatdhetarëve të vet, arbëreshëve tanë, Eko nuk mund të rrijë indiferent. Gjallërimi i arbëreshëve, atje poshtë në Kalabri, nëpër tokat më shterpe, është më se i dhimbshëm jo vetëm i kombit tonë.

Nëpër librat tonë historikë e shkollorë arbëreshët i konsiderojmë dhe vazhdojmë t'i konsiderojmë si ruajtës dinjitozë të zakoneve, kangjelave, legjendave, fjalëve të rralla shqipe, por edhe poetë të një peizazhi karakteristik që u inkuadrua në hartën gjeopoetike shqiptare. Tradita e shkrimit shqip vazhdon edhe sot. Çilet hulli i suksesshëm edhe në fushën e romanit. Karmine Abate me romanin "*Shtegtimi i valles*" nuk mahniti vetëm lexuesin italian. Ai tërhoq vëmendjen edhe të qarqeve arbëreshe atje në një vis të harruar nga e drejta njerëzore. Krahas Abates ecën edhe Konstatin Marko me romanin "*Pasqyra e djallit*", i cili u nderua edhe me një shpërblim të lartë italian. Eko, me siguri, i ka kapur mesazhet jo vetëm të romaneve në fjalë.

Metropolet dhe provincializmi

Ajo që u zu ngojë për letërsinë shqiptare në Arne, gati kudo flitet në metropolet e Evropës. Por për depërtimin tonë (të Kosovës) mbetet për t'u bërë edhe më shumë. Para së gjithash, organizimi ynë i brendshëm është katastrofal. Moduset bolshevike ende ndrydhin. Vlerat shpirtërore reklamohen si në kohën e Lidhjes Socialiste: Ai që ishte në kolltuk ishte edhe shkrimtari më i madh. Harrohet se kolltuku është i shijshëm më tepër për dështakë. Mashtrohemi, pra, nëse mendojmë se të huajt nuk dinë të na lexojnë as të na çmojnë. Logjika jonë farefisnore: Kombëtare është vetëm ajo që shikohet nga qyshku i fisit apo i nahisë sime, tregon injorancën tonë, primitivizmin. Copëzimi ynë shpirtëror lë përshtypje të keqe tek ata që duan të na nxjerrin nga pusi dhe inkurajon ata që na shtrengojnë lakun rreth qafe. Liri nuk mund të quhet vetëm nëse unë ha dhe pika rrjedh si duhet nga çatia ime. Përkrah çështjen kombëtare. Kjo është detyrë e shenjtë e secilit intelektual e qytetar. Por jam kundër atyre që patriotizmin e shndërrojnë në *monedhë*. Nga *unë* prej *unë* rrënojnë ngapak *Murin* dhe ëndërroj shtrirjen e rritjen normale jo vetëm timen. E ndiej të nevojshme gjërat t'i shikoj nga këndi tjetër. Kamy thoshte: Pakënaqësia shpie përpara.

Në Greqi kisha udhëtuar shpesh. Por udhëtimin e vitit 1986 nuk do ta harroj kurrë. Jetoja me peizazhin e shqiptarëve të Epirit. Ndieja se nga dheu shpërthente zëri pagan i të parëve të Marko Boçarit dhe të trimave të tjerë. Ai udhëtim ma kujtonte vrapin e Anton Bellushit, vëllait tim arbëresh, i cili çdo vit zbret nga Kalabria deri atje poshtë në More, kërkon fshatin e vet të lënë para plot pesëqind vjetësh. Gjatë atij udhëtimi shkrova një cikël poezish. Dëshiroja t'i marr me vete në Kosovë imazhet që i gëlltiste tmëri bizantin.

Pas disa vjetësh bisedoja me një mik nga metropola. Dhe parandjeja se Kosova kishte filluar t'i ngjajë ngapak Çamërisë dhe, në një farë mënyre, unë isha një çam. Tragjedia e Janinës, e Konicës, e Pargës, e Prevezës, e Artës, dhe e shumë lokaliteteve të tjera arvanite

m'i kujtonin lemeritë e njerëzve në Drenicë, Dukagjin, Llap, Grykë të Kaçanikut, të Zallit të Pejës, majave të Sharrit të Pashtrikut. Por miku im, që pinte *korni* ballë meje, prapë përsëriste: Çdo gjë është në rregull. Por tek ne nuk përkthehet poezia me shpjegime për çdo toponim, ngjarje e nocion nacional. Nuk është traditë të përcillet poezia me fusnotë. Dhe theksonte: Shumëçka që tek ju çmohet, nuk do të thotë se edhe tek ne duhet të shikohet me syrin tuaj. Shikoni, p.sh., problemi i fshatit. Në mes fshatit e qytetit nuk ekziston në Evropë gati asnjë dallim dhe nuk dimë se ku fillojnë kufijtë në mes rurales dhe urbanes e lëre më të botëkuptimit. Në fjalorin tonë nuk ekziston fjala *Atdhe, Mëmëdhe*. Për këtë emërtim ekziston një ekvivalent tjetër. Nëse tek ju, vazhdonte miku nga metropola, fjalët: *lis, djep, labutë, vek, çifteli, plis* e ca të tjera kanë kuptim të parë, tek ne mund të jenë vetëm fjalë të zakonshme, dekorative. Përkthyesi kërkon ato fije shpirti që mund të vazhdojnë jetën edhe në shpirtin e një populli tjetër. Pështjellimi pra, qëndron mu në tekst. Miku kishte edhe vërejtje të tjera.

Korbat e qiellit ballkanik

Por unë ndjeja se metropolet e Evropës shndërroheshin në lagje të fjalës e kulturës shqiptare me një qiell pakë blu të Ballkanit në të cilin fluturon edhe ndonjë korb. Dhe evropëizmi ynë që kishte filluar, ndoshta që në vitin 1504, me botimin e parë të “Historisë së Skënderbeut” të Barletit, shënon edhe udhën e mundimshme të gjeniut shqiptar që ia caktoi fati.

Mozaiku kulturor evropian pa nishanin tonë do të dukej pakëz më i varfër. Këtë si duket e veneroi edhe Umberto Eko.

DALJA NGA HARRESA

Ikën koha e nuk mund të lirohesh nga mbresat: Plot katër orë defiloi Shqipëria në TV gjerman (nga ora 20 e 40 deri në 24 e 40 minuta të një qershorit 1995). Kanali ARTE i Bajernit u mundësoi shikuesve një sheti jo aq të këndëshme në dheun e shqipeve. Ndodhte kjo në momentin kur në TV gjerman dëgjon shpesh edhe fjalë të rënda për mafinë shqiptare. Në spikamë ishte rruga e vështirë e një populli. Nga lashtësia ilire deri tek trokitjet e tij në dyert e rënda të një Evrope të ëndërruar, më humane.

Pa marrë parasysh, që emisioni ishte tepër i zymtë, kishte shumë pamje rrënjëthënëse; diç që e lidhin shikuesin me absurdin: Se paska ndodhur, ose po ndodhkan gjëra të tilla diku edhe në Evropë. Çdo gjë përcillej me një tekst të prerë. Konkludimi mbetet: Udhëtimi i Shqipërisë në Evropë nuk është i lehtë. Rruga jonë vendimtare tek fillon. Problem kyç: Dalja jonë nga harresa e plotë e botës, pra edhe gjermane...

Nuk i shpëtonte asgjë syrit të kamerës, ishte dashuruar në pamje rrënjëthënëse, morbide. Kishe përshtypjen se jeton në një kohë tjetër, e cila moti ka perënduar; ose lexon një vepër të Dikensit. Dhe, nuk mund të mos i shtrosh vetes pyetjen: Për mirëqenien kombëtare, ç'paska bërë shteti monist shqiptar? Me mbylljen në një dogmë pansllave dhe hapjen e burgjeve e të kampeve, mos është menduar se populli shqiptar shkonte në parajsë? A është e mundur një popull i lashtë, me një traditë bukur të lakmueshme të sillet në një situatë gati turpëruese: duke ia thyer kurrizin e dinjitetin, duke ia shpërlarë trurin gati nga çdo gjë nacionale! Harroji, lexues i dashur, një plejadë të tërë krijuesish, mendimtarësh; harroji..., por a harrohen pjesët e trupit që dalëngadalë i fsheh therra e huaj? Nënteksti lehtë mund të kapet. Për të shpëtuar nga një situatë më e rëndë sociale-politike dhe për të mbajtur gjallë kodin tonë etik, përmes të të cilit na njihnin të tjerët si

komb krenar, lypset punë e madhe në të gjitha fushat dhe jo vetëm nga shteti shqiptar e inteligjenca.

Omnibusi TV, i sajuar nga ca reportazhe, që ishin dhënë edhe më parë në TV gjerman, kishte tani tërësinë dhe fliste me një gjuhë filmike mjaft të qartë. Peter Duzdak, korrespondent i ARD-it, i kishte përcaktuar vetes një detyrë tejet të vështirë: *E vërteta për Shqipërinë nuk bën të fshehet...* Pra, edhe lëvizja e kamerës i ngjante një skalpi, i cili në mënyrë të çuditshme hapte plagët shqiptare – përmes bisedave të ndryshme apo filmimit të pamjeve tronditëse. Ndërkaq, shkrimtari dhe gazetari Rikard Shnajder, për tragjedinë shqiptare fajësonte, posaçërisht, *Kongresin e Berlinit* (1878), ku kishte marrë tatëpjetën etniteti ynë dhe kur në momentin vendimtar të shturjeve të mëdha në Ballkan, Bizmarku nuk kishte pasur njohuri të mjaftueshme për shqiptarët, prandaj kishte ndodhur ajo që dihet: copëtimi i trojeve shqiptare.

Unë nuk kam hyrë në arkivat gjermane dhe nuk di se ç’fshihet në to për kohën më tragjike shqiptare, por nuk mund të mos i besohet zotit Shnajder që në mënyrë mjaft implicite bënte fjalë për historinë tonë. Ai nuk nguroi të fajësojë baballarët e vet me shpresë se diç e tillë nuk do të ndodhë në të ardhmen. Qëndrimin e zotit Shnajder për Kongresin e Berlinit, dhënë përmes një karikature mjaft simbolike për marrëzinë e tragjedinë, që kishte ndodhur në të kaluarën e që në groplan e mbajti për pak kohë edhe kamera, ndryshe mund ta kuptojnë të tjerët, ndoshta edhe si një truk, por unë e lexoja si shfajësim, ndjesë...

Në Shqipëri sa vjen e *hakmarrja* bëhet dukuri tmerrues. Në zonat veriore, pra dhe në Shkodër, numri i gjaqeve është alarmues. Ndodhin këto në një kohë tepër kritike për qenien kombëtare. “Zgjimi” i gjaqeve tregon edhe situatën jo të mirë sociale, por edhe një keqkuptim i lirisë, i kanunit. Në këtë të ligë tonë shpesh pat dorë i huaji, intriga. Të mos na mbështjellë e keqja trupin, nuk bën më vetëm të *konstatohet*. Reporterit i ARTE-s nuk e shënoi këtë vetëm si dukuri, e cila tek të tjerët është harruar. Analitikët e ndryshëm të krimit mund t’i kërkojnë fjetet e këputura shqiptare edhe në mjedise të tjera. Flitet se mafia shqiptare shkel rëndë. Posaçërisht në emisionet e RTL-it paska

pasur edhe stërmadhime, duke cenuar edhe kodin etik shqiptar, por askujt nuk i paska rënë ndërmend të reagojë. Çudi, e kaq shumë shqiptarë bredhin Evropës.

Se ç'ndodh në momentin e pikërishtëm në Shqipëri, pra jo vetëm për ecuritë në politikë, u ballafaquan shkrimtari dhe ambasadori shqiptar në Paris, zoti Besnik Mustafaj dhe Ardian Klosi, profesor në Universitetin e Munitit. Në ca momente dialogu ishte tepër i rëndë, por që lejohet në një shoqëri plurale. Mirëpo kur u bë fjalë për kauzën shqiptare në Jugosllavinë e mbeturinave, të dytët ishin të një mendimi gati: Shqiptarëve në Kosovë dhe në troje të tjera duhen t'u njihen të drejtat e marra me dhunë dhe t'u lejohet vetëvendosja.

Rropatesha ende me mbresat e emisionit televiziv gjerman kur u gjeta në Parkun Kombëtar Gjerman në Bon. Duke bredhur nëpër të, e pashë qartë se çdo të thotë të jesh popull i madh e i fortë. Por nuk mund të pajtohesh me vetveten se nënat shqiptare lindin fëmijë vetëm për Kosovën. Prania e asimilimit, ose integrimi i shqiptarëve në një shoqëri të re, është i dukshëm. Gjeneratat e reja kanë filluar të belbëzojnë gjuhën shqipe dhe shumë pak të kujtohen se nga kanë ardhur.

Më 13 qershor, pikërisht në orën katërmëdhjetë hyra me mikun në Presse Hausse (në Shtëpinë e Shtypit Gjerman). Në orën e caktuar do të paraqitej zoti Dr. Klaus Kinkel. Biseda me gazetarët nuk zgjati hiç më pak as më shumë se një gjysmë ore. Atë që e tha Ministri gjerman për Unionin evropian, nuk më bëri përshtypje. Ishte një retorikë e rëndomtë e diplomacisë evropiane. Por habitesha, si u gjeta në mesin e fuqisë së shtatë e askush nuk më kishte ndalur për të më pyetur e bërë ndonjë kontroll rutinor! Dhe, derisa kaloja, m'u kujtua një mik imi atje në Kosovë. Kam pirë ca vagonë kafe me të. Ka përgatitur po ashtu tri përmbledhje të poezive të mia dhe ka shkruar dhjetëra faqe për to. Tani kur të shkoj deri tek ai, duhet të kaloj nëpër ca filtra...

Ç'do të thotë të jesh vend demokratik dhe i lirë.

NUK KAM KUJT T'IA KUSHTOJ NJË POEZI

Ylli ynë shfaqet

Gjatë pesëdhjetë vjetëve të vëllazërim-bashkimit asnjë libër yni i përkthyer në gjuhë të kombeve dhe të kombësive “tona” nuk kishte shkaktuar aq trazira sa libri “*Pa folje*” (Bez glagola, A. Cezarec, Zagreb). Ishte viti 1978 kur ndoshta kishte filluar të dukej kometa ogurzeze mbi Ballkan. Katërbëdhjetë poetë tanë, në mes dy shkrimtarëve kombëtarë – Migjenit dhe Kadaresë, frymonin shqip dhe bënin një udhëtim paqësor nëpër hapësirën e ish-Jugosllavisë. Kur e pata përgatitur librin kurrë nuk më kishte shkuar mendja se do të anatemohej aq vrazhdë. Nuk kisha bërë një libër politik, as nuk kisha shtruar në të kurrfarë doktrine. Kisha treguar një të vërtetë se kufijtë nëpër trojet shqiptare nuk janë edhe kufij shpirtërorë. Një ditë ata do të shkrihen në të mirë të vetë ballkanasve. Poezitë e katërbëdhjetë poetëve avanconin poetikën shqiptare në çdo aspekt. Nuk vuanin nga ndonjë dogmë e social-nacionalizmit, ishin një pastërti e mesazh njerëzor për respekt. Por dinjiteti i tyre i pengoi megalomanët, që kishin bezdisur çarshitë e tyre letrare. Poetët tanë ishin të shoqëruar nga dy njerëz të mençur të kombit dhe në njëfarë mënyrë kisha bërë me dije se populli shqiptar ka zgjedhur një rrugë tjetër të bashkimit të vet kombëtar, atë të bashkimit shpirtëror. E kisha të qartë se hapësira jonë dhe bota pushtohet me lehtë me art se me armë. E vërteta ishte tmerruese, megjithëse nuk kisha bërë kurrfarë mëkati ndaj vëllazërim-bashkimit të popujve “tanë”. Përkundrazi, u kisha ofruar një virgjinitet shpirtëror me një temperament lashtësie. R. Cvetiqanin me shokë irredentizmin tim shpirtëror e kishin lexuar në mënyrën e nacionalizmit serbomadh. Çdo tentim për të treguar se shqiptarët e dy anëve të Murit të Arbërit janë një popull; se për fatin e tyre është fajtoresh historia, keqinterpretimi i miteve – ishte i kotë. Kometës

ogurzezë veç i shihej fytyra. Pas Jogurt Revolucionit, diku në krye të SPS-it ishte gjetur edhe Cvetiqanini, në rolin e aparatçikut kulturor.

Këto ditë, rastësisht, më ra në dorë një gazetë e opozitës serbe. “*Nezavisni*” e paska emrin ajo dhe më 7 tetor 1994 qenka botuar poezia ime “*Njeriu me plagë në kokë*”. Pse e kishin botuar, e kuptova kur i rashë në fund tekstit të Vujica Rreshin Tuciqit. Ai sinjalizonte se hapësira e mbeturinës së ish-Jugosllavisë është shndërruar në një *Spital të Madh*. Një pjesë e intelektualëve serbë pashë se kishte venëruar para një çerek shekulli se ish-Jugosllavia ishte vërtet një *Spital* ku njerëzit lëngonin dhe ende nuk dinin për diagnozë. Por më habiste se poezia ishte marrë mu nga libri “*Pa folje*”, që ishte anatemuar si libër nationalist. Ky ishte satisfaksion për mua. Ata që më kishin akuzuar, pranonin se hapësira e tyre nuk ishte gjë tjetër pos një *Spital* i Madh. Habia tjetër ishte triumfuese: njëri ndër botuesit më të njohur të Beogradit përgatitet për përkthimin në gjuhën serbe të kompletit të veprave të Kadaresë, i cili ishte ndjekur e përzënë nga të gjitha gazetatat e botuesit serbë, bile edhe nga libri “*Pa folje*”. Dhe gjithë këto lëvizje i lexova si një inferioritet që ka kapluar “të urtit” e Ballkanit. Më së miri e kuptova këtë nga një shënim i shkurtër e mjaft diagnostik në gazetën “*Politika*”. Aty shkruante në Panairin e Librit Francez në Paris, ku ekspozohen edhe shkrimtarët e huaj të përkthyer në atë gjuhë, ballë të gjithë shkrimtarëve të Lindjes; bullgarëve, serbëve, rumunëve, rusëve e të tjerëve, qëndronte më superior Ismail Kadare, i cili kishte hiq më pak se katërdhjetë tituj në gjuhën frënge. Pezmi i gazetës beogradase zbulonte një të vërtetë që më ka munduar: pse e gjithë kjo dhunë ndaj nesh, lashtësisë, autoktonisë, kulturës dhe shkollës sonë? *No comment*. Inferioriteti shpie në krim. Megjithatë, mendoj se ballkanasit duhet të hapen njëri ndaj tjetrit, ta derdhin fruthin para se t’i kapë zjarmia.

Yllin tonë unë e shoh. Fare qart duket ai. Kadareja të lexohet edhe më shumë në Tiranë e Prishtinë. Nesër, pse të mos ndodhë edhe në Beograd. Ne jemi popull evropian dhe Ballkani u duhet atyre që fusin rruza në pe, urrejtjen që e kanë të vetmen mjeshtri arti.

Gati e kishin gëlltitur fjalorin

Nuk mbaj mend ndonjëherë të jenë nëpërkëmbur e sharë kaq shumë vlerat tona shpirtërore e dinjiteti ynë. E di, dhuna shkakton trauma, por nuk e kuptoj që ajo të bëhet bazament i të gjitha të këqijave tona moralo-psikike. Disi e kemi qitur menç se jemi të okupuar dhe kemi humbur gati çdo gjë rezistente, që e kishim. Për katandisjet tona fajtor e shpallim – kë tjetër pos veten! Vetvetes iu kemi bërë armik dhe punët e pushtetarit i kryejmë më shumë se tonat. Ka me dhjetëra shembuj. Këtë e bëjmë për shkak të inatit. Nuk e pranojmë; të gjithë nuk mund të jemi në krye. Problem kryesor është vetja, vetvetja. Si të lirohemi nga kjo e keqe që na gieti? Mazohizmi ynë i hap udhë të keqes: vetveten e hamë, e përbaltim, e shkelim, e fyejmë dhe shpesh e hedhim nga dritaret. Kështu shndërrohemi në diktatorë të vegjël të vetvetes. Claude Lefort do të na quante njerëz “të kufizuar e të paarsimuar” për çështje të mëdha. Pse të mos themi edhe narcisoidë të marrë. Diktatura është pjellë e njerëzve vetjakë. Duke sosur veten, duke ia zënë pusinë njëri-tjetrit për maskarallëqe më tepër të bajraktarizmit sesa çështjes kombëtare, ne po e zbrazim hapësirën tonë jetësore, po mbesim zogj qyqesh.

Mendoj se lokalet e shumta që hapen nuk janë shenjë i mirë. Në një çerdhe të tillë bisedonin ca krijues, iu thënçin. Dhe ç’bisedë, nga më marroqet: Ajo fjalë në filan tekstin e atij skribomani të Qeverisë dhe ajo ditë e javës, edhe ai muaj e ajo zgërdhirje, janë rekuizita të miat, thotë njëri. Zgjedhimin e asaj foleje dhe atë parafjalë kurrkush deri më sot nuk i ka përdorur si unë, pastaj atë mbiemrin foljor dhe atë figurën rreth qethjes së P. e K. (të mos na dëgjoj R. e Z.), nuk bën të m’i prekë kush, ia pret tjetri. Nuk rëndis tulla, as vargjet nuk i mas me milimetër; as nuk shkruaj poezi me fjalor, unë shpirtit i jap liri. Dhe këto fjalë e këto klithma urithësh, shtesa e prapashtesa, po qe se i vërej tek babaxhanët do t’i shpall për hajna. A e dini ju, hajnia është mjeshtri! Shkrimtarët e Qeverisë lehtë e kanë, ka kush i mban nënsqetull, po ne të gJORËT as pranvera nuk do të na çelë...

Para tryezës plot raki e meze dalëngadalë vinin monopolin mbi fjalë, e folje, mbi parafjalë e mbiemra, mbi rima e metafora, mbi sharje e zjarre, mbi ditë e javë, mbi muaj e vite dhe asgjë nuk u kishin lënë nga *Fjalori i Gjuhës Shqipe* brezave që vijnë. Tërkuazë e kishin bërë, vishkull. Po me çka t'i shkruajnë poezitë, dramat, romanet ata?, iu kishte kujtuar njërit, më në fund. Ishin shikuar sy më sy dhe kishin zbratur edhe gotat e fundit e nxënë pulëbardhat e vetmuara në pjata. Xurxull, me kapërdhiçkat e tyre nën sjetull, ishin bërë pikë e pesë. Secili më i madh se shoqi. Të gjitha predispozitat ekzistojnë se Çmimi “Nobel” mos sivjet, vitin e ardhshëm, qind për qind, do të na buzëqeshë midis Prishtinës.

Jemi popull gjenial, dhunës ia mbushim bulshit me marka nga Maja e botës. Ashtu do kapim kuçedrën e vjetër për bishti.

Nuk kam kujt t'ia kushtoj një poezi

Tepër të bukur e kam një poezi, të cilën e kam shkruar kur isha i ri dhe i besoj gjithkujt, edhe “birit” të popujve e pakicave “tona”. Kam rënë në hall, ç'të bëj me të? Ca “miq” të dikurshëm, siç thotë Izet Saraliqi nga gërmadhat e Sarajevës, e kuptuan gabimin e tyre se dashuria e madhe qenka e kobshme. Ata e kanë lehtë se kanë Vozhdin, Arkanin, Sheshelin; kushedi sa vojvodë që i di Izeti më mirë. Dhe, poezitë e “miqve”, në stilin e folklorit serb, mund t'u rrinë tepër bukur atyre, siç i kishin ndenjtur “birit” më të dashur të popujve e të pakicave “tona”. Njëherë përnjëherë unë kam vendosur atë poezi ta konservoj dhe ta lë atje ku është. Nuk kam kujt t'ia kushtoj. Po ashtu, edhe do kohë nuk kam ndërmend të bëhem patriot. Nuk dua në meqilise të flas për të pabërat. Në mënyrë time do të vazhdoj ta dua popullin dhe ta kërkoj Vozhdin tim, i cili dua të jetë ndërtues i madh i Njeriut dhe i Superatdheut të paatdhetarë. Do të vendos, ndoshta tek atëherë për poezinë time kujt t'ia kushtoj. Nuk di, Dheut të Arbërit do të më shohin në kal të bardhë apo të zi.

Kometa ogurzezë nuk i paska mbyllur sytë ende!

NËNTEKSTI I NJË TESTAMENTI

Amaneti i Faik Konicës (1942)

Të nderuar zotërinj!

Ndërroj jetë me mejtimin se ju jeni njerëzit që më keni kuptuar më qartë në këtë dbe. Nuk do të më tretë dheu nëse ti imzot Noli dhe Lamja im i vogël dhe gjithë ata që e quajnë veten shqiptarë nuk do ta çojnë kufomën time të tretet në tokën mëmë. Kam lënë mënjane edhe harxhimet e rrugës për trupin pa jetë dhe shumën për dy metrat vend në Shqipëri. Mbyll sytë se ju i nderuari Noli dhe ju të nderuar shqiptarë e ti Lamja im i vogël në Paris do të ma kryeni këtë amanet.

(Boston 1942)

Pakëz cinike duket, por shteti totalitar shqiptar frikësohej edhe nga të vdekurit! Vetë e tiranëve është kjo. Ata as miqve nuk u besojnë (Eskili). Çështja e varrimit të Faik Konicës mbetet njëra nga historitë më të dhimbshme të atdhetarisë. Plot gjashtë vjet (nga 1942-48) priti trupi i pashpirt në një frigorifer për t'u kthyer në Shqipëri, edhe pse Konica, vendlindja e tij, kishte mbetur jashtë kornizave të Atdheut. Nuk i dhanë as dy metra tokë për varr toskës së rebeluar, i cili “e deshi Shqipërinë me pasion e xhelozit” (J. Kastrati) dhe i cili e qiti në hall diktaturën edhe pas vdekjes. Në zenitën e vet ishte shteti i ri shqiptar. Me zell zbatonte dogmën e besimit të ri: Të rrënohen edhe majat e kombit po qe se lypset. Është tepër e ndjeshme kjo, e pakompensueshme për një popull të vogël e të pakrah. Pra, kishte pushuar kombëtarja. Asgjë nuk nderohej pos idhujve të tiranisë në hartën e së cilës nuk figuronin si shenjë as Kosova e Çamëria.

Amaneti i Faik Konicës, i cili u drejtohet edhe atyre që “veten e quajnë shqiptarë” (shqiptarë, me duket, pak kishte atëherë), është një

sarkazmë e gjenit që po vdiste i vetmuar. As Noli nuk mund bëri gjë. As Lamja i vogël (Seifulla Malishova), ministër kulture në shtetin e ri. Edhe këtë e hëngër terri i Majës së frikshme. Më mirë nuk kishte kaluar as Luigj Gurakuqi. Disa vjet u preh në anën tjetër të Adriatikut. Larot, siç thotë Noli, e shpallën edhe tradhtar.

Për fatin e intelektualit shqiptar, siç vërehet, vendosen të paditurit dhe despotët që nuk mund u liruan nga kompleksi i fronit, sepse ishin të vegjël. Në mes Pushtetit dhe Atdhetarisë hendeku mbet i çelur. Dhe, nëse më esull e shikojmë *Majën* e shtetit shqiptar mund të konkludojmë se në krye të tij u gjendën shpesh edhe individë që kombëtaren e kishin si një paradhomë për të hyrë në kierarkinë shtetërore. Pastaj zoti e di: profiti apo ideali i këndellte. Me pak përjashtime këtë të keqe mund ta hetojmë gati tek secila parti jona edhe sot.

Amaneti i Faik Konicës akuzon rëndë jo vetëm embargon e tmerrshme të shtetit ideologjik shqiptar, që ia kishte venë një pjese të kulturës sonë. E kjo bëhej në emër të ruajtjes së “shëndetit” të popullit dhe triumfit të besimit të ri si vëllazëri mes popujve, pa dallim feje e race. Por nuk ishte ashtu, siç predikonin “profetët” e besimit të ri. Ajo që u varros apo mbeti jashtë kornizave të atdheut ishte mu shpirti i ndrydhur i popullit, që priste të rilindte. Në të vërtetë, ata të Majës kryenin punën që kishin ëndërruar ta bënin “vëllezërit” e internacionalizmit, duke rrënuar vazhdimisht atë pjesë të shëndetshme që i vinte erë shqiptare. Shteti ideologjik, pra, ishte më së pakti shtet e ideologji shqiptare. Çfarëdo guximi i mundshëm intelektual e kishte edhe dënimin kapital. Vonimi për 50 vjet është tepër i thellë për një mëkëmbje normale dhe për sanimin e huqeve ideologjike, lirimit nga ato. Njerëzit e kulturës do të kenë punë të vështirë jo vetëm shpjegimin e shumë anomalive e eksodeve të mëdha, por edhe të rindërtimit të qenies shqiptare pas nokdaunëve të komunizmit.

Absurdi, ndoshta, që mund t’i japim edhe epitetin shqiptar: Ne nuk dijmë t’i mbrojmë vlerat tona sa e meritojnë, as të krenohemi me to. Afirmimin e individit nuk e marrim si afirmim edhe kombëtar. Nuk është i vetëm rasti i Konicës i cili ishte “shqiptari më erudit i Evropës” (Apolinieri). Etikimet e tmerrshme ndaj personalitetit e

veprës së Fishtës apo Skiroit nxinë ata që patën guxim t'i fyejnë kolosët. Gjëra makabra ndodhin edhe në ditët e sotme, kur gati na është këputur peri ekzistencial. Vlerat e njëmendta përpiqemi t'i nxjerrim margjinave ashtu siç vepronte diktatura dhe të imponojmë një shije malokçe, që nuk e ha më as batakun ynë. Qëndrimet e tilla më se qesharake mund të lexohen vetëm si komplekse, teke, krahinizma, sharlatanizma të të paartikularve. Afirmimi i secilit krijues, para së gjithash, është afirmim i gjenit kombëtar.

Seleksionimi ishte negativ: në mënyrën farefisnore u pushtua shpesh Maja. Dhe u mundësua infiltrimi i mediokërve, skizofrenëve, kleptomanëve, të cilët karrigen e panë si të vetmin mjet shpëtimi për të dalë në sipërfaqe dhe rrënimin e të tjerëve. Dhe, mu nga Maja nisi edhe pasiguria e tyre si karaktere e vlera. Nëse Faik Konica kishte lënë "mënjandë edhe harxhimet e rrugës për trupin pa jetë dhe shumë për dy metra vend në Shqipëri" dhe nuk iu mundësua varrimi, kjo tregon, në një farë mënyre, edhe sadizmin tonë. Por, nuk ka tradhti më të madhe sa nëpër tragjedinë e popullit tënd të shkelësh duke kërkuar një karrige për t'u ulur atje lart pranë Zotit.

Mbi amanetin e Faik Konicës, ndër lutjet më tronditëse që kam lexuar jo vetëm në letrat shqipe, nuk më vjen turp të them se pas leximit të parë kam derdhur lotë. Fliste për herë të fundit shpirti i gjenit me të vetmen kërkesë që mund të kapet edhe si mesazh për çdo brez: Në tokën mëmë, varrimi! Aty të tretet. Ndërkaq, refuzimi kategorik i "profetëve" të besimit të ri për varrimin e Faik Konicës në Shqipëri, zbulon fytyrën e vërtetë të shtetit ideologjik shqiptar: Një kreaturë e mjerë, me një vizion të paqartë e antikombëtar. Trupi i shkrimtarit të nderuar priti plot gjashtë vjet në një frigorifer! Disi kjo t'i kujton filmat e Hiçkokut apo atë realizmin magjik të amerikolinëve: "Në frigoriferin trupin që nuk dëshiron të varroset në dhe të huaj dhe i cili akuzon të vetët. Por ç't'i bësh, ideologjia ishte më e fortë se atdhedashuria e Faikut, i cili me atë fustanellën e gjatë të Toskërisë, që jo vetëm grekët ia shkurtuan dhe çoroditën me arna, kishte mahnitur metropolet e botës. "*Albania*" kujt nuk i kujtohet, ajo enciklopedi shqiptare, siç u quajt, ku me vjet kishte derdhur guximin prej intelektualit e eruditit mendimtari ynë, duke dëshmuar se Shqipëria nuk

ishite një vilajet i errët oriental, as shqiptarët popull pa identitet e trashamanë, siç trumbetonte shkenctaria sllavoortodokse.

Buzë Liqenit të Orhrisë, para shumë vjetësh, njohësi i veprës së Faik Konicës, dr. Luan Starova, kur më fliste për këtë testament, nuk i besoja as nuk mund e merrja me mend se diçka e tillë ndodh në vendin e shqipeve. Fatkeqësisht, edhe shumëçka që lexova më vonë ishte e vërtetë. Për 50 vjet ideologjia komuniste e kishte thyer keq shqiptarin, e kishte bërë palaço të një dogme të neveritshme pansllave; edhe krenarinë e dinjitetin kombëtar ia kishte rrënuar, e kishte lënë si një kallam të zhveshur në erë.

Nga amaneti i Faik Konicës edhe pse mban vjetin 1942, mund të nxjerret edhe një mësim: Rindërtimi i qenies shqiptare nuk bëhet me intriga e sakicë në krah, por duke madhëruar shpirtin krijues pa marrë parasysh i gjallë apo i vdekur, i cilit besim apo krahinë na është ai. *Monopoli* mbi shqiptarinë është i rrezikshëm. Edhe mediokrët e mjedisit tonë do të binden një ditë kur t'u dalë narkoza. Forma më e keqe e pleqërimit është bajrakarllëku, sepse despotizmi nuk është shenjë e qytetërimit, por një primitivizëm i thellë fisnor që mund të na shpie deri tek një ideologji edhe më e rëndë se kjo nga e cila po dalim me kokë ndër duar.

Njerëzit e mëdhenj veprojnë edhe pas vdekjes: Vepra e Faik Konicës tek hapet dhe komunikon lirisht me lexuesin, nga vetja duke nxjerrë tërë vrerin e ndrydhur me vjet. Dhe, do të lexohet si një kritikë e hidhur mbi shoqërinë shqiptare.

POETËT VDESIN BASHKË ME ATDHEUN

Nuk ishte hera e parë që dëgjoja nga intelektualët gjermanë fjalë të rënda për Evropën. Atë që e thoshte psikologia e Universiteti të Këlnit, më trimëronte. Shpesh nga miqtë isha qortuar për arrogancë. Ajo shkonte edhe më larg se buzëqeshja ime e hidhur. Thoshte se Evropa është më e zezë seç e kishte hasur në poezitë e mia. Qëndrimin ironik ndaj hipokrizisë së të mëdhenjve jo vetëm rreth çështjes shqiptare, ajo e kishte kuptuar si liri time nga kompleksi i metropoleve dhe mospërfillje perëndive të rinj. Shkilni pa kurrfarë kompleksi, kishte shtuar më vonë. Nuk e shikoni Evropën, siç e shikojnë kameleonët, që vijnë nga skajet.

Vdekja e quajtur Bosnje

Kur e thoshte këtë profesoresha e nderuar, aeroplani i parë gjerman përgatitej të fluturonte për në Beograd. Ndërkaq, në kanalim qendror TV të WDR jipej një dokumentar i llahtarshëm për atë ç'ndodhte në Bosnje. E kisha të qartë: kultura dhe politika, megjithatë, nuk puqen në Evropë. Ata që besojnë në lirinë e dinjitetin njerëzor, nuk u besojnë aq shumë atyre që premtojnë çudira. Mjafton një luhajtje e çdo gjë të rrënohet. Dhe, aeroplani sa nuk i kishte ndezur motorët, ndoshta, kur në ekranin TV fliste një reporter: Fotografitë nga Bosnja shiten si automobilat. Çfarë ironie! Nga vdekja e mijëra njerëzve mbusheshin vetëm xhepat. Fliste teteku gjakftohtë, pa kurrfarë dhembjeje për atë që ndodh në Ballkan. Por ata që vriteshin, thereshin, torturoheshin e dhunoheshin nëpër kazamatet e tmerrit, a ishin njerëz për të? Fatkeqësisht, të tillë ka shumë në Evropë.

Vdekjen të quajtur *Bosnje* kamera e shpaloste. Rrugëve të qyteteve dhe fshatrave të boshatisura shëtiste. Ndalje gërmadhëve.

Tek varret e reja e më të reja, që kishin bi si kërpurdha edhe në midis të lagjes, qytetit apo edhe para rrokaqiejve të nxirë të Sarajevës. Hynte nëpër parqe pa asnjë dru e bango. Kalonte brigjeve të Milackës. Xhironte tesha të përgjakura, ndonjë kafkë të ndeshur njeriu a qeni. Dilte në Bashçarshinë e katandisur, e cila dikur ishte atraktive mu për folklorin e saj. Diç traumatike kisha parë edhe në ekspozitën “*Nokturno për Kosovën*” të Arsim Kajtazit të hapur në Bad Dyrkahaim. Ballkanasi nga të shkojë nuk mund të lirohet nga tragjedia e vet. Filmi, në të vërtetë, ishte pasqyrë e thyer e Evropës: e ftohtë, e ngathtë, hipokrite. Brenda simbolit aksidental shihej ajo edhe pse dëshiroj shpesh të humb labirinteve të saj, sepse më vete ndërthen tmerrin e bukurisë.

Detaj që akuzonin rëndë civilizimin e sotëm ofronte kamera me një shkathtësi të çuditshme. Nuk më hiqet sysh, as nuk do ta harroj kurrë pamjen rrënoqethëse: Në një livadh gati të përzhitur, me ndonjë syth luleje aty-këtu, loznin voliboll fëmijët. Por fëmijët, që e hidhnin topin në ajër, të gjithë ishin të gjymtë, pa një këmbë. Mbaheshin në kugza të punuara nga ndonjë mjeshtër katundi, ndoshta. E hidhnin topin dhe qeshnin. Por nuk di, a i qeshnin fatit, që kishin mbetur gjallë apo buzëqeshja e tyre akuzonte ata që ua kishin prishur qetësinë. Sekuencat e filmit mbuloheshin pastaj nga një hije dhe rrathë-rrathë hapej krimi. Dikur ula kokën. As vetë nuk e di, zura këngën e Parasqevës sonë. E këndoja pa zë...

Në cilën kohë jetoja?

Isha bërë akull: Në ekran një arkë plotë koka njerëzish. Në cilën kohë jetoja dhe nga cila kohë vinin ato? Më ishte kujtuar koka e Ali Pashë Tepelenës. Disa ditë kishte udhëtuar nga Janina në Stamboll. Ajo moti kishte ndodhur. Por nga metropolet e Evropës kushedi sa aeroplani merrte udhë për në kryeqendrën e dhunës. Dhe, si të pajtohesh se Evropa bën politikë të meçme, ka mendim të drejtë jo vetëm ndaj etniteteve në Ballkan? Për shkak të paaftësisë, shpërblen dhunën. Kjo do të thotë se në gadishullin tonë fitojnë vetëm ata, që

nuk munden pa gjak dhe që politikën nuk e kuptojnë si mirëkuptim, sinçeritetet, fqinjësi, arsye, por si një art të barbarisë - mashtrimit. Pastrimet etnike nuk janë vetëm pushtime - poshtërim. Ato janë rebelime inferioritetesh ndaj qytetërimeve e popujve të lashtë. Në mes ardhacakëve dhe anasve nuk dihet si do të mbyllet ndeshja e përgjakur.

Mirëpo Evropa shikon punën e vet, neutralizon diversitete etnike (Bodriar). Nuk i peshon as vdekjet me të njëjtin kandar. Gjëra të tmerrshme kishin ndodhur edhe tjetërku. Pakëz kishin gjetur vend ato në faqet e gazetave. Rrënimet e hatatë në Mostar ishin shënuar disi turpshëm: Mund të ndodhë edhe kjo! Nganjëherë Evropa mbyll njërin sy, bëhet e shurdhër. Asgjë nuk i intereson jashtë hijes së vet. Por nga ne shqiptarët, nëse ajo deri më tani nuk ka mësuar asgjë, duhet të mësoj e diç nga toleranca jonë kombëtare. Brenda besimeve tona ngritëm diç që mbetë enigmë edhe për shumëkë. Te ne feja kurrë nuk u bë shtetërore, as nuk u ngrit gjë mbi baza fetare. Toleranca jonë, e kultivuar brenda besimeve tona, mund të jetë vërtet një shkollë e lartë edhe për Evropën. Si duket ajo ka hesapet e veta, kërkon profitin, ndërkaq humaniteti është diç tjetër. Shkak mos është ky që qytetërimin e sotëm e përcjellin edhe rënie, luftërat, kasaphanet?

Hotel “Evropës” nuk i kishte mbetur as hija. Më kërkonin aty miqtë e mi sa dëgjonin se gjendesh në Sarajevë. Por “Evropa” më nuk ekziston. Ngrihej si mallkim ndonjë shtyllë e nxirë mbi Bashçarshinë, ku zogitë nuk fluturojnë më as gumzhijnë fëmijët. Kamera fiksonte ndonjë dritare, ndonjë kulm të thyer përrreth dhe kthente objektivin nga hoteli i bërë rrafsh me tokë, tallej me atë Evropën e mbetur jashtë. Po ç’gaz ishte ky? Vaj i brendshëm i njeriut.

Gjaku i zi e kishte mundur njerinë

I kisha rënë poshtelartë Bosnjës shpesh. Në një mbrëmje letrare më kishte pyetur A. Sidrani: Ju shqiptarët tri letërsi përfaqësoni? M. Matevski dhe S. Guxheviqi ishin shikuar ndër vete. Unë vetëm kisha thënë: Ka edhe shumë të tjerë. Tërë kohën pastaj Sinan Guxheviqi më

kishte folur për Golien e tij diku atje në shpatijet e Pazarit të Ri dhe për një mësues nga Gjakova, që nuk e hiqte nga goja. Deri në klasën e katërt ai i kishte dhënë lëndën *Gjuba shqipe*. Thoshte se mësuesi i tij e kishte pasur për zakon të shëtiste deri vonë nëpër varre. Por tani nuk e kuptonte pse vepronte ashtu ai. Më vonë më kishte thënë se Frojdin pakëz e ka lexuar. Ishte kohë kur nacionalizmi serb shkilte rëndë, parullat e të cilit i kishin ndjerë më parë kurbetçinjtë tanë, të cilët gjithnjë e më rrallë i takoja. Gjaku i zi e kishte mundur njeriun.

Ka thënë dikush, nacionalizmi është mish i egër. E kisha uruar nënën që nuk më kishte mësuar të urrej. Ndanë udhe mund të më mbulonin therrat. Me shekuj nëpër lëkurën time nacionalizmi i fqinjve rrëshqet, duke lënë plot dhëmbë në mishin tim.

Në Ilixhe ishte mbrëmja ime e fundit letrare në Bosnje. Aty mbylleshin takimet e filluara nga Konjica, ku kisha parë ca emblema të prijësave shqiptarë. Qëndronim njëri pranë tjetri të heshtur thuajse kishim parandjerë të kegen. Dikur ia kishte behur edhe Karaxhiq, të cilin e kishte venë në lojë J. Bërkoviç. Dhe po atë ironi e gaz të hidhur të Piperit, e kisha dëgjuar një natë vjeshte në Bavari përmes valëve të Radio Zagrebit. Poezia "*Radovani i z?*", të cilën e recitonte Fabian Shovagoviç, ishte mallkimi më i rëndë që i bëhej një bastardi. Kush mund të besonte atë mbrëmje se edhe poetët mund të shndërrohen në vrasës të tmerrshëm; se edhe ata janë të etshëm për gjak kur fjala ua kthen shpinën dhe famën e kërkojnë në rrënim të gjithçkafesë.

Më vonë lexoja: Sidrani mbron Sarajevën (remishencë e çuditshme me një film) dhe vëllami i tij Branko Ç. zbraste tërë zjarrin mi Sarajevën. Ai ishte major dhe mbante të ngujuar Sarajevën e vëllamin, i cili dehej në Bashçarshinë e mbushur plot varre. E kisha hapur librin "*Qivuri i Sarajevës*" të Sidranit që as vetë nuk di si më kishte rënë në dorë. E lexoja dhe përcillja sekuencat e fundit të dokumentarit. Nga folklori i Bosnjës vërtet asgjë nuk ka mbetur. Njerëzit thuajse janë çuar lugetër. Rrënohet çdo gjë: edhe një shenjë e fqiut i pengon. Mbyllim shekullin gati e në bisht të Evropës nuk ka pasur kurrë më shumë urrejtje e varre. Sidrani nuk predikon më njëfarë vëllazërie. Ai akuzon. Nëpër vargjet e tij nuk vëtetinë më as

Shahabaza e Shehbanëve të Gjakovës. As del tek hoteli “Evropa”. Çdo ditë, çdo orë përcjell nga një tabut...

Kisha pyetur ndonjë kalimtar të rrallë se ç’bëhet atje. A është gjallë kush? Kisha pyetur edhe për Izet Sarajliqin. Pranoj se mendoja i pari do ta lëshoj Sarajevën ai, por kisha gabuar. I besoj tani edhe poezisë së tij për Kadarenë, të cilën e kishte shkruar pas leximit të “Gjeneralit...”. Thotë aty: *Tani kam edhe një mik në Tiranë...* Nëpër gërmadha të Sarajevës e kanë parë. Thonë se ndjek djallin. Shembull për antologji: Poetët vdesin bashkë me atdheun.

Pas Bosnjës, fytyrë tjetër do të ketë Evropa?

PA ATDHE NUK KA AS EMËR

Fati ynë na qenka i tillë: në këtë ditë të shënuar të kulturës sonë, ballë njëri-tjetrit, të qëndrojmë si qytetarë të dy republikave (!) në mes të të cilave bën hije ende Muri Arbërit, që e ngritën padrejtësitë e të mëdhenjve, duke shpërblyer apetitet e fqinjëve tanë dhe duke sakrifikuar një popull e një kulturë antike.

Ka shekuj që trojet tona kanë marrë pamjen e tmerrshme: me plot kufi e murana pas të cilave fshehet shqetësimi ynë gjithkombëtar. Siç e theksoi edhe shkrimtari ynë i nderuar Kadare në një intervistë - qetësia jonë antike u thye kur fiset sllave nisën të zbrisnin nga Karpatet dhe kur fqiu ynë jugor, për lirinë e mirëqenien e të cilit kontribuam edhe ne shqiptarët, ia ktheu shpinën antikitetit dhe u turr pas Bizantit. Pse veproi kështu, dihet.

Ato që ndodhën pastaj ishin ngjarje të dhembshme. Marramendëse. Të paharruara. Fiset ilire u shpërngulën në ëndrrat tona dhe në kujtesën e brezave e ngulitën emra tragjikë si Morea, Toplica, Çamëria, Kosova. Është për t'u çuditur se për këto humbje të hapësirës sonë, gati në asnjë tekst shqiptar nuk u vërejt ndonjë mallkim apo hasmëri ndaj fqinjve tanë, edhe pse trojet tona na i qitën shpesh në treg. Në bibliotekat tona renditen libra të dhembjes kombëtare, por edhe te shpresës së një ditë edhe fqinjët e të mëdhenjtë do ta kuptojnë hallin tonë gjithkombëtar.

Vitet 1878, 1913, 1919, 1924, 1945, të kongreseve e të konferencave të shënuara e të pashënuara, janë akte të tragjedisë sonë kombëtare, të eksodeve, të ndjekjeve, të vrasjeve dhe shpërbërjeve të hapësirës sonë. Në mënyrë misterioze, për një gjysmë shekulli na shkëputën nga bota dhe na dënuan me natën e gjatë pansllave, duke na çoroditur si komb e karakter. Në vetminë tonë të vdekshme tentuan të na mbyllin hermetikisht dhe monopolin mbi fatin e

identitetin tonë kombëtar e morën të huajt dhe sharllatanët e oborreve... E kjo, a mund të quhet krenari kombëtare?!

Stolisje i kishim kampet e përqëndrimit dhe kazamatet e panumërta: nga Veriu në Jug, nga Lindja në Perëndim. Nuk dinim ku gjendet Çamëria apo ku bie Kosova, ku nis Burreli e ku mbaron Idrizova famëkeqe. Thellë në qenien tonë ishte shtrirë nata e shkurrës dhe nga truri i kombit bëhej shpërlarja totale. Etiketimet e të gjitha kuzhinave na rrënonin dheun nën këmbë.

U desht të ndodhte 11 marsi i vitit 1981, kur studentët e Universitetit të Kosovës, ndër të parët në Evropën e Lindjes, ia kthyen shpinën ideologjisë bolshevike: *një popull, një kushtetutë, një gazetë*, që ishte rrena më ordinare e përgatitur për zhdukjen e popujve të vegjël. Ndodhi pastaj edhe dita e 22 marsit të vitit 1992, kur për herë të parë në historinë shqiptare triumfoi opcioni demokratik dhe populli shqiptar zgjodhi atë që e deshi, pa diktatin e huaj. Ishte ëndrra jonë, e nisur që nga koha e rilindësve; ishte kthimi ynë në Evropë.

Në momentin e pikërishtëm, në Republikën e Kosovës, gjëja më e dhembshme, më prekëse dhe më e tmerrshme se vetë vdekja është gjenocidi kulturor, që ushtron neofashizmi serb - gjymtimi i shpirtit, i mendimit dhe i shkollës shqipe. Ju lutem, për pak kohë përfytyroni, brenda një dekade, sa zgjat apartheidi në Kosovë, sa talente janë shuar, sa familje kanë marrë botën në sy, sa ëndrra ka vyshkur dhuna serbe...

Fjalët tona, që sonte do t'i dëgjoni, mund t'ju duken pakëz nevrrike, të dhembshme, të gjakosura, të lodhura, jo të zakonshme, pak të huaja, ndoshta edhe patetike, por këto janë fjalë të gjuhës shqipe të ardhura nga skajet më të largëta të Atdheut, që i shpëtuan gëlltitjes sllave. Do të bindeni, po ashtu, se mesazhi ynë është edhe juaji; se kauza jonë kombëtare mbetet e hapur për ne e shpirtin demokratik të Evropës, do të bindeni se një popull nuk mund të copëzohet edhe shpirtërisht, posaçërisht kur ai popull vendos të mbijetojë dhunën e padrejtësitë që iu bënë.

Në Republikën e Kosovës ka shumë krijues të mirëfilltë në të gjitha fushat e krijimtarisë shpirtërore e materiale, të ndërgjegjshëm për fatin e kombit dhe të paqes në rajon. Shumë prej tyre kanë bërë

emër edhe jashtë hapësirës sonë gjuhësore: kulturën, traditën e historinë tonë, duke e avancuar me qasje e ide të reja dhe duke i mbrojtur ato me dinjitet, në mënyrën më fanatike. Ka shembuj dhe për respekt gjithëkombëtar.

Përkundër dhunës e terrorit të paparë, në fund të shekullit XX, siç e vëreni, shpirti i arbërit gjallëron, është më i fortë. Fryma atdhetare e rilindësve: Populli është mbi çdo parti e besim, në udhëtimin tonë të gjatë na është e vetmja dritë që na shpie përpara. Guximin tonë intelektual duhet kuptuar si ekzistencë. Ne shpalosim fatin tonë tragjik. Brenda etnisë, po ashtu, lirinë e paqen që po e kërkojmë, nuk e bëjmë këtë për t'i frikësuar fqinjët tanë shekullorë. Liria dhe paqja janë liri dhe paqe edhe për fqinjët tanë. Ne jemi përcaktuar për mirëkuptimin mes njerëzve e popujve. Është etikja jonë, po edhe çështje jetike kjo.

Arma jonë: *ffjala*. Liria e saj është dinjiteti ynë njerëzor e kombëtar. Por pa atdhe nuk ka as emër, as liri. Besojmë se, megjithatë, do të triumfojë arsyeja, guximi ynë intelektual.

Tiranë, 26.6.1993.

(Fjala e hapjes në Javën e kulturës së Kosovës në Shqipëri)

MOS KEMI TEPËR ATDHE

A JE SHQIPTAR?

Me të vërtetë shikoja një film western, asish të Perëndimit të Egër. Si në një shirit celoloidi ishte zhvilluar krimi. Kishte zbritur teteku nga maja e Durmitorit ose e Llovçenit. Poshtë e lartë i kishte rënë qyteti dhe para Radio-Tivarit kishte nxjerrë revolverin. Kishte rrudhur sytë e përgjakur dhe në lule të ballit kishte qëlluar një djalosh *pse ishte shqiptar*. Nuk ishte larguar derisa kishte rënë ai, i cili për herë të fundit kishte parë diellin si përmytej në valët e Ujit të Madh. Kur djaloshi ishte shtrirë gjerë e gjatë, teteku kishte vënë revolen në brez. Kishte nxjerrë ca klithma të ngjashme me ato të indianëve të rezervatit. Ushës së vet ishte ngjitur si dhi e egër, i bindur se kishte qitur fare rodin shqiptar.

Krimi kishte ndodhur në pikë të ditës dhe në titërr të lëndinës: para ligjit dhe policit, të cilët unë i shihja si mbeturinë të një shoqërie, që kishte marrë tatëpjetën. Zatën ky ishte filli i “Jogurtrevolucionit”, që u shfaq në horizont me topuz, thikë e gjak. Dhe, ishte ai lëmshi i së keqes që rrokullisesj e nuk i shihej fundi.

Kush është shqiptar?

Pas shumë vitesh, kur mendoja se edhe morbiditeti ka fund, krimi ishte reprizuar kushedi edhe sa herë. Bile edhe aty ku nuk më shkonte mendja. Në pikë të ditës, diku në midis të Zagrebit: në një furrë buke kishte hyrë një paramilitar dhe kishte pyetur: *Kush është shqiptar?* Bilanci i “gjahut” ishte katër të vrarë. Në mesin e tyre edhe një afrikan: Kush tjetër? Një gazele që e kishte qitur udha atë pikë vape e tre përdrinas, që rreth trupit, e kishin pasur të mbështjellë Drinin. Simbolikë e çuditshme. M'u kishte kujtuar atëherë djaloshi buzë Ujit të Madh nën hijen e një pishe, ndoshta, me një kokërr ulliri në gojë e copë buke në dorë. Në pikë të diellit kishte qëndruar një kohë të gjatë derisa një kalimtar ia kishte hedhur një çarçaf mbi trup. Më ishte dridhur buza. E kisha përgjakur. Çdo gjë zhvillohej si në një film të ngadalësuar me një fund makabër.

Mirëpo të *jesh shqiptar* e të mos rrahësh, shahësh, a vritesh disa herë brenda dite, jave a viti, nuk mund të ndodhë! Vritet shqiptari në Bozhaj të Tuzit, në Qafë të Prushit, në Qafë të Thanës, në Kakavi, në Elez Han. Vritet se ka mjaft dhe nuk i duhet askujt... E kam parë edhe nga anija “Vlora” kur e kanë hedhur në Ujë të Madh dhe kur e kanë mbuluar me valë të kaltrta. Ku nuk e kam parë nafakprezin dhe ku nuk e qëllojnë! Është i jashtëligjshëm, me asnjë paragraf nuk mbrohet. Pamja e tij, që ta kujton një rrënjë të dalë buzë udhe, tmerron zonja e zotërinj. Dhe kur kalon ai, me ditë nuk mund të fusë kush gjumë në sy. Hija e tij zgjatet nga zemra e dheut deri në majë të botës. Përmalet. E kam parë atë duke i shqetësuar edhe zotrat. Ku nuk e kam parë. Por unë, si individ, ç'mund të bëja? Vetëm të mbyll dritaren ose të dalë në rrugë dhe të klith. E kisha shkruar poezinë “*Me qen?*”, e cila ishte vazhde e protestës sime të hapur. Për çudë të zotit, pakkush e kishte kapur sinjalin e krimin. Heshnja linte të kuptohej se rodi shqiptar është i lodhur nga morbiditeti, se ai kërkon një qetësi shpirtërore – qoftë ajo edhe pjellë e një rrene të kulluar.

Nga krijuesit e mëdhenj kam mësuar. Nuk shkruhet sa për të shkruar. Krijimi nuk është vetëm një thes fjalësh. Arti është një plagë,

e cila tërë jetën duhet shtrydhur. Krijimi, qoftë edhe një poezi erotike, duhet të ketë një shqetësim, një tërmet, një zjarr të fshehur. Lexojeni poezinë më të re amerikane me Ginsbergun në krye! Do të vëreni se edhe një poezi e kulluar erotike ka një zjarr që djeg më shumë se një poezi e kuqe a jeshile. Tërhiqni një paralele në mes të saj dhe një mjedisi çfarë është yni kur njeriu vritet si qen. Besoj se fenomenin e artit dhe funksionin e tij do ta kuptoni pak më ndryshe; se arti nuk është vetëm një mistri fjalësh, përkëdheljes, vetëkënaqësi. Pasi t'i keni peshuar gjërat dhe perceptuar, parafytyroni shfaqjen e një kërmilli diku aty në *Alene e Shpëtimtarëve të Kombit*, aktrimin e tij prej autoriteti: Arti nuk është realitet... Por grithjet e rënda, përgjakjet, rrënimet, lexues i dashur, kuptoju si të duash ti...

“Meka” serbe

Ca kokë qepë m'i mbështillte me një gazetë bulevardeske shitësi plak ku, rastësisht, në një kënd syri m'i kapi fjalët bizare të një radikalisti serb: *Kosova nuk është vetëm vend i shenjtë serb. Ajo është Amerikë, Gjermani...* Aty serbi shkon i varfër e kthehet i pasur... Fjala ishte se në mes të rodi të tij përditë bëhen gara: Kush do të shkojë më parë në Kosovë si polic e ushtarak, si gjykatës apo diç tjetër nga instrumentet e pushtetit serb...

Dhe pasi vranë e kthjellë në *Mekën Serbe*, do të ikë teteku një ditë me një makinë të tipit më të ri. Ose diku atje në Grackë do të ngrehë vilë... E lexoja një gjysmë të vërtetë serbe. Por në hapësirën tonë ndodh diç tjetër, që nuk dua ta shënoj se më vjen trup.

Në një takim të fundit letrar me ca krijues të ish-Jugosllavisë, romansieri i njohur Mirko Kovaç më kishte thënë: Ju shqiptarët më keni fascinuar! Jeni popull më i mençëm në këtë hapësirë të shthurur. Në mënyrën më dinjitoze keni amortizuar neofashizmin serb. Kovaçi nuk ishte i vetmi që mendonte kështu. Kafsha dresohet pasi të lodhet mirë. Ose, siç thotë populli: I lëshohet udha të çmendurit... Por?

Dokumenti se je shqiptar?

Tek guri i kufirit kishte dalë një mik imi. Tek ai guri që na vunë të tjerët. Tejt Muri të Arbërit kishte një vdekje. Dhe kur iu kishte afruar gurit, polici shqiptar, pasi ia kishte shikuar pasaportin, e kishte pyetur krejt ftohtë: *A ke dokument se je shqiptar?* Miku im, i cili e kishte kaluar kushedi sa herë atë guri, ishte shtangur. E kishin kapluar djersë e drithma. Nuk ishte gjithkush. Bile dritën e parë e kishte parë para pesëdhjetë vjetësh diku nën një çati gati të thyer në Mamuras, rrëzë Krujës. Kur prapë polici kishte përsëritur pyetjen me një ton pak më zyrtar, miku nuk kishte ditur ç'të bëjë, kishte filluar të buzëqeshë, duke menduar se polici tallej. Por polici kishte mbuluar zylyfet me kapele. E kishte futur deri në rrëzë të veshëve dhe iu kishte kërcënuar mikut, që ishte nisur ta kapërcejë Murin e Arbërit: Në Shqipëri nuk hyhet pa pasur dokument se je shqiptar!

Ajo që kishte ndodhur pastaj turpërohem të tregoj – i kishte ngjarë një karrige me plotë gozhda, ku nuk mund të ulësh. Dhe parafytyroni, ju lutem, hapësirën shqiptare me ca gurë në mes. Që pushtetarët e quajnë *kufi* e ne të revoltuarit *mur*. Në të dy anët e këtij Muri rrinë ballë për ballë dy hije të një gjaku. Njëra që ka kohë përsëtepërmi dhe nuk di ç'të bën me të: A të fusë rruza në pe apo t'i trembë mizat, tamam si në dramën e Joneskut. E tjetra, e tjetra hije që nuk ka kohë as për të ndezur cigaren. Nuk e vëreni se absurditeti ka zënë të shfaqet në mënyrën më të rëndë brenda qenies sonë?... Mikun nuk e dëgjoja më. Në mua rëndonte guri i kufirit.

Në mes le të mbese, lexues i dashur. Diku atje në Çabrat e kam një cung, ku më së miri e kam lexuar vdekjen. Shokët e mi të fëmijërisë, sa të dalin nga kazamatet e shkurre dhe sa të marrin veten në dorë, më kanë premtuar se do të ma sjellin atë cung në Prishtinë. Dhe, a di çka? Le të mbese në mes nesh edhe kjo. Nga ia cung do të gdhend një figurthë *kërmilli* të cilën si të duan, le ta interpretojnë shkuesit atë ditë dimri apo vere kur do ta ekspozoj në *Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit*. Vetëm aty mund të buzëqeshë ai *kërmill*, që me bezdis kur nuk mund të fus gjumë në sy. E hap dritaren dhe e ndjej

Kosovën si më rrëshqet nëpër gishtërinj gati të shndërruar në rrënjë të një rrapi të harruar buzë udhës së shkretë...

E kishte pyetur polici: *A je shqiptar?* Vetëm në zemër nuk më shkruan, iu kishte përgjegjur miku me një buzëqeshje të vvarë... Në të vërtetë, ky nuk ishte film, as nuk e kisha parë ëndërr Gjon Bellushin në një rezervat indianësh. Por merrja pjesë në teatrin e ri shqiptar, ku nuk di cili akt shfaqej nga jeta ime e marrë, apo duçi i cigares kishte filluar të tymojë në mishin tim, që e kishte hedhur një dorë e panjohur derisa trupoja tokën time, që ma kishte lënë amanet babai... Pastë ndjesë!

TEATRI I ABSURDIT

Shitja e “lirisë” me kg.

Askush nuk mund të më bind më se në Shqipëri nuk ka pasur liri. Ka pasur, bile, tepër sa nuk kanë ditur ç’të bëjnë me të. Hall i madh ka qenë t’i shpenzosh, bie fjala, pesë kg. liri. Fatkeqësia qëndronte se demosi nuk e kuptonte këtë “mrekulli” të quajtur diktat, diktaturë. Liria zgataraqej anembanë Atdheut dhe fillonte nga *Maja*, pra nga Byroja e PPSH-së lëshohej pingul ose, si thonë teoricientët, vertikalisht dhe derdhej në përfaqimin e demonit, që ditë e natë i numëronte yjet atje poshtë. Nganjëherë ajo copë liri merrte formën e pikës së gjakut, ose shpesh përfundonte në Gropa të Zeza. A e keni dëgjuar atë këngën: *Po del Dudia nëpër gropa?*

Të madhërishtit dallonin nga demosi se kishin edhe kohë më tepër. Në pikë të hallit binin me të dhe nuk kishin ku ta shpenzonin lirinë. Tërë koha nuk kalohej duke ndjekur miza. Infrastruktura dhe mirëqenia ishin në “nivel”; çdo gjë rentabël: burgje të zbrazta, kampet e përqëndrimit - fabrika për riprodhimin e mirëqenies kombëtare e njerëzore. Tregonin se as në Siberi nuk kishin parë fabrika të tilla, ku përpunohej aq mirë njeriu, mirëqenia. Malli më i kërkuar ishte *kultura*, përzierë me *folkkulturë* të shkallës së parë. Në çdo kthesë e rrugë “liria” shitej me kg. Ata që blenin më shumë, mbetnin vetëm në kamerën e “Të zhdukurve”.

Teatri i absurdit:

Çdo gjë prishte demosi, i cili ishte i “pangritur”, “tutkun”. Ai ishte hidhërimi i të “madhërishtëve”. Sa i përket *Majës*, lehtë bëhej me të. Gjendej ndonjë fajtor. Ky farë “pis” demosi rrëronte planet e

të “madhërishmëve” edhe pse binte e zgjohej me ta, aty rrëzë Piramidës. Fabrikat e kampet me emra “antikë”: Burrel, Spaç, Tepelenë, Pukë, Lushnje u bënë tmerr për Majën – se demosin nuk pranoin ta dërgonin në verime të detyrueshme dosido. Por a bën pa kurban?

Problem tjetër i Majës ishte – kur të hapet sezoni teatror dhe sa të zgjatë: një javë, një muaj, një vjet. Në Majë kishte edhe te atillë që nuk ngopeshin me art; kërkonin që sezoni teatror të mos mbyllet fare. Ishte i vetmi vend ku mund të tregonin secili dhëmbët, buzëqeshjet, aftësitë e tyre krijuese e interpretuese nga aktori e shkrimtari deri te servili e palaçoja. Mirëpo, mbi të gjithë duhej të ndriste njeri: Kryeregjisorin, pardon Kryeekzekutorin, më i dijshti. Ligji ishte edhe puthja nën pishat e Atdheut apo ajo puna me të dashurën e firajet e bregdetit, të dihej patjetër dhe të lajmërohej, përndryshe fyente Majën për jovigjilencë”. Në të vërtetë ajo ishte e përzierë. Bile edhe rrokullisej në shtrat plot pupla e ofshamë dashurie.

Sezoni teatror, pra nuk kishte kohë të caktuar. Mund të fillonte në verë, në pranverë, në vjeshtë ose në dimër. Kur e shihte të arsyeshme Maja. Kryesore të mos kalojë ndonjë stinë pa një zbulim epokal a derdhje gjaku në Gropat e zeza. Thonin pika e natës ose mesdita ishin më të përshtatshme. Demosi atëherë merrte pakëz frymë. I përfolte ëndrrat që i kishte parë. Apo ndonjë vashëz në minifustan kur turbullonte mendjet, ishte ajo koha e artë që ndahej dashuria e qetësia me miligram edhe pse liria peshonte me kg. Por në një shoqëri kur çdo gjë është okej, nuk ke kohë as për atë punën në shtrat lëre më të zësh miza e t’i biesh në gjunj një dame me karafil të kuqe në buzë që kalon pranë teje.

Rreth skenës, që kishte formën e një Piramide, demosi kryente punët e veta që ia kishte caktuar Maja. Dhe Kryeregjisorin, që ishte njëherësh edhe Kryeekzekutori, nuk mund të mos nderohej pa buzëqeshje e duartrokitje. Por nuk di, demosi a e kishte përnjëmend apo luante rolin që i ishte caktuar? Megjithatë, kjo mbetet të hulumtohet. Se “dashurinë” e madhe ndaj të “gjithë-fuqishmit” demosi e kishte paguar shpesh shtrenjtë në fabrikat me emra antikë,

ose në Gropa të Zeza. A e keni dëgjuar atë këngë: *Po del Dudia nëpër gropa?*

Le të mbetet për hulumtim edhe kjo. Kryesore: ditë, javë, a vite nuk ka kaluar pa u shfaqur ndonjë dramë më e re në teatrin kombëtar. Sezoni teator, të mos them, siç thonë tradhtarët e spiunët, sezoni i gjuetisë së “armikut” të brendshëm, fillonte pikërisht me një ritual heshtjeje, e cila zgjaste kushedi sa kohë. Dhe krejt kjo ndodhte të mos ia humbiste shkëlqimin spektaklit kur nga Maja zbriste triumfues Kryeregjisorin, pardon Kryeekzekutori i ndjenjave popullore, i cili me ditë kalonte në mes dejrexhive e bejtaxhive më në zë. Nuk ishte lehtë ta zbulosh armikun në gjak.

Njeriu që është dashur të vdesë patjetër

Moti rodi shqiptar kishte për t’u faruar të mos kishte qenë zoti në anën tonë. Bile aq i mëshirshëm është treguar sa, në çdo pesëqind vjet, na ka dërguar nga një shpëtimtar. Xhaxhit Skënder do t’ia ruajmë përmendoret. Këtij tjetri vetë zoti ia rrënoi. Nuk i kishte pëlqyer pjella. Ne që kemi rrënuar perandori e perandori do të ishte turp që Ballkanin të mos e lidhim mirë njëherë për kërthizën tonë.

E pranoj se nuk kam lexuar aq shumë vepra që merren me absurdin njerëzor. Por mjafton që pata fat ta lexoj *Dosjen “Shebu”*, të bindem se deri ku mund të shkojë urrejtja njerëzore dhe ç’mund të bëjë diktatura për të ruajtur karrigen dhe një grimë autoritet brenda një pëllëmbje dheu. Kërkoj falje nga Visar Zhiti, Maksi Velo e dyzet mijë të tjerë, që nuk i njoh, nëse ndonjëherë i kam lënduar ndjenjat e tyre njerëzore e patriotike pa e ditur se ç’kishte ndodhur tej Murit të Arbërit.

Duke lexuar *Dosjen “Shebu”*, kam ndjerë indinjatë se me çka qenka marrë “Nëna-Parti”. Paska kryer punën e fqinjve tanë që ëndërrojnë sa më pak shqipe të shohin qiellit të Ballkanit. Aq larg kishte shkuar ajo sa trupat e dy të rinjve të mbuluar me çarçafë ëndrrash, i kishte ndarë përjetë. Absurditet i dorës së parë, lakmi t’i ketë edhe një Beket.

Disa muaj Byroja e PPSH ishte marrë intensivisht rreth një fejese: A duhet djali i Kryeministrit të pranojë dorën e një vajze të profesorit të Universitetit? Vërtet, shteti kur nuk ka ç'të bëjë, duhet ta thyejë kush heshtjen që të mos flejë askush. Ose me vrasjen e një njeriu (në kandin e diktaturës asgjë nuk peshon) dhe me zhdukjen e familjeve të panumërta, të forcojë radhët rreth Piramidës. Dhe, nëse nuk ekzistonte fajtori, atë duhet trilluar pa tjetër. Çfarë sarkazme: Nuk di a ka ndodhur diç e tillë edhe me ata të Lindjes.

Dosjen “Shehu” e lexova edhe si *Njeriu që është dashur të vdesë patjetër*. Dhe është me interes të madh. Dëshmon: 1) Absurditetin e shoqërisë shqiptare në kohën e monizmit, 2) Monstruoiziteti i shkallës së lartë që na “prodhonte” një farë “lirie” plot art intrigash, insinuatash oborrtare dhe 3) Për të konvertuarit në socialistë është një satisfaksion se në kohën e PPSH-së, “liri” na paska pasur me kg. Por ky farë “pis” demosi nuk paska ditur të mbahet për vertikalen se gjithmonë na paska qenë i shtrirë. Na i paska numëruar yjet, atje poshtë. Ky tekst nevrík po të përkthehej, kam besim se çdo teatër i metropoleve do ta vinin në skenë. Nami nuk do të mungonte as për artin tonë të absurdit.

Ne, të viseve të *çkombëtarizuara* (Kadare) apo *shkërdhatat*, siç na quan rrugaqësia e trotuareve kombëtare, kemi të drejtë të revoltohemi më shumë se ata të qyteteve “antike”. Në tribunat e forumet e tyre Buroja e PPSH-së paska vënë do fejesa e mbytur ca miza, që nuk na duket punë serioze e më së pakti kombëtare. Do të ishte nder për të (Byron) të ishte marrë më shumë me çështjen e Kosovës e të “shkërdhatave” Dinjiteti ynë kombëtar me siguri nuk do të nëpërkëmbej kaq shumë nga shovinizmi i fqinjve. U përziva ndoshta, pakëz në punë të brendshme. Por desha vetëm t’iu shkund buzëqeshjen e thartë “shokë”... Nuk kam dëshirë t’iu shoh të pluhërosur.

KOKËQETHJA E NJË POPULL

E ka një poezi Maks Velo. Quhet “*Kokëqethje*”. Një dëshmi njerëzore që mbyllet me një akuzë të rëndë kundër diktaturës komuniste: *Ata, që si bagëtinë / qethin çdo vit Shqipërinë...* Irituese për një jetë qenqe, për një kohë pis, të frikshme. Një qethje e tillë (lexo: burgosje, internime, vrasje) edhe për një popull të madh e me një traditë të pasur kulturore është shkatërruese, lëre më për një grusht njerëzish të bëra pikë e pesë. Por diktatura lufton për pastërtinë ideologjike deri në njeriun e fundit, derisa e ha edhe veten. Psikologji tipike neofashiste: Të rrënohet çdo gjë që nuk i përulet.

Dhe këtë poezi fatlumi, sa herë e lexoj, rrëqethem, nevríkosem se është qethur Shqipëria, kur ka parë ndonjë ëndërr të keqe monarku. Dhe nuk mund të mos pajtohem me poetin se qethjet u ngjanin qethjeve të bagëtive. Por si të shkëputem nga një copë e udhëtimit, që i thonë edhe asaj histori? Aty diku, në një kënd të kujtesës, rri ndezur një llampë tmerruese, drita e së cilës ma kujton gjakun e zi. Ajo humbet ngadalë, por nuk di nga ankthi një gjysmëshekullor a do të lirohem pa tërmete e dhembje.

Leximi i poezisë omonime është lexim i një varianti të rëndë të dehumanizimit, në rastin shqiptar të diktaturës, që cytej nga ajo pastërti e imponuar me një fund makabër. Dhe pas leximeve të teksteve të tilla që nuk janë të pakta në letrat shqipe, nuk mund të mos pyesësh: Ç’u deshen tërë ato kampe, burgje me ata emra të tmerrshëm, rrënues gati të çdo gjëje dinjitoze që njeriun e bën njeri?

Diç e tillë, mos më e rëndë ka ndodhur edhe këndej Murit të Arbërit. Gjuetia në shqiptarë nuk kishte më lidhje me absurdin. Ishte shndërruar në Instinkt. Ndiqeshin, burgoseshin, vriteshin. Kuptohet, shqiptarët e gjorë, që nuk donin asgjë më tepër se të tjerët. Kërkesat e tyre mbetën: Liria kombëtare, një jetë më humane dhe zot të trojeve. Por kush t’ua kuptojë, kur vetëm njëra anë dëgjohej dhe ndëshkohej.

Poshtrimi ishte i rëndë

Në të dy anët e Murit të Arbërit e pësonin vetëm shqiptarët. Këndej shpallehin për irredentistë, enversitë, ballistë deri tek kriminelët më ordinarë. Tej Murit, ata që kalonin, pjesa dërmuese e tyre konsideroheshin të dyshimtë, sepse nuk mund të pajtoheshin me atë shqiptarizëm që e kishin gjetur pak më ndryshe se në letërsi. Dhe, poshtërimi ishte tepër i rëndë.

Në këtë deziluzion njerëzor Titoja ishte lojtar i rryer. Me të dy blloqet flertonte dhe nga të dyjat fitonte atë që i duhej; “xhaxhi” Enver besonte në sinqeritet: Të gjithë krerët e kibuceve komuniste duhet të mendojnë si ai, por politika është diç tjetër. Kështu në të dy anët e Murit të Arbërit shtoheshin kampet e përqëndrimit, burgjet – relikte të fundit, ndoshta, të diktaturës që humbte ngadalë në pastërtinë e vet. Se qethja e Shqipërisë për çdo vjet ishte qethje gjithëshqiptare. E dhembeshme, traumatike e një kohe që nuk mund të gjallëronte ndryshe.

Që të mbijetojë diktatura, kërkoheshin e shpikeshin mënyra të reja, përsosej mjeshtria e krimit deri në absurd. Por ajo që ndodhte brenda qenies shqiptare – nga lufta e klasave deri te kooperativizmi, shuarja e çdo të mire individuale, u shkonte për shtat elaborateve nacionaliste të fqinjve. Më lehtë mund t’i nënshtronin shqiptarët dhe çështjen e tyre ta mbyllnin përgjithmonë po qe se Shqipërinë e veçonin, e izolonin nga Evropa. Në këtë plan zhvillohej edhe politika e fqinjve. Diktatura të përkrahet në Shqipëri, të bëhet e përgjakshme ajo, irituese që Evropa të mos mendojë më për çështjen shqiptare. Kështu, Shqipërisë iu imponua frika, intriga, dyshimi për t’u hapur. Kishte humbur udhën.

Gjatë një vizite Kosovës, në Brezovicë Titoja kishte thënë edhe këtë: Nuk bën të brengoseni që më shajnë. Na duhet një Shqipëri e tillë (kishte menduar për atë komuniste). Kjo do të thotë shumë. Së pari: Një Shqipëri e hapur, properëndimore, rrëronte ëndrrën pansllave se me trojet e fatin shqiptar nuk mund të luajë më kush.

Vetë hapja shtronte-problematizonte kauzën shqiptare. Dhe, së dyti: Titoja frikësohej për qetësinë e brendshme.

Po të këputej hallka komuniste në Shqipëri, ç'do të ndodhte me Jugosllavinë?

Morali i diktaturës dhe shqetësimi i ri

Kibuceve ballkanik krehej diktatura e nëpër kampe e burgje zhveshej shpirti i saj. Në mure, gurë e letra cigareje shtoheshin fjalët, poezitë, librat – dëshmi e një fatumi njerëzor që përbirohej ferrit, që imagjinata e njeriut e kishte krijuar. Dhe ziheshin kibuc me kibuc. Por, kur u kanosej ndonjë e keqe, bënin çmos ta mbanin flamurin lart. Nëse nuk është truk policor, artikulli “*Titoja si e shpëtoi Enver Hoxhën?*” (Fjala është për vitin 1972, botuar në magazinën “MED” të Beogradit, shtator 1995. Me siguri do ta publikojë edhe ndonjë gazetë jona) dëshmon se në kibucet ballkanike kanë ndodhur gjëra nga më të pabesueshmet. Por morali i diktaturës është i tillë: Përshpëritje e perfiditet.

Secili fund është i tmerrshëm, se ndodhin të papriturat. Konvertimi i komunistëve në socialistë, partia e tyre në një parti më humane, sa mund të shlyejë nga kujtesa të kaluarën, atë këmishë të përgjakur? Dhe mbajtja e lidhjeve të vjetra me partitë e dështuara, sidomos në fushën e lirisë së individit dhe afirmimit të identitetit kombëtar, nuk di sa mund të jenë të arsyeshme, frytdhënëse në të mirë të vetë lirisë.

Në rendin e ri demokratik megjithatë duhet të ekzistojë seleksionimi, të mos them vigjilenca; as rrënimi i çdo gjëje s’e prish kontinuitetin e vlerave. Pakëz shqetësuese është kur lexon, bie fjala, në Kafën e Madhe të Shkodrës, dy këngëtare nga Beogradi (!) na paskan kënduar këngë edhe për Sllobodan Millosheviqin, Titon e vogël, siç e quan opozita serbe. Dhe nëse kanë kënduar dhe po kënduakan, në reportorin e tyre nuk paskan këngë të tjera që ftohën koka në këtë vapë ballkanike? Megjithëse, Shkodra nuk mund të merret me Slavica as me Cica, por ligjet demokracia nuk bën t’i ketë vetëm stolisje. Apo,

në Kuvendin e Jugosllavisë së mbeturinave, shpesh na ka rënë të dëgjojmë ultranacionalistin Sheshel: Ku janë dollarët e dhënë për destabilizimin e Shqipërisë?...

A nuk mjafton kjo për një zgjim gjithëkombëtar?

Repriza e qethjeve do të ishte e tepërt, bile trishtuese edhe për kujtesën e zotit Maks Velo.

MOS KEMI TEPËR ATDHE?

Nacionalizëm nuk është të duash abetaren, gjuhën, historinë, shkrimtarin, mitet, përrallat, atdheun tënd; nacionalizëm nuk është t'u këndosh prijsve tu të gjallë e të vdekur, të dëshmosh origjinën e lashtësinë tënde, të grithësh kujtesën e popullit, për ta mbajtur të zgjuar. Nacionalizëm është t'ia mohosh ekzistencën një populli; t'ia ngushtosh hapësirën jetësore-kulturore; t'ia përdhosësh gjuhën, historinë, shkollën, t'ia rrënosh majët, vlerat, identitetin e krenarinë kombëtare; t'ia imponosh memorocidin, harresën. Nacionalizmi në faqen e dheut, nuk sheh tjetër pos vetvetes; është një narcisoizëm me obstrukcion të thellë negativ. Në një mbremje letrare, në Munich, kisha thënë edhe shumëçka tjetër rreth kësaj fatkeqësie njerëzore, e cila rrënon jo vetëm atë që e ushqen dhe e ndan “tufën” nga qytetërimi, por edhe ata që i prek përreth.

Copëzimi i trojeve, copëzim i shpirtit

Në një qetësi olimpike, bavareze lexoja *Memoaret* e Hasan Prishtinës. Përpiqesha t'i gjej fijet e këputura të fatit tragjik, shkaqet e dramës kombëtare, lajthitjet, shkapërderdhjet e etnisë. Dredhakeve të përgjakura të viteve 1912, për të cilat mendonte të shkruante një libër tribuni ynë. Isha endur hamendjeve, dyshimeve e burrërisë, që nuk kishte qenë e paktë në një pyll Ballkanik. Rruga e H. Prishtinës mbeti rrugë tragjike. Ishte etiketuar, sharë e lavdëruar ngjashëm, siç veprohet në mjedisin tonë sot me shumë intelektualë e aktivistë. Harrojmë se lufta speciale kundër një populli bëhet kryesisht duke e përcarë atë dhe duke e pushtuar nga brenda. Sidoqoftë, prijësi kosovar kishte ecur një rrugë, të cilën e kishte mbyllur me vrasjen e tij nga dora e huaj. Brezat e mëvonshëm, e kuptuan dhëpërinë prandaj i dhanë vend meritot atij,

që kishte larë me gjakun e vet rrugët e Selanikut, qytet ky i Vilajetit të Janinës, i mbyllur fort në kujtesën tonë.

Brenda oborrit kosovar, brenda këtij vilajeti të errët, siç vazhdojnë ta quajnë shumë historianë, Hasan Prishtina kurrë nuk e shtroi, as nuk e pa çështjen shqiptare. Kërkesa e tij e parë, dhe e vetme, mbeti: *Të njëjten zyrtarisht kufijt e Shqipërisë*. Kurrë nuk kishte ëndërruar një Shqipëri xhuxhe prej 28 mijë km², as nuk mund ta merrte me mend. Atdheun e shihte të shtrirë në katër vilajete: të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit e të Janinës. Ideja e tij për etnikun nuk ishte kërkesë e një romantiku të vonuar, as utopi kombëtare formimi i shteti nacional. Me copëzimin e trojeve shqiptare shihte copëzimin e shpirtit të popullit, shthurjen e etnikumit.

Pas ca vitesh, më ra në dorë prapë *Memorandumi* (1986) i Akademisë Serbe. E rilexova. Qartë shihej projektimi i një Serbie të Madhe, pa të tjerët – krijimi i shtetit nacional serb. Asgjë të keqe, por anakronike, diçka iluzore, kundërvënia “kundër rendit të ri botëror. Keq me të gjithë”, një budallallëk që vetëm serbët dijnë ta bëjnë. Getoizmi i tyre shihej në horizont se megalomania paralajmëronte tragjikën e tyre të mëvonshme. Rëndë ishin atakuar popujt, deri dje “vëllezër”. Kërkohej, posaçërisht në Kosovë, “një luftë totale me të ashtuquajturin agresionin neofashist shqiptar”. Aq larg shkilet deri tek kontrolli i shtimit natyral të një populli. Kokat e “mençura” serbe konkludonin se lufta speciale e irredentës kundër popullit “qiellor” serb, bëhej mu me natalitet. Pra, atë duhet rrënuar me çdo gjë...

Egocentrizmi ynë

Mirëpo, ç’ngjet me partitë tona këndeje e andej Murit të Arbërit? Asgjë e re, do të thoshte Remarku. Le të valojë sa më lart bajraku i fisit, do të shtonte mediokri ynë. Nuk mendoj se partitë shqiptare duhet të kenë memorandume e programe nacionaliste çfarë i kanë fqinjët. Nacionalizmi është e zeza e vetvetes. Po ashtu, nga nacionalizmat e fqinjve nuk mësohet qytetërimi, as evropeizmi nuk troket në dyer tona të nxira. Nuk jam as për krijimin e bibliotekave të

urrejtjes ndaj të tjerëve, por çështja kombëtare nuk bën të zgjidhet në mënyrë parciale, pa një organizim gjithëkombëtar.

Ka nisur të thellohet harrimi i burrave tanë të devotshëm: kur çështja kombëtare ishte në rrezik, harroheshin hasmëritë dhe bajraçet, oxhaqet dhe gjaçet. Para tyre dilte populli i gjakosur, i uritur, i ndjekur, i sharë... Në lëvizjen tonë ka përjashtime e iniciativa të mençura, por do të dëshiroja pjesa dërmuese e anëtarësisë në partitë tona të mos lë përshtypjen se në to kanë zënë vend vetëm për ndonjë turizëm politik, që i vjen erë e lëvërdisë personale. Po ashtu, partitë nuk mund të shndërrohen në klinika për shërimin e komplekseve, egove. Egocentrizmi shpie tek tëhuajësimi, përçarjet dhe keqpërdorimi i lëvizjes gjithënacionale.

Është mjeruese *Kosova* e gjakosur, e shkelur, e rrahur, e helmuar dhe e nakatosur – ende të mos i bashkojë partitë shqiptare tej Murit të Arbërit! Ç’duhet të ndodhë me Kosovën që njeriu ynë të kthjellat se ajo që ndodh i vjen era asimilim, kolonizim, tkurrje të atdheut? Kosova, fatkeqësisht, përdoret si xhoker, gjatë zgjedhjeve e njiollosjeve ndërmjet partive, ose kur kërkohet të rrënohet një rend shoqëror. Trembëdhjetë parti u mblodhën në Tiranë, për të nënshkruar një kumtesë të përbashkët kundër rikonizimit të Kosovës me serbët tragjikë të Krainës. Dhe, siç shkruan M. Baze në gazetën “Bujku”: “për ironi të fatit ajo që nuk i bashkonte partitë në Shqipëri ishte Kosova”.

Dhe për çudi Brozi peshonte më rënd se Kosova martire! Si duket, ne shqiptarët nuk mundemi pa një Broz! (sic) Shkrimtari i veprave madhore “Ali Pashë Tepelena” dhe “Skënderbeu”, zoti Sabri Godo, ishte i vetmi që kishte ngritur zërin. Një për popull, e di shkrimtari i nderuar, nuk shkilet, as atdheu nuk mbrohet, duke mbajtur vetëm flamurin e fisit. Por Shqipëria, more zotërinj, nuk ka vetëm një Sabri Godo. Ku janë gjithë ata shkrimtarë e intelektualë, që nderohen e çmohen nga intelektualët e institucionet e Kosovës? Debatet e tyre të mos shndërrohen në tribuna nacionaliste, siç vepron Lidhja e Shkrimtarëve të Serbisë, por mendoj se, megjithatë, duhet mbrojtur dinjiteti kombëtar, guximi intelektual, njerëzorja, zëri i arsyes, lëvizja e rendit të ri botëror. As në *Promemorian* e 76 intelektualëve nuk

pashë emrat e atyre që më së shumti bëjnë zhurmë për do opzione fisnore në gazetetat bulevardeske shqiptare.

Kam përshtypjen se ne shqiptarët sillemi me veten thuajse jemi një popull më i madh se kinezët dhe se kemi aq shumë atdhe, sa ai shtrihet deri tek Oqeani Pacifik... Ne, patjetër, duhet ta gjejmë drejtpeshimin kombëtar. Të bëhet kjo edhe për hir të qetësisë së fqinjve. Po që se gjallërojmë prapë në katër-pesë shtete, do të thonë se partitë tona kanë qenë të paafta, se organizimi ynë ka qenë zero. Ky është primitivizëm nacional, që mund të krahasohet vetëm me getoizmin serb. Në fund të shek. XX nuk mund të kemi edhe një Toplicë, Çamëri. Apo, të pajtohemi se nuk mundemi të gjallërojmë pa lak në qaftë, pa robëri...

KUSH LUAN ME SHQIPTARI?

Atme e fe

Nderim çdo besimi, feje e tempulli! Asnjëherë nuk kam menduar, as do të mendoj, se cili besim yni ka shpëtuar – ndihmuar shqiptarinë, e cili do ta bëjë etninë. Në fund të shek. XX është qesharake të merresh me diç të kaluar. Nacionalisti (në kuptim pozitiv) dhe poeti e mendimtari i devotshëm i letrave shqipe At Gjergj Fishta e thoshte dhe e potenconte: *Atme e fe*. Pra, më parë e vinte atdheun se fenë. Moto e rilindësve u bë: *Feja e shqiptarit shqiptarja*. Kërkohej shtegdalje nga Pylli Ballkanik, gjallërimi e formimi ynë si etni e komb, pastaj le të besojë kushdo çka të dojë, kuptohet brenda kontekstit të kombëtares. Neve na mbetet të shikojmë se ç'na sjell e ardhmja pas këtyre kataklizmave njerëzore në Ballkan?

Nga ajo urtësi e rilindësve, që mbet urtësi mbi gjitha urtësitë e bashkimit tonë, mësova se shqiptarin kurrë nuk bën ta pyesësh i cilit besim është, se e fyen. Arsyeja: tek ne feja asnjëherë nuk lozi rol vendimtar. Mbet punë e ndërjegjies, e atmes, e ekzistencës, e ngadhënjimit mbi të keqen, që na shtrëngon lakun tash e sa shekuj. Enigma jonë, mozaik i besimeve dhe ëndrrave tona, mahnitë shumë popuj më të mëdhenj e me një traditë të thellë qytetërimi. Pse shqiptarët mbetën popull tolerant ndaj çdo besimi, dhe pse nuk pranuan ndasitë, nuk do kurrfarë komentimi. Bën të shfletohet nganjëherë edhe *Kanuni* i Lekë Dukagjinit.

Aksidentet nuk mundën të shkaktojnë përcarje

Nëse pranojmë se jemi pasardhës të ilirëve dhe se ata ishin të besimit pagan, atëherë qesharake është të shtrohet problemi i feve, që

tek ne nuk ekziston. Aksidentet që ndodhën më vonë, për fat nuk mund e lëkundën mirëkuptimin e paqjen brendëpërbrenda qenies sonë kombëtare. Ata që u ndanë nga ne, i hangër harrimi. Po ashtu, çdo gjë jona, që u pranua nga metropolet e oborret, nuk u pranua për shkak të përkatësisë së besimit: Shën Albani vinte nga Iliria dhe përhapte mirëkuptimin ndërnjerëzor tamam siç vepron sot Nëna Terezë; shën Jeronimi i fisit dalmat, që në shek. IV ua bëri të mundshme evropianëve leximin e Biblës, përkthimi i të cilit sot e gjithë ditën përdoret në Vatikan me emrin *Vulgata*, pastaj muzikari Dardani, Justiniani, Hoxha Tasini, De Rada, Kavaljoti, Marko Boçari e deri tek Kadareja. Dhe shumë të tjerë vazhdojnë të pranohen si vlera mendore – njerëzore të gjeniut të popullit që i përkasin.

Kam konsideratë të posaçme ndaj Kadaresë. Ia kam ngrënë edhe bukën, por nuk më duket aq bindës (ndoshta ky është cinizmi i tij), siç nuk më duken as shumë të tjerë se çështja shqiptare do të ishte zgjidhur po qe se ne shqiptarët të kishim qenë të besimit katolik (Sic!). Të mbështetnim këtë mendim, shtrohet pyetja: Po Kuvajti, mos na ishte tokë katolike kur Evropa e mori në mbrojtje: Ishte nafta para fesë; ishte interesi për tregje të reja; ishte dominimi i forcës, që mund ta lexosh si të duash. Dhe nga shumëçka tjetër shihet se Evropës politike më së pakti i kërset për fe. Ajo nuhat lëvërdinë e vet.

Gjeniu shqiptar nga Evropa

Ne shqiptarët ka vite që ëndërrojmë ta shohim veten në gjirin e Evropës, por asnjëherë nuk kemi ditur të bëjmë koncesione me të. Flertimi ynë ka qenë i shterpët, do të thotë nuk ishim seriozë, këmbëngulës në kërkesat tona. Gjithmonë diçka ka munguar sa shpesh na është shfaqur divorci. Rreshtimi ynë ishte i gabueshëm. Disa dekada anuam nga nuk duhej, kujtoni “dashurinë” me fustan të përgjakur me rusët, pastaj atë me kinezët; vetizolimim me “goditje” të përqëndruara. Dhe, për kë ato goditje: Për rrënimin e vetvetes! Kujtoni pastaj mbylljen hermetike ndaj perëndimit ku ishin shkolluar e ngritur kokat tona më të njohura të artit, politikës e guximit intelektual

e kombëtar. Mos e harroni edhe Murin e Arbërit, që likpërmjet trojeve tona gjarpëron. Dhe, nuk mund të harroj një pyetje, që ma kishin bërë në një mjedis intelektualësh në Tiranë: Kur shkoni në Zagreb, Lubjanë, Sarajevë, Beograd – a shkoni me pasaportë? Unë isha shtangur. Kisha përshtëritur vetëm: Do zoti e vjen ajo ditë. Nga përpjekjet tona lë përshtypjen se në Majë të Evropës na pëlqen të dalim si bajraktar jo si kolektiv.

Viktimizimi ynë është gati një zero e madhe. Shumë pakëz bëjmë për lirinë e atdheun! Me tre për qind, bie fjala, a mund të mbrohet atdheu, shkolla e libri ynë? Nuk mund të ndërtohet asnjë kulm. Ku keni parë me troha të mbahet një popull? Ndërkaq, këngët tona sa nuk pëlcastin nga jataganat e britmat e micsokolëve.

Unë Evropën kurrë nuk e kam shikuar si tokë a pronë e besimit katolik, protestan, ortodoks e ku ta di: as nuk më ka shikuar ndërmend se gjallëroj në një kontinent ku besimi është në krye të toplistës. Evropën e shikoj si djep të qytetërimit bashkëkohor ku nuk mungon as kontributi i gjeniut shqiptar. Pra, Evropës duhet imponuar me vlerë, me dinjitet, me guxim intelektual, me humanizëm, me karakter të fortë, bile edhe me qortim të rëndë, para se gjithash, me atë shqiptar – jo të këtij apo atij besimi. Koha e klounëve, e servilëve dhe oborrtarëve ka kaluar për metropolet evropiane.

Zgjidhjen e çështjes kombëtare, pra, nuk duhet kërkuar në përkatësinë fetare, por në forcën e organizimit tonë të brendshëm si vlerë e komb. Të vajtosh se nuk po zgjidhet çështja jonë pse nuk jemi të tillë apo të atillë, në një farë mënyre rrënon edhe atë grimë kujdes që Evropa po treguaka për çështjen shqiptare.

Simpatitë e përkrahja janë të rrezikshme

Mirëpo nëse Evropa vazhdon të kërkojë qime në vezë; se atë e pengon diç nga ndërtimi ynë shpirtëroro-mendor dhe se nuk po i përkëmbim përnjëmend besimit të saj, atëherë ky është problem i vetë Evropës – i ndërgjegjes së saj, i egoizmit të saj, i humanizmit të saj. Nga evoluimet që ndodhin shihet qartë se njerëzimi nuk vete nga

asimilimi ose korrigjimi i besimeve, por nga përsosja e tyre në të mirë të qetësisë e harmonizimit të shpirtit njerëzor – të mirëqenies gjithënjëzore. Simpatitë dhe përkrahjet janë të rrezikshme. Shkohet nga humnera e përbashkët. Këtë Evropa e ka të qartë.

Kush luan me shqiptari

Në këto kohë të liga ndjej dhembje kur dikush ndahet nga ne dhe pa të keq, ndoshta, prek shpirtin shqiptar. Nga ai përpiqet të nxjerrë derivate që, pavetëdijshëm, rrënon edhe atë pakëz fuqi që na ka mbetur në konsolidimin e qytetarit (Njeriut), shtetit dhe kombit tonë, siç tha një lider. Nuk dua të akuzoj askë. Por rruga nuk na shpie në oborrin e etnisë nëse kush nga ne besimin e vet e mban për bajrak kombëtar.

Do të turpërohesha të mos e them një të vërtetë: Nuk mund të kthehem nga Evropa pa bërë një sy gjumë e pa ia hëngër bukën Palit, Belushit, Franës, Di Maxhos, Gjeloshit, Sebes, Italos, Xhebelikos, Altimarit, Zefit e shumë të tjerëve që asnjëherë nuk i kam pyetur, se nuk kam dashur t'i fyej me atë pyetjen stereotipe: I cilit besim je, por a mendon si unë rreth zgjidhjes së çështjes kombëtare? Dhe në emër të miqve të mi, pra, kam të drejtë të pyes: Kush luan me shqiptari?

Për mediokrit nocioni *Rilindas* është i demoduar, ndoshta: Por unë kam dëshirë dhe ëndërrroj t'u ngjaj sado pakëz urtakëve tanë që më parë e vinin atdheun se fenë...

Pjerdhë Evropën ç'thotë për mua (popullin)... Kështu mbylla një poezi para dy dekadash. Do të dëshiroja që kohët e ardhme të më demantojnë. Edhe skribomanët... Unë nuk e kam kompleks Evropën. Vetën prandaj e ndjej të lirë si individ.

KOSOVA, SY QË LOTON

Njëherë duhet të marrë fund edhe udhëtimi ynë

Nuk di, ta mbyll maratonën e të pajtohem me qyqarllëkun? Kokat kryesore i kemi mbi supe. Dejtoni, Parisi, Londra, Boni kaluan pranë nesh e habere e habere. Ne mund të vazhdojmë ritualin tonë, të bëjmë sehir dhe të shahemi si në Mëhallë të Madhe. Por mua, ajo që më mundon, është: Kosova, mbet sy që loton! Disa herë pavarësia e saj trokiti nëpër dyert tona, por burrëria jonë: vetëm njëri-tjetrit t'ia nxijmë jetën. Keni dëgjuar ndonjëherë këngë micsokolash a kanë popujt e mëdhenj e të civilizuar? Tek ne mendohet se liria pikë nga qielli, ose shitet diku në Bit Pazar të Shkupit tonë, në çarshi të Madhe të Gjakovës apo tek Taphanet e Pejës.

Megjithatë, nuk jemi popull pa fat. I kemi të gjitha. Evropa është e jona. Kur të duam e lakuriqojmë. Ia pijmë qumështin na thithmat e shumtë. Po ashtu liri kemi sa të doni. Por ajo qenësoria ruhet thellë në ne. E mbështjellë me fjalë e shpresa tona. Nuk ka arsye të dëshpërohem. Përkundrazi, pakënaqësia na është ai motor ynë magjik, që na kujton se lëvizet për të gjallëruar. Njëherë duhet të marrë fund edhe ky udhëtim yni.

Me vete bart bekimin e saj

Duke shkruar këtë tekst, kujtoj edhe një mik timin nga fëmijëria. Ishte më i vjetër se unë nja gjashtë vjet. Nga ai kisha mësuar shumë gjëra. Në mes të tjerash, edhe si duhet atdheu në momente më të vështira. Gati identike me atë që e kishte thënë M. Kuteli. Ose, kujtoni më shpesh poezinë e Luigj Gurakuqit “*Qindresën*” e pastaj peshoni burrërinë. Nëna e mikut tim, aty rrëzë Çabratit, në një shkollë

dykatëshe, e ngjashme me këto të sotmet, m'i kishte mësuar germat e gjuhës sonë, përrallat e para për trimat e kombit. Se si dukeshin Skënderbeu, Ali Pasha, Baci Bajram, unë veç i shihja gati perditë duke zbritur nga fjalët e saj tek uleshin diku aty në klasën tonë të ngushtë.

Kremtohej nëntëdhjetëvjetori i Naim Frashërit (1971) dhe një natë me shi, pas disa vitesh, takova mësuesen time në skaj të Tiranës. Nuk ishte mplakur fare. Po ky ishte takimi ynë i fundit. Me vete bart bekimin e saj.

Librat e mikut

Agim Gjakova, i ndjekur dhe i presekutuar, student shembullor i Universitetit të Beogradit, qytetar i "lirë" i Kosovës, në mbarim të viteve të gjashtëdhjeta, një mëngjes e kishin hipur në një xhip policie. Pa teshekoteshë e kishin fërfëlluar tej Murit të Arbërit. Arsyet: irredentist, i papërshtatshëm, nacionalist, nip i Haki Tahës, që kishte nderuar kombin, e ku ta di. Agimi gjendej në gjysmën e rrugës së krijimtarisë letrare.

Ditën kur e kishin nxjerrë jashtë Kosovës, kishte të veshur një pallto të gjatë e të zezë, të blerë me honorarin e "Rilindjes" për tregimin e shpërblyer në konkursin e saj letrar. Për shifërën mbante nr. e qelisë së Burgut të Beogradit. Sapo kishte shkelur në Shqipëri, kishte vazhduar punën e tij prej intelektualit e krijuesi. Por libër pas libri, ishte bindur se çështja e Kosovës pak kë e shqetësonte. Pesëmbëdhjetë poezitë kushtuar mikut të vet Adem Demaçit, një dorë e padukshme, kishte lënë vetëm inicialet A.D. Kë frikësonte përkushtimi i një miku, që tej Bjeshkëve të Nemuna dergjej nëpër kazamate? Le të mbesë kjo çështje e ndërgjegjes së atyre, që dëshirojnë ta shohin Shqipërinë vetëm xhuxhe.

Dhe, kishte ndodhur ajo që nuk kishte besuar. Me 23 gusht të vitit 1979 nga drejtori i Shtëpisë botuese "Naim Frashëri", Thanas Leci kishte marrë poeti një shkresë, ku njoftohet pse libri i tij më i ri nuk mund të botohet. Me ca shkurtime e sjell atë për *ndërgjegjen historike*. Lart, në të majtë – emblema: Republika Popullore Socialiste e

Shqipërisë, nën të: Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Nr. 366 Prot. Drejtuar: Shokut Agim Gjakova, Shkolla 8-vjeçare “Avni Rrustemi”, Tiranë. Dhe teksti:

*“Për mundësinë e vëllimi poetik **“Rrënjtë po përtërriben”** me atë strukturë që e kishit ndërtuar, e shqyrtuam dhe në drejtori duke marrë dhe mendimin e disa shokëve të kolegjiut rezultoi se në këtë gjendje nuk mund të botohet. Pa përmendur ato vërejtje që in ka bërë me shkrim redaksia me të cilat jem plotësisht dakort, ju thekësojmë dy të meta themelore që dorëshkrimin e paraqitur e bëjnë të pabotueshëm:*

E para: Në vëllimin nuk gjen asnjë poezi kushtuar realitetit tonë socialist, transformimeve të mëdha që ndeshin në vendin tonë. Trajtimi i temave të mëdha, i luftës së madhe të popullit tonë nën udhëheqjen e Partisë për ndërtimin e socializmit dhe shpartallimin e bllokadës imperialisto-revizioniste, roli i klasës punëtore në shoqëri etj. janë në rënd të ditës për krijuesit tanë. Me një fjalë nuk kërkohet nga ju të shtoni katër apo pesë poezi nga realiteti ynë, por kërkohet që kjo të zërrë vendin kryesor.

E dyta: Gjuba që përdoret në mjaft poezi është e paqartë, e errët. Gjenden në vëllim dhe poezi të tëra hermetike, të paqartueshme për lexuesin, shfaqje këto që janë luftuar nga partia, sidomos në Plenumin e katërt...”

Dhe mbyllet shkresa me imzan e drejtorit, të cilën poeti A. Gjakova e vuri në krye të librit si *Parathënie*, që doli gati pas dy dekadash në botim të Euro-Rilindjes (Tiranë, 1995).

Në të vërtetë, ç’kishte libri i Agim Gjakovës? Kujtime të zymta e vuajtjet e bashkëndasve të tij të Tejmurit; Kosova e kurthuar nëpër vargje e pagjumësi, plagët e saj të mbështjella me shami nënash e këmishash të përgjakura martirësh; kurajoja qytetare e dinjiteti kombëtar, ëndrrat e klithmat nga fundi i botës që quhej *Kosovë*; disa trokitje në ndërgjegjen historike për vetëdijësim kombëtar. Se Shqipëri kishte, për fat, edhe tej Murit të Arbërit. Mirëpo, deklamimi i hapët se paska Shqipëri edhe Tejmurit, ishte e rrezikshme dhe e dënueshme nga Nëna Parti, nga Kreu dhe të shpërlarët nga ndjenjat e atdhedashurisë. Kërkohej të pikojë edhe pika e fundit e helmit e Kombi të bindet se vërtet Shqipëria fillon e mbaron aty ku fillonte e

mbaronte. Dhe ajo farë Shqipërie Tejmurit (e Jashtëmja – M. Kuteli) na qenka pjellë e ëndrraxhinjve..!

Nuk dua të merrem me mjerimin tonë kombëtar, as të zhvesh servilitetin e një Shtëpie botuese, që mban emrin e rilindasit me nam, të bardit kombëtar Naim Frashëri, por në atë tekst është edhe një fjali që fyen gjysmën e kombit: *Gjuha që përdoret në mjaft poezi është e paqartë, e errët...* Një mendim i tillë marroç nuk pran as tani nga tejmurasit tanë. Është shndërruar në një slogan, që largon e nuk pranon të veten gati asgjë që krijohet këndejmurit, Vështirë të bindësh ca se edhe kjo, që krijohet tek ne, është kulturë shqiptare. Dihet, po ashtu, se përçarjet e çfarëdo natyre shpiejnë nga zbrazja e hapësirës jetësore-historike, ose tek ata, që na shohin me syrin e gastartë – shqiptarët na qenkan njëfarë simbioze prej dy popujve. Dhe, cili shërbim derdh para për këtë çmenduri tonë intelektuale?

“Rrënjët po përtërihen” e panë dritën me një titull tjetër: “*I gjuaj ëndrrat me gurë*” Dhe, kur e lexon tani këtë libër të vonuar – poezi pas poezie, nuk mund të mos bësh pyetje vetes: Shteti shqiptar, mos frikëson nga Shqipëria etnike? Kënaqet me atë pëllëmbë tokë të shpëtuar nga përbindëshit, të mbyllur si në një konzervë, që vështirë mund e çelë edhe revolta e poetit: *Sa të coptuar të kanë lënë Shqipëri!...* Ky është lajtmotivi i veprës së Agim Gjakovës, që i kishte venë embargo censura moniste shqiptare.

Për të ardhmen tonë nuk fajësoj tani Dejtonin, Londrën, Parisin, Bonin; fajësoj *orën* tonë, që nuk ra kur u desh. Si duket maratona jonë tek ka filluar. Evropa ka zënë të zbresë më shpesh ndër ne dhe minishtetet nacionale të formuara vonë në Ballkan, të kuptojnë se pa formimin e shtetit etnik shqiptar nuk mund të ketë qetësi në bisht të Evropës...

Liria jonë, zgjim nga ankthi ballkanik apo jo?

SHQIPËRITË

Me rënien e komunizmit në hapësirën shqiptare u lëkund pakëz miqësia dhe komunikimi në mes njerëzve. Fjalën *demokraci* e kuptuam më tepër si qerim hesapesh se sa rindërtim të qenies. Shpesh ajo merr formën e një diferencimi, izolimi të njerëzve, heqje dorë nga ndonjë mendim i guximshëm. E kuptuam demokracinë se *patjetër* duhet mbështetur në njerëz “tu” – të nahijes, të farefisit, të bajrakut, të mëhallës e kulmit. Nëse është e mundur, bën të jetë edhe nga shtrati. A nuk ekziston këtu pakëz *nepotizëm*? Po mendimi ynë, sa mund të jetë demokratik kur gati të njëjtat metoda (me pakëz modifikime) i vëjmë në veprim, siç i vinin dikur monarkët? Nuk jam se nuk duhet dënuar krimi, por ne kurrë nuk po lirohemi nga krimi. Le përshtypjen se bëhet garë në mes njerëzve se kush është patriot më i madh. Po ky patriotizmi ynë aq fleksibil na është, sa një rrenë e lëshuar diku në Çarshi të Madhe apo në Lagjen e Pleshtave, mund të rrënohet si fluskë sapuni.

Shqipëria e jashtme

Unë rrallë dal në Kryeqytet. Dhe kur dal, bëj gjumë shpesh tek Dritëro Agolli. Këtë e di edhe më i Madhi, që e çmoj. Po ashtu, miqtë nuk i zgjedhi sipas bindjeve momentale politike. Miqësinë nuk e kuptoj, siç e kuptojnë neobolshevikët. Metropoleve, nëpër tribuna të ndryshme, kam takuar njerëz që gjatë debateve të rënda sa nuk rrahen, por kur dalin nga salla ulen bashkë dhe pinë kafe thuajse asgjë nuk kishte ndodhur në mes tyre. Tek ne ndodh diçka tjetër: toleranca zëvendësohet me primitivizmin më të rëndë.

Dritëron kam dëshirë ta takoj kur e ka shkruar ose e shkruan ndonjë poezi apo tregim të bukur. Atë ditë ai ndrit nga gazi e humori. Por nëpër barcoletat e mendime të ngutura shpesh, që nxitojnë t'i publikojnë gazetatat bulevardeske për qëllime të tyre që vetëm ato i dinë, nuk e kërkoj mikun tim, as nuk kam dëshirë ta gjej. Barcoletat e mendimet e papeshuara zvetnojnë personalitetin e tij si krijues, qesin hije të keqe mbi “*Shkëlqimin e rënien e shoku Zylë*” dhe të ca veprave të tjera të ndaluara që në kohën e monarkut.

Nuk dua të flas për kohën e tij kur ishte kryetar i LSHASH, se nuk di gjë. Mirëpo, Dritëro Agollin dua ta zë, para se gjithash, nga rrafshi që na mundon të gjithëve: *Çështja kombëtare*. Ai pajtohet se politikën pakëz ose aspak nuk e njeh, por atë nuk e lënë të qetë dy Shqipëritë: e brendshmeja dhe ajo e jashtme. Dhe kur e vë gotën në buzë, e di se çdo gjë do të ndizet. Vërej atëherë se nocioni *Shqipëri e Jashtme*, nëpër fjalët e mendimet e tij, ka një dimension e peshë më të rëndë seç të thuash, bie fjala, *Kosova, Çamëria apo Maqedonia*. “Me ecjen e shek. 20-të në Ballkan kanë ndodhur përmbysje të mëdha. Kanë rënë perandori dhe mbretëri. Janë ndërruar regjime politike dhe shoqërore, janë zëvendësuar ideologji dhe rryma filozofike, por vetëm një gjë për ne shqiptarët nuk ka ndryshuar. Shqipëria ka mbetur e ndarë përgjysmë si popull dhe si tokë, e ndarë nga fuqitë e mëdha në dobi të fqinjve tanë...”

Tragjedinë kombëtare, që është njëherësh edhe tragjedi njerëzore, me plot zë e thekson kudo dhe nuk e fajësoj pse nuk na ka shkruar ende një poezi për Kosovën apo Çamërinë, siç ka shkruar I. Kadare, F. Arapi, Xh. Spahiu e shumë të tjerë. Kjo nuk do të thotë se ai nuk e qan hallin e viseve të *çkombëtarizuara*. Përkundrazi imazhi i atdheut xhuxh zhdaravit ëndrrën e tij: “Rënia e komunizmit ndryshoi edhe kufi konceptesh edhe kufi gjeografikë dhe jehona e kësaj rënie do të ndryshojë edhe mjaft gjëra të tjera. Me rënien e komunizmit edhe mjaft ligje e nene të Kartës së Helsinkit janë vjetruar... Po të vijmë tek *çështja shqiptare*,

shekulli që po mbaron nuk e zgjidhi problemin shqiptar në Ballkan...”

Do të thotë se do t'i kemi prapë dy Shqipëri.

Vetëm bibla është e pandryshueshme

Ka ndodhur me ditë, me net të bisedojmë me Dritëron rreth çështjes kombëtare si dhe rreth nocionit *demokraci*. Mendimi i tij është kategorik: “Në Shqipërinë e brendshme dhe në Shqipërinë e jashtme edhe demokracia mbetet gjysmake, mbetet një demokraci e paktë me një horizont të ngushtë, një demokraci provinciale, e fyer... Sepse ngushtimi i popullsisë dhe territorit sjell edhe ngushtimin e vetë demokracisë. Kjo ndarje e Shqipërisë në dyshë gymton njeriun dhe prish moralin...”

Në tryezën e punës shfletoj ndonjë libër më të ri. Shoh se miku im është esull; ende nuk e ka afruar gotën tek buzët, as ka treguar ndonjë barcoletë. Dikur mbush një gotë, pastaj edhe një: “Ne themi, me gjuhën e diplomacisë, se kufijtë janë të pandryshueshëm pasi këtë ndryshim nuk e paska Karta e Helsinkit, *Bibël* na qenka? Vetëm Bibla është e pandryshueshme...”

Biseda ime me mikun përfundon aty tek *Bibla*.

Pa marrë parasysh se Dritëroi nga një komunist u konvertua në një socialist, me opcion të vet për demokracinë, revoltën e tij prej krijuesi e lexoj si revoltë të një populli të ndarë padrejtësisht, që vështirë do të njëzohet.

Dhe hap notesin tim: Ne shqiptarët kurrë nuk kemi pasur kokëçarje me popullin serb (lexo si *popull*), në raste më të vështira e kemi ndihmuar njëri-tjetrin. Por ne shqiptarët kemi pasur e do të kemi probleme të mëdha me politikën e krerëve të tyre, e cila është politikë hegjemoniste, pushtuese, asimiluese dhe jociivilizuese. (Abdi Baleta në një shkrim të tij, për këtë problem mendon ndryshe. Është më radikal. Barazon pushtetin me

popull!). Çfarëdo autonomie t'i jepet Kosovës, çështja shqiptare mbetet e hapur. Nuk evitohet as konflikti i mëvonshëm në mes të dy popujve.

Dritëro Agolli tha: Vetëm Bibla është e pandryshueshme. Pse të mos lëvizin kufijtë për hir të drejtësisë, të qetësisë e mirëkuptimit ndërbalkanas.

Por hallin tonë kush të na dëgjojë kur çdo gjë peshohet me kandar të të fortit!

A KA DRITË NË TUNELIN TONË

Udhëtimi për në Atdhe

Për ne shqiptarët *kufiri* u bë problem nga ajo ditë kur na bënë pikë e pesë. Unë nuk jam nga ata patriotët që me një kërcim kenguri e kalojnë atë larë të pafund të lëkurës së tigrin, bile pa një therrë në këmbë. Kur marr udhë për në Kryeqytet, udhëtimi im zgjat disa ditë. Dhe, shpesh miqtë e mi Kim Mehmentin, Emin Azemin e ca të tjerë i bezdis me atë kokën time në thes. Romanin e Kadaresë “*Pashalleqet e Mëdha*” nuk nguten ta kryejnë se nga cilido qytet i vilajeteve tona të nisesh, do të bindesh se vërtet ka momente kur kokën gjatë udhëtimit njeriu e vë diku nën sjetull. Se kufiri mbet thikë e ngulur në mishin tonë, të cilën nuk dihet kush do ta shkulë. Rreth këtij problemi tragjik kam lexuar shumë shkrime e vepra nga krijues tanë e të huaj dhe të gjitha ato kanë vetëm një këshillë: Muret duhet rrënuar edhe nëse vetë murohesh! A nuk iu kujtohet Kavafisi?

Me një nëntor duhej të isha në Tiranë në mbledhjen e jurisë për ndarjen e çmimit “Kadare”. Por unë isha nisur nga data 28 tetor. Thashë se unë nuk jam patriot. Udhë ime është me plot befasi të cilat dua t’i përballoj në mënyrën time. Ndoshta, mu për këtë kam vendosur të heq dorë nga fjalët e mëdha. Kam frikë nga bubullimë e tyre. Materia tepër, tepër e konsumuar më bezdis, posaçërisht më bezdis kur mediokërt shkumojnë pranë ujërave të zeza.

Diku në një qytete të Iliridës ende nuk e kisha pirë kafën kur një mik m’i hodhi para poezitë e mia të përkthyerë në gjuhë daneze. Vasil Popeski (Vasko Popa) më thoshte se çdo gjë duhet shënuar për hir të brezave. Për poezitë e përkthyerë nga Palle Rossen, nuk dija fare. Përkthimi ishte bërë nga gjuha gjermane. Pra, nga përkthimi i mikut tonë, Hans Joachim Lanksch. Dhe derisa e shfletova ato, m’u kujtuan

kohët e hershme kur mediokriteti ynë vraponte për të dalë sa më parë në gjuhën e Vukut. Përkthimet i bënin vetë, se fqinjët tanë nuk e dinin një fjalë nga gjuha e Buzukut! Kisha dëgjuar pastaj se kishte raste kur ca nga ata të gjorë kohën e kalonin para pasqyrës me “Jedinstvon” në dorë. Qesharake pakëz, por Evropa për disa mbaron në Leposaviq.

Bindem se Danimarka nuk mund të jetë Gjermani.

Ditën e pestë shkela në Kryeqytetin e atdheut tim xhuxh. Fjalën e parë që ma tha një mik ishte: Tej Murit shumë paskan vdekur! Dhe vërtet, kurrë më shumë nuk është vdekur në Kosovë se tani. Iku Mirko Gashi, Gani Bobi; tani na lanë Antonët: Pashku dhe Çetta...

Atdheu im xhuxh, *pashë se kishte nisur të zgjohet*.

Fshehtësia e gjakut

Kam përshtypjen se ne nuk do të ishim ata që jemi, as do të na quanin shqiptarë të mos na ndiqte pas tragjika. Nuk njoh njeri tonë që nuk ka një gërvishje në jetë. Çudë! Afrohej dita kur duhet të zbriste *Ernest Sabato* në dheun e të parëve të tij, por lajmi nga tejoqeani ishte i kobshëm: kishte humbur djalin “i cili ishte ministër i arsimit, një talent i madh, me vlera njerëzore dhe morale të jashtëzakonshme”, i shkruante zonjës Mira Meksi. Letrën e tij e përcillte një shqetësim i madh njerëzor i cili, më bëhej, se dilte nga fundi i shpirtit. Sabato, megjithëse shpesh thotë: “Asnjëherë nuk është fort i ndërgjegjshëm për ato që shkruan. Personazhet, bota e fiksonit dhe fati i tyre ecin nëpër udhë të përcaktuara nga forca që nuk manovrohen nga autori”. Lexo: edhe Njeriu.

Nga leximi i parë kisha parë Sabaton tek dilte nga tuneli me atë tragjikën personale në shpirt. Por fjalët e tij në letrën dërguar zonjës Mira Meksi: *Nuk dua t'i mbyll sytë pa i parë malet e Shqipërisë*” zbulonte fshehtësinë e gjakut që tërë jetën e kishte munduar-kërkuar: “Kur Gjergj Kastrioti nuk pati më forca të luftonte kundër ushtrisë otomane, dhe shkoi në Napoli për të hyrë në marrëveshje me mbretin burbon, arriti që mijëra e mijëra shqiptarë të pranoheshin të

vendoseshin në jug të Italisë, në fshatra ku mund të ruanin gjuhën, zakonet dhe fenë e tyre. Stërgjyshërit e mi u vendosën në Santo Martino de Finita, në Kalabri. Figura e Kastriotit, së pari në Turqi dhe më pas në atdheun e tij, përherë më ka krenuar, dhe në dhomën time të punës kam një portret të bukur të bërë në Venecia me emrin SKANDERBEG”.

Duke lexuar letrën e Sabatos më parafytyrohej një gjeni tjetër i letrave shqipe, Faik Konica, *Testamenti* i tij rrënoqethës: *Nuk do të më tretë dhen...* Ishte gati identike me dhembjen e Sabatos: *Nuk do t'i mbyll sytë pa i parë malet e Shqipërisë*. Në kujtesën e shkrimtarit të nderuar ç'forma mund të kenë ato male, një zot e di. Por në mes dy gjakimeve të të dy krijuesve të mëdhenj, që kurrë nuk kishin dëgjuar ndoshta njëri për tjetrin se jetonin në dy kohë kur i thanë këto fjalë më se njerëzore, mbetet e vërteta: *fshehtësia e gjakut nuk varroset...*

“*Tuneli* është romani i dëshpërimit dhe i moskomunikimit, është roman i një njeriu maniak që bredh pas të pakapshmes – dhe e pakapshmeja është kthimi në fëmijëri”, përfundon zonja Mira Meksi në një shkrim kur Sabato me gjasë kishte parë atë dritën e vogël në fund të tunelit që vazhdimisht i zmadhohej dhe kur ishte nisur në drejtim të saj, tek sa dilte, kishte ndodhur fatkeqësia. As kësaj here nuk zbriti në Shqipëri, megjithëse nuk kishte probleme me pasaportë si unë.

Mirëpo ekziston një forcë që njerëzit i bashkon: Ajo është *dhembja*.

Hyrja në Kryeqytet ishte më se e mundimshme se ne jemi popull i pafat nga se nuk ditëm t'ia përcaktojmë fatin vetes nga dita kur na derdhen. Për irlandezët Bernard Sho thotë: Janë njerëz të lezetshëm. Ata kurrë nuk flasin mirë për njëri-tjetrin. Nga kjo vuajmë edhe ne. Dhe, përderisa nuk e kuptojmë se liria është e të gjithëve, udhëtimi ynë vazhdon tunelit të mistershëm. Por në këtë tunelin tonë, unë ende nuk shoh dritë...

INSERTE

1) Befasinë e kuptova në mënyrën time. Në vendin e dikurshëm të “Rilindjes” renditeshin stendat e botuesve kurdë. Në të djathtë, pak më larg, të palestinezëve. Nuk është shenjë e keqe kjo. Të përndjekurit dhe të dënuarit ktheheshin. Parandjej se kjo ndodh edhe me “Rilindjen”. Shkëputja jonë nga nata e tmerrshme pansllave ka zënë të bëhet kokëqarje edhe për metropolet.

2) Derisa i shikoja librat në gjuhën kurde, që me asgjë nuk dallonin nga përgatitjet e atyre evropiane, mbi krah ndjeva peshën e një dore. Ishte miku im i vjetër nga Llapi. Çdo vit na vizitonte. E pashë se vështirë i qeshej. Një dhembje i përhapej nëpër fytyrë. Do të kthehem në prapë, i thashë. Më përqafoi fort dhe për çdo gjë më pyeti, i thashë: Në vend i ke. Edhe gurët, edhe varret. Dikur ia pranova se kam qenë tepër i lumtur kur Teatri i Podujevës vuri në skenë “*Lum Lumi*”. Po ata të mitë gati ta kishin pas hequr flamën, tha pakëz në gaz. Kur lënim kurdet, miku im u kthye prapë. Aty mbi një tavolinë la një karafil, që e mbante në dorë. E kuptova pse e bëri këtë.

3) Është viti i pestë që nuk ekspozon “Rilindja” në Panairin e Librit në Frankfurt. Kjo tregon se dhuna serbe ka qenë tepër e madhe ndaj librit tonë. Njëherëz tregon dhe frikën e tyre nga ai. Me vitet nuk pranë gazetatat: Plisëbardhët ishin të urtë! Erdhën këta shkollarët e na i qiten maleve. Ka gjëra që nuk harrohen. Me rëndësi të mos rrokulliset edhe më guri.

4) Kadareja është kaptinë më vete. Kishi më kishte thënë në një takim: Ai heq më rëndë se tërë letërsia serbe. Nuk ka botues, që nuk ka diç nga veprimtaria e tij. Vetën e ndjen më shqiptar kur kalon para stendave të metropoleve. Populli yt i dha vlerë që pak kush e ka. Ka vite që as Kadareja nuk e bën udhëtimin vetëm.

5) Kur shkela për herë të parë në Aeroportin e Frankfurtit, kisha pasur ca telashe me vigjilencën gjermane. Më tepër se një orë

dokumenti im kishte shëtitur nga dorë më dorë. Nuk dija gjë se mu atë ditë kur kisha zbritur në Frankfurt një aeroplan gjerman e kishin kidnapuar palestinezët. Dhe atje në Gadishullin Arabik e kishin ulur me dhunë. Faca dhe kaçurrelat e mia i kishin tmerruar. Mua më kishte ardhur për të qeshur. Vigjilenca gjermane kishte humbur qetësinë. Ç'poet do të isha po të mos kisha fërkime edhe me njerëzit e rendit. Tani kur shëtitja me mikun tim nga Llapi, më bëhej se i kam të njëmjat. Assesi nuk e pranova atë që e thoshte ai. Poetët, megjithatë, janë perëndi që nuk plaken kurrë.

6) Dikur u gjetëm para botuesve të shkapërderdhur shqiptarë. Mungonte ende përgatitja e mirë e librit, po ashtu dhe hapësira e tij. Çdo gjë të botuar e kishin vënë në stenda. Panairot nuk ekzistojnë vetëm për qëllime financiare. Para se gjithash, aty reklamohen-propagandohen vlerat shpirtërore të një populli. Letërsi kosovare, siç shkruante dikur, nuk më ra në sy. Edhe të Tejmurit e kuptuan, më në fund, se gjithçka mund të copëzohet pos shpirtit. Ne nuk jemi aq të varfër, por propagandën e kuptojmë si manir të Evropës. Aty mbet miku im dhe unë u nisa për në hotelin "Marriot".

7) Rast i mirë të takohem me Zajcin, Shallamonin, Jançarin, Zilobecin. Kishin ardhur heshtas për këtë manifestim. Në të vërtetë, populli sloven në mënyrë dinjitoze, prezentonte vlerat e veta dhe në njërin nga sallat e shumta të "Marriotit" Ministri i kulturës së Sllovenisë jepte një koktej. Një gjë të tillë kur do ta bëjë shteti ynë shqiptar?

8) Sllovenët duan të dinë çdo gjë ç'ndodh atje në Dardani. Zajci nuk më shkoqet nga qafa, kurse Shallamoni më bezdis për *Mbrëmjen e poezisë shqipe në Lubjanë*. Policia slovene ishte alarmuar. Në "Ivan Cankar" është venë një bombë, aty mu në sallën ku poetët shqiptarë i lexonin poezitë e veta. Na kishin nxjerrë vrap dhe mbrëmjen e kishim vazhduar në PEN-in Slloven, ku numri i dëgjuesve ishte rritur. Shallamoni thoshte se kishte ëndërruar diç e tillë t'i ndodhë. Por këtë mbrëmje të rrallë, fantastike e përjetuat ju shqiptarët, e përsëritte vazhdimisht. Jeni popull antik. Ju ndjekin të bërat. Ishte vërtet diç e çuditshme. Temë për mitologët e ardhshëm. Ajo mbrëmje nuk

harrohet as tani se ishte debakël i Çarshisë serbe. *Srpska posta*. Malokhane, do ta quante R. Konstantinoviç.

9) Më kishte rënë në sy moti se diç nuk ishte në rregull me reklamimin pompoz të letërsisë shqipe, kroate, maqedone. Nga ta merrja, nuk ishte ashtu. Botime seriale në gjuhë të huaja. Fama e një kulture të madhe, u kishte rënë në tokë. Më vonë e kuptova se këtë e bënin për shkak të xhelozisë ndaj kulturave të tjera, që bënin një jetë normale. Dhe ata i botonin veprat në gjuhë të huaja përmes fondeve të ndryshme. Nëpër metropole kishin themeluar botuesit e vet. Megallomania e tyre shkoi aq larg sa një shkrimtar trumbetonte: *Pyet Parisi Beogradin, ç'të re ka!* Në mes të mëdhenjve vetëm Kishi përmalej.

10) Vete njeriu në Panaire për të parë se si ecet dhe për të mësuar diç nga skajet e ndryshme të Universit. Afirmimi i letërsisë sonë është afirmim edhe i gjenit tonë. Por, fatkeqësisht, botimi i ndonjë libri të mikut – ca i pikëllonin më shumë se i gëzon. Egoizmi ynë ende na është ballkanli. Kur pritej të nderohet Kadareja me Çmimin “Nobel”, që do të ishte nder edhe për tërë shqiptari, mbi veprën e personalitetin e tij ishin rrënuar gurë e gurë. Njerëzit tanë nganjëherë nuk duan të shkëputen nga bishti i Evropës. Tregojnë për njerin, mbasi nuk kishte mundur të duket në fshat, kishte rënë në qytet...

11) Se ç'do të thotë *Kadare*, një poet gjerman e tha më së mirë në Pallatin e Jaltos në Frankfurt: Unë blej çdo libër të autorëve shqiptarë kur shoh se *Parathënia* është shkruar nga Kadareja. Nuk e përflet veprën, ai e rikrijon. Më ishte kujtuar romani “Thika”, *shkas* për të rrënuar Sigurimin e shtetit monist shqiptar dhe ishte lëshuar në një aventurë të çuditshme. “Thikat” nuk është rast i vetëm. Përmes një libri qoftë edhe i lodhur ai, Kadareja hulumton kombëtaren, para se gjithash. U ofron të tjerëve atë që don, mënyrën kadariançe.

12) Shtrohen edhe shumë pyetje në Panaire. Por një ndërmarrje e përbashkët, me qëllim kombëtar - nga mënyra e reklamimit të vlerave deri të plasimi i tyre, do të ishte gjysma e lirisë së fituar. Po gjysma tjetër? Të thyen dyert nëse shtëpiaku nuk na i dorëzon çelësat. Çelësi, pra, është nocioni i parë i fatit njerëzor. Mendoj se ne nuk jemi popull pa fat. Ju lutëm, Çelësi?

DIELLI LIND NË PERËNDIM

Fik radion, të vetmin mjet që, momentalisht, më lidh me dheun tim. Ne shqiptarët, jemi, ndoshta, i vetmi popull që shumë pakëz mësuam nga pësimet e së kaluarës. Artet tona gati janë të shkundura nga mitet. Ndjenja nacionale, nacionalizmi në kuptimin pozitiv, është thuaj se i vdekur. Shkaktarë për këtë, para se gjithash, ishte diktatura moniste, një farë vëllazërim-bashkimi, që fqinjët tanë i shikonin pak më ndryshe, nga interesi i tyre. Brenda një hapësire përplitemi si peshqit në bllaçuk: Me tre përqindësh e ca iniciativa të vonuara duam të bëjmë mrekullia. Me vite Perëndimi kërkonte shteg për të depërtuar në Shqipërinë diktatoriale. Deri diku këtë ia mundësuan partitë tona. Dhe ra bastioni i stalinizmit edhe në Dheun e Shqipëve, një sistem ndër më të egrit për rodin tonë. Tekefundit, Stalinin nuk e kishim të fisit, as nga dajët. Dogmën e tij bëmë mirë që ia varëm për qafë.

Mirëpo, sllavoortodoksizmi ekstrem bën çmos të instalojë edhe njëherë komunizmin në trojet tona, pra edhe në Shqipëri. Ndjek po atë rrugë që ndoqi Perëndimi. Depërtimi të bëhet nga ne edhe nëse duhet përkrahur forcat që dikur i ndiqte. Si fara e kuqe lexohet: Triumfi i plotë i demokracisë në trojet shqiptare nxjerr tërë arapllëkun e fqinjve. Në çdo fushë ne do ta fitonim lojën. Mirëkuptimi ndërretnik gradualisht do t'i hapeshin shtigjet dhe paqja do të kthehej jo vetëm nëpër vatrën tona. Për një politikë ekspansioniste, kjo është vdekje. Destabilizimi ynë iu konvenon vetëm fqinjve. Synimet e tyre ndryshe nuk mund të realizohen, as pastrimi etnik e dominimi i tyre. Në mes nesh ata kërkojnë rrogëtarë. Si duket, kanë filluar të gjejnë: mediokërt. Shikoni ca gazeta tona: niveli i tyre ai i vitit 1946: As një hap më tej nuk e kemi bërë. Në një poezi kahmoti e parandjeja: *Dielli lind në Perëndim*. Lindja për ne është shkatërrim-harrim gradual i qenies sonë kombëtare. Vetëm një Urë të Qabese nuk do ta kishim nëpër këngët tona.

Intriga politike

Në Podgoricë dilja nga shfaqja “*Futa*” (Crnina) të Zh. Komaninës. Me nervozizëm Jevrem Bërkoviç theksonte se *intriga politike* popullin malazias shpesh e kishte qitur në gjunj. Ajo e kishte rrënuar më shumë se çdo e keqe nga jashtë. Tek popujt e vegjël intriga destabilizon dhe është pjellë kryekreje e shpirtrave të errët. Në të vërtetë “*Futa*” ishte një intrigë politike. Korrespondonte me kohët: të kaluarën dhe të tashmen. Bosht kishte informbyronë kur malazezët kishin paguar të gjitha mëkatet e stalinistëve të tjerë. Mesazhi ishte i qartë: Në një shoqëri totalitare mund ta paguash me kokë edhe një gaf. Mua ca skena ende më rrinë parasysh. Dhe, ajo dritë e kuqe që lëviste nëpër skenë, disi është ndezur edhe në mesin tonë. Vërej se *intriga* tek ne është bërë mjet rrënues, që shpesh mund të lexohet edhe si qërim hesapesh. Një dialog i zakonshëm na ka edhe bishtin. Mos bëhet kjo për shkak të situatës socialo-politike, apo udha deri në Maje na është e gjatë, mos po tregohemi tepër tolerantë ndaj çështjeve esenciale të kombit dhe shumëçka po na i grabitin nga dora mediokrit? Shoh: asgjë nuk ka qetësi. Na rrëshqet edhe guri nën këmbë. Kam frikë se orientimi ynë gjithëkombëtar mund të marrë drejtim tjetër. Intriga në “*Othello*” dhe “*Makbeth*” të Shekspirit ishte kulmi i tragjedisë. Në momentin vendimtar të qenies sonë, të ndodhë diç e tillë, do të ishte fatale.

Shtëpia e Hajnrih Belit lahet në shirat e Zhak Preverit. Unë endem qull, si në romanet e Kadaresë. Me ditë nuk ia shoh syrin diellit. Nga dritarja kap, ndoshta, edhe ndonjë gjurmë të harruar të Hemingueit, i cili kishte kaluar mu këndejpari pas invadimit të forcave perëndimore në Normandi. Vendasit tregojnë: Nga të dy anët ka pasur shumë të vdekur, të cilët janë varrosur në një varr të përbashkët. Prapë parandjej: *Për ne dielli lind në Perëndim*. Largimi i Nolit nga skena politike tregon se ai politikën e kishte kuptuar si “art të të mundshmes”, si sinqeritet, si pastërti të një triumfi kombëtar pas një udhëtimit të gjatë që nga koha e Skënderbeut, ndoshta. Por kur kishte nisur rikonstruimin e shtetit, ishte shfaqur *intriga* nga brendë e jashtë.

Largimi i tij në Amerikë ishte i paevitueshëm. Depërtim e lëvizje të çuditshme hetohen tani jo vetëm në Dardani. Por, heqja dore nga kërkesat tona do të ishte turp kombëtar.

Fati i gjysmës së kombit ndodhet ende i pazgjidhur për shkak të atyre, që trojet tona i qitnin në Pazar sa herë donin. Udhëtim ynë mbetet ai i maratonit. Figurativisht Noli na kishte bërë me dije: Udhë deri në fitore nuk është çështje e ditës, as e vitit. Por, ajo duhet të kalohet nëse duam të kemi atdhe e emër. Të kalosh nga aparteidi deri në pavarësi duhet pasur një përgatitje psikike e mendore të polemicit. Përndryshe, përpjekjeve tona u kërcënohen *sorrat*. Brenda të mundshme gjërat mund të lëvizin, të shkundet pasiviteti ynë politik, por nëse për hir të dikujt tentojmë rrënimin e asaj që e ngritëm edhe me sakrificë: Aktualizimin e çështjes sonë në skenën ndërkombëtare – ajo nuk është qëllimorë, ka shenja të intrigës politike.

Leximi kolektiv dhe testimi intelektual

Dhe, sipas të gjitha gjasave, në hapësirën tonë do të bëhet edhe më luftë për opcionin demokratik. Fqinjët tanë do të bëjnë çmos të rrëshqasim diku e të na shkëpusin nga Evropa. Atëherë gjenocidi do të jetë i shkallës më të lartë. Përmes kanaleve të fshehta do të propagandohej se shqiptarët nuk dinë ç'është demokracia, as nuk u duhet. Pastrimet etnike në trojet që tani më janë helenizuar-sllavizuar, nuk dua t'i zë ngoje. Por nuk bën të mos përmendet Toplica e gjorë dhe Çamëria e therur deri në zog (Çamërinë poeti çam Bilall Xhafferri e kishte parë vetëm në ëndërr). Toponime këto nga më tragjiket të qindvjetëshit tonë të fundit. Njerëzit tanë kam përshtypje, mbrapsht i lexojnë gjërat: shumë pakëz e kuptojnë edhe Fishtën, Nolin, Konicën, e rilindësit e tjerë. Ose veprat e tyre i lexon vetëm një person dhe ç'thotë ai përflitet. Kjo ka zënë të bëhet traditë e leximit tonë kolektiv. Vërehet edhe nga topitja e sensibilitetit. Nuk e kuptojmë lojën e fqinjëve, as nuk duam të mësojmë nga e kaluara që t'u ikim kurthave të reja...

Në një kënd të bibliotekës së Hajnrih Belit rastësisht syri më ndalet tek një libër për ish-Jugosllavinë. Aty, në një kapitull, bëhet fjalë edhe për proceset kulturore-letrare, me theks të posaçëm për *Takimin e fundit të Shkrimtarëve të ish-Jugosllavisë* në Novi Sad. Aty ishte bërë edhe testimi ynë intelektual. Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova dhe Hasan Mekuli patën treguar se vështirë mund të pranohet ajo që shihej në horizont. Pas sa vitesh ia kisha shtrirë dorën Qosjes. Novi Sadi e repriza shumë shpejt në Prishtinë. Letra e 40 shkrimtarëve serbomalazezë për të cilët M. Bullatović thoshte me të drejtë se ata nuk bëjnë as një gjysmë shkrimtari, por duhet mbrojtur si të ishin nobeliste, gjet përkrahje në shtypin e verdhë serb. Në aktivin e atëhershëm të Shkrimtarëve të Kosovës u bë problem paraqitja e Qosjes në foltoren e Novi Sadit. Dhe, është për t'u çuditur, ai u mbrojt mu nga ata që ishte zënë për kurrgjë send, ose kur nuk mund t'i bëjmë gjë të huajit i bien të vetit, primitivizmi ynë ballkanik! Besim Bokshi as unë, Qosjes nuk ia kishim mbajtur pallton as karrigen, por akuzat që bëheshin në adresë të tij, i kishim kuptuar si kërcënime ndaj intelektualit shqiptar në përgjithësi. Ishte ndershmëri për të ngritur zërin se mbrohej dinjiteti krijues dhe kultura e një populli, që kishte filluar të nëpërkëmbët. Në vendin e Qosjes më vonë u ul tërë një popull. Ngoje e zura kalimthi këtë. Prapë e ktheva librin në raftin e bibliotekës së Belit, që dikush aty e kishte lënë kushedi për çfarë qëllimi.

Përmes qerimit të hesapeve dhe intrigave në mes partive e intelektualëve, populli nuk mbrohet. Kjo është filozofi e ca kërmijve dhe profiterëve të nahive tona që *çështjen kombëtare e kuptojnë vetëm interesin e vet*. Por kombi është diç i shenjtë dhe i vetmi nocion, që na tregon se kush jemi e ç'jemi. Dhe, kur është në pyetje ekzistenca e tij, zënkat harrohen. Kështu na mësonin disi edhe rilindësit. Më se e qartë është, lirinë nuk e sjell as atdheun nuk e mbron individi. Ai mund të luajë rol, por lirin e atdheun e bën populli.

Në hapësirën tonë ajo që ndodh është shqetësuese. Kam frikë për të ardhmen. Sado naive, intrigat tona, në mënyrë mjeshtërore po i përdorin fqinjët, të cilët rrinë zgjuar derisa ne flejmë. Çilni pakëz dritaret dhe shikoni se ç'ndodh rreth e shtëpive tona, në fshatra e

qytete të shkretëruara. Duhet lexuar prapë Shtjefën Gjeçovi. Pastaj zgjedhim më burrëroren. Populli thotë: Qeni i keq të sjell ujkun në vathë.

Në horizont diç shfaqet.

Trjka, mos e dhashtë zoti!

AFIRMIMI I ANTIJETËS

Propaganda është armë e tmerrshme. Ajo i prin të keqes më shpesh. Pas një distance kohore vëren pastaj se në hapësirën tënde ka ndodhur një rrëmujë e madhe. Gjërat duken pak më ndryshe. Asgjë nuk është në vend të vet. Je diçka që nuk ke ëndërruar. Një gërdi, kështu do të thoshte poeti rumun, M. Soresku.

Versionet e së vërtetës

Në këtë shkrim, do të prek zvetënimin e së vërtetës dhe efektet. Në Moskë merrja pjesë në një takim letrar (1982). Pas vizitave të ndryshme nëpër institucione e revista, një ditë na dërguan të shikojmë një film. Sapo dëgjova emrin “Rublov”, m’u kujtua Onufri i Beratit, i Kosturit, i sa qyteteve antike shqiptare, pastaj ato të pakta fjalë që më kishin mbetur në kujtesë të njohësit të madh të pikturës murale shqiptare, Theofan Popës, për ato të pakta freska të kishës sonë, që kishin shpëtuar nga zdrukthi i diktaturës. Pas përfundimit të filmit zbuloja një “mrekulli” allarusçe: *arti në versione*. “Rublovi” nuk ishte ai filmi që e kisha parë në një kinema të rrëzbitur të Kosovës. Ishte një version i zbehtë, i zhveshur nga shumë skena që në këmbë e kishin mbajtur shikuesin anembanë Evropës. As sot nuk e kam të qartë pse mikëpritësit na kishin dërguar ta shohim atë version. Përmes trukut, ndoshta donin ta zbulonin të vërtetën e hidhur që e fshihnin pushtetarët në çdo hap nga ne. Shpërblimin ndërkombëtar për film diktatura në mënyrë mjeshtërore e kishte përdorur për strategjinë e vet. Filmi ishte mashtrim i dyfishtë: 1) Shikuesin rus e mbante në iluzion: Ajo që krijohet në hapësirën e baçushkës është e përsosur dhe çmohet edhe nga “dekadentët” e Perëndimit dhe 2) Shikuesve të huaj ua tërhiqte vërejtjen: Në Rusi nuk ekziston censura. Atë që e thoshin

Solzhenjicini, Saharovi e disidentë të tjerë rusë ishte një rrenë kluçe. Arti pra, lëvizte në mes bindjeve ideologjike dhe iluzionit me pasoja të mëdha të lirisë së individit dhe të vetë shoqërisë ruse. Diçka e ngjashme ka ndodhur edhe me traditën tonë. Terrorizoheshin për së vdekuri rilindësit pse nuk kishin lindur marksistë (!) dhe gërrshërët nuk pranin nëpër veprat e tyre. Përgjegjësinë bartin edhe ata që nxitonin t'i qesin firmat nëpër veprat e cinguar, që akuzojnë rëndë.

Në formë të vrazhdtë shfaqej pra, propaganda.

Në Universitetin e Paderbonit në Gjermani (1993) na ftuan mikun tim Hansin dhe mua. Ishte hera e parë që gjendesha në mes të studentëve në një sallë vezore si në filma fantastikë. Na thanë se ora do të zgjaste vetëm 45 minuta. Por tema: “*Marrëdhëniet shqiptare-serbe-greke*”, fjalë për fjalë, nxorën mospajtime mjaft të nxehta. Vërehej qartë propaganda e fqinjëve tanë. Gjithë ato që i kisha lexuar si mashtrime ordinere, ata i merrnin si të vërteta. Punë djalli ishte t’ua shkundësh nga kokat atë mjegullinë për ne. Kishte kaluar ora që na kishin caktuar, kur u thashë: Më bezdisët edhe për minoritetin grek në Shqipëri, i cili gëzon të gjitha të drejtat dhe mezi kap 60 mijë. Një gjë më çudit: Nuk patët guxim të më pyetni edhe për afro dy milion arvanitë e çamë në Greqi. Evropa veten e mban për kampione të demokracisë, por vërejtja se shumë pakëz iu shqetëson krijimi i aparteidit në Kosovë dhe fare nuk u prek gjenocidi grek ndaj çamëve! Harruat të shtroni një pyetje fundamentale: Në vitin 1821, kush e bëri shtet Greqinë dhe për kontributin e madh të shqiptarëve në historinë e kulturën greke. Ora e tretë ikte kur Hansi më tha: Lexoju: *Macen e zezë*.

Faji shqiptarë

Kishte rënë një heshtje e rëndë. Mund të dëgjohej edhe miza. Trupi mësimor dhe studentët nuk di si na shikonin dhe për çka na konsideronin. Dikur një profesor pat guxim e tha: Ne në Evropë nuk kemi faj që nuk dimë më shumë për ilirët, shqiptarët, arbëreshët, arvanitët, çamët, Kosovën, Çamërinë, Toplicën, për suliotët e vëllezërit Boçari, Bubulinën e Xhavellën... për të gjitha gologotat

shqiptare... Fajtorë jeni ju shqiptarët, që nuk na bombardoni me të vërtetat e njëmendta dhe nuk na lironi nga lajthitjet”. Kurrfarë komentimi nuk do kjo që e tha profesori i nderuar nga Universiteti i Paderbonit atje në veri të Gjermanisë. Në shikimet e lëvizjet e të rinjve gjermanë vëreja megjithatë se diçka ishte thyer në ta. Ajo ç’ndodhi pastaj nuk dua t’u tregoj.

Ditë më parë lexova intervistën e Kadaresë dhënë Milaim Zekës (“Bujku”, 26 qershor 1994). Për etikën e skizofreninë në gazetarinë tonë është e vërtetë ajo që e thoshte Kadareja. Është e vërtetë se gazetaria në Shqipëri, në ditët vendimtare të ekzistimit tonë si popull, bën tepër pak për çështjen kombëtare. Preferon tema skandaloze, rrënimin e sistemit të vlerave. Thashethëmat janë rrënim i brendshëm i qenies kombëtare, nuk kanë të bëjnë me synimet tona. Por a duhet të merret me halabakët e letrave shqipe Kadareja? Duke lexuar intervistën e tij, më kujtohet ferri ynë monist për rrënimin e të cilit kontribut të madh ka dhënë shkrimtari ynë. Dhe atë që kërkonte Kadareja dhe insiston, duhet ta bëjë ligji, nëse ekziston, për mbrojtjen e personaliteteve kombëtare, pa marrë parasysh se cilës parti i takon. Njerëzit e shndërruar në institucion i mbron shteti.

Shkrimzeza e K. Kallushit dhe mungesa e ligjit

Para se të gjendesha në Hanover, mezi kisha lexuar shkrimzezën: “*E vërteta mbi Ismail Kadarenë*” të Kapllan Kallushit e të financuar nga klubi “Jusuf Gërvalla”, ku do të mbaja një orë letrare. Ato ditë kisha lexuar edhe intervistën “ekskluzive” të Kapllanit në “Pobjeda” të Podgoricës, e cila fliste më së miri se kush na ishte ai. Të merresh me një vdektar, që në mënyrën më të turpshme e ka varrosur vetveten, do të thotë t’ia rrisësh morrin dhe ta mjegullosh horizontin tënd. Prekse ishte keqpërdorimi i mërgimtarëve tanë rreth botimit të atij shkrimi, i thënçin. Fjala e parë që iu drejtova atyre ishte: Ju keni fyer atë (I. Kadarenë), i cili me shkrimet e veta e bëri të njohur emrin e martirit që mban klubi juaj.

Në bisedë me M. Zekën e shihja Kadaren në një dritë që nuk dëshiroj ta shoh mu për hir të veprës së tij. E them këtë se ai nuk lexohet nga Dushkaja në Dumnicë. Ai është maje Tomorri që shihet larg. Në rrëzë të tij halabakët mund t'i vrigëllojnë shpatat. Por kujdesi i Kadaresë ndaj fjalës publike është edhe respekt ndaj veprës së tij, e cila nuk është më vetëm e tij. Konkretisht mua më tmerron lavdërimi i ndonjë halabaku. Intervista e tij lë përshtypjen se është kapur kalimthi dhe me siguri është e paautorizuar. Se, atë që na ofroi M. Zeka, unë e lexova si antri-propagandë për vetë veprën e Kadaresë. Arsenal i fjalëve ishte i kohëve të perënduara. Njerëzit e mëdhenj, ndoshta, mund të thonë edhe shumëçka më rëndë e t'u falët. Siç shihet mikun tim e kishin lodhur halabakët dhe pasiviteti i ligjit.

T'i kthehem prapë propagandës. Ne ende nuk kemi një propagandë të mirëfilltë. Patriotizmi ynë zgjat sa zgjat një bateri rryme. Plaku i Vlorës porosiste se diplomacia e re shqiptare duhet të ngritet në mes kontradiktave të të tjerëve. Por ç'diplomaci kemi dhe me çka merret ajo, më së miri ilustron intervista e Anton Kolajt në "Zërin" e kaluar 12 gusht 1994. Kam frikë se edhe për një kohë nuk do të mund t'i amortizojmë të rënat e fqinjëve tanë.

Zoti ynë, ke mëshirë për ne! Kaq shumë të thërrasim e Ti veshët në lesh galash.

POSHTËRIMI NUK ËSHTË DEMOKRACI

Repriza e ëndërrës së keqe

Ka tre vjet, ndoshta, mos më tepër, një mik imi ma përmend një *pliko*, e cila na qenka e treta me radhë dhe kur të hapet (nëse kemi jetë ta presim atë mrekulli), çështja jonë do të shihet se ku e çfarë jemi. Të shkretën, çdo ditë e parafytyroj: A do të shtrihem sa jam apo do të humb prapë ndonjë krah; do të bëhem më xhuxh seç jam. Miku im ka besim në atë që e thotë dhe fjalën e tij nuk mund e luan topi. Është i vetëdijshëm se gjëra spektakulare nuk do të ndodhin, as nuk kanë për të ndodhur kurrë mbasi u mësuam me atë që na imponojnë.

E shikoj mikun tim si pi kafe, si lëviz e shqetësohet kur do të ma heq mërzinë, qind për qind i bindur në atë që teleiset salloneve të Evropës. Vërej se edhe unë kam filluar të ndërroj ngapak. Nuk shahem, as nuk hahem më; se të gjithë shqiptarët, megjithatë, nuk janë Resulbegoviça. Narracioni i mikut tim është zëri pikëllues i realitetit të hidhur që më përplas vazhdimisht mureve dhe i cili desh m'i shpoi veshët një ditë shkurti sapo ndeza TV Shqiptar. Nga foltorja e *Parlamentit* zoti Hercog lexonte atë që kishte ndërmend ta thoshte e që, ndoshta, ishin ca shkëputje nga plikvoja që ma përmend miku im tash e sa vjet.

Gati çdo fjalë e të nderuarit përcillej me duartrokitje të deputetëve, të cilët aq bukur e kishin kuptuar realizimin politik dhe tragjedinë shekspiriane, që shfaqej kushedi për të satën herë në skenën shqiptare. I duartrokitnin ata se zotëriu nga Veriu fliste pa pardon. E kuptoj tashti mikun tim pse nuk dëshiron të flasë më për atë, që u dëgjua edhe në midis të Tiranës. Duartrokitjet e deputetëve, megjithatë, nuk i interpretoj siç bëjnë ngucakeqët e ca folkloristë. Kam konsideratë për burrërinë shqiptare dhe e di pse ata kanë duartrokitur

dhe kujt. Buzëqeshjet e duartrokitjet e tyre dikur vendosa t'i mbyll në një *pliko* nr. 4. Pas njëqind vjetëve le ta hapë kush të dojë atë. Por jam më se i bindur se çdo gjë do të fillojë nga bishti i sorrës.

Mirupafshim vëllezër në shekullin XXI.

Zoti në mes të shqiptarëve

Kush mund të thotë se Zoti nuk zbriti në mes nesh? Poshtelartë e pashë kur i ra Shkodrës. Gati sa nuk doli në Ulqin. Të vërtetën t'ju them u gëzova që, më në fund, Zoti u kthye në mes nesh. Por u habita kur pashë se asgjë timen nuk kishte ai. Bile ta kishte pasur një plis të bardhë të Dukagjinit apo një xhura të xhaxhit Naim; një gunë të barinjve të Tomorrit apo ta kishte kërkuar një fustanellë në Devoll të Dritëro Agolli. Tekefundit, të m'i kishte pëshpëritur nja dytri fjalë të *Glubës së Buzukut* kur kaloi pranë meje, do ta ndjeja veten më të lumtur dhe do t'ia hidhja edhe ndonjë mimozë nga shkilte këmbë e tij.

Në midis Shkodrës zbriti, e shkeli Dheun e Arbërit dhe për çudi nuk ia ndjeva një ofshamë nga Qerbelaja e Naimit. Tepër keq e ndjeva veten pse Zotit nuk i kishte pëlqyer asgjë imja. Dheut të Gjuhës e Gjakut nuk e vëneroi as përvujtninë time që më ishte lidhur fort për të folmen shqipe sa nuk pata guxim as gojën ta hapja.

Nuk kam asgjë kundër fesë dhe festave fetare. Le të besojë populli sa më shumë dhe sa më shpesh Krisht e Muhamet le të jenë në mes nesh. Por kam të drejtë dhe kam dëshirë i Madhi kur të shkelë në dheun tonë të jetë pakëz më shqiptar. Nga fryma ime të ketë diçka. Para të tjerëve të krenohem dhe ta ndiej veten më të fortë – se edhe unë paskam zot, bile zot akademik, që i flet disa gjuhë, siç thotë një poet skrapariot.

Miku im Hove, kur më fliste për zotin e vet, thoshte se zoti i tij nuk mund të jetë zot tjetër pos afrikan. Ndër viset më të lëna kur del i Madhi nuk guxon të mos bartë në dorë bile një copë lëkurë të tigrin apo një dhëmbë elefant, shenjë nga dheu që e ka bekuar. E Zoti ynë,

që zbriti pas pesëdhjetë vjetëve mu në Shkodër, të uruarit harruan se mysafirët pos bukës, kripës, e zemrës t'i vënin nën sjetull edhe *Abetaren e Gluhës* së Buzukut. Dhe, Kuran e Biblël t'i hapnin kur i Madhi të kishte bekuar *Arbërinë*. O Shqiptarë, zbrita në mes Jush pse ju dua dhe çdo gjë Tuajën e çmoj! Qofshi nën mbrojtjen time!

Në vend të Tij, u pikëllova unë. Tepër poshtëruese ishte gati çdo gjë. I shihja si hije Orkestrin dhe Ibrahim Tukiçin e famshëm. M'i kujtonin klaunët e oborreve mbretërore. Në një farë mënyrë, sjelljet e orkestrimi i tyre disi fyenin të Madhin para tërë atij xhemati, që ishin tubuar dhe nuk dinin se ç'po ndodh. Ndoshta e lëshova udhën e Tij se ai moti ka çuar dorë nga unë. Por tërë kohën them se kam të drejtë dhe dëshiroj që Zoti ynë kur prek Dheun tonë të më ngajë pakëz e të më trimërojë në këtë kohë krize e plot pabesira. Rreth Dheut të Arbërit shqip t'i dridhë minjtë. Kudo në botë, edhe në vendet më primitive, për të cilat më fliste edhe miku im Hove, feja është në shërbim të çështjes kombëtare. Imponimi nga cilado anë dhe nga cilado fuqi zvetënon besimin dhe poshtëron vendin. Uroj që Zoti ynë të jetë sa më afër nesh dhe t'i bëjmë vend në krye të logut. Por çështjen kombëtare ta shtrojmë siç e shtronin Rilindasit: *Zoti yni, por feja shqiptaria*. Dhe kur nuk kam atdhe, nuk di sa bën të kem zot.

Koncerti festiv i Bajramit të madh nxori në shesh edhe një të vërtetë. Rrenë qenka se veprat e rilindësve vuajkan nga religjioni. Për këtë u binda kur as dorë e të Madhit nuk e pa të arsyeshme bile një lutje ta zgjedhë nga to. Besimtarët e shumtë, që ishin gjunjzuar para hijes së tij, do ta bënin edhe një vizitë me të deri në Plazhin e Madh. Me këtë sjellje atërore, mos desh i Madhi të ngrisë edhe një akuzë ndaj ish-shtetit totalitar shqiptar, në emër të pastërtisë ideore që kishte bërë gjymtimin e shumë veprave, apo rilindësit nuk ishin në nivelin e *ilabëve*, që m'i kujtonin këngët e Çarshisë së Madhe pas orës dymbëdhjetë? Ca lutje lirisht kanë mund mikpritësit t'ia vinin në buzë të Madhit. Njëherë ta bindim botën se me të vërtetë Zoti na u kthye në Arbëri pas një ekzili të gjatë tej deteve.

Pikëllimin kombëtar, siç duket, presidenti Berisha e kishte ndërjerë atje në galeri. Shuplakat ia vërejtja në ajër kur i bëri grusht. Nuk di a kërcënohej apo ngazëllehej për mysafirin, që kishte zbritur në

midis të Shkodrës dhe e argëtonin ilirët e gjorë për një grusht dollarë, aty nën ballin e djersitur të Rozafës.

Zoti im! O zoti im, nëse Ti vërtet më do dhe më mbron nga të ligat, ki mëshirë për robin Tënd, e më fol shqip më shumë! Dua ta ndjej vuajtjen Tënde për fatin tim të zi.

Poeti i vargjeve jeshile

Nuk u besoja syve kur një mik imi, ish i burgosuri i ndërgjegjes, që në lavd e kapital kurrë nuk pranoi t'i shndërrojë vitet e humbura nëpër kazamate, hapi një gazetë të ditëve më të reja dhe m'i lexoi ca vargje me zërin e tij karakteristik. Nga britmat e stili e njohja të gëzuarin. Ishte një poeti i kuq, që shkruante vargje të kuqe e dhihej kuq se të kuq e kishte vatanin dhe miletin. Një mijë herë të bëhej qervish dheu, ai nuk do ta ndërronte bindjen për ngjyrën e kuqe. Më përfytyrohej shkallëve, duke u ngjitur deri tek unë atje në katin e nëntë me një tufë vjershash të kuqe. Ulej në karrige dhe me rend shante farefis deri tek unë, që vargjet e tija të kuqe nuk i shndërroja ende në plumb. I kuq tashti nuk ishte as mallkimi i tij. Ishte mbështjellë në ngjyrën jeshile dhe heronjtë kombëtarë i dilnin pejgamberë, që fluturonin nga qiejt azurë. Më erdhi keq se vargjet e teshat e reja nuk i rrinin mirë, edhe pse ramazanin e kishte shpallur si grevë gjithëkombëtare. Ia ktheva gazetën ish të burgosurit të ndërgjegjes, i cili e hodhi dhe mezi e përfundoi bisedën e rëndë: Kur nuk di ç'kërkon, Feja e Komunizmi puqen diku, megjithatë.

Liria ime, tani për tani, nuk peshon hiq më rëndë se një kafe dikun në metropole. Kontributi për mirëqenien tonë aq na është! Kur ta ketë kjo vlerën e qindpërqindshit; pra, kur të vetëdijësohemi, besoj se nuk do të vritemi më si qen. Do të kemi një vdekje më të bukur, më njerëzore.

Hipodromi Kombëtar mbetet hapur...

TKURRJA E ATDHEUT

TERRI MBI GADISHULLIN ILIRIK

Evropa a zgjohet nga kllapia miterane

Shtypi opozitar serb nuk pran kohëve të fundit se Serbia mund të hyjë në Evropë vetëm përmes Kosovës. A është ky cinizëm apo diç tjetër, nuk dihet por kjo është rrëshqitja më e madh e Serbistanit. Deri dje këto gazeta trumbetonin se Shqipëria nuk mund të hyjë në Evropë pa kaluar nëpër Serbi ose Greqi. Dhe profetizonin se fundi i Shqipërisë është afër. Saltomortalet rreth nesh shtohen, por kush do të bie në litar, zoti e di.

Sidoqoftë më në fund, Evropa a e lexoi ëndrrën e Serbisë së Madhe? Miqësitë e dikurshme proserbe (Rusi-Francë-Angli e ca shtete sllavo-ortodokse), a hoqën dorë nga populli i llastuar dhe i vetëshpallur *qjellor*? A u zhgënjyen me barbarinë e të zgjedhurve? Dhe, si duket, Evropa zgjohet nga kllapia miteraneske, që ishte kohë e hipokrizisë dhe e pritave tinzare. Bëri çmos të mbetet i paprekur shpirti pansllav e të shtrihet thellë në kontinent; ato pak lidhje që ekzistojnë në mes popujve, të cilët e duan dhe e çmojnë lirin e paqen jo vetëm vetjake, desh t'i këpusë. Filozofi francez, Andre Glyksman

thotë: “Miterani donte të krijojë një pozicion antigjerman dhe antiamerikan, pozicioni ky që do të ekuilibronte dhe që ky e konsideronte si kanosje kundër Francës”.

Historia e propagandës është mijëvjeçare. Nisi nga ajo ditë kur fqiu fqitua ia shkuli hurin në oborr. Në mënyrë më hysterike fqinjët tanë kultivuan një propagandë rrënuese-asimiluese ndaj çdo gjëje shqiptare, e cila vazhdon edhe tani me një ritëm të shtuar. Shkaqet e kësaj albanofobie dihen, por prishin imazhin evropian.

Mirëpo në kohë kur vendoset ndoshta edhe për fatin tonë, të merresh me marrëzira të tilla, pa dashje ndodh të rrëshqasim edhe ne. Prandaj e ardhmja jonë varet nga serioziteti ynë: si t’i qasemi problemit tonë ekzistencial dhe cila rrugë na shpie te formimi i shteti tonë nacional. A bën edhe shekullin e njëzet ta mbyllim të shkapërdedhur nëpër ca minishtete, që u formuan në Ballkan pas derdhjes së ish-Jugosllavisë?

Për këtë situatë më se tragjike, para se gjithash, fajtorë jemi ne. Na mungon guximi qytetar dhe organizimi kombëtar. Kënaqemi kur opcioni i kësaj apo asaj partie dështon. Çdo deshtim ynë dhe i akcilitë parti, është deshtim i politikës kombëtare dhe vë në pyetje vetekzistencën tonë si komb. Të tjerët çështjen kombëtare e shikojnë më ndryshe. Sjell një fakt më të freskët. Para ca ditësh në një gazetë të Beogradit lexoj dy serbë diku nga Amerika, Banjallukës për rimkëmbje i ofruan falas hiç më pak se 28 milion marka. Neve na dridhet dora kur japim një markë për shkollën e mësuesin tonë! Solidariteti ynë më së miri tregon edhe atdhedashurinë tonë. A lahet borxhi ynë kombëtar me koprraci e qyqarllëk?

Shpesh ma tregonte një barcoletë një azilant. Na kish qëlluar një farë trimi, ku kishte shkelur nëpër klubet e LDK-së, flakë kish qitur nga goja për rrahjegjoks e fjalë pa ujë. Një natë i trokasim në derë dy miq të tij më të ngushtë. Del ai farë trimi dhe i sheh shokët të zymtë të cilët troç ia thonë: Na ka thirrur Bali, se plasi... Trimin e kap një dridhmë dhe mezi i nxjerr fjalët: Pasha zotin ende nuk e kam marrë rrogën. Nisuni ju, se ju zë... Nuk di a ka diç më ilustrative për atdhedashurinë e një populli iluzionist? Kanë të drejtë ca intelektualë

të Tejmurit që neve na konsiderojnë si qenie abstrakte, diçka të paparë, të padefinuar; njerëz që kemi filluar t'i humbim virtytet tona, që na pranoin dikur edhe armiqtë.

Djali në mes të shkrimtarëve

Aeroplani ishte shkëputur nga pista, merrte drejtimin e veriut të largët e të përgjumur. Dhjetë shkrimtarë të të gjitha nacionaliteteve të Jugosllavisë së atëhershme, udhëtonim për në Moskë. Mbahej një tryezë për letërsitë nacionale, që krijoheshin jo vetëm nga vendi që ishim ftuar. Dhe aty secili folëm për letërsitë nacionale. E thashë mendimin edhe unë për letërsinë tonë, i cili zgjoi interesim të dukshëm tek të pranishmit. Kështu në Redaksinë e revistës për *Letërsinë botërore*, na shtruan edhe pyetjen: Cilët shkrimtarë nga letërsitë nacionale dëshironi të përkthehen në gjuhën ruse? Unë e dija se në Rusi Kadare ishte persona non grate, po ashtu e kisha hetuar se në praninë e ca shkrimtarëve të delegacionit tonë, emri i tij shkaktonte nervozë, megjithatë nuk u hamenda: Mendoj se lexuesi rus duhet ta lexojë veprën e Kadaresë. Dhe, me aq u mbyll biseda në Redaksinë e revistës për *Letërsinë botërore*. Nuk u dëgjuan as propozimet e të tjerëve.

Unë besoj në pastërtinë e shpirtit dhe në emisionin e shenjtë të krijesit. Se ai duhet të bëjë çmos për t'i afruar njerëzit pa dallim ngjyre e kombësie. Se krijuesi i mirëfilltë qëndron mbi çdo të ligë njerëzore. Por me kë isha e ku punonin bashkudhëtarët e mi të rastit, e dija. Ma kishin tërhequr vërejtjen, ca nga ata, se Jovan Raduloviç, autori i “Guvës së pëllumbave”, që kishte shkaktuar aq shumë probleme ndërnacionale në Teatrin e Novi Sadit, nuk ishte vetëm një krijues.

As dy javë nuk kishin kaluar e në “Rilindje” kishte arritur fletëdenoncimi për gjestin tim, që kishte shkaktuar shqetësim në Redaksinë e revistës për *Letërsinë botërore* në Moskë. Sipas J. Raduloviçit, aty unë kisha përmendur armikun nr. 1 të popullit serb dhe të Jugosllavisë së atëhershme. Ai quhej *Ismail Kadare*. Dhe kushedi se deri ku kishte arritur ai fletëdenoncim i tij. Por në adresë të “Rilindjes” ishte nisur nga zyra e Suslovit tonë në Beograd –

akademikut, pardon anemikut S. H. Kërkohej nga drejtori Asllan Fazliu, të merren masa rigorozë ndaj poetit nga Prishtina, që paska pasur guxim të propozojë haptas një armik të përбетuar mu në Moskë. E vetmja përgjigje imja ishte: Një popull a mund të ndahet edhe shpirtërisht? Ishin fillimvitet 1983. Në integrimin tonë, bile shpirtëror, nuk bën të kalërojnë edhe kalorësit e apokalipsës.

Ndodhi Kosova

Gazeta “Oslobodjenje” e Sarajevës (dita e enjte, 21 dhjetor 1989), me rastin e Takimit të fundit të disa shkrimtarëve të ish-Jugosllavisë, që konsideroheshin për disidentë, kishte botuar artikullin *Çelësi shpirtëror për Shtëpinë e Evropës*. Artikulli përcillej edhe me një blicë-anketë me ca nga pjesëmarrësit. Në pyetjen: Ç’mund të bëjnë krijuesit në këtë moment të rëndë ndërnacional? Unë kisha deklaruar: Botën tonë mund ta ndryshojmë vetëm nëse hyjmë në Evropë. Po të mbesim në Ballkan, çdo gjë ka marrë fund, si duket. Dhe kisha prekur çështjen shqiptare: Çfarë demokracie na ofrohet, haraçi për ne shqiptarët është tejet i rëndë: disa mijëra të burgosur, më se një gjysmë milioni njerëz në dosjet policore dhe shumë të vrarë. Kjo është shokante për Evropën. Dhe nuk di a i vie era demokraci? Përmes gazetarit të “Oslobodjenjes” J. Mashiq, i kisha apeluar edhe opinionit, që kishte filluar të parandjejë kalorësit e apokalipsës: Për këtë fare demokracie që gëzojmë, pyetni më mirë intelektualët e Jugosllavisë.

Mirëpo, ndodhi *Kosova* me mijëra të helmuar, të rrahur e të vrarë. Ra Vukovari. U përgjak pastaj Dubrovniku, Sarajeva, Mostari dhe tërë Bosnja deri në Sanxhak. Pakkush nga intelektualët e gjorë e tha një fjalë. I frikësoheshin territ, që kishte rënë mbi Gadishullin Ilirik. Ose, ishin shpërndarë tamam si zogj të qyqes. Me ca kuptoheshin përmes teksteve, që aty-këtu i botonim.

Vaji arvanit

Mbyllja e këtij teksti le të jetë një strofë nga një këngë arvanite, nxjerr nga libri “*Arvanitët*” të Irakli Koçollarit:

Dy fjalë çova Djevit

Të fala! Të të thotë

Po Djevi nuk ta tha

Se nuk e lanë retë.

Dhe Gadishulli Ilirik noton në mjegullirën e shpirtrave. Unë nuk kërcëj më nga Ura e Shenjtë, as në këmbë nuk e kaloj dot Grykën e Otrantit, se deri tek veshi i të të gjallëve pak zëra arrijnë...

MAKROTËRMETI

Më bie ndërmend shpesh një distik plot mençuri e guxim i zotit Breht. E tha në një kohë tepër të rëndë për popullin gjerman atëherë kur nazifashistët marshonin dherave të përgjakura të Evropës. Por intelektual i vërtetë nuk pranon zot tjetër, pos vetvetes. Ai distik është: *Për çështjen e armikut do luftojë. Ai që s'lufton për çështjen e vet...* Fundi i një çmendie u mbyll me një zhgënjim të thellë të atyre që kishin vajtur pas Fyterit. Kështu la këshillën më së njerëzore për koka të krisura (Xh. Spahiu) nëse i zë gjaku.

Për fat, ne shqiptarët moti jemi liruar nga nacionalizmi. As nuk dimë ç'është e si duket ai. Ne jemi i vetmi popull që nuk vuajmë nga atdhedashuria. E kemi derdhur, si duket, kur na prenë kërthizën. Prandaj jemi ata që nuk është dashur të jemi, as nuk mund të kemi më shumë. Rreth kësaj le të merren pakëz ata që rrahin gjoks metropoleve me shqiptarizëm. Por unë dua mesazhin e zotit Breht ta vendos në një kohë të re, konkretisht në këtë tonën, një formë pakëz moralizuese t'i jap: *Ai që fut përçarje në popull, nuk punon për çështjen shqiptare, ai rren se e don Lirinë dhe Kosovën.*

Skepsa

Sekpsa u shfaq atëhere kur dhuna hyri lirisht nëpër fshatra e qytete tona dhe kur Kosova filloi t'i ngjajë një "atdheu mjerues" (figurë poetike e Bardhyl Pogonit, poet e intelektual i mërgatës së hershme shqiptare). Pasojat u panë gati në çdo përpjekje individuale, siç ishte Greva e Urisë së "Rilindjes", qoftë përmes një demonstrimi paqësor, siç ishte ndezja e qirinjve; ose qoftë përmes manifestimit protestues – Varrimi i Dhunës. Dhe shihet edhe në lëvizjen e mendimit tonë rahatikopolitik.

Populli e ka një fjalë të urtë: Kur bie tërmeti, minj e gjarpërinj bashkohen. Ne nuk e shohim se na bëri pikë e pesë. Ndoshta kolektiviteti në krimkulturë na prish qetësinë personale; ose nuk e kuptonim se armiku të lufton edhe pa plumb. Nëpër plasaritjet tona tani mund të përbirohen edhe buajt e Drinisë të Camajt. Por një gjë është e qartë: Përçarjet, ndërskamcat në mes e brenda partive dhe popullit, nuk mund ta avancojnë çështjen tonë as për një milimetër, lëre më t'ia prishin gjumin "shokut" Sllobodan. Sjelljet tona nuk përkojnë as me kodeksin tonë moral. Ne zotërinj, qenkemi sortë e veçantë. Bëjmë, pra sehir.

Mirëpo, dridhjet tregojnë se nuk dihet kur do të kalojë tërmeti. Se ai vazhdon të frymojë në mesin tonë. Dhe se nisi me rrënimin e sistemit të vlerave e institucioneve; pastaj me ndërrimin e emrave (për besë ende nuk ia di emrin rrugës sime); me përdhosjen e përmendoreve tona dhe me ngritjen e atyre serbe; me heqjen e të drejtës për të jetuar dhe për t'ia bërë atë punën të dashurës; me pranimin e pozitës së robotit. Dhe, ç'mbeti tjetër t'i shtohet peizazhit mahnitës të atdheut të okupuar? Ndoshta, edhe ndonjë stoli. Por as ajo nuk mungon. Përplot i kemi rrugët. Diç të tillë a nuk ju paralajmëron Vuk Karaxhiq, i cili me një këmbë zbriti një mbremjeje nga Serbistani dhe nguli në kungjin e një bazamenti, që ia ngritën para Fakultetit Filozofik të Kryeqytetit të Republikës sonë? Tani çdo ditë na përshëndet nga aty ku para një gjysmë shekulli poeti e prozatori Gjikë Kuçali (në shtëpinë e tij në Tiranë banon miku im e poeti Fatos Arapi) bashkë me dhjetëra martirë të tjerë nga Arbëria, u bë dhe Kosove për mirëkuptim ndërnjerëzor dhe për njëfarë lirie që na qenka një mut i madh, siç thotë një mik imi... Nga burimet e sigurta merret vesh se as Car Dushani në midis të Prizrenit të zambakëve nuk mund të shihte Kompleksin e Lidhjes *Gjithëshqiptarë të Prizrenit* krenar. Prandaj brenda nate u alarmua Perandoria dhe u soll urdhri: Të hiqet ajo kasollë! As në mermer të mbështjellë, gjumë të mirë nuk na bën Cari. Sa i përket shqiptarëve, as kësaj here nuk iu ndalon kush të bëjnë sehir...

Ja, pra, do verbërohem nga malli të shoh një shtatore të ndonjë heroit diku në ndonjë rrugicë fshati apo qyteti, lëre më në sheshe të

njohura të Kosovës; të mos them, ruajna zot, diku aty në *Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit*.

Ke të drejtë lexues i dashur, që ankohesh, por unë nuk mund të rrej se do të vazhdosh të bësh gjum të thellë. Megjithatë, këtë herë do të gëzoj. Kam informata të sigurta se Serbët nuk janë më popull qiellor nga ajo ditë e lume kur mësuan se ne shqiptarët jemi popull biblik. Për këtë informatë, ma qet kafenë diku në Evropë, por të lutem mos ma përmend se heq dorë nga shqiptaria.

Qoftë zoti me ne! Edhe qielli yni.

Koloneli i Markezit në Dardani

Rruga për në shtëpi më qet nga dera e një mësuesi plak. Aty shpesh trokas. Ulemi diku, në një skaj të kuzhinës dhe bisedojmë gjer' e gjatë, edhe për hafije. Kam parë se mësuesi plak nuk epet. Vazhdimisht është i disponuar edhe kur më flet për krizat. Një tenxhere asnjëherë nuk e heq nga shporeti. Ditë e natë rri aty. Dhe derisa një ditë e shikoja, mësuesi më tha: Do të na bijnë barishtat në bark... Kam frikë vetëm për fëmijët. E hoqi kapakun: barishta vërtet, pa një copë mish e fije yndyre. E bëj këtë për inat të fqinjve, t'u tregoj se ende ka diç në magjen time, shtoi sapo kishte veneruar se më ishin turbulluar sytë. Dhe nëpër kujtesën time u përvodh fytyra e rraskapitur e Kolonelit të Markezit, udha e tij nga një epror i shquar i atdheut deri tek një varfanjak i përbuzur, gruaja e të cilit çdo ditë qistte në flakë të zjarrit një kusi plot gurë dhe i zinte m'u për inat të fqinjve. Kishte vepruar njëjtë siç vepron familja e paepur e mësuesit plak nga Dardania. Fatet njerëzore, megjithatë, kanë diç të përbashkët: krenarinë. Mësuesi i lagjes sime nuk është i vetëm që e ka lëshuar takati. Shoh se varfëria na kërcënohet. Solidariteti ynë ka rënë në hundebuzë; në një mazohizëm të pashembullt është shndërruar: Kënaqemi me mjerimin e tjetrit. Një veti e tillë më së pakti i karakterizon njerëzit që e çmojnë dhe e duan Lirinë dhe Atdheun.

Vërtet nuk i ndieni dridhjet? Sojli na qenkeni, trima!

Trimëria në këngë dhe Alea e Shpëtimtarëve të Kombit

Intervista e zotit Demaçi dhënë “Zërit” të Prishtinës, vazhdon të interpretohet në mënyrë të çuditshme. Më së rëndi i ka prekur ata që kanë diferencuar njerëz në kohën e komunizmit dhe që nga ajo zeje nuk mund u ndanë as në një shoqëri plurale. Nuk ishte budalla ai që tha: isha duke e lënë, por më hyri në gjak. Maskaranë e “Kosovares” të meshkujve gra e kuptova se civilizimi më parë do të arrijë në Mars se në Kosovë... Ne jemi popull, bre, që trimërinë e kemi mbyllur në këngë e qenefhane! Disa njerëz tanë duhet ta hapin e mbyllin ditën me vargjet e cituara të Brehitit.

Për një popull nuk ka gjë më tmerruese kur mediokri aktron autoritetin. Çdo gjë atëherë ka marrë fund se ke punë me një diktatorth potencial, që prish rendin shtëpiak edhe për një..

Në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit nuk të pihet kafja se nuk mund të marrësh frymë se gumzhinë. Vërtet paska ndodhur një makrotërmet. Një re e zezë ma fsheh qiellin dhe Brehti nuk më lë rehat të merrem edhe pakëz me inflacionin e patriotizmit tonë të rremë:

Dhe nuk do të thonë: kanë qenë kohëra të errëta,

Por, pse kanë heshtur poetët?

HARTA E GJËRAVE TË HUMBURA

Ku ishit ju shqiptarët?

Miku im nga metropola ma theksonte disa herë një fjali që nuk doja ta dëgjoja. Por kishte plotësisht ta drejtë. Me një buzëqeshje, që gati i rrëshqiste nga skaji i buzëve, nxirrte fjalët: Shqiptarët kanë zënë të rrejne më shumë se serbët. Si bën një vend aq i pasur – me dy dete, tri të korrura në vit, me një pasuri të madhe tokësore e mbitokësore, me një potencial të mjaftueshëm njerëzor për çdo gjë vazhdimisht të ankohet. Pas Luftës së Dytë Botërore, ne nuk kishim asgjë që, momentalisht, ka Shqipëria. Por natën e bënim ditë, siç thoshte ai poeti juaj. Miku nga metropola m'i thoshte këto fjalë sa herë lexonte ndonjë ankesë shqiptare në shtypin e vendit të tij. Dhe, dikur u pajtova: një vend tepër i pasur, më i varfëri në kontinent! Në Shqipëri kam qenë disa herë. Aty dorë e njeriut thuaj se ka prishur çdo gjë. Këtë fjali e potenconte ngadalë, rrokje për rrokje. Po ku ishit ju shqiptarët deri tani?!

Kishte tri orë që e kishim lënë Tetovën. Me Miço Kallamatën, Fatos Kongolin e një mik timin të fëmijërisë na rrahte shiu e një frymë e ftohtë në majë të kodrës së zhveshur, ku na la një matrapaz nga Pogradeci e për nja treqind metra udhë na mori valutë, aq sa do t'i jepnim për një udhëtim qindra km diku në Evropë. Gjestin e taksistit, megjithatë, nuk e kuptova plaçkitje. Ai nxitonte për të kompensuar kohën e humbur, për të cilën miku im nga metropola, atje në veri, nuk dëshironte të dëgjonte fare. Ka pasur kohë edhe më të vështira, por një popull kur e don atdheun dhe çmon lirinë e vet, bën çdo gjë.

Kodrës së zhveshur lëshoheshim në drejtim të xhades së vjetër. Mezi e perceptonim se ku gjendej mbasi asgjë nuk shihnim nga shiu i dendur. Më vonë filluam ta kërkonim Miçon plak, i cili na ishte

mbështjellë në mjegull dhe u takuam me të tek kur zbritëm në xhade. Aty hipi në një makinë që e shpinte në jug. Bisedën rreth përkthimit në gjuhë bullgare të romanit të tij “*Nën hijen e dordolecave*” nga Marina Marinova nuk arritëm ta kryenim.

Në orën e caktuar, në Sallën e Kaltër të Hotelit Internacional në “Tiranë”, u dorëzuan shpërblimet e Fondacionit “Velia” për veprat më të mira të botuara në të dy anët e Murit të Arbërit. Ndjeja një kënaqësi të posaçme. Shqipëria, më në fund, e kishte kuptuar se gjëra të bukura shqiptare krijohen e botohen edhe në Shqipërinë e Jashtme. Dhe muri nuk do të thotë kurrëgjë kur një popull nuk e pranon atë.

Kim Mehmeti ishte triumfues i dyfishtë.

Kisha ortodokse shqiptare dhe Janullatosi

Nuk ma merrte mendja në midis të Tiranës, pikërisht më 25 dhjetor, në Natën e Kërshëndellave, kur të dy kishat tona kremtonin *Ngjalljen e Krishtit*, një peshkop grek të lutej edhe për ata që më së rëndi kanë rrënuar ose rrënojnë etninë tonë. Përcillja TV shqiptar. Kisha, përplot vizitorë. Asgjë e keqe nga ai pelegrin. Njeriu ka nevojë edhe për lutje, edhe për kërkimin e zotit; njeriu ka nevojë bile edhe për mashtrim. Por në *Kishën Ortodokse Shqiptare* dëgjoja nga goja e peshkopit grek Janullatos diç befasuese, shqetësuese: Lutemi për Serafimin e Athinës, lutemi për Pavlin e Beogradit, për atë të Moskës... Por, i bekuari, një lutje nuk e tha për popullin shqiptar në të dy anët e Murit, as për Kishën Ortodokse Shqiptare, as për shtetin e Presidentin shqiptar, që ia mundësojnë qëndrimin e tij. Dhe kush mund të thotë se Shqipëria nuk na është demokratike; bile demokratizimi i saj shkoi aq larg sa të heq dorë edhe nga pavarësia e kishës së vet! Nën diktatin bizantin ndërrohen edhe tekstet fetare të përkthyer ose të përpiluara nga Noli. Janullatosi, ashtu do. Dënimet të tij nuk mund t’i iku as Noli i famshëm, ai që ia solli krenarinë kombëtare kishës sonë. Kulmi i këtij turpi kombëtar ishte *Mesha*, e cila u tha në gjuhën greke! Tërë ai popull, brenda e jashtë, i lutej zotit në një gjuhë të huaj, e cila me shekuj bën përpjekje ta na nënshtrojë.

Mirëpo atë që nuk mund e bën Qeveria shqiptare (E di ajo pse.), kohëve të fundit ka filluar ta bëjë vetë kisha. Në Livadhi të Sarandës, në kufi me Greqinë, priftërinjtë shqiptarë nuk e lejuan të hyjë Janullatosin në kishën tonë. Në pavarësinë dhe kthimin e dinjitetit kombëtar ecën edhe kisha ortodokse në Elbasan. Me gjasë kështu do të veprohet edhe në mjedise të tjera. Por nuk di kur peshkopi grek do ta kuptojë se vërtet gjendet në vend të huaj dhe mikpritjen e popullit dhe Qeverisë shqiptare e nëpërkëmbi?

Patriotizmi i një forumi të grave

Askush nuk e di si arriti, kujt iu kujtua e kush e lansoi dhe pse u desh një protestë e tillë e një forumi të grave tona? Këtë gjest të femrave tona mund ta keqpërdorin vetëm horat. Revolta e tyre, më duket, se është një trimëri e pashoq në një kohë hamletiane për të mbajtur gjallë qenien kombëtare. Çarshia dëshmon se protesta e atij forumi ka arritur aty ku duhet. As për këtë nuk di më shumë. Por mesazhi i tyre nga qenka: Duam që djemtë dhe vëllezërit tanë të na kthehen sa më parë nga ekzili, ose t'u lejohen burrave deri në moshën gjashtëdhjetëvjeçare të kenë nga tri gra. E bëjmë këtë se nuk duam t'i shohim rrugët e sheshet e Kosovës të zbrazta dhe në shkolla gjithnjë e më pak nxënës; duam që kopshteve e parqeve tona t'u kthehen buzëqeshjet e fëmijëve, të gumëzhijnë stadione e salla nga zhurma e lojërat e tyre; duam që gjaku të mos na përzihet, as të na bëhet ujë... Protesta ka edhe ca ide të tjera, që ia shtojnë peshën guximit të tyre qytetar, para se gjithash, kërkohet të mundet dhuna. Nëpër kuluare dëgjohet se ca "moralistë" kufirin e moshës kanë kërkuar ta shtyjnë edhe për një dekadë. Besoj se këtë e bëjnë për hir të patriotizmit të flaktë, që assesi nuk mund ta konsiderojmë si humor të zi... Përgjegjja më e mirë ndaj kësaj proteste është: kthimi sa më i shpejtë i djelmoshave tanë, nëse duan atdhe dhe të kenë nishanin e tyre familjar...

Hipokrizia frenge

Miterani nuk ishte francezi i fundit, që e la Evropën me gisht në gojë dhe që zhgënjeu inteligjencien e vet të mirëfilltë. Nuk mund të konsiderohet, po ashtu, se Franca na qenka shtet largpamës pse e para ndërroi ambasadorët me mbeturinën e ish-Jugosllavisë (Serbinë e Malin e Zi). Politika franceze kahmoti lexohet e interpretohet si politikë e të papriturave, kërkuese e hulumtuese e baraspeshës së forcës në Evropë. Bllokun amerikano-gjerman nuk mund e pranon si forcë të vetme, që dikton ecjakët e kontinentit tonë mjaft enigmatik, të mos them dinak, siç do të thoshte Zhak Atali.

Shtrohet pyetja: Kush pas Francës do ta pranojë Jugosllavinë e mbeturinave? Pa mëdyshje do të jenë miqtë e saj të vjetër, shtetet sllavo-ortodokse. Por ne shqiptarët nuk e di deri kur do të bëjmë një politikë puthadorëse, farefisnore, pa konceptcion e strategji kombëtare. Miqtë nuk krijohen brenda natës. Ata kërkohen me qirinj. Çerçili thoshte se në politikë vetëm *interesi* është i përjetshëm, miqësia është kaluese. Për çfarë interesi tonin mund t'i lidhim ata që i kanë gërshërët?

Përkundër deklarimeve se politika franceze do të ketë një sens të ri, shartimi i zotit Shirak në hapësirën ballkanike tregoi se nuk mund të shkëputet, tani për tani, aq lehtë nga udha e trasuar e Miteranit. Edhe ky i la anash intelektualët e mirëfilltë, që ndryshe mendojnë rreth zgjidhjeve ballanike, posaçërisht për çështjen shqiptare. Mirëpo politika ushqehet nga dredhitë, jo nga guximi intelektual. Ish-ministri i punëve të jashtme të Austrisë, A. Moku, në një intervistë, thotë se ka marrë letër nga zoti Shirak, ku i premtohet se Kosovën nuk do ta hedh në harresë. Por a iu zihet besë fjalëve në këtë kohë kur vështirë lëvizin gjërat për të mirë, sidomos tonën?

Postimi i ambasadorëve në të dy kryeqytetet, francezi në Beograd, tjetri në Paris, nuk mund të kapërdihet aq lehtë nga forcat demokratike jo vetëm të mjedisit shqiptar. Ironike duket, po ashtu, zbarkimi i shumë delegacioneve franceze në Tiranë, kur Franca i afrohet Serbisë. Kam frikë se takimet me delegacionet shqiptare

shpiejnë tek pajtimi me gjendjen në terren: Kaq keni bërë, kaq meritoni. Më së dëshpëruese do të ishte kjo për një popull të lodhur e të derdhur në ca shtete e të shkapërderdhur rrugëve të botës pa një organizim kombëtar, bashibozukçe. Një popull i tillë është i destinuar të humbë çdo gjë. A do të përjetojmë fatin e kurdëve?

Në anën tjetër, asnjë shtet si Franca nuk ka treguar interesim për historinë e kulturën tonë. Parisi na është shndërruar në një Mekë shqiptare. Aty gjen shkrimtarë tonë eminentë, artistë, piktorë, profesorë e ç'të duash, që nuk ke mundësi t'i hasësh nëpër metropole të tjera të Evropës. Por politika franceze nuk ndërron as një centimetër rreth çështjes shqiptare. Përsëri anon nga shtetet sllavo-ortodokse. Pse? Ku qëndron ai defekti në mes nesh e politikës franceze? Loja frenge në mes nesh, Evropës dhe sllavo-ortodoksëve nuk mund të lexohet ndryshe pos si hipokrizi. Premtimeve dhe fjalëve boshe vetëm të marrët u besojnë. Parisi, a mund të jetë më dekor yni?

Autobomba në Tiranë

Në hapësirën shqiptare ngjarjet moti kanë kahje të kundërta. Diç e shënuar në Kosovë, bie fjala, në Tiranë do të plas diç tjetër, që këtë e hedh në harresë. Kjo dukuri përsëritet shpesh dhe bën të besosh se në hapësirën shqiptare vepron një forcë e fshehtë. A mos do të vritemi edhe ne mesveti në mbarim të shekullit XX?

Në Holiday, aty nën Sharrin antik, në një sallë koncentrale, as mbretëreshës së këngëve polifonike Eli Faros, nuk i shkonte kënga mirë. *Mora udhën për në Janinë, Qiraxhi i Grebenesë*, e ca të tjera na kthenin në një të kaluar të hidhur të popullit tonë – në kohën kur shqiptarët merrnin udhën e të papriturave. A ju kujtohet Ura e Qabesë? Pas atyre këngëve ishte përzier edhe vaji i “*Vajtojçave të Rekës*” dhe revolta e ca poezive, që i recitoja mbasi u gjeta rastësisht në atë mes. Mbrëmja u shndërrua në një mbrëmje zije për viktimat, që kishte shkaktuar autobomba aty në midis të Tiranës. Vërtet, mos po vritemi nga kurdisja e dorës së huaj? Ishte nata e 27 shkurtit. Më 26 ishte kremtuar 60-vjetori i Demaçit në Akademinë e Kosovës.

Mirëpo *liria* ime u mbyll në fillim të javës së dytë të marsit. Mbeta pa pasaportë. Nuk di se kur do ta nxjerr. Nuk jam nga ata, që kur të duan e marrin. Do të ndjej dhembje e vetmi për miqtë. Një zot e di se kur do t'i shoh. Në shekullin e ri, ndoshta, nuk do të ekzistojnë as kufijtë. Po kaçakllëku? Babai im ishte kaçak me dhjetra vite. Baci Bajram i kishte thënë: Ndryshe nuk bëhet atdheu...

Ballkani, bisht i Evropës

Çfarë janë ballkanasit, ç'gjak i mundon? Apo do të mbesin *vetëm* bisht i Evropës, i cili shpesh tymon. Për këtë, ndoshta, fajtorë janë vetë ballkanasit. Formimi i shteteve të tyre nacionale ngeci shumë dhe gllabërimi i hapësirave tej mundësisë, i çoi shpesh në *kasaphane*. A nuk u bind Bosnja? Ndodh diç edhe me vise e popuj të tjerë, por përgjakje kaq e madhe e shkatërrim nuk ndodh tjetërkund! Nuk është në pyetje vetëm gjuha, besimi mentaliteti...

Më ka rënë të gjendem në shumë vise të Ballkanit dhe shpesh më është bërë se gjendem diku në midis të Shqipërisë. Se shumë gjëra që i kisha parë, bie fjala, rrëzë malit të Pindit apo në Horën e Arbëreshëve në Itali, i kisha hasur rrëzë Bjeshkëve të Nemuna apo në Majë të Tomorrit, ku isha përmall një ditë vjeshte e ia kisha dhuruar edhe syzat Abazalisë, të mos e verbojë dielli i fortë (1993). Dhe nga gjithë ato shenja, emra, emblema – të derdhura që nuk i takojnë ca vetëm kulturës e historisë sate, në kujtesën tënde krijon një hartë të gjërave të humbura. Përkundër dhembjes, dikur fillon të ndjesh njëfarë respekti. Pa të keq vë buzën në gaz kur shoh se gjaku e shpirti yt, megjithatë, lëviz edhe nëpër shpirtin e fjalët e viseve të tjerë.

Nën Sharrin antik, diku aty në qendër të Iliridës, kisha kaluar orë të tëra për të vënë lidhje me vendlindjen e Bagerit. Ishte ndërprerë çdo lidhje. Në rrjetin telefonik ishte përzier edhe shovinizmi. Më lehtë zhvillova bisedën me Radio-Melburnin në Australi, që gjendej nja 20 mijë km. larg, siç thoshte gazetari në anën tjetër të telit, se sa me Gostivarin, që ishte një vrap kali.

Punë ballkanasish, njëri-tjetrin e shohim dhe e nderojmë vetëm përmes grykës së pushkës... Dhashtë zoti, gjërat e humbura të kthehen në vend të vet dhe fatin ta përcaktojmë vetë.

Tek Kasëmi në Tiranë

Ngjiteshim shkallëve të një apartamenti, aty afër Euro-Rilindjes në Tiranë, kur Mehmet Kraja dhe Ramadan Musliu ma tërhoqën vëmendjen: Për Kadarenë, asnjë fjalë mos ia thuaj. E dija qysh moti se autori i “*Promemorjes*” (1953), specialitet e kishte Kadarenë. Pse? Nuk pajtoheshja as me të vërtetën, që një i huaj e quan turp.

Në krye të shkallëve na pritri i buzëqeshur dhe sapo zumë vend në mes librave, m’u drejtua: Ta kam borxh, libri im që doli në gjuhën gjermane, ke një meritë edhe ti... Nuk e pritja një falënderim kaq njerëzor nga disidenti me namë, që nuk iu kishte frikësuar as monarkut të kuq. I thashë se për përhapjen e kulturës sonë e kemi për detyrë të gjithë dhe se unë librin e tij ia kisha dhuruar një miku tim gjerman. Krijuesit të sa e sa veprave, të botuara e të pabotuara, që shkilte në dekadën e shtatë të jetës, i rrëshqiti një buzëqeshje dhe ngriti dollinë me ne. Miqtë e mi përcillnin me kureshtje bisedën që zhvillohej në mes një disidenti të devotshëm e meje.

Dhe në dhomën ku gjendeshim, nuk frymonin vetëm librat e shumta, por edhe fjalët tona, që vështirë nganjëherë i zinin. Siç na pritri, ashtu na uroi kthim të shpejtë. Pika sa nuk më kishte rënë. Ne jemi popull që i ekzagjerojmë gjërat dhe kënaqemi duke rrënuar njëri-tjetrin, se trimëria jonë shpërthen si gjak i keq.

Kasëmi nuk ishte ai, që ma kishin përshkruar. Herën tjetër do të flasim më shtruar.

Humori i zi serb

Në Dokumentacionin për paqje në Bosnje (Dejton, Ohajo) ende nuk ishte tharë ngjyra e nënshkrimeve të presidentëve

Izetbegović, Tugjman e Millosheviq, kur nëpër Serbistan nisi fushata se Kasapi i Ballkanit, siç e quan shtypi botëror Millosheviqin, duhet të kandidohet për Çmimin “Nobel”. Arsyet: E shpëtoi Ballkanin nga një kasaphane të re; se vetëm ai mund t’iu sjellë paqen e begatinë popujve të këtij rajoni, etj., etj., etj. Vetëm logjika serbe mund ta thotë një gjë të tillë kur ende fiset nuk i kanë futur thikat në kllafe të nderohet personi, që shkeli e përgjaku vise e popuj; me bekimin e tij që u bënë pastrimet etnike, euforinë neofashiste që e nisi mu në Kosovë me eshtra të Shën Savës e me dryra e thika, me sloganin e njohur: “*Serbia do bëhet ose nuk do të ekzistojë*”, që ta kujton atë fjalinë e famshme: “*Gjermania do bëhet ose nuk do të ekzistojë*” të Hitlerit kur nisi marshimin e vet mortor. Të përkrahet një monark i tillë, do të thotë se humori serb ende gjallëron.

Mirëpo në Ballkan shpejt harrohet e *keqja*. Para primitivizmit të tij Evropa shpesh është gjuhëzuar. Pse të mos shpërblejë prapë *krimin*, që katandisi popuj e vise dhe mbushi lulishte e stadione futbollistike me varre... Çka nuk mund të bëjë kjo Evropa demokratike! Edhe mjerimin serb mund ta mbyllë me një Çmim “Nobel”. Nuk do të me çudiste fare nëse pas një kohe Slloba zbret nga *Bishtit i Sorrës* e na stoliset. Në këto kohë tragjikomike të Ballkanit është mirë që vetë vrasësi na u bë shakaxhi.

DËGJO, ZHURMA NUK ËSHTË KËNGË

Diçka tjetër është Shtëpia botuese “Rilindja”

E pabesueshme dhe jashtë çdo logjike, një institucion me përmasa të mëdha kombëtare t’i kthehet shpina. Atë që nuk mund e bëri dhuna serbe, e bëri injoranca jonë. Shtëpinë botuese “Rilindja” ca e kuptuan si një luks aristokrat dhe e shpërngulën nëpër kafene pa kurrfarë të ardhurash e ndihmash. Derdhet paraja vetëm atëherë kur ndonjë shkrimtar qeverie ose i zemzadrugës boton librin dhe dëshiron të ketë në të firmën e saj.

Për shuarjen e këtij institucioni protestoj për herë të tretë publikisht; se për kontributin e saj është e tepërt të flitet. Protestoj, bile, edhe për shkak të kurajës qytetare të një grupi krijuesish e gazetarësh, që në vitin 1993 mbajtën grevën e urisë prej njëmbëdhjetë ditësh. Në krye me Adem Demaçin, protestuam për lirinë e fjalës e të librit shqip. Një institucion kombëtar a bën të nëpërkëmbët për shkak të interesave e grupacioneve fisnore?

Nëpër kuluare flitet kohëve të fundit se kush nga shkrimtarët paskan marrë e po merrkan pagë mujore nga Qeveria. Nëse është kjo e vërtetë, duhet pagëzuar një gjest për vetëdijësimin tonë: 1) Shtresa më e rrezikuar e shoqërisë sonë janë shkrimtarët. 2) Ngazëllyese është, po ashtu, se Qeveria jonë e paska kuptuar mirë kopilinë serbe, e cila fushatën antishqiptare e nisi mu ndaj shkrimtarëve dhe librit shqip dhe 3) Më gëzon posaçërisht, se Qeveria nuk po i ndaka shkrimtarët, siç veprojnë ca mediokër: Shkrimtarë të Qeverisë dhe të Çarshisë. Por shtrohet pyetja: Këtë privilegj, a e gëzuakan të gjithë apo vetëm ata që sillen rreth partive e ca institucioneve të kulturës?

Në një kohë tepër kritike nuk di a mund t’i duartrokitet injorancës, e cila nuk e mori në mbrojtje *librin shqip*, atë të institucionit

tonë kombëtar “Rilindjes”! Para se gjithash, nuk dua të nënçmoj punën e askujt e më së paku të shtëpive të tjera botuese, që bëjnë çmos për të mbajtur gjallë kujtesën tonë. Por diç tjetër është “Rilindja”.

Ikin vitet dhe pak libra mund të vendosësh në bibliotekë. Shumë nga ato i kthenim si dorëshkrime, se nuk i plotësonin as kriteret elementare për botim. Ndryshe e kuptonin autorët e ndryshe ne reagimet e tyre. Por huqet e tyre nuk mendonim se një ditë do t’i shndërronin në stoli të një patriotizmi të rrejshëm. Trumpetojnë se librat e tyre nuk e panë dritën për arsye se redaktorët ua paskan pasur zili (!) dhe nuk i kishim pranuar vlerat as mesazhet e tyre të mëdha kombëtare-ndërkombëtare. Shumë nga të “diskriminuarit” e shihnin veten aty pranë Çmimit “Nobel”, bile të mundshëm. Dreka e darka u shtruan se na kishte lindur një “gjen”. Pastaj tjetri, e tjetri. Fat i madh ky edhe për letërsinë e përbotshme. Por vështirë shtohen librat në bibliotekë.

Nesër nuk dihet se çfarë vargje do të shkruhen

Marshimi euforik nuk pranë, sepse terreni është më se i përshtatshëm. Por, fatkeqësisht, fama e “gjenive” është tepër e shkurtër, deri tek gota e rakisë. Prapë kafenetë tona gumëzhijnë. Aty-këtu mezi shihet ndonjë fukara “gjeni”. Trokiti koha e vargjeve jeshile. Të revoltuarit e të ngujuarit deri dje nëpër kazamate, mbyllen nëpër xhami e shkruajnë *ilahi* për Muhamedin e pejgamberët (qofshin fal ata!) dhe t’i konsiderojnë si të vetmit shpëtimtarë të popullit shqiptar. Ndërkaq, neorilindësit tanë nxituan në Stamboll (Ku mu në Turkistan?!) për të mbajtur *Kuvendin e Madh Shqiptar Shpëtimtar*. Pra, aty u tubuan baballarët e kombit nga ishte nisur Naim beu Frashëri e të tjerët në Evropë për të shpëtuar Mëmëdheun e giorë nga shpata otomane.

Mirëpo Z. e M. nuk revoltohen dot pse çdo ditë hynë e dalin nga “Panorama”, por pezmatohen pse vargjet jeshile nuk i pranon

dinjteti ynë kombëtar. Dhe i derdhin etiketat si sheqerka, të vetmin zanat që dinë ata. Oh, Kosovë e mjerë, kush të tërheqë për kapistoll!

Dëgjo, zhurma nuk është këngë

Rrugëve tona vetëm zhurma i rrah krahët, e cila dalldiset kasabave tona. Shenjë se diç serioze ndodh rreth nesh e brenda nesh. Po ç'ndodh, vërtet? Asgjë. Vetëm zhurmë dhe rrugët tona gati nuk pëlcastin nga micsokolat e nobelistët e Marcit. Dhe brengosesh, asnjëri për mexhlis t'i dalë Kralit. Si duket, po mësohemi me zhurmë. Kalojmë pranë asaj që nuk është e zakonshme për periferinë e Tunguzisë. Dhe bindesh se teshat shpesh na i pret mediokriteti ynë, i cili na u bë hiperprodukti ynë. Nga skena nuk do të bien këta micsokola për një kohë të gjatë derisa ta kuptojnë se nga xhuxhllëku nuk tregohet burrëria, as nuk ndërtohet qytetërimi ynë. Përndryshe, uji nuk do të lëvizë. E, kur nuk lëviz shndërrohet në moçal. Por moçali, qelb larg.

A e keni venëruar mediokrin në kasabanë tuaj? Sillet brenda një rrethi, që i shkon për shtat dhe përmes përçarjeve e etiketave forcon pozitën aty në krye. Përndryshe vogëlsia e tij, xhuxhllëku, nuk e lë të dalë mbi sipërfaqe. Të dëgjohet, zotynë. Nëse mundet, edhe të respektohet nga esnafi i çarshisë. Ç't'i bësh, mediokri ynë, lëshon lozën e vet e luan ciperdonscullak vallen e minjve balosh.

Njeriu bosh

Mediokri e sheh dhe e ndien veten më mirë e më të madh vetëm në mes të vegjëlve. Seleksionimi i tij është vazhdimisht negativ. Se vetëm në mes të tillëve mund të gjallërojë, të dëshmojë se kush e ç'na paska qenë. Ai është më i madhi, më i shquari ndër më të vegjlit, ndër më mediokrët. Psikologjia e tij, mentalitet i malokhanës: Pjata ime të jetë sa më e plotë dhe fqjuit t'i cofë lopa! Askë nuk kursen në marshimin e tij se ka mësuar dhëlpërinë nga diktatorët e kaluar. I

mungon komunikimi normal me njerëz e rrethinë, se është i kompleksuar. Nga xuxhllëku i vet botën e sheh. Mu për këtë është i dyshimtë si vlerë e karakter. Rënia e tij prandaj nuk dëgjohet fare kur rrëshqet. I ngjan një thesi plot tytësinë. Përdora këtu njëjës in nga poema e Eliotit: *Njerëzit e zbraçët*. Të ketë sa më pak mediokër në mesin tonë, të këtij fenomeni më të bastardhur të shpirtit, herrës i vlerave dhe i dinjitetit njerëzor, rasti i humbur, klinikal...

Pra, ajo zhurmë që dëgjoni, nuk është këngë. Mbylluni më mirë nëpër kibuce e lutjuni Zotit të mos iu falënderojë kurrkush rastësisht...

A PO PËRSËRITET HISTORIA?

Kërkimi i Itakës

Gati çdo gjë në zgripç. Shqetësuese është pyetja: A po përsëritet historia? Tatëpjetën kur merr liria, tkurret Atdheu; pikë e pesë bëhet populli, fiket çdo shpresë për rikrijimin e etnisë. Ku ishim dikur: A nuk ju kujtohet Toplica, Molla e Kuqe që ka zënë të zbehet nga turpi? A nuk ju kujtohen Çamëria, Dodona, Suljotët, vëllezërit Boçari?

Si nuk na u kujtua asnjëherë se ç'përjetuam! Menduam se gjithçka rreth nesh ndërroi në të mirën tonë. Dhe harruam për të fituar, duhet ndërruar historinë – hartat, logjikën, burrinë. Si duket, as këtë herë nuk ishim të organizuar si komb e vlerë; nuk ishim më dinjitozë – se për çështjen kombëtare duhet derdhur edhe fuqinë e fundit. Fatit tonë ia lamë stuhisë. Në momentin vendimtar nisi të na lë takati. Njëri-tjetrin ta shikojmë si të huaj. Vrapuam si fis, si katund, si lagje, si bajrak. Maja e Evropës mbet e shurdhët, as nuk e preku dorë e jonë. Lejuam të na injorojnë dhe të na nxjerrin nga loja se në kërkesat tona ishim konfuz. Dhe, besuam se propagandën tonë do ta bëjnë të tjerët dhe se të tjerët do të vdesin për lirinë e etninë tonë përderisa ne të endemi metropoleve të Evropës duke deklaruar qyqarllëkun.

Parisit, Londrës, Shën Stefanit, ato njolla të errëta nga harta e humbjeve të etnisë, druaj se i bashkëngjitet edhe Dejtoni. Po në kujtesën time fëmijërore, ku ta vendos figurën e Vilsonit të famshëm? Neveritëse m'u bë edhe ajo thënia e Borhesit: Sa më gjatë të mbetem fëmijë...

Se pat koncesione në Dejton, në mes Perëndimorëve dhe palës serbe, vetëm qorri nuk e sheh. Forcat e NATO-s arrijnë në Bosnje kur tridhjetë për qind e popullsisë fitoi gjysmën e Federatës të B. e H dhe kur definitivisht u pranua Republika e Serbëve. Pak më parë, dr.

Kinkel pat thënë: Shqiptarët në Kosovë duhet të fitojnë atë që u takon serbëve në Bosnje. Bundestagu gjerman mendon pakëz më ndryshe: Autonomia e Koosvës duhet të garantohet (kuptohe në kuadër të Serbisë) dhe nuk lejohet kurrfarë recesioni...

Unë nuk jam ndër ata që rrahin gjoks se e njohin gjuhën e politikës, por dhembjen e ndjej më shumë se ata që i mashtron edhe një gjysmë fjale e çfarëdo kapoje. Bekimi, pra, u bë ose do të bëhet: Me 14 dhjetor në Paris, ku tjetër pra (aty na janë prerë shpesh teshat), nënshkruhet edhe Karta e Sigurisë së Ballkanit. Me siguri aty do të vë nënshkrimin edhe Qeveria shqiptare. Dhe, të rrova, më rrove, brisku i berberit, thotë populli...

Pra lamtumirë etni! Lamtumirë breze të arta të viteve të '80, që rrënuat diktaturën ndër të parët në Evropën e Lindjes; që u burgosët e u torturuat nëpër kazamatet mesjetare të serbosllavisë; që vdiqët me emrin e Kosovës në buzë...

Nuk di as vetë, unë e shkruaj këtë tekst? Unë që shkrova aq shumë poezi e peticione kundër dhunës. Por nuk mund t'i mbyll sytë para fundit të një ëndrre të brezeve të arta. Le të mbesë vetëm ëndërr kjo. Unë do të vazhdoj të kërkoj Itakën time.

Patriotizmi si biznes

Rrena është kategori filozofike. Në raste vendimtare, arsyetohet ajo. P.sh., kur Atdheu është në pyetje. Kështu mendonte një autoritet nga lashtësia. Por kur ajo shndërrohet në shprehë, kur bëhet ushqim i të përditshmes, nuk di a ka të bëjë më me etikën, me dinjitetin njerëzor të një kolektiviteti.

Në rrafshin politik më së pakti ka sinqeritet. Çdo gjë varet nga koncesionet. Fill pas nënshkrimit të Dejtonit, në Burzën londineze çmimet e metaleve të çmuara të "Trepçës" u rritën dhe për dhjeta herë. Shenjë se Serbia u ka ofruar çdo gjë Perëndimorëve vetëm e vetëm çështja e Kosovës të mbetet çështje e saj e brendshme.

Ndërkaq, mjetet tona të informimit përbëjnë kaptinën më pikëlluese të krenarisë sonë, nëse e kemi. Shkruajmë e trumpetojmë siç na ka ënda, duke bërë sehir. Me piskatare grash kërkojmë atë fije të këputur të një gjysmë të vërteteje dhe me të mbajmë gjallë shpirtin deri ditën e nesërme, kur fluska na ka shpërthyer para syve. Por, a keni dëgjuar ndonjëherë se fluskat kanë peshë dhe nga fluskat krijohet *Kulla*? Nga nënteksti i një kapeje duam të krijojmë disponim, të argëtohem me fatin tonë cubel në momentin më tragjik të ekzistencës sonë. Dhe sapo të kthjellemi kuptojmë se gjatë rrebelimit tonë kemi qenë të mashtruar dhe kemi manipuluar me ndjenjën më fisnike që mund ta ketë një popull, *patriotizmin*. E shndërruam në monedhë, në biznes dhe përpiqemi si mall ose rrenë ta shesim sa më shtrenjtë. Por një popull dinjitoz, i urtë, antik e me kurajo qytetare, siç themi, a lejon të nëpërkëmbët një gjë kaq e shenjtë? Prandaj në lojë nuk ishim të barabartë me të tjerët. Kultivua një filozofi qyqarllëku, malokhanjeje. Nga letra e parë na lexuan se me ne mund të luhet e të bëjnë ç'duan.

Marshimet e tubimet i filluam 1). Për pavarësi, 2). Për një shtet neutral, nëse nuk lejohet bashkimi me shtetin amë, 3). Zbritëm pastaj në Republikë, në kuadër të Jugosllavisë së mbeturinave, por ata, që menduam se do të jenë në anën tonë, nuk na ofrojnë as Kushtetutën e 74 dhe na mbyllën në kornizën e minoritetit brenda Serbistanit. Dhe, finalja 4). Garantimi i lirive dhe i të drejtave të shqiptarëve në Kosovë, kuptohet nën pendrekun e “shokut” Sllobodan. Kërkesat tona u reduktuan në minimum, kurse mjetet e informimit bubullojnë me tituj artikujsh bombastikë, thuaj se Evropa dhe SHBA mendojnë vetëm për koqet tona.

Kë mashtruam? Vetveten, pra Popullin!

Kurbani dhe filozofia e malokhanes:

Ka vite që, jo vetëm Shesheli, në Parlamentin Jugosllav trumbeton se shqiptarët nuk e çmojnë lirinë, as nuk dinë të vdesin për Atdhe; se shqiptarët kënaqen me një vilë, me një kafiteri, me një makinë dhe me ndonjë rrospi pranë. Pa nervozë të peshosh edhe

shumëçka tjetër, pajtohesh se ne me të vërtetë kënaqemi me një grimë bukë, vetëm ta kemi kokën mbi supe. Burgjet e Evropës janë përplot me shqiptarë. Dhe a e dini për çka? Për hajni të fliqta (për një pako cigare, për një palë këpucë ose për një çokoladë), për shitjen e stërshitjen e drogës ose për vëllavrasje. Dhe deri më tani nuk kam dëgjuar se ndonjë mik yni u burgos pse ia prishi Evropës qetësinë për shkak të çështjes kombëtare!

Ne vetëm mund ta ngushëllojmë veten se këtë e këtë e bëjmë për atdhe e liri...

Buzë rruge për në Shkup, një ceremonial rasti ma tërhoq vëmendjen. Dhe fika makinën. Pak më thellë në arë ca punëtorë serbë hapnin themele të një shtëpie të ardhshme. I zoti i asaj familjeje, si duket, kishte rrokur një derr dhe pasi i ra disa herë thikë, e hodhi diku aty poshtë: Nuk ndërtohet shtëpi pa kurban. Derisa dëgjoja fjalët e tij përzier me erë rakië, parafytyroja malokhanen në *Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit*, shqerrjen e tyre: Ngadhënjim duam edhe pse bëjmë punë grash! Ç'filozofi na lindi! Aman, or zot! Shoh: Itaka ime qenka tepër larg...

Atdheun e ke atje ku e ke më mirë, thonë romakët. Por atdheu im mbetet ajo pëllëmbë toke ku ladrojnë ende kuajt e varreve...

TË SHQIPTARIZOHEMI MË PARË

Pa të keq mund të shtrohet pyetja: vërtet a ka integrim dhe deri ku ka arritur? Kjo është çështje tepër e ndjeshme. Duhet qasur mençurish e kolektivisht. Për ndarjen e dekoratave dhe posteve do të ketë kohë pastaj. Mirëpo:

1) Integrimi ynë ekziston përmes gjuhës dhe humbjeve tona të përbashkëta. Por mungon Libri gjithëkombëtar i shkollës sonë – ai i leximit, i historisë, i gjeografisë, i muzikës, i etikës. Dëshira për integrim, bile shpirtëror, merr vrap dhe ngec; ose sillet aty tek Guri i Murit tragjik.

2) Luftëtarë të pakompromis për këtë çështje dhe që mund të jenë shkollë e patriotizmit kombëtar, mbeten shqiptarët e Shqipërisë së Jashtme. Shqetësimi i tyre nuk pran qyshse etninë e bën copegrima. Ëndrra për integrim ka shpesh forma të rebelimit. Përfundon edhe me gjak.

3) Për shkak të rritjes normale dhe për shkak të paqes së brendshme e të jashtme bëhet ky rrugëtim më se njerëzor – kombëtar. Por insistimi duhet të jetë i dyanashëm, këmbëngulës dhe pa hile. Përndryshe, Atdheu vazhdon turrjen, të na bëhet laraman.

4) A janë edhe shqiptarët e Shqipërisë së Tejmurit për integrim? Këtë pyetje duhet shtruar shpesh. Se këtë gjë të shenjtë ca e kuptojnë si humbje, ca frikësohen se do të bien nga karriga. Prandaj duhet kërkuar drejtpeshimin kombëtar, që në Pazar të mos dalin partitë.

5) Manfred Osten thotë: “Çdo komb duhet të përkufizohet në radhë të parë si komb kulturor... “Kombin tonë a mund ta quajmë komb kulturor kur libri ynë asnjëherë nuk është tamam? Për më tepër se një gjysmë shekulli munguan Fishta, Konica, Koliqi, M. Frashëri e shumë të tjerë, tani kërkojmë t’i heqim të tjerët, që libri ynë vazhdimisht të jetë me defekte. Pra, kultura jonë ndërtohet sipas

bindjeve momentale në hapësirën shqiptare. Dhe formësohet ajo, që më tepër është përshtatje e çastit. Pak respektohen ose nuk përfillen fazat historike të zhvillimit tonë. Jemi këta, pra, që jemi.

6) Në mënyrë të pavetëdijshme, ose me qëllim, *Murit* ekzistues duam t'i vejmë edhe ca të tjerë. Në pyetje vejmë edhe vetekzistencën tonë. Është kohë që në të dy anët e Murit të lirohemi nga paragjykimet dhe nënçmimet; të bindemi po ashtu se kulturën shqiptare e përcakton vetëm *gjuha* jo kufijt politikë, siç e lansojnë matrapazët. Të pajtohemi me të tillët, që ngulin këmbë se puro shqiptare është vetëm ajo që krijohet brenda Shqipërisë xhuxhe – nga Kukësi në Durrës, do të thotë të pajtohemi me tragjedinë tonë kombëtare e të mos fajësojmë askë për të. Romanin “*Gryka e kobës*” të Migjen Kelmendit, mbasi në rrafshin estetiko-letrar nuk mund e rrënuan, doli problemi i *gjuhës*. Ne të Këndejmurit nuk bën të pranojmë edhe një mur të ri brenda qenies sonë. Katastrofa kombëtare do të na ishte aty tek dera, në shtëpi. Kjo do të ishte një fitore e madhe e propagandës së tmerrshme të fqinjve që e bëjnë rreth identitetit – lashtësisë – autoktonisë sonë. Në të dy anët e *Murit* ka diçka që i mungon anës tjetër. Ajo është *bukuria*. Shileri thoshte: është e domosdoshme ta zbulojë atë njeriu.

7) Nëse një poezi apo tregim të akcilit krijues nga Kosova e diaspora gjen vend në *librin* gjithëkombëtar të leximit, nuk mendoj se është arritur integrimi. Shumë krijues tanë nderohen dhe gjejnë vend edhe nëpër libra të metropoleve. Hapjen e Librit gjithëkombëtar për krijuesit jashtë Shqipërisë xhuxhe, unë e kuptoj si një korrigjim dhe hapjeje ndaj etnisë. Kjo mund të thuhet edhe për tekstet tona teatrale, që vihen në skenën e Teatrit Popullor të Tiranës, në atë të Shkodrës apo të Vlorës. Edhe pjesëmarrja e këngëtarëve dhe artistëve tanë në festivale të ndryshme nacionale nuk mund të kuptohen ndryshe pos si kthim nga vetvetja. Vërtet të kemi integrim, bile shpirtëror, duhet kaluar edhe ca pengesa: Para se gjithash, të jemi tolerantë dhe të respektojmë të bukurën nga cilado anë që shfaqet ajo, të bindemi po ashtu se copëzimi shpie tek shkapërderdhja kombëtare.

8) Në baza farefisnore nuk bëhet leximi i asnjë kulture. Nuk ka kulturë të fisit, të nahisë, të katundit, të çatisë, as kulturë të bindjeve. Ka art të mirë dhe të dobët. Idhtarë të kësaj fryme, më tepër janë bolshevikët e demokracisë. Nxitojnë të bindin rrethin e mediokërve: Ja, ne jemi të parët; me ne nis çdo gjë demokratike. Fatkeqësisht, këta janë prodhim i zemzadrugave tona, që fërkimet nuk i kuptojnë si tolerancë as korrigjime. Në një farë mënyrë, të tillët paralajmërojnë neodiktaturën. Tregojnë për njërin derisa shqirrej, i kishte rrëshqitur nga xhepi i zembrës libreza e ish-partisë, që nuk e kishte dorëzuar kurrë. Pa fije të turpit e vë prapë aty nga i kishte rënë dhe vazhdon retorikën e vet të përditshme.

Mendoj se nuk bën të çohet dorë nga asnjë fazë e zhvillimit tonë kulturoro-historik. Le të mbesë trashëgimi kulturore dhe të përvetësohet, siç thotë Adorno, ajo që është e vlefshme. T'u kthenim shpinën, p.sh. Kadaresë, Agollit, Arapit e ca të tjerëve, që krijuan në një kohë tmërri, Libri gjithëkombëtar do të ishte tepër i gjymtë.

9) Izolimi pesëdhjetëvjeçarë në Shqipëri ndrydhi shpirtin, mendim, lirinë. La pasoja në çdo fushë. Bredhjet metropoleve të krijuesve të atjeshëm, arsyetohen tani. Kam respekt edhe për ish të burgosurit, të cilët dallojnë nga tanët. Por shtegu i të dy anëve shpinte tek *Liria* e Kombit. Në shkrimet e mia u kam kërkuar ndjesë disa herë për atë që ka ndodhur e nuk e kam ditur. Por nuk mund të pajtohem se *vetëm* të burgosurit e bëjnë kulturën shqiptare dhe *vetëm* ata mund ta përfaqësojnë kombin.

Mbahen *Javë të Kulturës Gjithëshqiptare* (e dinë ata si i organizojnë) nëpër metropole të ndryshme dhe nuk ftohen krijues eminentë nga Kosova, as nga diaspora. Nuk di a mund të prezantohet, bie fjala, piktura shqiptare pa Ibrahim Kodrën, Muslim Mulliqin, Gjelosh Gjokën, Omer Kaleshin, Daut Berishën; pa skulptorin Agustin Shytin e shumë të tjerë. Këso vërejtjesh ka edhe nga fushat e tjera të arteve tona. Prania e emrave në manifestime të tilla nderon më së pari Kombin, Shtetin Shqiptar; i jep dimensionin e etnisë çfarë synon vërtet integrimi ynë, bile shpirtëror. Mosrespektimi i vlerave të Këndejmurit forcon sharlatanizmin e rrugaqësisë kombëtare – se

kulturë shqiptare na qenka vetëm ajo që krijohet brenda kufijve politikë! Paradoks ky i shkallës më të lartë, të mos them primitiv.

Nderimi i Kim Mehmetit me një shpërblim nacional nga Fondacioni “Velia”, ka edhe një qëllim: Sharlatanëve dhe mediokërve ua zbuloi se Tejmurit, ekziston një krah i Atdheut që quhet Kosovë. Aty jetuakan edhe shqiptarët, që po e flitkan dhe shkruakan gjuhën e Naimit.

A keni dëgjuar për ndonjë shpërblim tjetër nacional, bile kurajues, që iu dha ndonjë kosovari, dhe pse?

10) Integrimi nuk është utopi, as nuk e përcaktojnë perënditë ditën kur do të bëhet ai. Është forcë e brendshme, që tërheq nga bërthama e *Kombit*. Dhe, secili popull ka të drejtë vetes t’ia përcaktojë fatin. Rrugëtimi ynë, pra, është i llahatarshëm, por detyrë e shenjtë. Mund ta realizojnë vetëm urtakët e guximtarët e kombit. Skizofrenët janë pjellë e zhurmës, e rastit. Paralajmërojnë shenjat e një neodiktature, tërmete. Edhe për shkaqe të tjera, përgjegjësia është e madhe dhe u takon të gjithëve. Tani për tani, fajtor kryesor është **Guri** i Murit tragjik, që nuk na lë të shohim të tërë *Arbërinë*. Mu për këtë, ne duhet të shqiptarizohemi më parë. E pastaj, e pastaj i ndajmë dekoratat...

TKURRJA E ATDHEUT

Nuk ka gjë më pikëlluese se kur sheh Atdheun duke u tkurrur dhe kur nuk mund të bësh asgjë për të. Ai vazhdon të tkurret në vete e Ti të humbësh besimin se nuk mund të vdesësh më për të. Në hapësirën e tij, sa merr syri nga cepi, shndërrohesh një ditë në njollë të zezë, ose fshihesh në një guaskë të padukshme derisa të kalojë furtuna. Dhe kur të zgjohesh, nuk di a do ta gësh më atë grusht dhe aty tek koka.

Atdheu është shqetësim se diç i mungon. Zgjohet vazhdimisht. Gjendet në kërkim të vetvetes dhe të drejtpeshimit. Pa një ndodhi vështirë kalon ditën se shtrirja e tij tmerron. Kurrë nuk e takon ashtu siç e ëndërron.

Në një shkrim etnografik, konkretisht për kostumet, prof. Eqrem Çabej ishte i mendimit se shumëllojshmëria e kostumeve tona është një begati e madhe shpirtërore. Krahas këtij problemi ai prekte edhe çështje të tjera me interes.

Pas takimeve të *Poetëve të Mesdheut* në Mazara del Vallo (Trapani, 1986) humba udhën nëpër fshatra arbëreshe. Dhe ajo që më kishte rënë në sy ishte shumëllojshmëria e kostumeve në të cilat gërshetoheshin ngjyrat karakteristike: e kuqja, e verdha, e gjelbërta të përcjella shpesh nga ngjyra e kaltër. Ata që dinë t'i lexojnë ngjyrat fare lehtë mund të lexojnë edhe kostumin arbëresh, i cili ngërthen më vete, para se gjithash, tragjikën e qenies arbëreshe. Etnografi dhe mbledhësi i zellshëm i kangjelave, Anton Bellushi, që në fillim të udhëtimit ma kishte bërë me dije se udhës, pos fjalëve të rralla shqipe, do të na mahnitin edhe kostumet, të cilat nga fshati në fshat dallonin edhe për një të vetmen larë.

Po në vitin 1986, në vjeshtën e thellë derisa kthenim në Kryekuq, qytezë tipike arvanite, nja tridhjetë kilometra larg Athinës e ku vlonin toponimet shqiptare, nuk na interesonte vetëm peizazhi dhe

e folmja e rëndë e dialektit toskë, por edhe mënyra e lëvizjeve dhe e veshjeve. Dhe ato kostume arvanite shumë pak dallonin nga ato të arbëreshëve të Kalabrisë. Edhe njerëzit kishin të njëjtën buzëqeshje e të njëjtat mustaqe. Apo barinjte arvanitë të Pindit të famshëm që kishin zbritur atë të diel në mes të Kryekuqit, *gumat* e tyre të bëheshin se ishin punuar në ndonjë vektore të Bjeshkëve të Nemuna apo diku në Skrapar. Leshi i dhinjtë ishte i krehur e i rrahur fort. Përmes kostumeve profesor Çabej kishte zbuluar gjenin popullor, i cili e kishte mahnitur me fantazinë e bujshme.

Dhe një ditë derisa shikoja *Hartën e Atdheut* të kohës së Gadishullit Ilirik, vëreja se turrja e tij kishte qenë e tmerrshme dhe e vazhdueshme. Shpesh ishim detyruar t'i linim trojet tona e të zbritnim në zemër të Dheut. Dhe secili fis a krahinë sillte me vete diçka karakteristike nga vatrat e braktisura dhe me xhelozi e kultivonte brez pas brezi në atë copë tokë që quhet *Atdhe*. Dhe kështu brenda një pëllëmbë toke, bezdisë për grabitësit e trojeve iliro-shqiptare, ku nis etniteti ynë kombëtar, u shfaq bollshmëria e kostumeve që nuk cilësojnë vetëm pasurinë tonë të madhe shpirtërore.

Nën okupimin pesëshkullor të gjysmëhënës prapë filluan shpërnguljet. Në anën tjetër të Adriatikut kaluan ata më të pasurit. Deti për ta ishte deri në gju, një vrap kali. U boshatisën fshatra, qytete. Për një kohë truri ynë veproi jashtë Atdheut. Në romanin më të ri "*Mekani*" (botim i "Buzukut", Prishtinë 1994) Kasëm Trebeshina, përmes një personazhi, thotë: "Gjithçka e mirë që kanë bërë shqiptarët duhet kërkuar jashtë vendit të tyre dhe kur kanë jetuar në mes popujve të tjerë". Sa ka të vërtetë në këtë konstatim mjafton t'i lëshosh një sy *Hartës së Atdheut*, të shfletosh pastaj thesarin tonë shpirtëror të shkapërderdhur nga vepra e Mikel Marulit të Artës së Moresë nga ishte edhe pjesa dërmuese e arbëreshëve të Kalabrisë e të ndalemi jo vetëm tek Viktor Karpaçi i famshëm i *Shkollës shqip* në Venecie, por edhe tek një plejadë e tërë krijuesish të kulturës italiane. Të zbresësh pastaj thellë në histori deri tek Shën Albani nga Ilirikumi ose tek Shën Jeronimi nga dalmatët, do të konkludosh pa të keq: shtrirja jonë ishte një farë mënyre edhe dominimi ynë në Gadishullin Ilirik. Mosinteresimi i Evropës rreth lashtësisë dhe çështjes shqiptare

nuk mund të lexohet ndryshe pos si xhelozia e evropianëve ndaj qytetërimeve të vjetra.

Në Schwalenberg, qytezë muze në Gjermani, gjatë bisedave “Përçarjet e Evropës” (1993) kisha shfaqur mendimin edhe unë. Në fjalën time: *Apo i kthehemi Mesjetës?* Kauzën shqiptare e shihja brenda lëvizjeve të kontinentit tonë dhe propagandës shovene të fqinjve. E luta mikun tim gjerman, ta përkthejë pikë për pikë atë që do e thosha e që ishte si shtesë e fjalës sime: Nuk mund të mos e them, vazhdova pastaj, se tragjedia e popullit tim filloi mu në vendin Tuaj. Në vitin 1878, në *Kongresin e Berlinit*, Bismarku, që ishte kryesori, në mënyrë arrogante kishte deklaruar: unë nuk i njoh shqiptarët. Dhe trojeve tona kishin vërtetuar gërshërët e fqinjve. Secili kishte marrë atë që kurrë nuk i kishte takuar. Bismarku shtihej ose nuk kishte dëgjuar se intelektualët gjermanë mendonin pak më ndryshe dhe ca prej tyre kishin dhënë kontributin e tyre edhe në shkencat albanologjike, për çka u jemi mirënjohës. Shkenca gjermane ishte ndër të parat që datat tona historike i kishte shtyrë deri në Ilirinë e hershme. Dhe të isha gjerman, në mes Bismarkut dhe intelektualëve tuaj, unë do të përkrahja të dytët, të cilët patën një kurajo qytetare e qëndrim korrekt rreth zgjidhjeve etnike jo vetëm në Ballkan. Miku im ishte djersitur.

Deri vonë bota, fatkeqësisht, na shikoi përmes *dritares së zymtë* të fqinjve: si fis, pa histori, pa kulturë, me një gjuhë të bastardhur, bile bile edhe njerëz me bisha (V. Gjorgjeviq). Dhe agresiviteti, frustrimi, është veti karakteristike e popujve të kompleksuar. Serbët nuk mund ta pranojnë lashtësinë as autoktoninë e shqiptarëve në Gadishullin Ilirik, kurse grekët i rrok tmerri kur kujtojnë faktin se në vitin 1821 shqiptarët e bënë shtet Greqinë. Por ata që janë të liruar nga paragjykimet si propagandën serbe, ashtu edhe atë greke, para së gjithash, e lexojnë si paranojë të një kolektivi eksesiv. “Baballarët” e serbëve pranuan rrenën si virtyt kombëtar (Qosiq), kurse tek grekët afirmimi i antijetës u bë vlerë filozofike.

Mirëpo, tek ne ndodhin gjëra nga më të çuditshmet. Lë përshtypje se çdo gjë e kemi të tepërt: edhe Atdheun. Sillemi thuaja se Atdheu e Liria mund të fitohen kur të duam ne. Shikojeni pakëz vetëm toponimin *Maqedoni*. Nëse jemi pasardhës të ilirëve dhe nëse

Lekën e Madh e konsiderojmë ndër prijësit tanë të parë, pse atëherë nuk kundërshtojmë ndërrimin e një toponimi tonë, por rreth tij bëjnë luftë verbale grekët e sllavomaqedonët për një hapësirë e toponim shqiptar? Ose, nëse erdhi deri tek derdhja e ish-Jugosllavisë, a duhet edhe ne shqiptarët të pranojmë derdhjen e trojeve tona? Po qe se pranojmë, do të thotë se ne përkrahim hegjemonizmin sllavo-ortodoks, i cili bën çmos të shtrihet thellë jo vetëm brenda trojeve shqiptare dhe të lirohet nga joortodoksët. Ky paradoks yni, që na vë në bisht të sorrës, dëshmon se çështja kombëtare tek ne shikohet më tepër nga këndi i bajrakut. Nuk jemi të organizuar, sepse jemi individualistë të mëdhenj edhe kur është në pyetje Atdheu dhe Kombi. Përndryshe, tkurrja e Atdheut nuk ka të sosur. Humbëm Epir dhe Toplicë, tani na kanoset më e keqja. Si duket, ne çdo gjë e kemi të tepërt, pos vdekjes.

Gjelosh Gjokaj e ka një pikturë, e cila ishte punuar më parë si një pllakat për një kremte rasti. Atë e ka pagëzuar: *“Fluturimi i zogut”* Përmes tri ngjyrave dominuese: të kuqes, të zezës dhe të kaltrës ai arriti simbolikisht të na japë udhëtimin tonë më se tronditës. Nga zemra e dheut ngrihet zogu me ca pikla gjak në krah dhe merr qiellit. Ai fluturon. Dhe, po qe se fluturimi nuk e tradhton, do të ndodhin çudira në Gadishullin Ilirik. Ky do të ishte edhe triumf i intelektualit, siç do të thoshte një estet i huaj.

SHËNIM

Shkrimet e tubuara në këtë libër janë botuar më parë në “Thema”, “Zëri” (Prishtinë) dhe “Euro-Zëri” (Çyrih). Këtu kanë një sistem të ri dhe ndonjë korrigjim. “Tkurrja e atdheut” mbetet revoltë e hapur jo vetëm imja.

Autori

LIBRI QË NUK MBYLLET
(ESE DHE SHËNIME NGA ESNAFI KRIJUES)

Rilindja, Prishtinë, 1997

KUR PRAN TEKSTI

MBROJTJA E VDEKJES

Disa herë i kam rënë Kalabrisë dhe, duke udhëtuar poshtelart saj, më ka fascinuar gati çdo gjë që kam hasur - qoftë ajo edhe një gjysmë fjale e gjuhës sonë. Ose, me ditë kam dëgjuar kangjelat arbëreshe dhe kam pyetur veten ç'forcë fshihet në gjakun e shprishur?

Në një varg mbyllës të një poezie, poeti arbëresh Voreo Ujko thotë: Ju lutem mproni vdekjen. Në të parë ky apel i poetit na duket pak i çuditshëm, absurd. Çfarë vdekje është ajo dhe si mund të mbrohet; a është vdekje e çastit, apo shtrirja kohore e saj është më e madhe; pastaj në çfarë konteksti shoqëror e historik ngritet dhe çka e kushtëzon? Nëse ecim rrjedhës së mendimit të poetit nga poezia në poezi dhe nëse i bashkohemi atij udhëtimi pak ëndërrues e të frikshëm, të cilin Ujko vazhdimisht e potencon në poezi si mundësi për identifikimin e vetvetes në tërë atë rrëmujë, do të shohim se vdekja, që poeti kërkon të mbrohet, është një vdekje që ka një histori të gjatë e mjaft të çuditshme. Ajo hyri në poezinë e tij dhe trajtohet në tekst si nocion shqetësues, që ngërthen më vete një të vërtetë të hidhur. Pra, ajo është vdekje që “lindi” qysh atëherë kur identiteti i një

kolektiviteti mbeti në mëshirat e fërfëllizave të kohërave e zu të pësojë metamorfoza të ndryshme në një truall të huaj e të varfër.

I vetëdijsëm për gjithë atë çka ka ndodhur e ç'po ndodh brenda e jashtë kësaj qenieje. poeti kërkon shpëtimin. Ai ndien vazhdimisht “mërgimin e vëllezërve”, se si katundet arbëreshe po zbrazen dhe se ajo qenie jeton në iluzion. Toka e tij ka mbetur e shkretëruar, e vetmuar, nuk gëzon asgjë prej kohësh. Ajo ka mbetur, si thotë poeti, “pa kumbime e pa drejtme”. Vëren se koha e arbëreshit kurrë nuk ka qenë e sigurt dhe as nuk do të jetë. Ora e tij është ndalur diku. Veç tik-taket ia ndien në shkëputje. Në një rënie shpirtërore e pesimiste, duke parë se “arbëreshi u bë lodër”: se me të gjithkushi po luan si të dojë e kur të dojë; si ai gjithkushi ia mat impulset e frymëmarrjes. Poeti klith në rezignatë “më jepni rishtaz ëndrrën”. Se kjo qenie, në një botë kaotike e të makinezuar, arriti edhe të mos ketë ëndrra. E si mund të jetohet pa ëndërrime? Klithja e tij është një protestë, që u drejtohet jo vetëm përpjekjeve arbëreshe, por edhe atyre që e kanë hedhur në një gjendje të tillë. Gjithashtu. Ujkoja lirinë e vet nuk e sheh brendapërbrenda qenies arbëreshe. Ai është në anën e të mundurve. Pra, edhe në anën e Jan Palahut. Poeti është i vetëdijsëm se nuk mund të jetë i lumtur, po qe se edhe tjetri nuk është i lirë dhe po qe se nuk mendon si i lirë. E, kjo është veti e krijuesve humanë, por edhe traditë që populli ynë e ka kultivuar me shekuj.

Kthimin e shpeshtë në kujtime e bredhjet nëpër to që të takojë diçka nga e kaluara e kombëtares, pastaj kthimi në botën e fëmijërisë e ndonjë idilikë janë vetëm një pushim shpirtëror - një qasje diçkasë së perënduar për ta trimëruar vetveten dhe për ta mbajtur gjallë qenien arbëreshe. Kështu, në vargjet e tij zë e ndihet “troku i kalit të Konstantinit që qaset me shpatulla vdekjeje”; tingulli i lahutës së varur në ndonjë qoshe të shtëpisë paemër, diku afër ndonjë ranishteje që ka etje, po edhe ujë të turbullt nga ëndrrat e poetit. E gjithë kjo thuhet me një figuracion të pasur qoftë të krijuar nga imagjinata, qoftë të vjelë nga letërsia popullore e duke ngritur në një shkallë të lartë artistike. Ujkoja

nuk lejon që poezia e tij të jetë një pozë apo një ambalazh, mashtrim, grumbullim simbolesh apo të jetë një vargënim i thjeshtë, fjalamani: ai e kupton aktin krijues si artist i njëmendtë; po ashtu e ka të qartë misionin e krijuesit, edhe pse gjendet në një mjedis e kohë jo fort të lakmueshme.

Poezia e Ujkos shtron probleme ekzistenciale njerëzore. Në to kemi të bëjmë me një luftë shpirtërore, që i ka të rënat më të forta se të vdekjes. Po ashtu, në këtë poezi nuk shtrohet çështja e individit, por e një kolektivi, i cili, duke u përpjekur të ruajë identitetin e vet, atë që trashëgoi nga trangu, para poetit vjen e humbet jo prej sotit.

Hulumtimin e së vërtetës mbi arbëreshët e kemi përcjellë edhe te krijuesit e hershëm arbëreshë, por imazhi i poezisë së Ujkos është i ditëve tona. Ai imazh vjen e bëhet gjithnjë më i qartë, kristalizohet. Nga gjithë ajo që përjeton arbëreshi, vdekja arriti edhe të humbë misterin e vet e posaçërisht kur në qenien arbëreshe u duk ajo botë e ftohtë e makinës, e teknologjisë. Kur shiriti i asfaltit zu të silltet edhe rreth shtëpisë së paemër, të asaj shtëpie ku frymon vdekja dhe jeta. Pra, kur identiteti i kësaj qenieje zu të varet edhe nga shumë faktorë qofshin ata ekonomikë, shoqërorë apo shpirtërorë. Ja, edhe një dert më tepër për arbëreshin: lufta psikologjike.

Nëse dikur arbëreshin e trazonin varfëria, malli për truallin e lashtë, emancipimi shpirtëror e kulturor jo i lartë, përpjekjet mbinjerëzore për të ekzistuar e ruajtur me çdo kusht vetëdijen kombëtare, përkatësinë, gjuhën probleme këto që u shtruan e u trajtuan edhe në veprat e krijuesve të hershëm arbëreshë, tash këtë qenie e shqetësojnë zbulimet teknologjike, dinamika e jetëskohës, kataklizmat e ndryshme në planetin tonë, presionet sociale-psikologjike qoftë brenda apo jashtë qenies së tij, lojërat para e pas në skenën ndërkombëtare, kontakti me të panjohurën. Nga kjo dron edhe poeti. Mu për këtë nuk dëshiron të shkëputet nga tradita, nga e kaluara - se aty e sheh ekzistencën e qenies arbëreshe. Ai ka njëfarë skepse për të ardhmen megjithëse e synon: ç'do t'i sjellë të re e nesërmja; a do të ndërrojë diçka në

gjallërimin e kësaj qenieje; a do të mund ta ruajë edhe tash e tutje gjuhën, etnosin, kulturën shpirtërore; a do të mund të inkuadrohet në të mirën e gjithmbarshme të kombit? Prandaj depërtimi i botës së ftohtë të makinës dhe të teknologjisë në botën arbëreshe solli shqetësim jo vetëm tek poeti. Shkapërderdhja e kësaj qenieje filloi të jetë më e madhe, të bëhet më e shpejtë. Rruga e kurbetit, që dikur shkilej shumë më pak, tash rrahët ditë e natë. Ajo rrugë zu të kapërdijë me qindra shpirta, ndoshta t'i ndajë përgjithmonë nga gjuha e vatra e tyre.

Dhe, kështu një ditë të kohës së teknologjisë, nëpër ato rrugë të asfaltuara, rreth asaj shtëpisë së paemër, dikur rrëzë ndonjë bregoreje apo ranishteje, rrëshqiti makina, rrota e së cilës ngreh me shpejtësi të rrufeshme kah e papritura e për të cilën bardhi zezak Eme Sezer, thoshte se “është zbulimi i bukur i njeriut dhe i vetëm”. Ajo vë në lëvizje gjithçka, bart e ndoshta, nuk kthen as njerëz, as kohëra; piku ajo makinë dhuratë e mendjes njerëzore kuptimësia e së cilës në poezinë e Ujkos është e shumëfishtë. Ajo, me siguri, solli diçka të re në jetën e kësaj qenieje, por ajo makinë është makinë e harrimit për arbëreshin; e shkëputi më shpejt nga gjiri familjar dhe nga tradita për çka poeti ndjen dhembshuri dhe proteston në emër të një ekzistence njerëzore. Makina, ushtima e së cilës ndihet rrëqethshëm, duke rrëshqitur nëpër ato rrugë arbëreshe është para së gjithash simboli i së keqes; ngërthen një tragjedi njerëzore; është një vdekje që rrokulliset rrugëve të pafundme ku edhe sorrat, siç thotë poeti, “kanë marrë sëmurjen e njeriut”.

E, çfarë udhëtimi mund të jetë ai? A fillon atje nga ajo shtëpi e paemër, diku në Kalabrinë e varfër e të lënë në mëshirën e zotit e të djallit, apo fillon diku nga ndonjë rrokaqiell i ndonjë qendre të zhvilluar të Evropës së “pahalle”, nuk është me rëndësi. Me rëndësi është se ajo makinë është makinë e vdekjes arbëreshe që kërkon besim, mirëkuptim njerëzor dhe, si e tillë, mbetet çështje e hapur si shumë poezi të Ujkos. Prandaj një vdekje e tillë, e cila nuk është vetëm vdekje e një individi apo një mjedisi, kërkon mbrojtje dhe respekt. Dhe, kush mund ta bëjë këtë pos

atij që gjendet në anën e të mundurve dhe i cili është një “makinë që trazon trafikun” e botës së veshur e të ngjeshur për bukuri; e asaj bote që fshihet pas buzëqeshjes falso e premtimeve të kota. Kuptohet, pra, edhe rebelimi i poetit, në këtë udhëtim poetik i identifikuar gjithnjë me qenien arbëreshe se “liria nëpër ujë nuk është e këshillueshme”. Çfarë ironie, Evropë e qytetëruar!

Dhe nuk ke zemër të shkëputesh e të mos e dëgjosh deri në fund një kangjelë të re që lindet.

(1978)

GJUHA SHENJË E PARË

Pakëz e çuditshme ta filloj këtë tekst rreth interesimit të Xhevahir Spahiut për fatin e gjuhës, kur në veprën e tij shtron edhe shumë probleme qenësore për fatin e kombit. Arsyet janë të shumta, pse veproj kështu, në këtë moment jo aq lakmues. Dua të potencoj se gjuha është shenjë e parë e identitetit, por a mjafton ajo të mbetet vetëm shenjë?

Dy poezitë: “Gjuha shqipe” dhe “Tek rrënja e fjalëve”, prekin këtë çështje. Dhe në mes tyre frymon bota jonë shpirtërore e materiale, rindërtohet dhe ruan kontinuitetin e vet historik, ku herë-herë ngjarjet kanë intensitet mjaft dramatik nga kohë më të hershme (poezitë për Krujën e për figurat historike), ngadhënjimi i së resë me plot nuanca të një lirizmi sugjestiv (poezitë për vendlindjen, për dashurinë dhe detin); lirizmi ironik për ruajtjen e pastërtisë shpirtërore-kombëtare nga njollat e errëta, që i nxjerr jeta margjinave; ironizimi i mediokërve, shpifësve, servilëve, kalkulantëve, mikroborgjezëve, që si “shpëtimtarë” të kombit, fshihen prapa lustrës e komoditetit familjar dhe rrënojnë në emër të shoqërisë (poezitë: Dhelprat, Kapela, Miço. Shtëpia e vetmuar, Monolog mikroborgjezi) e deri te një poezi arketipe e të shprehurit të moçëm shqiptar (Çbane), apo nga mitologjia kombëtare (Anës gjakut qan Ajkuna).

Dhe në to gjejmë ide, syzhe e forma të laryshme, ku forca krijuese e kuptimore është vazhdimisht në lëvizje në ngritje dhe ngacmon kërkshërinë e lexuesit-interpretit, që përcillet deri në fund. Poezia e këtij poeti, njërit ndër më të talentuarit të poezisë sonë moderne, të mahnit edhe me sensibilitet e qasje. Duke shpalosur përmbajtjet, idetë, figurat dhe mesazhet hetohet se shkrimin e poezisë ky poet nuk e ka zeje, as nuk e kupton si mjeshtri, siç e kuptonin pansymbolistët, por nevojë të domosdoshme shpirtërore-shoqërore-historike të një krijuesi të angazhuar e të njëmendtë në kohë krizash e

shqetësimesh traumatike. Brenda kreativitetit, atë që rrëfen narratori lirik, e thotë pa ngurrim e halë në gjuhë, dëshmi për guximin e potencialin krijues të vetë poetit.

Theksova poezinë “Gjuha shqipe”, që si pikënisje ka fjalët e rilindasit P. N. Luarasi: “Mblidhmani gjakun”, që na kujtojnë tonin elegjiak e burrëror të një këngë popullore përdrinase. Në të parë, kjo poezi na duket e zakonshme, mezi arrin t’i ketë 14 vargje; nuk e ka atë zjarrin e patosin, as kumbimin madhështor të Naimit apo të rilindësve, që me aq flakë këndonin për gjuhën. Mirëpo, më vete, kjo poezi ngërthen një histori të dhembshme njerëzore; mu atë dramën e rilindësve, që poshtpërpjetë botës vraponin, duke ngritur zërin e protestës, me sakrifica të mëdha, për të ruajtur emrin, nishanin, identitetin: aty shpalohej jeta jonë e viktimizimit, posaçërisht e intelektualit tonë, që nëpër bodrumet mesjetare të Evropës, shpesh, ia gjetëm eshtrat dhe fjalët e shkapërderdhura.

Duke lexuar këtë poezi, përjetojmë dramën tonë që nuk pran. Aty dëgjohen plumbi vdekjeprurës, vetëtima e tehut të thikës e të shpatës, përbirohet vdekja mureve të plasaritura pas shpine; vizuelisht na bëhet se shohim montime e çmontime të ndryshme në trupin e gjuhës sonë, e cila, siç thotë poeti, “po thelbi i mbeti” edhe kur të huajt deshën ta vënë në pranga, ta zhbijnë.

Për ta kuptuar më mirë këtë dhembje e dashuri të poetit, mjafton t’i shfletojmë veprat, e të shëtisim nëpër biografite e rilindasve; mjafton të vëmë veshin e të dëgjojmë zëra lashtësie, mureve të kullave, rrasave të varrezave, të shpërndara anembanë dheut. Ose t’i kujtojmë përpjekjet prometeane të diasporës sonë, këndeje e tej detit, vlerën e rëndësinë e gjuhës do ta kuptonim më mirë, atë fuqinë magjike që njeriun e bën të harrojë edhe vetveten në çastet më vendimtare; do ta kuptonim atëherë edhe udhëtimin tonë të mundimshëm në kohë-hapësirë. Gjuha nuk është vetëm mjet komunikimi, por edhe shenjë e identitetit para drejt e të birit, guri hapësiror i qenies, i atdheut. “Gjuha shqipe”, poezi kjo e një evokimi artistik, është ngritur në një metaforë martiri, po edhe të një krenarie kombëtare:

*“Një plagë plumbi,
një vrragë shpate
dhe fshehtësi helmi
ca fjalë u shkoqën
ca rrokje ranë,
po thelbi mbeti...”*

Këto vargje, a nuk na i kujtojnë shumë figura të shquara nga e kaluara jonë, që shpesh në pabesi u therrën, u helmuan dhe u prenë; a nuk na i përkujtojnë përpjekjet tinzare të të huajve, që gjuhën e kulturën deshën të na i bjerrin, për të na vënë në lak më lehtë? Me disa vargje, poeti arrin të na thotë një histori të përgjakur e të tmerrshme jo vetëm për gjuhën. I bindur thellë se me bjerrjen e gjuhës e të kulturës, me humbjen e saj, nis edhe çrregullimi i qenies kombëtare - asimilimi, vdekja, harrimi i përrjetshëm, ai proteston në mënyrën e vet dhe na duket i arsyeshëm, po ashtu, kthimi i shpeshhtë i poetëve tanë në çështjen e gjuhës si objekt trajtimi, si nocion i parë kombëtar.

Mirëpo kjo poezi e Xhevahir Spahiut do të ishte e thatë, e pashpirt, po qe se do të ishte vetëm një regjistrim i fakteve; po qe se do të mungonte ajo dorë artisti, e cila nga trupi i saj di të hedhë ç’është e tepërt; poeti bën seleksionimin e gjithë asaj që para tij parakalon. Është konciz. Materies, duke ia inkuadruar nervin ndjenjor, e shpirtëzon. Mesazhi është njerëzor. Shkrimi i tekstit na shpie te një poezi aforistike, sentencë, që shënon kulmin e një krijimi, ëndërr për krijues të njëmendtë.

Poezia tjetër, “Tek rrënja e fjalëve”, që mbyll udhëtimin imagjinativ, është njëra ndër poezitë më të bukura të shkruara në kohën tonë të modernitetit. Nuk mund të mos them se sa herë shfletoj veprën e këtij poeti, ndalem mu te kjo poezi: Pse kam mall për njërin ndër levruesit më të mëdhenj të gjuhës shqipe, prof. Eqrem Çabejn, dhe pse poeti ka arritur të na japë një poezi, vërtet me vlera të mëdha artistike. Leximi i parë i saj: portreti i E. Çabejt, ndriçuesit e arkeologut të fjalëve shqipe; pra portreti i studiuesit të mirëfilltë, i cili

vetëdijëson qenien tonë dhe vë në lëvizje gjurmimin e përhershëm të çdo fjale, forme a kuptimi të saj.

Dhe, derisa në poezinë “Gjuha shqipe”, Spahiu shtron çështjen e martirizimit për ruajtjen e identitetit, në poezinë “Tek rrënja e fjalëve”, objekt trajtimi ka prapë gjuhën, por shikuar nga këndi i ndërtimit të qenies sonë kombëtare, gjurmimit të lashtësisë, etnisë, autoktonisë. Leximi i dytë nis (mund të nis) nga zgjimi asociativ i kësaj poezie-metaforë. Mbarimin e udhëtimit të studiuesit, konkretisht vdekjen e prof. E. Çabejt, poeti nuk e pranon - do të ishte baraz me asgjënë atëherë; do t'i vihej pikë çdo gjëje. Por largimin e Çabejt nga mesi ynë, gjegjësisht, siç thotë poeti, zbritjen e këtij hulumtuesi “tek rrënja e fjalëve”, ku vetvetiu merr formë dramatike përmbajtja, koncepti i poezisë na shfaqet si një mesazh shprese e vazhdimi. Prof. E. Çabej, thotë poeti, iku atje “drejt ashtit të dheut, atje ku nis shqipja dhe brumi i vullkaneve”, zbriti, pra, e jo vdiq. Ai vajti t’ua gjejë fillet e lashtësisë fjalëve “përtej Iliadës”. Çabej shkoi të ngrehë shtëpinë, përgjithnjë, tek rrënja e fjalëve”... Vargje këto plot asociacione për t’ua pasur lakmi edhe poetët në zë të të sotmes.

Një poezi e tillë e madhe, dhe shumë të tjera si kjo, që i hasim në poezinë tonë të modernitetit, në të vërtetë është pritur: poezia jonë ka një traditë prej disa shekujsh, me një taban të fortë e të rrallë. Të kujtojmë letërsinë tonë popullore me të gjitha ato balada e këngë epike; ta përkujtojmë poezinë tonë të kultivuar nga Budi, Bogdani, De Rada, Naimi, Çajupi, Serembe, Ndre Mjeda, Noli, Lasgushi, Migjeni - emra këta që pakkush i ka.

Veçova këto dy poezi, në këtë shkrim, pa shqyrtuar shumë të tjera, mjaft të suksesshme, nga ky poet, që rënojnë klishe e kritere të çoroditura rreth shkrim-kuptimit të poezisë së sotme bashkëkohore.

(1988)

EKZISTENCA SI NOCION

Ekzistenca nuk është nocion vetëm i kohës sonë, atë e lindën kohët dhe përpjekjet njerëzore për të ngadhënjyer. Para se të hyjmë në botën poetike të Fatos Arapit, lypset të nisemi nga fillimi. Pra, ç'është fillimi?

Miti, ekzistenca

Trajtimi i mitit është shpalim i vetvetes dhe dëshmi se asgjë nuk fillon nga ne e me ne; se e kaluara kurrë nuk mund të jetë diçka e vdekur, tabu për kohët e tashme e të ardhshme. Kemi të bëjmë me vetënjohjen, me identitetin, me udhëtimin e thellë në traditë, me kontinuitetin historiko-shoqëror të një kolektiviteti njerëzor, me një sintezë ekzistuese apo supozuese.

Ky interesim ndaj të kaluarës ka kohë që botën e mban në ethe, ka kohë që ndërron shumçka në ne e rreth nesh dhe vazhdimisht vjen e merr dimensione të reja. Dhe, nuk ka arte, që, në njëfarë mënyre, nuk i janë kthyer lashtësisë, origjinës, hulumtimit të legjendave, gojëdhënave, baladave mitike. Nga ky kthim i botës te burimi i vet i parë, na tërheqin vëmendjen: kultivimi, para së gjithash i humanes, se krijuesi nuk është vetëm vrojtues i zakonshëm në inkuadrimin e të kaluarës në kohën e tashme. Vetëm nga trajtimi i tyre i drejtë varet mesazhi, mirëqenia, ekzistenca dhe zgjidhja e shumë enigmave shpirtërore e historike.

Mirëpo, shpesh ngjet që legjendave e gojëdhënave mitike t'u qasemi nga një terren i rrëshqitshëm e i pakapshëm: faktet mistifikohen, dominojnë aspiratat e ndryshme, ëndrra, iluzioni. Vihet në pikëpyetje objektiviteti, etika e krijuesit, shkrimi, koha. Ndodh që një krijim artistik apo një vepër, mu për shkak të keqtrajtimit të mitit,

të pësojë fiasko dhe të mbetet e huaj, edhe për mesin ku ka lindur. Kemi një determinim të papritur. Fillon mbyllja brendapërbrenda vetvetes, neveria. Në një freskë, në erë apo tym temjani, mbetet fjala, mendimi, heronjtë, eposi popullor, magjia; zverdhon e gjithë historia e një populli.

Krijuesi ynë pak shkeli këtë rrugë. Është fat ndoshta në këtë udhëkryq të madh të botës.

Qenia jonë, duke qenë vazhdimisht e kërcënuar, e duke humbur hapësirën, duke ndjerë tërheqjen diku thellë në vete, për t'u mbrojtur nga të këqiat eventuale që i kanoseshin, bëri që vetëdija e krijuesit tonë të jetë e lartë, të inkorporohet në një mesazh kolektiv. Kjo është rrjedhë e kohëve të ashpra e grabitçare. Nga një gjendje e tillë historike-shoqërore lindi dhe poezia e ekzistencës si revoltë, si pakënaqësi, si luftë aktive për të ekzistuar, artikulum ky që na përcjell nga lashtësia jonë dhe i cili u desh të mbajë gjallë shpirtin e popullit, virtytet e tij të larta.

Gjatë shekujve mungesa e lirisë, rënia sociale, ngecjet e formimit të një kulture me vetëdije të fortë, bredhjet nga e keqja në të keqen, bëri që kënga jonë të jetë e ngjeshur me zjarr. Është e natyrshme dhe “patetika”, që po na u hetuaka edhe te krijuesit tanë të njëmendtë, por kjo athua nuk ishte e nevojshme në çastet vendimtare të ekzistencës sonë, në ato çaste hamletiane? T'i shfletojmë rilindasit, të përcjellim mendimin tonë në mes dy luftërave dhe më vonë, do të konstatojmë: klithja është krejt diçka tjetër. Lidhet me fatumin e qenies sonë. Është zëri i ekzistencës dhe ngërthen tragjedinë e kohëve tona, këngët e pakënuara. “fjalët që na mbetën në gjysmë”, histori të tëra, betejat e humbura e të fituara, lojërat e gjata të kobit e të shpresës, ëndrrat e parealizuara, të mbetura ndanë udhëve; ngërthen frymëmarrjen e kohëve që do të vijnë; kap vizionet e zonave të humbura, horizontet; para së gjithash është mendimi ynë i ri, besimi për çlirimin nacional e social, dëshira për të gjallëruar me çdo kusht, kombi të mos mbetet “gjak i shprishur”, siç do të thoshte De Rada. Një klithje e tillë, që është më tepër zë i fundit i një drame njerëzore, mund të kapet si shqyrtohet e peshohet një poezi që krijohet në kohën e lirisë dhe në vetminë e madhe krijuese. Në këtë poezi-klithje, siç ka

zënë të thuhet, ka zjarr, ka fjalë, që ndoshta na duken të tepërta, fjalë që nuk lëvizin, as thuakan gjë, por aty fshehet edhe vlera që është sublimim i kohëve për të ekzistuar. Në poezinë tonë, ajo “patetikë”, na është vija e kuqe e ekzistencës, tërhequr që nga shkalla zero, pra nga lashtësia jonë, është sinjal i kanosjes së të keqes. Me këtë nuk do të thotë se krijuesi ynë ishte i varfër për nga idetë e format, motivet e shkathësisë së shkrimit letrar, se ai mbet krijues tradicional, fati e desh të jetë i tillë, se ai kishte kohë vetëm për të vepruar, pra për të ekzistuar, shqetësimi i tij mbet frymëzim i tij i përthershëm, akt ekzistimi.

Me një shprehje të ndjeshme, Fatos Arapi i qaset të kaluarës duke e pasuruar me ide, forma e leksik. Jo vetëm ky poet na bën me dije se temat nga koha e ashtuquajtur ekzistencë kurdoherë janë aktuale e të preferueshme, vetëm ato duhet kapur në totalitet.

Skënderbeu, populli

Shtirja kohore, në poezinë e Fatos Arapit, është e gjerë. Aty frymon e kaluara jonë, aty frymon e tashmja jonë, aty është vizioni për të ardhmen. Ritrajtimi i shumë temave, i ideve dhe transformimi i tyre në kohën tonë, bërë jo vetëm nga ky poet, mbushi disa zbrazëti të ndjeshme. Së pari: historia e qenies sonë kapet në kompleksitetin e vet dhe me një trajtim bashkëkohor; së dyti: kjo qenie na qenka jo e ditëve të sotme, e lindur me përdhunë: paska të kaluarën dhe një traditë të begatshme. Nga ky kënd shoh “Kështjellën” e Ismail Kadaresë, “Ali Pashën” e “Skënderbeun” të Sabri Godos, disa vepra të tjera, si dhe poezitë e Fatos Arapit kushtuar epokës së Skënderbeut, ku edhe “në një kokërr grurë - ishte liria”.

Në të vërtetë, problemet që shtron Fatos Arapi në këto poezi, ishin probleme edhe të rilindësve, të traditës sonë, por te Arapi kanë një qasje e figuracion të ri dhe kapen në dy rrafshë. I pari: koha e Skënderbeut - simbolika e kombëtares; e bashkimit kombëtar, e shandanëve që digjeshin ndanë udhe, duke pritur e përcjellë të ashprat - lirinë, Arbërinë, dashuritë pesëqindvjeçare; koha e tragjedisë së

Beratit, e Vajkalit, Torviolli; koha e intrigave, e tradhtive “tmerrësisht të egra”, e heroizmave - Albulena; koha e atyre që ishin “ankthi i Muratit’ e “që lëviznin jetën, që diku kishte mbetur”, koha kur Skënderbeu ishte dhe mburojë e qytetërimit, e Evropës, që ishte po ajo Evropë dhëlpërake, e salloneve, e maskenballeve, e mistereve, e udhëkryqeve, e mbretërve. e ahengjeve dhe e cila shtirë se ishte e fortë dhe frikësohej nga hija e vet; akceptimi; kur të mëdhenjtë e të vegjëlit luanin dramën njerëzore; raportin: agresor-mbrojtës, por dhe dëshira:

çdo njeri ka në krahëror një copë qiell

dhe në të fluturon një dallëndyshe.

(Sulltan Murati dhe shqiptari)

Dhe rrafshi i dytë: asocijimet me botën e sotme, me superfuqitë, me marshimin e akullnajave, kur “zeroграда e tmerrshme, multisuperhataja”, siç thotë Kadareja, shfaqet: kur njeriu lypset të jetë vigjilent e në lëvizje, pra edhe qenia jonë. Poeti vë mesazhin poetik në funksion të mbrojtjes së qenies kombëtare nga të papriturat dhe forcon mendimin e rilindësve: kombin e bën gjuha, eposi, historia, liria; atë e kushtëzon kolektiviteti i pathyeshëm.

Në këto poezi nga lashtësia jonë e për lashtësinë tonë, Fatos Arapi ngrit edhe problemin në relacionin *Skënderbeu - populli*. “Populli? Po, ai ishte Skënderbeu, Skënderbeu, po, ai është populli” konstaton poeti dhe është i mendimit se heroizmi i individit, sa është heroizëm personal, aq është edhe heroizëm i një kolektiviteti njerëzor. Interesant është të shikohet në këtë kontekst ndërtimi i tekstit dhe folja *me qenë*, që na jepet në dy forma e që lidh dy kohë: *ishte* dhe *është*. Nga kjo na del se populli është i pavdekshëm dhe se heroizmin e vet e ripërtërin nëpër kohë dhe duke ripërtërirë e kujtuar atë, fiton shtrirje të re. Si duket, Fatos Arapi këtu korrigjon - plotëson më së shumti rilindësit e sidomos në ndërtimin e tekstit poetik: indi poetik është indi i një poezie meditative-metaforike, ka një figuracion të pastër e konkret, një ritëm dinamik: trajtimin e kësaj fytyre markante të historisë sonë, nuk

e keqtrajton, siç ndodh shpesh, po ashtu ky është ndër të parët në poezinë shqiptare që Skënderbeun vjen dhe e zbret në mes të njerëzve të thjeshtë, në mesin e atyre që e kishin bërë trim, që e kishin ndarë të mirën e të keqen me të, e zhvesh nga një romantikë e kohës, e bën më njerëzor e më të afërt, se populli dhe Skënderbeu janë “një pikë ku shkrihen hapësirat e kohët”.

Ndërkaq, rreth çështjes popull i vogël apo i madh, që është aktuale dhe në kohën tone, poeti është i vetëdijshëm se edhe tash e tutje kjo do të ekzistojë se e tillë është krijuar bota, por raportet në mes tyre nuk do të varen nga forca, ato nuk u varën as në kohën e Skënderbeut. Ekzistenca e një kolektiviteti njerëzor nuk mund të përcaktohet nga askush po qe se ai kolektivitet ka forcë shpirtërore e logjike të fortë të qëndresës, ta shpjerë vetveten kah rruga e dritës. Na mbetet të dëgjojmë zërin e poetit në këtë botë plot temperaturë.

Lufta, fëmijëria

Qenia jonë, thuajse kishte lindur të jetë në shënjestër të çdo të keqeje e kohe. Shfaqej e keqja në gjithfarë formash, qoftë nga brenda, qoftë nga jashtë. Shkaktarë të saj ishin shumë faktorë, por, para së gjithash, shoqëria e këputur që e kishte sjellë në një gjendje “të rrosh a të mos rrosh”; ajo shoqëri që ishte “si brenda, si jashtë, ndërtuar prej hicit”. Qenia jonë, megjithatë, kahmoti ishte vënë në kundërshtim të këtyre të këqijave, ishte në kërkimin e identitetit, drejtpeshimit kombëtar.

Dukja e fashizëm-nazizmit, e inkuizitorëve modernë të lirive të reja, siç thotë poeti, brenda kufijve të saj, ishte shenjë se diçka ziente në njerëzimin, në ndërgjegjen e tij. Forcat ishin të pabarabarta, tmerresisht të pabarabarta. Në një anë kanosej zhdukja totale, në anën tjetër vetëmohimi, sakrificat dhe “gjak ishin këngët” (Drashovica). Kjo e zezë që i kanosej njerëzimit dhe ky heroizëm i “leckamanëve” erdhi e u derdh edhe në poezinë e Fatos Arapit, i cili sy më sy kishte ndejtur me atë kohë, i cili kishte parë tmerret, vrasjet e shokëve dhe të njerëzve të pafajshëm dhe i cili kishte ndjerë idhtësitë e egërsitë e saj,

atë dhëmbin vdekjeprurës që hapte dhe “varre në një kokërr grurë”. Ishte ajo një përrallë që kurrë nuk e kishte dëgjuar më parë, as nga gjyshja, por një ditë, pas gjithë atyre të këqijave, erdhi e iu shpalos nëpër fjalë.

Lirikat e luftës së Fatos Arapit, nuk janë krijime, thjesht, imagjinative, të ndërtaura në bazë të gojëdhënave, baladave, miteve; ato janë të vërteta të mëdha të një kohe pis, janë ngjarje të ndiera thellë, të kapura e të transmetuara me një shkathësi artisti. Dhe, megjithëse në to ndihet prolisiteti, konvencionaliteti, ato shquhen për idenë rebeluese dhe janë dëshmi e një ekzistence që merrte formën e vet, duke kërkuar drejtpeshimin - se ishin “brenda kokrrës së grurit: gjyshërit, stërgjyshërit, prindërit, ne, të tjerë e të tjerë”, brenda qëndresës sonë, ishin kohët tona që i kishim vjelë ndanë udhe, ku digjeshin shandanët e dashurive tona. Të rënat ishin të panumërta, edhe pse optimizmi merrte rritë. Me kohë, motivet nga Lufta Nacionalçlirimtare erdhën e morën thellësi mitike, u mbyllën si imazhe tmerri e heroizmi, diku në kujtesën e kombit dhe në fjalën e poetit u shtresuan.

Në lirikat e luftës, ku frymon tërë një popull e sidomos në lirikat ku bën fjalë për fëmijërinë dhe ku na jepet një pasqyrë e zymtë e reale e gjendjes shpirtërore-materiale të qenies kombëtare para e gjatë luftës, poeti është mjaft emotiv dhe këtë e shoh për dy arsye: kur filloi lufta, poeti kishte dymbëdhjetë vjet, dhe dy: gjatë të shkruarit të poezisë nuk mund ta frenonte veten, se ishte dëshmitar i asaj lufte, disi dëshiron të kapë çdo gjë të asaj kohe dramatike, të mos lëshojë asgjë pa e futur në tekstin letrar, pa e mbyllur në atë kutinë magjike të quajtur poezi.

Këtij shtegu e shohim edhe kthimin e poetit në fëmijëri, që për të është “mesjetë e vdekur dhe e pavarrosur”, në atë udhëtim ëndërrues-përmallues, që na shpie deri te koha e dridhjeve të forta, e cila është dhe një zë shprese që kishte plasur nga thellësitë e tokës, e legjendave, e baladave - ishte ky zë i lashtësisë, siç do të thoshte një bashkëkohanik yni: dalje nga ankthi shekullor.

Luftën Nacionalçlirimtare, Fatos Arapi, po ashtu, nuk e trajton vetëm si luftë të çlirimit nacional e social. Është i vetëdijshëm se “çdo

kohë e urtë është dhe e madhe” dhe vëren se çdo kohë nuk mund të jetojë e shkëputur nga njeriu, se ajo në psikën e njeriut lë diçka të paharrueshme, diçka që vjen gradualisht e merr trajta njerëzore. Në kujtesën e poetit, ajo është humaniteti, solidariteti, se në historinë e vet populli i tij nuk kultivoi kurrë ndjenjën e agresorit. Pra, pse të mos i besojmë.

Deti, intima

Në poezinë e Fatos Arapit, *deti* është simbol i preferuar dhe gjithmonë ka kuptimin e parë: identifikimin. E ndeshim në pjesën dërrmuese të poezive. Koha e parë, aty, përshkohet nga një mall e tragjikë jetësore, lidhet fort me kujtimet e poetit, më mirë të themi, me fëmijërinë e tij që ishte “lodër guacash deti”, e që mund të ngritet edhe në një simbol kombëtar: a) deti na ka sjellë të keqen shpesh te pragu, na ka larguar nga trangu e kurrë nuk na ka kthyer; b) deti na ka mbyllur në kulla e na ka shtyrë të perceptojmë hapësinë e qenies sonë dhe c) sakrifica për të mundur të keqen, për t’u kapur për fijet e jetës; ëndrra, pra, për identifikim. Bëmë një digresion, mbasi koha e parë e detit në poezinë e Fatos Arapit, është një vizion i diçkajes të frikshme që ka perënduar, por e lidhur fort me fatumin njerëzor-kombëtar:

*“Nëpër fushat e gjëra të natës
ngriheshin kope të çuditshme të panumërta
kuajsh të bardhë
nëpër hapësirat e pafundshme
suleshin aradhë-aradhë”*

(Deti)

Koha e dytë: deti na jepet si një element burimor - dekorativ në hartën e ekzistencës sonë, na është një peizazh gëzimi, i triumfit të së resë. Është koha kur poeti i kthehet të tashmes dhe nis ndërtimin e

vetvetes nga takimi i tij me detin, atë ujin e madh që është edhe frikësim.

Qasje interesante në krijimtarinë poetike të Fatos Arapit janë edhe lirikat e dashurisë, ku kryesisht dominon të folurit figurativ me një patos qyteti, pra, fryma e poezisë urbane. Poeti vë dialog me dashurinë, me kohën, me botën që e rrethon, dhe shpalosen fate me dimensione të reja.

Dendësia e mendimit në këto lirika, na shpie deri te poezia meditative, që shënon shkallën më të lartë të botës poetike të Fatos Arapit. Në kultivimin e një poezie të tillë, del në pah të shprehurit e tij bashkëkohës, i cili na shpie kah racionaliteti i figurës bazë në poezi.

Poet i romantikës moderne

Përderisa në Evropë poezinë e re e ka rrokur vala e madhe brehtiane, revolta ndaj ekzistueses, që nganjëherë po shndërrohet në mënyrë specifike të sjelljes, poezia e Fatos Arapit shtron një problem tjetër e që është mjaft qenësor: ndërtimin e qenies kombëtare. Jeta e re sollti mendimin e ri mbi kohën, mbi shoqërinë, mbi artin, mbi ekzistencën, por kohës së poetit, para së gjithash, i duhet guximi, besimi, prandaj:

*Mbi supin e kohës sime
kryet mbështeta.
S'dremita. Nuk fjeta.
Mbi supin e kohës sime,
si mbi supin e Asaj—
rashë në mendime
rashë në mendime.*

(Mbi supin e kohës sime)

Duke parë se kohët që shkuan kishin lënë shumë zbrazëti në botën e qenies sonë, poeti na angazhon, na vë në lëvizje ndërgjegjen, vazhdimisht, dhe na nxit të mendojmë për çdo gjë që na rrethon, por që më vete ka njëfarë romantike që, në këtë rastin tonë, do ta quanim romantikë moderne, apo, si thotë vetë poeti: “ndej romantikat e reja”, sepse “romantikët e dikurshme”, ato të gjumit shekullor, përdridhen tash si një imazh i zymtë e i largët i së kaluarës...

Poezinë e këtij poeti e shikua brenda ekzistencës sonë. Kjo nuk do të thotë se mu këtu ekziston e tërë madhështia si poet e njeri e Fatos Arapit.

(1979)

LARG PIKËS SË VDEKJES

Për gruan e tokën

lë kokën

D. Agolli: Toka ime, kënga ime

Të pagjumët, vetëdija historike

Kokëçarje më të madhe, asgjë nuk i ka sjellë Botës sa Negacioni - Pakënaqësia. Brenda natës, brenda ditës, zhdukeshin popuj, shtete, gjuhë. Mbetej vetëm zbrazësira në kohë-hapësirë dhe kujtimi i zymtë, ose flitej për ata popuj e shtete e gjuhë, si për data tragjike të njerëzimit, si për gojëdhëna e mite të një qytetërimi të zhdukur.

Një fat ogurzi, gati pësuam edhe ne. T'i kthehemi vetëm të kaluarës; të lexojmë baladat tona të hershme, epikën; të shikojmë evoluimin e gjuhës, toponimet, emrat tanë; të gropojmë kështjellat, bedenet e qyteteve tona-botën tonë materiale; mjafton të dalim pak kohë nga vetvetja dhe të shikojmë në distancë nga jashtë, jetën-kohët-historinë, do të shohim se e kaluara ishte, sa e lavdishme, aq edhe tragjike: “Një copë, një copë! Një çikë, një çikë! Ulurinën ujçit në mes zhegut, kallkanit”.

Ndodhnin njëmijë e një e zezë sa çel e mbyll sytë.

Mirëpo e gjithë kjo kurdisje e kanosje rreth qenies sonë në vetëdije u kultivua ndjena e rreptë e ekzistencës, e urtisë shekullore që do të bartet brez pas brezi, ngjalli datat e figurat historike. Dhe brenda kufijve gjeografikë të qenies sonë; brenda gjuhës, e cila shpesh na ish “lesh arapi”, brenda simbolit tonë mbetej jeta e kafshuar. Jashtë saj

përgjonte vdekja se “mua më gjuan, dhe mua më ndjek me gisht në këmbëz shtrënguar” (Poema e të pagjumëve).

Mesazhi poetik, që na doli si urti e këtij udhëtimi tronditës, nuk kujton, as nuk mbeti vetëm një e vërtetë e hidhur e kohëve të sotme, plot nokdaune e të papritura, të cilën na kujton Dritëro Agolli, e që u bë lajtmotiv jo vetëm i poezisë së tij, nuk mbeti, pra, problem qenësor vetëm i qenies sonë. Ky mesazh poetik, i cili mund të lexohet edhe si pllakat vjen e thellohet si alarm i përgjithshëm njerëzor, ndezur kahmos, ndaj mendjeve të ndryshkura që Botën e sollën shpeshherë në zgripç.

Nga ky kënd i të vërejturit duhet ta shikojmë edhe simbolikën e kullës sonë, të cilën njeriu ynë e ngriti jo pse dëshiroi të mbyllet në të, “të izolohet” në atë vetminë e madhe e të ftohtë, por pse Bota e solli në një gjendje të mosbesimit, para aktit të zhdukjes, dhe pse njeriu ynë deshi të ruante identitetin e vet. Se, përralla e kecape, siç thotë poeti, ishte për qenien tonë një e vërtetë e përjetuar nëpër shekuj e që iu desh kohë pastaj ta deshifrojë “gjuhën e gënjeshtreve”. Kemi të bëjmë, pra, me një sublimim kohësh që shkroi historinë dhe formoi vetëdijen.

Konteksti i pagjumësisë në tekstin poetik të Dritëro Agollit, që është negacion i shqetësimit të krijuesit human, na duket mjaft karakteristik për kohën tonë, mu për shkak të nëntekstit të tij të forte, i cili na thotë: Bota është e të pagjumëve dhe përderisa të ketë të pagjumë, Bota do të ketë qetësinë e vet. Fjala është për një ikje nga katastrofa eventuale që do të mund të ndodhte në Botë. Që vetëdija të mos vërë ndryshk, siç do të thoshte Kadareja, dhe që e keqja Njeriun dhe Botën të mos e gjejë në gjumë, ajo duhet të rrijë zgjuar në çdo kohë.

Vetëdija historike mbron të ardhmen, kohën e tashme, duke e shndërruar në radar.

Toka, njeriu

Në poezinë tonë, simbolin Tokë e kushtëzon simboli Njeri. Dhe simbolin Tokë duhet ta kuptojmë si akt të vetëflijimit të simbolit Njeri. Prandaj thënie e poetit se “për gruan e tokën lë kokën” nuk duhet ta marrim si pozë, as si retorikë e momentit. Njëra nga arsytet është kjo: këtë nuk e thotë një njeri, i cili mund të fshihet pas nocionit popull; këtë e thotë njëri prej poetëve tanë që ka bërë emër, e i cili në poezinë shqiptare hyri me një zë burrëror, me temperamentin dhe shpirtin e malësorit, thotë një kritik, duke e pasuruar traditën tonë historike me tema e realizime të suksesshme.

Simboli Tokë, i shfaqur mjaft dendur në poezinë e Agollit, rri pranë simbolit Njeri. Të dy këto simbole janë të lidhura fort dhe bëjnë mozaikun e ekzistencës sonë. Së pari: njeriu ynë shpeshherë diti të lërë kokën në kufirin gjeografik të Tokës, të mbetet një datë e saj historike, apo, thjesht, një muranë dhe poeti ta ngrisë Tokën deri te personifikimi *nënë*. Së dyti: njeriu ynë brodhi kurrizit të kësaj Toke me shekuj dhe duke udhëtuar nëpër të zbuloi fshehtësitë e kohëve, magjitë, ëndrrat, pritaj; ndjeu frymëmarrjen e saj dhe ruajti identitetin e vet me çdo kusht; mësoi, pastaj, shumëçka për vete e tokën e tij, se ato (ngjarjet shoqërore-historike) “i mbollli rugëve të gjata historia e derdhur valë-valë” (Zgjimi i baladave). Dritëro Agolli, nga ky udhëtim yni, ta quajmë këtë udhëtim imagjnativo-historik, nxjerr dhe selit thënie e urtë: “Një grimcë e tokës së madhe jam unë” (Toka ime, kënga ime). Identifikimin e krijuesit (lexo: edhe Njeriut) e sjell deri te depersonalizmi. Është i vetëdijshëm se Toka i takon secilit dhe secili ka të drejtë për dashurinë dhe mbrojtjen e saj.

Një segment tjetër që tërhiqet në tekstin poetik të Dritëro Agollit e që harmonizon simbolin Tokë me simbolin Njeri, janë malet, që në poezinë shqiptare u shfaqën si lartësi të papritura e dramatike për këmbën dhe plumbin e të huajit. Konstatimi i poetit “S’besoj të ketë kaq male poezia e Evropës sa ç’ka poezia jonë” dëshmon edhe një herë lidhjen e fortë të simbolit Tokë me simbolin Njeri e që është vazhde e traditës sonë krijuese. Ngritja e maleve në tekstin letrar të

poetit arrin deri te poezia-figurë. Kjo dëshmon se Agolli mund të krijojë poezi edhe me një semantikë të pasur bashkëkohëse çfarë krijohet sot edhe në poezinë më të re shqiptare. Në këto vinjeta poetike (Për bukurinë, Përsëri për tokën, Duke udhëtuar në male etj.) shihet disiplina krijuese e poetit, imagjinata e vrullshme, konciziteti dhe dendësia e vargut.

Duke shpalosur poezinë tonë në përgjithësi, do të dilte ndokush e do të thoshte: Ç'janë gjithë këto male në poezinë shqiptare, ç'na duhen, kur Evropa i nxori nga artet, do të thoshte ndokush. Mirëpo, të dëgjonim të tillët, ne do të ndienim shkëputjen e simbolit Tokë nga simboli Njeri dhe simbolin Tokë të ngritur në simbol kombëtar, do ta zhvlerësonim e zhvishnim nga kuptimi i parë, që ka rëndësi të madhe për ne. Prandaj kur poeti u drejtohet maleve, na bëhet se ndiejmë frymëmarrjen e njeriut të kësaj Toke; na bëhet se kemi hyrë në një botë tingujsh të çuditshëm, legjendash tragjike, epikash të rënda; se zërat nga baladat arketipale zënë e përplasen për veshin tonë dhe dialogu me traditën-kohët-historinë, zhvillohet në mënyrë mjaft spontane. Sensibiliteti i një substance lirike, vjen e na shndërrohet në një jehonë këmbanarësh.

Para madhësisë së maleve, mahnitet poeti, dhe në atë botë epikotragjike përpiqet të zbulojë atë enigmën shekullore, të cilën do ta quajë enigmë shqiptare (Poema malore). Ç'është me rëndësi dhe primare në këtë rastin tonë, Dritëro Agolli malet, figura më e preferueshme në poezinë e tij, i shikon si mburojë të qenies sonë: në to u strehuam, por në to i lanë eshtrat edhe ata që erdhën e që na ndoqën. Kemi një qasje këngëtimi krejt tjetër prej atij të Naim Frashërit, i cili malet i kujtonte nga brigjet e Bosforit, më tepër për atë bukurinë vizuale. Ndërkaq, në tekstin e Agollit, malet kryejnë funksionin e mbrojtjes. Pra, koncepti i bukurisë këtu merr edhe dimensionin vertikal. Mendimi i dikujt do të na dukej naiv, po qe se këtë strehim në to, do ta trajtonim ndryshe, pos si ekzistencë. Qenia jonë, e mbështetur vetëm në forcën, heroizmin dhe logjikën e vet të fortë, historinë e kuptoi drejt dhe, siç thotë poeti, tokën s'e deshi si njerikë. Mendimin tonë do ta forconim, po qe se pakëz merremi me poezinë "Krevati i perandorit" ku poeti, përmes partizanit Meke, na

jep portretin e njeriut tonë: urtinë, humorin, botën ndjenjore, shpirtërore, syçeltësinë, karakterin e tij të paluhatshtëm para historisë: “Kudo jam unë Mekja e kudo kam qenë e do të jem kudo e ti do të dridhesh nga unë”. Apo lidhshmërinë e fortë brendapërbrenda qenies sonë, ndërrimin e brezave dhe thellimin e traditës në poemën “Baballarët”.

Dhe një plotësim: qenia jonë, megjithatë nuk ka shtrirje të madhe kohore-hapësinore në artet tona. Gati çdo gjë fillon me kohën e Skënderbeut. Asnjë hap më larg. Nuk mund të shtrohet mungesa e fakteve... Ose, bëhemi aq qesharakë sa gjërat brendapërbrenda qenies sonë të trajtohen si probleme të një gjysmëqenie, të një gjysmëkulture apo të një gjysmëhistorie. Nuk ka tërësi, nuk mendohet për totalitet. Ngjet të këputen lidhjet me vetveten e traditën. Korrespondimi i Dritëro Agollit e posaçërisht i I. Kadaresë dhe i disa krijuesve të tjerë me të kaluarën, deri diku kanë zënë të ngrisin këtë si çështje.

Gruaja, kanuni

Në vazhdimësinë e qenies sonë dhe në formimin e simbolit Njeri, kontribut të madh, pa dyshim, dha gruaja jonë, atë vakuum që kishin lënë pas kohët, luftërat, rrënimet, arriti ta mbushë vazhdimisht me kocin e së nesërme, me mishin e ri, siç do të thoshte Alen Boske. Ishte e mbeti ajo një feniks i çuditshëm, që mbajti gjallë qenien tonë, nishanin, ninullat, ëndrrat në momente më dramatike, që shpeshherë e sollën para aktit të kryer. Fuqia e saj e madhe përtëritëse nuk është një “ekspansion” dhe nuk mund të jetë, është një vazhdimësi e natyrshme brendapërbrenda qenies sonë e që veten e sosur rilind. Mund të ketë dorë, ndoshta, momenti socialo-intelektual, kështu mendojnë ca; ndoshta, mund të kenë dorë edhe ndonjë faktor tjetër, që në këtë rastin tonë nuk na tërheqin vëmendjen aq shumë, por gruan tonë, vazhdimësinë tonë të përhershme, duhet ta shikojmë, para së gjithash, si një metaforë të qeniesisë shqiptare.

Duke parë se ç’përjetoi në të kaluarën ajo si nënë e si luftëtare, sakrificat e saj, dhe duke ndier praninë e saj vazhdimisht në jetë. në

ndërtim, në arte, në përpjekjet tona, Dritëro Agolli i qaset me një respekt gruas, botës së saj ndjenjore, shpirtërore. Ai çmon dinjitetin e heroizmin e saj nëpër shekuj. Dhe te ajo nuk sheh të bukur vetëm trupin e saj, apo të merret vetëm me bukurinë e saj vizuale, siç do të vepronte ndonjë krijues pornografik, i cili kënaqet sensualisht, e të bukur sheh te femra vetëm vijëzat e trupit, lakuriqësimin e saj. Poeti ynë, as kur asaj i pëshpërit intimitetin e vet, nuk e zhvesh nga ndjenjat. Për të gruaja mbeti një bukuri e thjeshtë, si në kohë lufte, kur ajo lindte e luftonte krahpërkrah me të tjerët, si në kohë paqeje, kur u bë faktor i rëndësishëm i shoqërisë: “E bukura, tokësorja, e thjeshta grua” (E bukura).

Poeti, duke kënduar për personalitetin e gruas sonë, është i mendimit se për të ende nuk kemi bërë shumë; se për atë që ka lindur “kreshnike e përrit” mendojmë dhe këndojmë shumë pak. (Gratë tona). Pra, kërkon emancipimin e plotë: gruaja nuk mund të jetë më “rob” shtëpie, as nuk duhet të merret nëpër këmbë se “përparimi i një shoqërie, siç thotë Marksi, mund të matet saktësisht me pozitën shoqërore të gjinisë femërore”. Indikacione të theksuara mund të nxjerrim në poezinë “Mundja e Lekë Dukagjinit”. Aty poeti godet anët e vjetëruara të kanunit, i jep krah të resë dhe të drejtë lirisë së personalitetit të gruas. Pra, kemi shpalimin e një të vërtete që mund ta quajmë të vërtetë historike dhe diferencimin nga një e kaluar, e cila la pasoja në vetëdijen tonë dhe i kushtoi shtrenjtë, posaçërisht gruas sonë.

E, se gruan do ta shpjerë larg, duhet t’i besojmë betimit të poetit.

Përfundimi

Flitet shpesh se në poezinë shqiptare të viteve ‘50 e ‘60 kanë ushtruar ndikim të dukshëm Jesenini e pjesërisht edhe Majakovski. Bazë e këtij mendimi merret ndërtimi i poezisë, përkimi i temave, verbi poetik, krijimi i atmosferës... Ky konstatim nuk është i pabazë. Por poezinë nuk duhet ta shikojmë vetëm nga ana e jashtme, që do ta

quanim formalitet, ose të kryqohemi në atë thënie: për një subjekt nuk mund të këndojnë dy, apo më shumë poetë. Ne duhet të hulumtojmë atë kryesoren: mëvetësimin e botës ndjenjore e mendore të poetit. Dy shtëpi mund të jenë identike, të kenë të njëjtën arkitekturë, të njëjtat fasada, të njëjtat dyer e dritare, por njëra të jetë prej kartuçit e tjetra prej gurit. Kërkohet çelësi: poezia e një poeti mund të përkojë me modelin e poezisë së një poeti tjetër, por cila do të ketë jetë më të gjatë, varet se ç'probleme shtron dhe ç'hallkë është ajo në mozaikun ekzistencial të një populli.

Dritëro Agolli nuk kultivon një poezi të revoltës, as nuk merret me boeminë në krijimtari, e që në poezinë ruse, konkretisht Jesenini, e ngriti njëfarë ure në mes poezisë rurale dhe asaj urbane. Poezia e poetit tonë rrëshqet kah poezia e hapet si krijim dhe tenton të jetë një poezi e këndimit kolektiv, të kapë dimensione të mëdha kombëtare siç ndodh me poemat “Nënë Shqipëri” dhe “Baballarët”, ku poeti mbështetet fort në amën e traditës sonë krijuese dhe vë kontakt me ato fytyra e data të rëndësishme historike të qenësisë sonë e që këtë ia parashtron vizioni i tij poetik e n'daç edhe estetiko-filozofik.

Apo, atë ironinë, e cila e përshkon gati tërë krijimtarinë e këtij poeti dhe e cila i rri vazhdimisht në majë të gjuhës, mendojmë se duhet kapur nga dy rrafshë. Rrafshi i parë është kur Dritëro Agolli ironinë e drejton kundër dukurive e ligjeve prapanike të trashëguara nga e kaluara e që kemi të bëjmë me mentalitetin tonë bizantino-anadollak. Rrafshi i dytë është kur shoqëria e re kërkon një farë pastrimi, të themi shpirtëror e moral, të brendshëm. Është koha kur mund të nxjerrin kokë karrierizmi, snobizmi, moda, keqpërdorimet; shfaqja e pseudove në krijimtari e kulturë, që kriteret e veta i ndërrojnë orë e çast, ose të arriturat e një shoqërie i lidhin ngushtë me egon e vet. Kujt nuk i kujtohet Zyloja, njëra ndër fytyrat më markante të prozës sonë të re. Ai nuk ishte vetëm, as mbeti, por Zyloja u bë unikat, sinonim i shkëlqimit të rrejshëm, i cili ngërthen më vete tërë karakteristikat e një fytyre të padëshiruar për një rend të ri. Dritëro Agolli, në krijimtarinë e vet bën dhe kërkon, pra, një katarzë nacionale: himnizon virtytet e larta dhe thumbon atë që nuk lë të ketë një rrjedhë të natyrshme transformimi shoqëror, çfarë i është përcaktuar.

Në të parë poezia e Dritëro Agollit lë përshtypjen se mund të shkruhet pa u djersitur e sidomos poemat, mirëpo mu kjo thjeshtësi ka edhe atë thellësinë e mendimit poetik-filozofik që ne na mbetet ta shpalojmë - interpretojmë. Përkundër kësaj, për vlerat e veta krijuese dhe të brezit të vet, poeti është modest dhe beson në mirëkuptimin e brezave që do të vijjnë; se ata do t'i kuptojnë mundësitë e tyre krijuese e se kohë kishin vetëm për çështje të tjera më të rëndësishme të ekzistencës - se brezi brezin plotëson-korrigjon. (Poetëve që vijjnë).

Në poezinë e këtij poeti, që është një dokument i fortë i historisë sonë më të re, vërehet prania e letërsisë popullore. Do të thoshte dikush: kthimi kah letërsia popullore shpie te "folklorizmi". Krijuesi i njëmendtë i kthehet asaj për dy arsye: në krijimin e vet imagjativat kërkon të sintetizojë urtinë e popullit dhe të lidhë hallkat qenësore të historisë e shpirtit të tij dhe, së dyti, në kreativitetin e vet artistik, figurat, metaforat e "vjela", syzhet e idetë, t'i ngrisë në një shkallë më të lartë artistike. Këtë e bën edhe Dritëro Agolli, i cili hyri në letërsinë shqiptare në vitet '60, vite këto që mund të merren vite kthesash për kulturën tonë në përgjithësi. Në këtë kohë u shfaq brezi i artë i shkrimtarëve me potencial të madh krijues si Kadare, Fatos Arapi etj.

Nga kjo që u bë fjalë e që mund të zgjerohet me ide të tjera, përfundojmë se veprimtaria e gjithmbarshme e këtij poeti na begaton shpirtërisht e kombëtarisht dhe na shpie larg pikës së vdekjes.

(1982)

VENDLINDJA - PREOKUPIM EKZISTENCIAL

Në tekstin poetik të Abdylazis Islamit ngriten si probleme kombëtare: kurbeti dhe ekzistenca. Të dyjat problematizohen brenda kufijve gjeografikë të qenies sonë dhe vihen në kontekstin historiko-shoqëror. Shkaktari i këtyre problemeve dihet. Por kjo, tani për tani, është jashtë kompetencave të artit. Krijuesi ynë vetëm i emërton ato dhe i vë në spikamë, si probleme më se qenësore.

Ne na mbetet vetëm të vështrijmë tekstin e tij dhe të merremi më tepër me problemet që shtron.

Vendlindja

Pra, pikënisje e tekstit poetik të Abdylazis Islamit është vendlindja. Nga aty jeta shpalohe, degëzohet dhe artikulohe.

Po çfarë na është kjo vendlindje?

Duke ecur gjurmëve të poetit, do të mësojmë se vendlindja e tij është një rrip toke gurore, e cila gjendet dikund pas sa bjeshkëve e lisave, atje në majat e errëta e me borë të Sharrit, e harruar në halle të veta. Rrugën për në ato maja, e di poeti dhe malësori ynë. Kështu, fjala e tij na bëhet gjithnjë më domethënëse, më dinamike, duke mbyllur në vete peizazhe, erëra, ngjyra dhe fuqinë epike sharrjane. Para nesh poeti ngrit perden e një ambienti të ashpër malor, ku “natën ëndërron kroi (e) ditën ecën me drojë”. Na vendos në një kuadër të jetës sonë, e cila nuk është pa fshehtësi e dramë njerëzore. Në të vërtetë, vendlindja e Abdylazis Islamit, të cilën na e ofron përmes një ligjërimi figurativ, në të cilin, në të parë, figurat na duken mjaft të eksploatuara, është fshati ynë: me kulla të shpërndara e të vetmuara e ura gati të rrënuara, fshat ky që e kemi hasur sa e sa herë në letërsinë tonë. Por ajo që e bën këtë

më tragjike nga fshatrat e tjerë, është kënga e kurbetit, e cila vazhdon të këndohet e ta trandë thellë qenien tonë.

Në vendlindjen e Abdylazis Islamit gjendja sociale është rrjedhë e shumë brengave, dramave, historive pikëlluese. Këtë nuk e ilustron vetëm udha e pafund e kurbetçarëve. Megjithatë, ka diçka në atë tokë gurore që e inkurajon poetin, që poezinë e tij e bën të gjallë, optimiste dhe të shpresosh në gjithë atë që shpalohej para poetit dhe nesh, ai është morali e vitaliteti i njeriut të maleve tona, karakteri i tij i fortë, që nuk jepet para së keqes e presioneve, ngado që vijnë. Kjo forcë jetëbesimi hetohet në tekstin e tij, megjithëse, siç thotë poeti, në atë skenë të hapur malore: “nuk mund për çdo gjë të shkruaj”. Skepsa nuk është vështirë të kuptohet, as të arsyetohet.

Po qe se vazhdojmë të lexojmë poezinë e Abdylazis Islamit me një kujdes më të madh, pra gjithnjë brenda tekstit të tij poetik, do të shohim se cenzura e tij shpirtërore, n’daç edhe jetësore, shpesh e vë poetin para të pamundshmes, para një dileme të vështirë. Cilës udhë të nisët: të kurbetit apo të mbesë në mes të njerëzve të vet të varfër, atje lart, në majat e Sharrit. Rrugën e dytë e sheh, para së gjithash, te përpjekjet e vazhdueshme të njerëzve tanë për të mbetur të lidhur fort për truallin, se vetëm “lisi pranë lisit - lis i lartë”. Kjo ide, preokupim kryesor i qenies sonë që nga Rilindja dhe që u bë lajtmotiv gati i tërë poezisë sonë, në poezinë tonë bashkëkohore merr një dimension të ri e mjaft të theksuar: forca për jetë qëndron vetëm në unitet. Ky nuk është vetëm problem i popujve të vegjël.

Vendlindja si nocion për Abdylazis Islamin është një pasqyrë e tij jetësore-kuptimore, ku percepton e shënon çdo gjë të rëndësishme që ndodh brenda e jashtë saj, ku jeta lë apo merr diçka. Poeti është në lëvizje ekzistenciale me tokën e tij gurore dhe dëshiron të pësojë një dëlirësi shpirtërore, katarzë dhe përkundër përpëlajtjeve e ndeshjeve, pengesave të gjata, bredhjeve e udhëtimeve në vete e jashtë saj, shpesh me pasoja të rënda, përkundër presioneve të ndryshme dhe ngjyrës e ftohtësisë së gurit, Abdylazis Islami, megjithatë, në atë natyrë të ashpër, burrërore, vëren se diçka po ngjallet, po lëviz; se gurgurina e tij prej ditës në ditë po ndërron:

*“Tanimë
ke ushtruar
Skifterin tënd”*

(Gurgurina, IX)

Fshati i tij nuk është vetëm një rrip toke gurore, para të cilës njeriu ynë i varfër shpesh e ndjeu veten të lig. Ai ka nisur të ndërrojë, por edhe kuptimi ynë për jetën. Gurgurina e tij shndërrohet në një fuqi ekzistuese, në një grushtinë, toponim ky që bashkë me disa të tjerë si: *dëshprinë, mosdaça, dufekinë*, që bëjnë një simbolikë të fuqishme në tekstin e Abdylazis Islamit e shoh në kontekstin historiko-shoqëror. Kjo do të thotë shumë për një kolektiv të vogël njerëzor, për një zgjim të vetëdijësimit diku në majat e errëta e me borë, të Sharrit.

Kurbeti

Në letërsinë tonë, kurbeti shfaqet në dy forma: kurbeti i dhunshëm dhe kurbeti social. Të dy këto forma patën përmasa të mëdha, varësisht kur u shfaqën dhe faktorët që ndikuan në të. Si njëra, si forma tjetër linin pas shtëpitë e braktisura, lëndinën e lotëve, tokën e shkretë, fshatrat e vdekura. Udhë e ftohtë e kurbetit fillonte në qenien tonë e mbaronte diku përtej bjeshkëve, deteve; diku në shkretëtirat e Anadollit; përtej Urës së Qabesë e cila u ngrit në një këngë të thekshme tragjike të kombit. Mirëpo, derdhja e qenies sonë nuk u bë vetëm udhës së Anadollit, ku “shqipja (gjuha) kaloi” (Bokshi). Me ndërrimin e kohëve, kurbeti çeli rrugë të reja. Pra, qenien tonë e gllabëronin njësoj Lindje-Perëndim dhe gjithë kjo bëhej në bazë të besimit, interesit dhe humanitetit.

Nga dy format e kurbetit, më e rënda, gjithsesi, mbeti forma e parë, qëllimi i së cilës dihej: zbrazja e hapësirës sonë, zhdukja fizike, asimilimi. Kjo, gati vazhdimisht, kishte fund tragjik: njeriu linte kokën në ballë të truallit-vatres, ose nisej udhës së ftohtë të kurbetit, për të

shpëtuar diçka nga nishani. Dhe krejt ç'ruante në dhe të huaj, ishte harta gjeografike e qenies: emrat, mbiemrat, legjendat, këngët, përrallat, heronjtë, ndonjë relik t nga vendlindja. Ato flisnin më shumë se ç'flisnin shkrimet e dokumentet e ndryshme të kohës. Kjo, të themi dramë e fisit (mjafton ta shikojmë diasporën tonë), nuk mbeti pa u trajtuar nga krijuesi ynë dhe ishte një kohë tema më e preferueshme. Shumë balada, legjenda, kallëzime, i thuri edhe krijuesi popullor dhe i ngjeshi me elemente të një fantastike të rrallë.

Formën e parë të kurbetit Abdylazis Islami vetëm e prek:

*“Rrëshqiti një guri nga pllajat e Sharrit
dhe vajti me xixcat e veta të ndezë Stamboll”*

(Guri i shkukur)

Ndërkaq, forma e dytë jepet më bindshëm dhe mbizotëron në poezinë e tij. Edhe kjo nis mu nga toka gurore e vendlindjes dhe merr një shtrirje më të madhe sociale-hapësinore. Vetëm gurgurina e tij nuk ka halle, as nuk jeton vetëm nga andrallat. Kështu, përmes disa poezive e sidomos të poemthit “Gurgurina”, arrin të na japë një tablo të theksuar emocioni: kurbetçiu kthen në vendlindje, ku kulla mbetej “pa ëndrra të bukura”, kthen vetëm në vjeshtë, atëherë kur mbyll një vit jete, duke bredhur dheut të huaj. Tërë kohën tjetër gurgurina e tij mbetet në duar të fëmijëve dhe të grave, duke përkundur e rritur shpresën deri në vjeshtën tjetër.

Pra, jeta fillon e mbaron në vjeshtë, atëherë kur edhe dasmat e gëzimi zgjasin “vetëm një javë”, se prapë duhet kthyer pas erës së bukës. Dhe prapë, gratë duhet të endin shpresën, pikërisht si Penelopa pëlhurën e ngjgrave.

Këtë shqetësim njerëzor e kohor, këtë bredhje të vazhdueshme në jetë për të siguruar ekzistencën, preokupim ky gati i tërë krijuesve të Rrethit letrar të Pollogut, Abdylazis Islami e kap në një mënyrë mjaft tronditëse, duke përjetësuar disa momente mjaft karakteristike të jetës kurbetçare. Na duket se poeti i ndjek kurbetçinjtë hap pas hapi; se po

ua ndien frymëmarrjen; se po ua lexon rrudhat në ballë e duart e çara; se është bërë pjesë e pandarë e ëndrrave, e dëshirave, e udhës së tyre; i përcjell ata që me jetë e vdekje janë “kredhur në miqësi”. Drama e tyre mund të lexohet e të mbyllet, pa ia nisur fillit e pa ia gjetur fundin.

Ka në këtë ballafaqim të rëndë jete-kohe një zymtësi shpirtërore, një sentimentalizëm: ka edhe një farë didaktizmi, më tepër ky i odave tona. Por këto janë deri-diku të arsyeshme, siç është edhe fryma patetike, që e përshkon gati fund e krye poezinë e tij. Në situata të tilla krijuesi përmes tekstit përmbajtësor kërkon të aktivizojë vetëdijen dhe, nga një udhë, thuaja fatkobe, çfarë është kjo e kurbetit - me pasoja, situata e kriza të rënda, poeti përpiqet t'ua zgjasë dorën të humburve, ose ata që gjenden në udhë, t'i trimërojë. Prandaj na është e kuptueshme edhe retorika si rezultat i një zhgënjimi jetësor e që mund të vërehet edhe nga gazi i hidhur, ironia: “Nga vetja dikush a thua ka ikur i gjori?”.

Që nga fillimi i rrugës së vet krijuese Abdylazis Islami angazhohet për të renë. Atë që hapet para tij - jetën, rrethin, mikrokozmosin e tij, nuk ka dëshirë ta shohë më me sytë e gurgurinës, të bukës, së kurbetit, të shushatjeve nëpër botë, të tragjikës dhe, siç thotë, dora e tij (lexo: e njeriut tonë) shkon “tek këmbana e ditës së re”.

Duke i lexuar poezitë për kurbetçinjtë dhe fatet në ato objekte-simbole të derdhura pllajave të Sharrit, na kujtohen Zagoria e Çajupit, por edhe Hasi i thatë i Gjeçovit, na kujtohen fshatrat arbëreshe tej detit, por edhe hija e rëndë e Urës së Qabesë, që rrinte pezull mbi djepat e kulmet tona, fati ynë.

Problemi jetësor i tokës gurore ngrihet në problem të një kolektivi, të cilin ndryshe nuk mund ta lexojmë as interpretojmë, pos si tragjikë kombëtare.

Ekzistenca

Të kthehemi prapë tek vendlindja e poetit, bazë e poetikës së tij. Ekzistenca nuk mbyllet brenda kufijve të atij rripi toke, as individi nuk

është vetëm kreator i fatit individual. Gurgurina e tij, siç thamë diku më lart, merr kuptim të ri. Tashti ajo është një grushtinë kolektiv. Gjëllin ndryshe. Hapësira e saj është hapësira e qenies sonë. Ka të kaluarën, të tashmen. Ka dëshirat, shpresat.

Përshkohet nga ngjarje të mëdha e të vogla. Ka dasmat, lindjet, vdekjet. Ka simbolikën e vet. E, këto e bëjnë historinë. Por historia e saj nuk ndërtohet, as nuk shkruhet gjithmonë sipas rendit të brendshëm. Në të kanë dorë shumë faktorë. Ata më tepër janë të jashtëm. Fillon shprishja e jetës, e ëndrrës. Shkapërderdhja. Shfaqet forma e parë e kurbetit, dhuna. Eksodet. Diaspora. Tragjike nuk është vetëm udha e Anadollit. Përmes simboleve të tjera jepet rezistenca ndaj të keqes, ndaj forcës. Ky është erupcioni i brendshëm i qenies kombëtare. Udhëtimi thellë në vete është i gjatë. Mund të zgjasë njëqind vjet, siç thotë një poet yni. Ose, krejt ajo që ndodh me qenien tonë, vihet në relacion me Evropën. Është kohë e ngjarjeve vendimtare: “për vdekje a liri”. Shumëçka ndodh në relacionin qenia jonë - Evropë. Në mënyrë të vetëtimshme. Të pabesueshme. Orë e çast ndërron shumëçka, brenda e jashtë. Por, shkallën më të lartë të vetëdijësisimit e shënojnë përpjekjet për të ekzistuar dhe për të ruajtur identitetin.

Abdylazis Islami, nga gjithë kjo lëvizje, të themi marramendëse, kap edhe ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit. Dhe këtë e bën duke portretuar disa figura historike dhe duke na afruar ambientin, atmosferën, dekorin përmes një përshkrimi jo aq fatlum. Mungon forca krijuese, depërtimi në palcë, përkushtimi. Udhëtimi deri te vetja e parë, megjithatë, vetëm shënohet, mbetet i papërfunduar.

Mbyllje

a) Poezinë e parë Abdylazis Islami e botoi në vitin 1954. Atëherë shkruhej një poezi mobilizuese. Kritikë jonë e ka vërejtur këtë. Më tepër shprehej entuziazmi se bëhej seleksionimi i materies. Krijimi i librit të tij të parë zgjati plot një dekadë (1964). Kjo hapësirë kohore do të tkurret prej përmbledhjes në përmbledhje. Nga vitet

1971-78 boton poezi më të realizuara, është koha kur shfletojmë përmbledhjet: “Gurgurina”, “Oaza” dhe “Ujrat”. Poetika e tij, prapë do të ketë, pastaj një shtrirje horizontale me disa oscilime e reflekse në formësimin e tekstit poetik. Të kishite harrë e përpunuar tekstin më shumë, problemet do të qartësoheshin, natyrisht dhe vlerat do të ishin evidente.

b) Poezia e Abdylazis Islamit është poezi e vargut të lire, por dinamik. Shpesh ka organizimin strofik: katrenën, tercinën, distikun. Bën përpjekje për shkrimin e sonetit. Nga kurorat sonetike, dallohet “Prizreni”. Disa poezi të tij kanë për model poezinë popullore.

c) Teksti poetik i Abdylazis Islamit do shikuar e interpretuar brenda fuqisë kreative të poetit, si dhe në kuadër të poezisë sonë të traditës, nga e cila mësoi përvojën e shkrim-këndimit. Me këtë nuk duam të themi se ky poet nuk ka përpjekje serioze për një shkrim të avancuar. T’ua lëshojmë një sy poezive; *Në teh të shpatës, Uji, Shtëpia vetmitare, Helmi, Lëvizje, Maje malesh* etj.

Të shtojmë edhe këtë: mund t’ia fillonim ndryshe këtij shkrimi. Menduam se kjo ishte rruga më e drejtë, t’i mbetemi besnik leximit të tekstit poetik të poetit - për kurbetin dhe vendlindjen apo?

(1983)

DALJE NGA VETMIA

1. Gryka e Radikës. Fillimi i vetmisë

Refreni “zotëria im ka vdekur...”, i cili përsëritet disa herë në poemthin “Shtëpia e humbur në mjegull...” të poetit Eqrem Basha, paralajmëron diçka rrëqethëse, që ka ndodhur ose po ndodh diku në hapësirën tonë. Dramaciteti rritet edhe më, kur poeti fillon dhe e plotëson dekorin e imazhit me elemente të tjera shprehëse aspak më të lehta se refreni: shfaqja e njerëzve me tesha të zeza para dyerve, që t’i kujtojnë shumë fytyra nga antika e largët, ose plakat e veshura në të zeza, që lëvizin në prozën e Kadaresë, pastaj shqiptimi i fjalëve të përmortshme dhe bredhjet pa cak “në fushën e shkretë të Torviollit”.

Tërë ajo që zë të na shpaloset tani për tani, zhvillohet vetëm në dy kohë. Ai veprim shkatërrues-harrestar, me një shtrirje të thellë në kohë, a do të ketë edhe të ardhmen, varet, para së gjithash, nga faktori njeri: sa do t’u bëjë ballë të papriturave të reja për ruajtjen e identitetit dhe të integritetit të vet shpirtëror-hapësinor. Ndryshe, tatëpjeta eventuale do të ishte fatale. Refreni i zënë ngoje, mbi të cilin ngrihet poemthi, bindshëm dëshmon për dhunën që është bërë në një hapësirë të caktuar për një kohë kushedi sa-vjeçare, për të ardhur deri te shthurja totale. Ky është nënteksti i fortë i tekstit poetik të Eqrem Bashës. Zatën shqetësimet, traumat e natyrës psikosociale, bredhjet poshtelart të heroit lirik janë drama e kolektivit. Diku në poemth ai thotë: “si kjo shtëpi - është fjala për shtëpinë e humbur në mjegull - ka edhe shumë të tjera, që “gjamën e fshehin në zhurmën e Radikës”.

Me poezinë e Eqrem Bashës shoqërohem duke e kujtuar Jugun. Pakëz i çuditshëm do të jetë ndoshta ky shkrim se shoqërohem me një peizazh të shqetësuar e të akullt. Por këtë nuk e bëj për shkak të përmallimit për diçka që tashmë ka zënë ta mbulojë tisi i harresës dhe

të ndritë loti në bebëz. Asgjë shpresoj se nuk humbet përgjithmonë. E bëj këtë se atë që e kam shtresuar në pjesën dërrmuese të poezive të Eqrem Bashës, të cilat ca nga to kanë edhe elemente të fantastikës, i kam ndjerë si këlthitje e përjetime të miat. Zjarmia e asaj heshtjeje të ftohtë, që derdhet vargjeve të trand e të nxit të mendosh për kohën e fatin cubel jo vetëm të njeriut tonë. Harmonia trishtuese e ngjyrave, reflekset, idetë që i kam ndeshur në poetikën e Bashës, i kam parë si në shuplakë dore, Grykës së Radikës, sa herë më ka qitur udha andejpari dhe duke hyrë në atë heshtje, shpesh kam mbetur pa tekst.

“Ruga deri te porta e fundit”, na bën me dije poeti, është e gjatë, e mundimshme. mjegullore, heshtake, besa edhe tragjike. Deri tek ajo portë e shtëpisë së humbur në mjegull, silueta e së cilës është ngulitur diku në kujtesën e poetit e që atë mjegull si figurë do ta gjejmë gati kudo në tekstin e tij, të shoqërojnë serpentina të panumërta, shushurimë lisash vetmitarë, muzika e përvajshme dhe mahnitëse e ujit të ftohtë të Radikës, duke u lëshuar grykës teposhtë, heshtja e thellë dhe monotone, ndonjë krikëllimë e papritur dere e zë i shtjerrë i atyre njerëzve të veshur në të zeza tamam si në antikë, fshatrat e zbrazura përreth (Pse? Çfarë e keqe na paska qenë?), ndonjë fluturim i rrallë i zogut mbi shkrepat e lartë e vetmitarë të Korabit - kjo befasi e ky peizazh frikësues që të pret pas çdo serpentine të bën të pyesësh tekefundit vetveten: ç’mund të bëjë më tepër njeriu për të dëshmuar se ka jetuar këtu me kohë ose ende jeton?

Jam i mendimit se poezia e mirë nuk kërkon ndërmjetësim të tepërt.

2. Dalje nga vetmia

Vetmia është kategori poetike në veprën e Eqrem Bashës. Pak ka poetë shqiptarë që në vargjet e veta kanë mbërthyer aq shumë vetmi sa ky poet. Edhe në poezitë më alegro e deri te ato sensuale, Basha inkudron ndonjë element a detaj të këtij fenomeni, të përcjellë me një buzëqeshje ironike, që shpesh lë të kuptohet si reagim intelektual ndaj ca proceseve që janë më tepër jashtëletrare e që

cenojnë integritetin e njeriut. Perceptimi dhe zgjedhja e mjeteve shprehëse, bëhet me një nonshalancë të çuditshme, duke ta servuar një përmbajtje sublime, të rëndë. Dhe përhapet ajo zyrtësi, vibron dhe me intensitet pushton hapësirë të re. Ajo arrin nganjëherë të jetë edhe morbide. Nuk është e rastit, pra, që në krye të kësaj zgjedhjeje vura njëren ndër poezitë antologjike e më domethënëse që ka shkruar ky poet “Hyrja në kuptimin e një vetmie”, lajtmotivi i diskursit poetik të Bashës.

Poezia në fjalë nuk ka më shumë as më pak se dhjetë vargje - dy katrena dhe nga një varg mbyllës. Secilit varg na bëhet se i vjen erë ftohtësi, se i vjen erë harrimi dhe të shpie në vetmi, ku poeti (lexo: njeriu) vështron përreth nga këndi i vet dhe përgjon heshtjen, absurdi i mosbesisë, e që jepet njëherësh edhe shpjegimi kuptimor-poetik i vetmisë si kategori ekzistenciale. Kjo poezi, konkretisht vetmia, hapet me: “gendet dikund një shtëpi e braktisur”. Cila e çfarë është ajo shtëpi? Mos na është shtëpia e lindjes së poetit, apo përmes shtëpisë së vetmuar që e merr për objekt trajtimi, përfytyron diçka të harruar fëmijërore, që në kujtesën e tij ka lënë vrragë të thella? Me tablo të rënda jepet, pastaj, dekori: “mure gërvishtur me kulm të përkulur”. Pra, shtëpia na është, pos e braktisur dhe e vetmuar, edhe me kulm të përkulur. Pse? Nga varfëria apo lashtësia? Lëmshi nis të çshtjellat dhe të dalin edhe probleme të tjera: autoktonia, po edhe migrimet e shpërngulje që nuk mund të verifikohen as në këtë shkrim. Dhe finalja: në oborrin e saj “bari i paprerë/pluhuri i pafshirë, dera e patundur”, do të thotë diçka më se e hatashme ka ndodhur, ndonjë ekzod. Vetmia e konceptuar dhe e trajtuar përmes objektit, konkretisht të asaj shtëpie gati të rrënuar, tani merr formën e protestës së heshtur. Atë e ruan vetëm: “një qen”. Me këtë konstatim ironik e të prerë të poetit, mbyllet akti i parë i hyrjes në vetmi, që para nesh ngrihet, pa dëshirën tonë, si një bina e çuditshme.

Në aktin e dytë, që nis menjëherë pas vargut mbyllës të të parit, na shfaqet: “një njeri i vogël i harruar”, ai është dibrani i tij, me gjasë babai i poetit, i cili na paraqitet edhe në poemthin “Trashëgimia”. Portreti i këtij njeriu të vogël bëhet në vargun pasues: “mjekërr parruar flokëkërleshur”; për arsyet që i di, ndoshta vetëm poeti, ai “shëtit

posht e lart sillet si i çmendur/fytyrë humbur shpresë këputur” dhe defetizmi - njeriu e ka humbur edhe qenin: “qenin e kërkon” dhe mbyllet poezia, e njëherësh fillon dalja nga binaja e çuditshme e vetmisë: në oborrin me bar të pakositur ka nisur diçka të lëvizë, të zgjohet e të frymojë, njeriu e humbi qenin dhe kërkon trajtën e vet njerëzore në atë mjegullinë. Por ç’e do? Para njeriut të vogël shtrihet një det i paanë si në përralla. Nuk është si detet e tjerë, asgjë nuk ka të përbashkët, bie fjala, me atë detin që e ndeshim dhe e lexojmë në poezinë e vlonjatit Fatos Arapi - ata kuajt e bardhë në peizazhin e ngrohtë, apo ullinjë me dy mijë unaza në poezitë e ulqinakut Basri Çapriqi. Deti i shfaqur para këtij njeriu të vogël me “bark të fryrë” është det i halleve, i brengave, i përpjekjeve, i zjarrmisë së brendshme për të jetuar edhe më. Është, pra, ai deti jetësor e krijues i Eqrem Bashës, ku gjuha figurative është e dendësuar me shtresime e kuptime të shumta, do të thosha se ai është det metafizik. Megjithatë, edhe pse i këtyllë, i padefinuar aq, duhet të ketë ai det diçka, mos gjë tjetër - polipë, peshq, fosile, meduza, algje, eshtra, barka të fundosura, qytetërimi të harruara e objekte të tjera që do të hyjnë në poezinë e këtij poeti si simbole që përmes tyre do ta thotë tërë neverinë për atë det të imagjinuar. Dhe, ndoshta, janë të vetmet simbole që i ka trajtuar që nga libri i parë “Opuset e maestros” (1971) deri te ai i fundit “Udha qumështore” (1986).

Më lart, diku, pamë se në atë vetmi totale, i rrethuar tani edhe nga ai det i imagjinuar dhe i ngopur me heshtje e rrenë të llojit të vet, njeriu, “i këputur në shpresë e i prerë në besë”, tjetër ç’të bëjë, pos të përpiqet për të deshifruar gjuhën e peshkut dhe të “struket i mërdhezur nën pullazin e kashtës”. Në këtë rast vlen të peshohen fjalët *besë dhe pullaz i kashtës*, që nuk janë vënë pa qëllim në tekst. Zatën, këto fjalë janë përcaktuese për ambientimin e idesë dhe të identifikimit të njeriut në atë mjegulli, triumfin e të cilit poeti do ta shënojë me: “zgjohet i zbardhur në sy”, sepse në gjumin e tij kushedi savjeçar “janë bërë kompromiset”, që tashmë dihen. Diçka morbide, por edhe shpresëdhënëse se atë njeriun e vogël të dalë nga ajo mjegulli e rreth vetmie vëren poeti se “shpresa e ndritë”. Ndoshta. Ngazëllim krijuesi.

3. Hyrje në dhembje

Është e pamundur, mbas gjithë asaj vetmie e përpjekjeve sizifiane para atij deti të imagjinuar, kënga të jetë e çiltër. Fati i njeriut është i pandarë nga fati i krijuesit, ai është fat i përbashkët që përjetohet në mënyrë vetanake. Për Eqrem Bashën nuk është më problem qenësor vetmia as shkaktari që e solli njeriun deri te ajo mbyllje dramatike. Bashën e preokupon tani ekzistencja e mëtutjeshme, ruajtja e dinjitetit në situata në të cilat ka rënë ose po bie njeriu, pasojat që mund t'i ketë në të ardhmen. Çështje është sedra e njeriut si krijues e pjesëtar i një shoqërie, transformimi i tij psikik e social. Këto janë nga çështjet kyçe që do t'i shtrojë Eqrem Basha zëshëm në baladat e tij të cilat, duhet kapur e lexuar nga rrafshi moral e social.

Para së gjithash, Eqrem Basha është poet urban dhe ndoshta i vetmi në poezinë shqiptare, i cili që nga fillimi i krijimtarisë së vet tërë filozofinë jetësore-njerëzore-kombëtare e ka hulumtuar e thënë përmes atyre refleksive e shpërthimeve lirike të asaj jete të zhurmshme. Në poezinë e tij nisen rrugë, mbyllen rrugë, hapen sheshe, çelen kanalizime, fluturon zogu, kumria, frymon dhe vlon përditshmëria, bëhen transformime të çuditshme dhe jo vetëm këto segmente nga jeta urbane përcillen besnikërisht e me një sens artisti. Po kjo qasje vërehet edhe në baladat e tij, ku del në shesh më së miri angazhimi i tij jo vetëm si krijues i mirëfilltë që kërkon vazhdimisht teksti poetik të jetë më cilësor, por në baladat e sidomos në ato të moralit. Basha na bën shpalosjen e përbrendshme të njeriut si karakter, inkuadrohet dhe merr pjesë në fatin e tij, do të thosha historik. Kohët e reja e më të reja lypin edhe njerëz më seriozë, por kohët e reja e më të reja njeriun mund ta sjellin deri në zgrip të humnerës që mund të jetë tragjike në formimin si karakter dhe ekzistencën e tij. Nga një tatëpjetë e tillë Basha kërkon ta shpëtojë njeriun të mos bëhet mjet kusurimi, por të mbetet vlerë për kolektivin e shoqërinë që i takon. Prandaj poeti ndjen dhembje kur e sheh në telin e cirkut, kur edhe të tillët i ironizon, kur i parodizon. Dinamika e

hatashme e përditshmërisë e valërrëmbyese urbane, dhuna dhe totalitarja njeriun ka nisur ta tëhuajësojë, para erërave t'ia thyejë kurrizin e të bëhet diç manipulues; sheh se njeriu po e humb qetësinë e brendshme shpirtërore, se po bëhet një cirkusant i zakonshëm, të cilin ëndrrat e këqija shpesh e zgjojnë, e qesin rrugëve: “për rrugën që s’do kish më kthim”. Njeriu nuk është më ai i kohëve të kaluara me atë krenarinë e tij të patundshme prej burri për të cilin netëve të vona ka dëgjuar shumë çudira ose ka lexuar histori të mahnitshme, por diçka krejt tjetër, dikush atij ia imponoi rolin e një mediokri, të poltronit, të një puthadorësit, e bëri për pesë para. Njeriu na u bë thjesht një abrakadabër, një ëndërrimtar i përhershëm që nisi të çojë thuaaja një jetë ireale: “kur sosej qiriu e dinte/se pritet një ditë e re”.

Rënia e njeriut si vlerë është trishtuese, ndaj mllëfi dhe ironia e poetit shpërthen si kurrë më parë. Prandaj baladat nga rrafshi i moralit duhet t’i marrim edhe si një katarzë të njeriut që e kërkon poeti. Dhe, i vetëdijshëm se njeriu nuk është fajtor, se në ato situata të palakmueshme ku “botërat ndërrohen për një çast” e qiti një hall i madh ose dora e paparë e një fuqie pas perdeje, brenda kodeksit të krijuesit, Basha proteston në mënyrë të vet kundër asaj neverie njerëzore që na shfaqet edhe si një totalitet i rëndë (Baladë e zezë e një dite të bardhë). Dhe ky është angazhimi i tij i dytë në planin njerëzor, ai intelektual.

Krijuesi shpesh i kthehet të kaluarës. Kjo nuk bëhet gjithmonë për të dëshmuar origjinën ose për të vrapuar pas ndonjë miti që tashmë ka nisur ta mbulojë harrimi; të kaluarës i kthehet nganjëherë edhe për të kërkuar një qetësi shpirtërore. Kështu do të veprojë edhe Basha në baladat e rrafshit social. Na kthen në fëmijëri, në atë jetën virgjër e të pastër, ku ende hilja as shërrit nuk kanë hyrë. Si në shiritin filmi na parakalon ajo botë në një qytezë tipike shqiptare: me shtëpi përdhese e protagonistët e vet karakteristikë, që heshtjen nganjëherë ua prish ndonjë zë i largët këngëtareje, apo zëri i ndonjë të dehuri të vonuar nga kafeneja në periferi të lagjes. Nga një rikonstruktim i të kaluarës, ç’mund të pritët tjetër prej poetit, pos një përmallimi e dëshmie, për një udhëtim e jetë të rëndë sociale: nata dhe dita i çel diku në kafene ose duke vrapuar pas erës së bukës përtej

shtatëdhjeteshtatë bëshkëve, ndërkaq një fëmijë aty diku kyç në kujtesën e vet tërë atë që humbet para tij si shkumë deti. Kthimin në fëmijëri të Bashës ne e marrim edhe si pretekst për të rrëfyer një histori të dhimbshme e sociale të një qytezës sonë. Rrjedha e ngjarjeve është krejt e natyrshme megjithëse shihet seleksionimi i poetit, rekuizitat poetike dhe mjetet e tjera shprehëse janë të një lirizmi të çuditshëm dhe do të thosha ai zë që nxjerr na është më tepër një vaj i brendshëm i burrit. Imazhi për vendlindjen e njerëzit e tij, megjithatë, vazhdon të na bëhet edhe më i zymtë. Dhe, duke e lexuar atë dhe duke i nxjerrë mesazhet e tekstit, na bëhet se kthehemi në kohën e neorealizmit, por, kësaj here shqiptar. Lexojeni me kujdes “Baladën për Xhekun”, “Shfaqja e filmit Majat me stuhi në kinemanë verore”, “Baladë për Suzin”, “Baladë për poetin e kafenesë së lagjes sonë” etj. A nuk ju bëhet se Xhekun e keni parë në shirit filmi? A nuk ju kujtohet Entoni Kuini në filmin “Rruga” të Felinit? Në mes tij dhe Xhekut tonë ekziston ndryshimi se Xheku ynë nuk na është një cirkusant që kërkon nga akrobacionet të jetojë, ai është argëtues i vetvetes dhe një imitues i asaj që ia ka ofruar shoqëria ose arti dhe tërë rrethin e vet e sheh në një kopje të zbehtë, që edhe asaj i thonë jetë. Të tillë në qytezat tona nuk ka pak. Merreni udhën deri në provincë, do të shihni në formën më të llahtarshme edhe kozmopolizmin, edhe snobizmin dhe idolatrinë tonë. Eqrem Basha bindshëm verifikon edhe një herë, se fati i njeriut me atë të krijuesit është i përbashkët dhe se krijuesi i mirëfilltë nuk mund të mbetet idiferent ndaj gjithë asaj që ndodh brenda e jashtë njerëzores.

Pjesa dërrmuese e baladave nga rrafshi i moralit kanë gati një intonim dhe na bëhet se lexojmë mbi moralin një ligjërime në variante, dhënë shumica në forma strofike, gjegjësisht përmes katrenave e rimave mjaft strikte. Kur ta kryejmë së lexuari do të shohim se ajo që e shfletuam është një përrallë gati e harruar, por, fatkeqësisht, është bashkëkohore dhe për njeriun e kohës sonë. Në baladat e rrafshit social natyra e rrëfimit dhe forma është tjetër - subtile e monokolone dhe na bëhet se marrim pjesë në to, megjithëse kanë ndodhur moti. Do të thotë se kohët e përmbajtjet mund të afrohen në tekstin letrar, por përcaktimi varet nga lexuesi-interpretuesi.

Për ruajtjen e kontinuitetit dhe për avancimin e baladës si shkrim në poezinë bashkëkohëse shqiptare, Eqrem Basha pa dyshim, është ndër më meritoret.

4. Pa mbyllje

Eqrem Basha është poet lirik. Lirizmi i tij ka edhe tone baladeske. Nga libri i tij i parë “Opuset e maestros” (1971) deri te i fundit “Udha qumështore” (1986), poezia e tij na është gjithnjë e më interesante, qoftë për figuracion, ide, motive, qasje e mesazhe, qoftë për modernitet që rrëshqet kah poezia meditative. Përkundër simbolikës, do të thosha ekspresive, poezia e tij interpretohet më tepër si poezi metaforike, kuptimi i së cilës vilet tek atëherë kur kemi arritur të ndërtojmë atë mozaikun e çuditshëm të ngjyrave e reflekseve, të shenjave e ideve brenda një poezie ose tërësisë ciklore. Në tekstin e tij ka ca nuanca të poezisë sonë dhe të muzës së popullit, por ndikim të dukshëm kanë ushtruar artet e tjera, sidomos filmi dhe skulptura. Konceptimin e idesë e bën me një shkathtësi habitëse, kurse në ndërtimin e tekstit inkuadron me mjaft sukses abstraksionin e skulpturës. Te poezitë e ciklit “Një njeri te porta” dhe epitafet e tij të njohura. që do i quaja vinjeta poetike, na bëhet se ato kultura kanë zbritur aty nga ndonjë ekspozitë skulpturash ose kanë ikur nga ateleja krijuese e Xhakometit.

Poezia e Eqrem Bashës në të parë, lë përshtypjen e ftohtë, si e pakapshme, poezi efektsh dhe fjalësh. Edhe bukuria është e ftohtë, derisa nuk e pushton. Kur të hysh në të, do të dëshirosh gjatë të mbesësh aty. Do t'i kuptosh atëherë edhe titërrimën dhe përmbajtjen e krijuar nga ato dridhje që shpesh i kemi marrë për efekte të një sjelljeje specifike. Ti kujtojmë poezitë “Shi shi”, “Mama mama m’i blej edhe plumbat”. Kritiku ynë Ibrahim Rugova, në një vështrim të vetin e potencon mjaft mirë ritmin në tekstin e Bashës. Pra, edhe pse ky poet nuk shkruan poezi me metër e me rima të sakta, vargu i tij është muzikal, ka një fuqi të brendshme që ta ka ënda ta dëgjosh dhe mu nga ato efekte si i quajnë disa, Basha formon edhe kuptimin,

përmbajtjen. Do të shtoja se ky poet, ndër më të talentuarit e brezit të vet, krijon një poezi mjaft origjinale me laryshi temash, idesh e formash. Kreativiteti i tij nuk varet vetëm nga talenti, por edhe nga guximi për të shtruar probleme. Basha më së paku ka arsye të komunikojë vetëm me një rreth lexuesish. Baladat e ca poezi të tjera shkojnë kah një poetikë e haptë, ndërkaq teksti i tij poetik mundëson interpretime nga më të ndryshmet. Çudi pse kritika jonë ka treguar aq pak interesim për të.

(Prishtinë, maj 1989)

KUR PRAN TEKSTI

Teksti i ngjan një krijese më se të çuditshme. Me plot të papritura e me një lindje të vështirë. Shenjat e para nuk janë edhe mbyllja e udhëtimit të tij. Ai paralajmëron tërmetin shpirtëror që do një kujdes të posaçëm. Nga vrojtimet, peshimet, e deri te studioja krijuese, ai pëson metamorfoza nga më të mundshmet. Është i lëvizshëm brenda njësisë dhe librit. Kur zgjat dorën ta mbyllësh në fjalë, ai sapo ka pësuar ndonjë ndryshim. Sepse sa herë i qasesh, vëren se atij diçka i mungon, ose ka diçka që duhet flakur. Asgjë nuk është e përsosur.

Në relacionin teksti-krijuesi, shqetësimet janë të pranishme dhe të përhershme. Brenda tensionit të lartë ato puqen dhe ndahen, duke lëvizur për nga kuptimi, forma. Do të përfundonte mirë, po që se durimi krijues do të arrinte shkallën e lartë të përgjegjësisë - lirimin e tekstit nga gjymtyrët e tepërta që, rastësisht, janë inkuadruar ose imputuar gjatë lindjes së tij. Pra, rikthimi, rindërtimi apo riparimi i tekstit asnjëherë nuk pushon te krijuesit, të cilët janë bërë mish e kockë me të. Ndodh që për një fjalë, metaforë, t'i kthehet autori disa herë dhe vetëm kur bindet se nuk ka ç'të punojë më, mbyll rrethin.

Teksti lind nga lëvizjet, klithmat, fjalët, ngjyrat. Nervi ndjenjor-shpirtëror, ia dikton intensitetin, gjallërinë. Mund të jetë tekst vizuel, auditiv, artikulues në momentin kur Ti, p.sh. nga një kënd i çuditshëm apo nga një birucë burgu përcjell lojën e përgjakur të korbit, në një rriskë të nxirë të qiellit mbi kokë. Apo, rreth vetes në qivur, zgjimi i natyrës, papritur të kthen në një kohë të largët e të pabrenga. Ose ndjen goditje vdekjeprurëse e nuk e vëren fare nga cila anë të vjen. E sheh: Në thjerrëzën e syrit tënd të shqyer vazhdimisht zvogëlohet *Arbëria*. Të bëhet se një ditë atë do ta mbyllësh si plaçkë në arkën e familjes, do ta bartësh metropoleve të Evropës, për t'ia hedhur dikujt në qafë. Ose hutueshëm thith cigaren nga duhani tarabosh. Sapo

duçin e hedh, vëren se Ti humbesh në ca rrahë të dendur të tymit. Përgjak buzën. Në mes dhëmbëve dridhet fija e barit, ajo e Uitmanit, ndoshta. Të kujtohet farefisi, nëna, babai, fëmijëria buzë Drinit, Llapit; kënga e barinjve pas kecape të Grykës së Rugovës, gugatja e kumrisë nën çatinë e gërmuçur. Pajtohesh se e pamundura do të të lodhë, do të bëhet edhe varri yt bri një lumi a lisi. Kushedi.

Shfaqja e kësaj krijese dinamike përmes shenjave e mjeteve të tjera shprehëse, heton se ngadalë ta vjedhë edhe shpirtin, formën, trupin. Një ditë zbulon se nuk jeton më vetëm në unin tënd. Ke edhe qiraxhinj të potershëm. Korrespondimi me vetveten dhe atë që të mbështjell, fillon e zbulohet në një kohë kozmike, ndoshta. E njeh shpirtin tënd, ëndrrat tua, të prekurën tënde, puthjet tua të harruara në breg të një liqeni apo metropoleve të Evropës, fjalorin tënd, kaçurrelat tua të shkapërderdhura e të thinjura. Të vjen keq për ndonjë zënkë me mikun e rrallë. Kur ulesh në një karrige, përcjell vëmendshëm rritën e fëmijës, që hyn në hapësirën tënde. Ndoshta, ai të sjellë telashe të mëdha. Kërkon të jetë i shëndetshëm, i bukur, i veshur, i krehur me krahër Arbërie, e pak irredent.

Kamy thoshte: “Veprat e mëdha lindin shpesh në kthesën e një rruge ose në kthinat e një restorani?”. Unë nuk njoh kthesë më të madhe se kjo jona: Nga një shoqëri totalitare, me të gjitha shenjat e aparteidit, i përgjakim ëndrrat për një jetë më njerëzore. Në dhomën tënde, në shtratën tënd më të *panjoburën*, ndoshta, në një birucë të ndonjë kazamati mesjetar, nis punën e vështirë: Shkundjen e shpirtit nga hijet, lirimën e tekstit nga zvetënimet, teprimet. Nuk të dhimbsen as fjalët, pas të cilave ke vrapuar kushedi sa net. Zhurmë e tyre të tmerron. Ke mësuar mjeshtërinë e shkrimit. Je një gjahtar i relikteve. Epitetet, krahasimet, rimat i var në ndonjë tra të shtëpisë. Pikas idenë, përmbajtjen, motivin, formën. Traumata e përditshmërisë, lëvizjet shoqërore-politike-historike-mitike të ngacmojnë vazhdimisht, nuk të lënë rehat. Thellë në natë dëgjon fishkëllimën e fjalëve tua. I mbyll veshët. Kamxhiku të mbështjell nga maja e kokës deri te gishtërinjtë.

Dikur, pas vënies së pikës, me sy tjetër e shikon fundin e ngrehinës. Dhe, kur mendon se ajo është kryer, të vjen keq më vonë pse të ka lëshuar durimi. Gjatë projektimit ke harruar ta lësh një

dritare nga faqja e *Shkretëtirës*. Dino Buxatin e ke dashur. Ose, pse dritaret i ke harruar të mbyllura nga ana e *Liqenit* të dërmitur. Nositin e Lasgushit ke ëndërruar ta mbyllësh në fjalë, ta shpëtosh nga grabitçarët. Bindesh se me të vërtetë duhesh vënë një rend të ri. Pas një kohe i kthehesh prapë tekstit. Fillon riparimi, ndërrimi i gjërave. Dhe gjuetia e zogut, siç do të thoshte Kishi. Nga dita në ditë vëren konturat e reja si zbulohen, dhe nis e e lexon pak më ndryshe. Ai tani është një variant i pagjumësisë sate, i shqetësimit tënd, i fjalëve tua.

Në letërsinë tonë ka shembuj të shumtë që tekstit të vet shpesh i janë kthyer edhe: Lasgushi, Fishta, Mjeda e deri te krijuesit bashkëkohorë. Dendur e bën këtë edhe Kadareja. Gati pas çdo ribotimi. Kështu vepron edhe shumë krijues botëror. Një mik i Kishit tregon se shkrimtari i nderuar nuk kishte mundur të mbyllë sytë pa i bërë edhe një retushim tërë veprimtarisë së vet. Dhe, ashtu kishte ndodhur. Atë ditë kur i kishte vënë pikë fjalisë së fundit, i kishte lëshuar qepallat. Këtë e kishte ndërë si borxh jo vetëm ndaj punës së tij krijuese. Teksti mund të ripunohet-korigjohet *vetëm* për të gjallë të autorit. Dhe teksti është i shpirtshëm derisa dorë e autorit e përkëdhel.

Mirëpo barrë e rëndë në tekst është padyshim *fjalamania*, e cila të nxjerr jashtë vetes shpesh, ose të bën ta hedhësh librin në një qosh. Çdo gjë humbet në zhurmën e fjalëve. Edhe ideja. Edhe figura. Kjo është veti e krijuesve që u mungon ndjenja e masës, e seleksionimit, perceptimit, fantazia, shkathhtësia e zejes së shkrimit, guximi. Vrapimi pas efekteve e vargjeve kumbuese mbulohet pastaj nga një mjegull nga e cila nuk mund ta shohësh as autorin.

Mediokrit thonë: teksti sa më i errët është më i thellë, më modern. Me mosidentifikime, terrorizojnë lexuesin. Konfuziteti vijëzon dukshëm karakterin labil të krijuesit. Ai është sharlatanizëm që shpie te një skizofreni e thellë. Një ide jepet përmes disa sinonimeve, metaforave që kanë vetëm një kuptim. Vepron jashtë logjikës. Në të vërtetë ke punë me manipulatore, që fshehin mosaftësinë krijuese, duke luajtur rolin e një eruditi. Fatkeqësisht, në letrat tona sa shtohen këta kacagjelë të çoroditllëkut tonë.

Borhesi, i cili është i pranishëm me të madhe në mjedisin tonë jo vetëm përmes ideve e temave mitike, tërë historinë e jep me dy-tri metafora, ose përmes dy-tri personazheve shpalos fatumin njerëzor. E parafrazova një mendim të Luan Starovës, të cilin, me ca nuancime, e thonë edhe të tjerët. Apo, siç thoshte Lasgushi: Ç'i do katër romane, atë që ke për ta thënë, e thua me katër vargje. Urtaku ynë, me siguri mendonte në poezinë e pastër. Ky konstatim, ndoshta pak i tepruar, shpie tek thënia e urtë, sublime e popullit: "Pak e saktë, shumë e për lumë". Tërë filozofia e të krijuarit mbështetet në: ç'thua e si e thua një çast nga jeta njerëzore. Numri i faqeve, as i librave nuk dëshmojnë shpesh cilësinë. Njoh poetë që kanë nga një libër, e vazhdon të jetojë teksti i tyre. Fatkeqësisht, njoh edhe shumë vargënues që kanë libra me kilogramë, e harresa i ka nxjerrë jashtë loje. Brenda mundësive, mprehtësinë e saktësinë, unë personalisht e kam mësuar më shumë nga kashelashet tona. Thashë, unë u frikësohem fjalëve për lumë. Ndërkaq, teorizimi i letërsisë deri-diku ma kujton një kritik serb, i cili shkruante edhe poezi. Ato ishin, thjesht, klishe të nxëna nga teoria, por edhe bredhje nëpër veprat e shkrimtarëve për të cilat kishte bërë fjalë.

Pas hulumtimesh e persiatjesh, do të bindesh se *fjala* është kryesorja. Vendosja e saj në tekst është me përgjegjësi dhe kërkon shkathtësi mjeshtërore. Loja me të ta kujton lojën e zhonglerit me flakë apo me thika. Dhe ajo humbet, po qe se nuk i di rregullat. Fjala të mundëson çdo gjë. Edhe kënaqësinë. Por duhet të kesh durim të të mos nënshtrijë ajo.

E kishte trilluar Kishi një varg: *Shiko kobën si rrjedh*. Në frymën e simbolistëve francezë përmes tij kishte krijuar pastaj një poezi prej disa vargjeve, që ishte, në të parë, vetëm një *lojëfjalë*. Në të vërtetë, Kishi ua tërhiqte vërejtjen krijuesve të rinj, se fjala është diçka magjike dhe mundëson veprime të mëdha kur bie në dorë të mjeshtrit. Kështu, më parë, kishte vepruar edhe poeti rus V. Hljebnikov, kur kishte shkruar poezinë "Buzëqeshja".

Bartja e tekstit brenda një njësie apo libri, po ashtu, ofron interpretime të nduarduarta. Mitrush Kuteli kishte shënuar se poezia e Lasgush Poradecit mund të lexohet-interpretohet më mirë, po qe se

nga dy librat e tij sajohet një i ri: Ciklin e parë të librit të parë, duke e përcjellë me ciklin e parë të librit të dytë, e kështu me radhë. Insistonte që në një dritë të re të shpaloset sistemi poetik i Lasgushit. E kishte parandjerë këtë lexim të ri. Kështu, plakushi i fjalës shndërrohej në një abetare të poetikës së re shqiptare. Librin e tij të ri, atë që e kërkonte Kuteli dhe insistonte, unë do ta pagëzoja *Gjeniu i anijes*. Se ne gjendemi, pajtohemi apo jo, në një anije, të cilën e ndërtoi gjeniu ynë. Në udhëtim nuk dua ta kujtoj, as të më ndjekë *Albatrosi* i Bodlerit.

Teksti ka edhe vulën e vet. Shënon edhe kohën e krijesit, i cili nuk mund të jetë i pakohë. Ai nuk mund të jetojë në ndonjë planet tjetër. Ndryshe, si të lexohet imazhi i përgjakur i latinoamerikanëve, që fanitet metropoleve të Evropës? Apo, eskadronet e vdekjes në Kosovë, a mund të heshten me indiferencë? Postmodernë e çuditshme! Se kemi të bëjmë me një transparencë, është trillim i frikacakëve, që nuk duan ta prishin qetësinë e vet, as të digjen në zjarr. Prandaj i mbyllin sytë para dritës së fortë të gjakut, dhunës e mjerimit kolektiv.

Dhe vjen koha miku im, kur do të pajtohesh me Zhak Preverin: Në tekst ta qesësh firmën. Kalon Lumin e Verdhë, ose humbesh brigjeve të Detit të Vdekur. Për të dy, ndarja është e dhembshme. Pushon një kohë jo aq fatlume dhe nis një tjetër, e panjohur: ndoshta e amshueshmërisë - se zogu të ka fluturuar lart. Lexuesit-interpretit, i mbetet ta lexojë dorën e fundit të tekstit, por t'i lëshojë edhe një sy udhës së tmerrshme të krijimit, i cili ndoshta rastësisht ka qitur krye te ndonjë kthesë.

JANË ZBUKURUAR PLEHRAT NË ATDHEUN TIM

NJË PARANDJENJË E ÇUDITSHME

Takimin e parë me poezinë e Fatos Arapit e kam pasur para tridhjetë vjetësh. Krejt rastësisht më patën rënë në dorë disa poezi të tij për detin. Në e parë, ishin ato vetëm kroki-poezi, por për mua perla. Shenjë e mirë se hynte në jetën tonë letrare një poet i vërtetë. Qesh gëzuar si fëmija. Duke i lexuar ato, kisha bredhur në një kënd të mrekullueshëm të atdheut. Llogoranë, Borshin as nuk i kisha parë e imagjinuar si të tilla. Ato poezi të Fatos Arapit që, në një kënd të redaksisë, i kisha lexuar tinëz dhe shënuar në ditarin tim, ishin edhe një çelës poetik për të hyrë më vonë në botën e poetit. Çështjet që shtroheshin thuheshin bukur e me një sensibilitet të ri. Nga ai takim i rastit nuk kaluan shumë vite dhe para lexuesit tonë nxora përmbledhjen e tij të parë “Kaltërsirat” (1971). Në atë libërth i pata vendosur edhe ato poezi për detin me atë peizazhin karakteristik shqiptar, vazhdimësinë e të cilit e kisha takuar edhe diku thellë në Greqi, apo kur fshatrave arbëreshe në Kalabri, të derdhura buzë detit, ku kishim rënë me Anton Bellushin për ta dëgjuar ndonjë kangjelë gati të harruar.

Mirëpo atyre poezive për detin, edhe pse inkuadroheshin për mrekulli në poezinë mediterane, megjithatë u vinte erë shqiptare, e

ruanin vendin e lindjes. Ndonjë toponim e simbol nga mitologjia jonë e re dhe e lashtë lëvizte pa zhurmë nëpër atë trup fjalësh e ndjenjash. Ajo qetësi hyjnore, do të thosha, me atë peizazh të ndezur nga ngjyrat e dritat e forta të Jonit, më ndoqën vazhdimisht në udhëtim. Dikur vonë fituan hapësirë më të madhe në librin reprezentativ “Fatet” (1979), të cilin, prapë pata fat ta përgatis. Disi, thuajse, fati me poetin na ishte bërë një vëlla i përbashkët, megjithëse botën e shikonim ndryshe. Deti në shkrimet e mia kishte një simbolikë krejt tjetër.

“Dafina në shi” është libri i tretë që u ofrohet lexuesve nga ky poet. Në të vërtetë, këto janë poezi, sa di unë, që ende nuk e kanë parë dritën as në Tiranë. Dhe botimi i tyre te ne ka edhe simbolikën e rrënimit të njëfarë muri që ka ekzistuar në hapësirën kulturore shqiptare. Nuk do të jetë interesant vetëm për këtë, por, para se gjithash, për vlerat letrare të pakontestueshme e ndoshta më të shënueshme të këtij poeti. Fatos Arapin e shohim në një sfond krejt tjetër, që deri më tash nuk kemi pasur rast ta shohim. Megjithëse disa refleksione poetike paralajmëronin një gjë të tillë.

Para se të shoqërohemi me poezinë më të re të tij, duhet të theksohet se në thyerje të mëdha shoqërore, gjithmonë janë shfaqur individualitete që kanë shënuar kohën e vet me potencialin e tyre krijues e mendor. Kjo ndodhi edhe me treshin Dritëro Agolli, Fatos Arapi e Ismail Kadare në fillim të viteve ‘60, kur skematizmi i monizmit linte gjurmë të thella në gjithçka shqiptare. Historia jonë fillonte e mbaronte te LNÇ. Treshi i lartpërmendur, brenda mundësisë, bëri një hap të guximshëm qoftë në trajtimin e temave, qoftë në rrënimin e ngadalshëm të shijes bolshevike e të huaj për qenien shqiptare. Historia nuk fillonte as nuk mbaronte me LNÇ, por ajo ishte mijëvjeçare që pakkush e kishte në Ballkanin e miteve. Prandaj edhe ironinë “Ngriu historia Marshon e s’luan vendit”, që do ta ndeshim në një poezi të këtij libri, Arapi e vë në bisht të lahutës një forcë, do të thosha rrënuese, që e vuri në gjumë për disa dekada qenien tonë këndeje e andej murit.

Derisa në librat e parë të Fatos Arapit, intuita luante rol më tepër se talenti, ku kishim një poezi gati uniformiste çfarë krijohesh në lagerin socialist, brenda realsocializmit, me heroin pozitiv në qendër,

ku gati njësoj këndohej për të gjitha figurat nga lufta e fundit dhe ku çdo mbarim përfundonte me një happy end, në poezitë më të reja kemi një poet, i cili ka pësuar metamorfozë të dukshme, në të mirë të artit. Poeti nuk është më vrojtues i rëndomtë i gjërave që me shpejtësi të hatashme ikin, duke na lënë me gisht në gojë. Tashti hapësira e tij poetike ka një shtrirje të gjerë. “Mbi copën e diellit që ka rënë atje poshtë” shoh edhe pikën e zezë të kohës dhe poeti me ngulm kërkon ta dijë edhe shkaktarin e asaj pike të zezë. Pra, i bindur se jeta nuk është vetëm faqja kah shihet dielli, por ka diçka edhe në anën tjetër të errët, të cilën për arsye të ndryshme shpesh kemi hequr dorë ta shohim. Por, ai që merr pjesë në ndërtimin e shpirtit dhe të mendimit njerëzor, sakrifikon edhe qetësinë e lumturinë e vet, mbasi e vërteta gjithmonë është thënë vështirë. Prandaj edhe poeti ynë jetën më nuk e shikon vetëm nga një kënd i dirigjuar.

Rol vendimtar në poezinë më të re të Arapit do të ketë prapë dashuria, ajo ndjenjë fisnike e njerëzore e cila në disa poezi ka kuptim ekuivok. Me një sensibilitet herë-herë mjaft të theksuar bën edhe vijëzimin e dhembjes, të trishtimit deri te disa kategori të tjera. “Nuk e lëshoja, e shtërngoja fort” do të thotë poeti në poezinë “Dorë për dore me tragjedinë”, të cilën lexuesi-interpretuesi mund ta kuptojë edhe si një absurd të një kohe të errët që, ndoshta, po i lë lamtumirën edhe populli ynë.

Për herë të parë në poezinë e Fatos Arapit takohem edhe me një kategori tjetër, atë të çështjes së moralit. i cili vjen e bëhet më i theksuar. Se një popull antik, ç’moral mund të ketë në një kohë kur çdo gjë kontrollohet rreptësisht dhe “ushqehet me dhembjen tënde”. Dhe në një jetë, me vibracione të mëdha, i bëhet se “ti di vazhdimisht të ikësh”. Ajo nuk është vetëm dashuria ndaj femrës, megjithëse “akoma ishim bashkë, kur ndarja kishte nisur”. Kjo ndarje mund të jetë edhe ndarja e kombit se “më në fund, përtej tragjeditë, ç’ka?” Pyetje kjo që shtrohet në të përditshmen tonë ekzistenciale. Për një jetë nuk mjaftonin vetëm qetësia e jashtme, por edhe begatia shpirtërore, komunikimi normal në mes vetes dhe kombit që ka munguar me dekada; pra, edhe riorganizimi gjithëkombëtar.

Mirëpo, në një kohë apatike ka vepruar me të madhe edhe dyshimi ndaj njëri-tjetrit që tjetërkush e ka shfrytëzuar për qëllime të veta të errëta. Ishim viktimë e atij dyshimi dhe “ti një dosje e pluhurosur në kasafortë”, ku në hijen e forcës, që më tepër do të thosha të karrigës e injorancës, dikushi “leçit, korrekton, ritushon jetën tënde... ndaj gjithçkajes”. A mund të mohohet një e vërtetë e hidhur se ishim në prag të mashtrimit të madh dhe zhdukjes si komb e kulturë; se me ne komandonte monstrumi i quajtur ideologji? Kjo le t’u mbetet brezave të ardhshëm.

Jeta, sado e lumtur që të jetë, do të ketë diçka për korrigjim qoftë edhe të një hijeje që ia fsheh fytyrën. Në sistemin e vet filozofik Kamy pakënaqësinë e konsideronte forcë të madhe që njeriun e vë në veprim. Prandaj temperaturën që ka zënë të ngritet për çështjen tonë ekzistenciale, duhet ta kuptojmë si dëshirë për ta avancuar mendimin tonë qoftë politik, qoftë estetik.

Me disa poezi më të reja, Fatos Arapi thaujse e ka parandjerë këtë moment vendimtar të genies sonë.

(Prishtinë, prill 1991)

JETA NË DY KOHË

Poezinë “Nina-nana në dy kohë” të Sulejman Matos në këtë shkrim nuk e marr as nuk e trajtoj si një rën ndër poezitë më të suksesshme të tij. E zë ngojë për idenë që shtron në të e që është ide qëndrore në krijimtarinë e tij poetike. Në e parë, kjo poezi ka afri të madhe me ninullat tona popullore, të cilat i dëgjojmë çdo ditë nga nënat. Ka të njëjtin ritëm, metrikë, gati të njëjtin figuracion. Ajo që e bën të dallohet nga kënga popullore, është shqetësimi krijues dhe realizimi i idesë, i njëfarë sinteze të kohëve, ndërlidhjet e forta të kohëve dhe shkrirja e tyre në një ekzistencë kolektivi.

Përmes nënës dhe fëmijës në djep, poeti na jep një jetë të tërë njerëzore, e cila zhvillohet në dy kohë. Sulejman Mato bën përpjekje të vijëzgjë me vija mjaft karakteristike dhe në mënyrë sa më të plotë portretin socio-psikologjik të femrës sonë, e cila i këndon fëmijës: *“Kur të rritesh do të mësosh / të fshebtat e kësaj botë”*. Përmes këngës së saj thur jetën që ka një shtrirje të madhe kohore. Ajo i rrëfen fëmijës për rrugën e saj të mundimshme dhe për fatin që mund ta presë atë në botë të pabesive. Po ashtu, kjo poezi përcakton kufijtë në mes narracionit imagjativ me atë real.

Kohë e parë në “Nina-nana...” është koha e shkuar, e cila bart barrën, gati në tërë diskursin e Matos; është kjo kohë e cila ka zënë të mitizohet. Koha e dytë është vazhdimësi e natyrshme e kohës së mitizuar, koha e triumfit sociokombëtar, e tashmja. Po që se vazhdojmë ta shtresojmë më tutje këtë poezi, do të shohim se koha e parë është kohë e epizmit, e sakrificave të shumta, “e luleve të pavdekësisë”, e heroizmave, e pabesive; koha e dytë është koha e lirikës: e rindërtimit të vendit dhe të qenies kombëtare, e intimes, e qetësisë shpirtërore, por kjo kohë është e mbështjellë edhe nga një vel i shqetësimit, shqetësim ky më tepër i fatimit njerëzor se sa kombëtar. Poeti është i bindur se ka ikur larg të këqia, se të këqiat që do të

mund t'ia trazonin qetësinë e brendshme qenies sonë. mbeten larg (Botë mistike). Në kohën e parë poeti u kthehet përmes një jete pagane legjendave, miteve, po edhe përmes kujtimeve nga fëmijëria. Është interesant se në këto poezi Mato ka një figuracion mjaft të pasur dhe një reduktim teksti, vjelë e mësuar gati kryesisht nga thesari i popullit, si dhe nga disa shkrimtarë shqiptarë (Kadareja. Arapi, Agolli etj.). Në kohën e dytë që del si kohë e tashme, poeti është vetëveprues, vetëcaktues, vetëndërtues i fatit të vet, pjesëmarrës në triumfin e fatit kolektiv të qenies sonë. Në këtë poezi më shumë na ofron vetëm fakte, që shpesh u ngjajnë klisheve të cilat mund t'i kemi ndeshur më parë te ndonjë krijues tjetër. Këto ide-motive duan një përkushtim më të madh dhe një dorë më të fortë artisti.

Përpjekjet e poetit për një rindërtim të ekzistencës së njeriut tonë, herë-herë nuk realizohen në masë të duhur dhe dobësojnë formësimin e tekstit poetik.

Riviera

Në poezinë shqiptare Sulejman Mato hyn si poet i rivierës. Përvijëzimin shpirtëror të Jugut, diskursi i tij do të duhej të ishte mjaft karakteristik, siç është, bie fjala, ai i Fatos Arapit, apo i poetit ulqinak, Basri Çapriqit... Por nga riviera ku njerëzve, siç thotë poeti, “deti u buzëqesh në sy”, sjell vetëm peizazhin blu, ndonjë ushtimë dallge, ndonjë kujtim nga fëmijëria, erën e portokajve, ullinjte, Jugun e ngrohtë etj. Edhe pse poeti vazhdon të shkruajë për rivierën deti prapëseprapë nuk është simbol i parë në krijimtarinë e tij poetike. Nocioni *det*, disi mbetet më tepër si toponim, shenjë me të cilin poeti dëshiron të na bindë me këmbëngulje se nga vjen. Poezitë e shkruara për detin janë më tepër inserte, krijime fragmentare të një ngazëllimi të rastit, ku poeti fascinohet nga triumfi e depërtimi i të resë në hapësirën njerëzore.

Kulti i heroizmit

Poetin Sulejman Mato duhet ta kërkojmë në poezitë me motive nga e kaluara, ku vërehet më së miri forca e tij krijuese. Me inkudrimin e së kaluarës në tekstin letrar, krijuesi faktikisht formon credon, për të hedhur dritë mbi fillet e origjinës së vet në kohën e parë. I vetëdijshëm se çdo gjë ka të kaluarën, Mato i hyn rindërtimit të ngjarjeve të shkapërderdhura nëpër kohë. Këtë rindërtim, kryesisht të disa datave e figurave historike, e bën me mjaft sukses. Ndhimë të madhe ka nga disa shkrime të shkrimtarëve tanë, po edhe nga kënga e popullit, e cila diti t'i ruajë e t'i përkryejë aq mirë shumë ngjarje e figura nga e kaluara, t'i përjetësojë ato, duke u dhënë dimensione të reja. Këngën e popullit, e cila ngërthen më vete zjarret e shuara e të pashuara, urtinë shekullore, heroizmin, dashurinë, gjakun e ri dhe e cila mbajti gjallë breza e breza, të huajt bënë çmos ta shlyenin nga kujtesa jonë.

Si shumë krijues tanë, edhe Mato i kthehet, pra, asaj gurre të pashtershme frymëzimi dhe mu këngën e popullit e bën bazë të fortë të tekstit të vet. Niset nga kjo, duke dëshiruar të bëjë një simbiozë në mes të artit të popullit dhe të tekstit letrar, por vazhdimisht duke i kërkuar e funksionalizuar pikat më qenësore. Respekt e dashuri ka posaçërisht për portretimin e femrës, e cila është pjesë e pandarë e tragjikës sonë. Ajo nuk ishte vetëm nënë. Shumë sugjестive është poezia “Gratë e Sulit”. Aty guximi i femrës sonë shndërrohet në kult heroizmi të rrallë. Ngjarja jepet në dy rrafshë. Rrafshi i parë: nizamët, të huajt, ekspedita ndëshkuese e Ali Pashë Tepelenës për t'i mposhtur me çdo kusht, edhe malësorët e Sulit të Çamërisë. Dhe rrafshi i dytë: Suli kishte mbetur thuaja në gra: ato, kur hetuan se u kanosej e keqja, zgjodhën vdekjen - hedhjen nga shkëmbinjtë. Me to, ndoshta, ishte edhe fundi tragjik i vet Çamërisë. Po ky vetëfljirim, kult i heroizmit të femrës sonë, nuk ishte i pari as i mbrami. Reprizohet kjo, kushedi sa herë në udhëtimin e qenies sonë dhe vetëfljimi ishte bërë tashmë traditë. Para hordhive romake kështu kishin vepruar gratë ilire në kohën e Batonit, kështu vepruan edhe krutanet. I paharrueshëm mbeti

vetëflijimi i vajzave gjakovare që duke mos dëshiruar t'u binin në duar ushtarëve turq, përvëluan veten. Nga gjithë kjo mbeti vetëm kënga e popullit, Shkëmbi i grave të Sulit, ai i grave krutane, Vorri i Çikave në Gjakovë. Ky kult heroizmi u përvodh nëpër korridore të forta të të huajve, hyri në këngën e popullit dhe arriti deri në kohën tonë si një dëshmi më se tragjike e qenies sonë, pra hyri edhe në “Gratë e Sulit”, poezi kjo e cila veçohet në krijimtarinë poetike të Matos dhe për formësimin vërtet artistik të tekstit.

Mbi glob fryjnë erëra

Diku në fillim të këtij shkrimi thamë se koha e dytë e jetës në tekstin e Matos, është jeta e re, e tashmja: triumfi i të resë, zgjimi i vetëdijes. Por këtë të tashme e mbështjell edhe njëfarë veli i shqetësimit e që e shoh nga dy arsye. Së pari: njeriu të jetë plotësisht i lirë dhe i lumtur, veten ta ndiejë të vetes, duhet të jetë i lirë edhe tjetri dhe, së dyti, po qe se njeriu dëshiron të ruajë autonominë e vet patjetër duhet të jetë vigilent se në botën e sotme, trolli i njeriut nuk është i pacenueshëm; se njeriu ende nuk e ka atë qetësinë e vet absolute përderisa mbi kokën e tij rri dikush. Prandaj lufta për ruajtjen e identitetit vazhdon të jetë gjithnjë e më e fortë. Në këtë nuk ndikon vetëm forca, por edhe shumë faktorë të tjerë. Dominimi në trollin e njeriut, bëhet edhe përmes arteve e kapitalit. Negri, i cili bredh nëpër poemën “*Mbi glob fryjnë erëra*”, nuk është i vetëm. Dehumanizmi në botën e sotme ka përmasa të mëdha. Mjafton të lexojmë lajme tronditëse; se kaq e kaq, se kaq e kaq... Njeriu nuk po humb vetëm trollin, por edhe shpirtin. Duke parë këtë padrejtësi, poeti ngre zërin kundër një shfrytëzimi të egër të njeriut në botën e kapitalit, ku kushton më shtrenjtë një qen se një jetë njeriu, dhe kundër një “kolonializimi shpirtëror”, siç do të thoshte Encensberger. Prandaj kjo poemë, megjithëse është shkrim estrade, ka një mesazh të fortë, i cili theksohet e plotësohet fort me poezinë asociative “Ja, Itaka” prej nga fillon pabesia dhe dyshimi në mes njerëzve. Nga mesazhi i saj del: të keqes, udhën prej përderisa nuk të ka hyrë në shtëpi.

(10 prill 1983, Prishtinë)

TMERRI I RI

Pas një bredhjeje nëpër të kaluarën arbëreshe dhe shfletimit të teksteve letrare, librin e parë të Voreo Ujkos (Domenico Bellizit) të botuar te ne, e pagëzova “*Ankth*”. Emërtim ky pakëz frikësues, por në një farë mënyre, simbolizon udhëtimin e mundimshëm jetësor, krijues dhe intelektual të arbëreshit. Poezia e Ujkos mundësonte një interpretim të tillë: përpjekjet për të mbajtur gjallë kujtesën historike, kultivimin dhe ruajtjen e traditës, të gjuhës, zakoneve e deri të një kangjele. Mesazhin dhe peizazhin arbëresh e shihja, po ashtu brenda kontekstit ekzistencial kombëtar. Në poezinë e tij dëgjohej troku, i kohëve të shkuara, ai kali i Konstantinit, frymëmarrja e moteve moderne me atë kërcënimin e përhershëm: *kurbeti* dhe *ligji* që zbrazin hapësirën arbëreshe. Po këto plagë hanin trupin e shqiptarëve të këndejetit. Pra, frika shfaqej si shqetësim gjithëkombëtar.

A ishte i qëlluar pagëzimi i librit me nocionin “*Ankth*”? Pas disa vjetësh, takova Ujkon diku në Kosovë. Fjala e parë ishte: Është e vërtetë, ne arbëreshët jetojmë dhe veprojmë në një ankth të tmerrshëm njerëzor. Ne, vdekjen nuk mund ta paramendojmë pa e parë *Atdheun* e të parëve. Ajo që thoshte poeti, nuk ishte një rrëfim patetik. Ai shpaloste trishtimin arbëresh, me të gjitha nuancat, që e ndiqte nga lindja në vdekje, brez pas brezi e që, në mënyrë të çuditshme, ajo frikë njerëzore për të ekzistuar, gjithsesi, hyri edhe në poezinë time. Vdekja nuk është diçka reale, as metaforë.

Shfletoj librin e fundit të Ujkos “*Hapma derën, zonja mënie*” (Naim Frashëri, 1979). Një sensibilitet tjetër, më pak është e pranishme koha mitike, ka probleme të ditës që lexohen edhe si protestë jo vetëm e arbëreshit. Poezia është e hapët, komunikuese, e me një pyetje ekzistenciale që shtrohet vetvetiu:

çka më tutje? Njëpër fjalët e tij të bëhet se diçka merr flakë. se diçka shpërthen: *Jam ende një fëmijë / të cilin ia kthejnë fytyrën / nga atdheun i të parëve*, mbyllet një tercinë karakteristike, ku jepet portreti shpirtëror jo vetëm i poetit. Udhëtimi i arbëreshit, qoftë ai edhe imagjnativ, ekziston si një gjakim i përhershëm për një *riktim* të ri brenda hapësirës arbërore. Ai përpiqet të krijojë *Atdheun* edhe në ëndërr, të shkelë këmba vetëm një herë në tokën e të parëve, sepse, siç thotë Ujko, arbëreshi i ka *“buzët e djegura nga ëndrrat e natës”*. Ky gjakim, më se njerëzor, për të gjetur diçka të humbur, m’i kujton udhëtimet e studiuesit të mirënjohur Anton Bellushit, që i kishte bërë deri atje poshtë në More. Një zë i largët e kishte shqetësuar për disa vjet dhe, derisa e kishte gjetur fshatin e të parëve, Morca kishte qenë për të mbarimi i botës. Apo, shikimi mjegullues, i hedhur tej deti i De Radës nga ballkoni i shtëpisë së tij në Maki të Kalabrisë, për të cilin përmallim, në mesin e arbëreshëve tregohet edhe tash në variante thuajse Dc Raden para dy-tri ditësh e kanë parë. Shpesh ia kam shtruar vetes: Ç’fuqi magjike fshihet në shpirtin e tyre dhe ç’bëri *Atdheun* për ta?

Diçka e tillë nuk ndodhi me shqiptarët e vilajeteve të tjera, edhe pse shpërnguljet ishin më të vona dhe më të mëdha. Në shkretëtirat e Anadollit ata nuk mund i bënë ballë harrimit as brenda një brezi. Kopeisht shkuan dhe kopeisht u asimiluan, siç do të thoshte një mik imi. Besimi as dhuna anadollake nuk ishte më rrënuese se “qytetërimi” i tejetit, por vetëdija për të ekzistuar dhe ruajtur identitetin mbeti këmbëngulëse tek arbëreshët. Ja pse kam një konsideratë të posaçme ndaj teksteve që na vijnë nga tejetit.

Voreo Ujko ka vite që prehet në dhe, diku në Kalabri, pranë ndonjë rrënje apo kangjele. Shqetësimi i tij prej krijuesi e njeriu, pezull që rri si re e zezë në pjesën dërrmuese të poezive të tij, kohëve të fundit merr përmasa kombëtare. Hapësira jetësore-kulturore shqiptare ngushtohet vazhdimisht. Këtë e kishte paralajmëruar edhe poeti gjatë një udhëtimi për Atdhe: *Unë vizën s’e kisha në pasaportë. Po kisha mallë për Shqipëri*. Brenda një pëllëmbë

toke kufij të rinj linden, shumohen dhe gllabërojnë çdo shenjë tonë, një tmerr i ri shfaqet në horizontin shqiptar.

Teksti arbëresh mbetet edhe një lloj lektyre e dinjitetit kombëtar: si të ngadhënjehet mbi kohët që poshtërojnë?

(1994)

KUR LEXOJ LIBRAT E MIKUT

Më së vështiri është të shkruash për librat e miqve. Ndoshta, pse emotivisht je i lidhur me ta, ose pse ekziston mundësia e keqkuptimit të dyanshëm: autori-lexuesi. Miqtë, më së lehti edhe lexohen, por, asgjë më shumë se fjala e mikut nuk prek.

SINTAGMA: ARBËRI RRON: Përkundër dhunës së paparë ndaj çdo gjëje shqiptare dhe gjendjes së rëndë sociokulturore, sintagma e njohur: *Arbëri rron*, dëshmon edhe në këto kohë të liga se shpirti ynë krijues është i gjallë dhe identifikohet me kërkesën gjithëkombëtare: Një popull që i këndon lirisë, herdokur do ta gëzojë atë.

Nga mjeshtrit e dhunës, edhe pse u privua katër herë, Xajë Nura ruajti kontinuitetin krijues. Nga vepra në vepër dëshmon me përmbajtje, ide, forma. Guximi intelektual dhe ironia, qoftë kur iu kundërvua dhunës në *kohën e ndaluar*, qoftë përmes motiveve mitike ua hoq maskat idhujve të rremë, shquajnë tekstin e tij letrar. Poezia e tij simbolizon jo vetëm rrugën e tij të mundimshme si poet dhe intelektual i pakompromis. Mesazhi i tij mbetet mesazh gjithëkombëtar, një segment i fortë i rezistencës sonë. Shumica e poezive të tij nuk u shkruan në kohë të qeta e komode, por birucave të kazamateve të diktaturës, në vetminë më të madhe që ia imponuan mjeshtrit e dhunës. Vetmia e tij është disavjeçare, protestë e heshtur, dinjitoze e që lexohet-interpretohet si një tekst ekzistencial kolektiv.

POET I TRONDITJEVE TË MËDHA: Ende nuk i kisha rënë brisk fytyrës, kur u shfaq Murteza (Xajë) Nura. Sokaqeve të Gjakovës daravitej një mjegull e rëndë dhe me delikatësinë e mjeshtrisë së fjalës, pakkush merrej në Kosovë. Ylli i Kadaresë, sapo kishte zënë të ngritej në horizont tej Pashtrikut. Në letrat shqipe, trokitjet e para dhe emra të rinj: *dridhjet krijuese*. Me motive rurale e rekuizita të një bote më tepër naive, retorikë odash. Nëpër vargjet e

tyre ndihej prania e Martin Camajt, poetika e të cilit edhe tani lexohet me kujdes. Mjafton të shfletojmë përmbledhjen e fundit *Palimpsest*, botuar për të gjallë të poetit në Amerikë. Ndërkaq, nga poezia botërore më i pranishëm ishte Lorka. Ai ushtroi “terror”, posaçërisht me atë magjinë farfuritëse të peizazhit e shpirtit të Granadës, nuancime këto jo vetëm të rezistencës spanjolle në kohën e Frankos.

Në mes të këtyre rrymave përbirohej një pjesë e poezisë sonë.

Një i ditur pat thënë: Ajo që krijohet tek ne është një letërsi e virgjër. Më vonë, preokupim nuk ishte vetëm *djepi*, *labuta* - jeta rurale. Skalpi krijues kishte prerje mjaft serioze, sensibiliteti i ri tek vërehej: inkuadrimi i urbanes si element i ri me traumat e përditshmërisë - qofshin ato edhe poezi me ngjyra politike, apo siç kanë zënë t’i quajnë ca: *pllakatpolitik* (!).

Kapërcimi ishte më se kualitativ. Poezia kishte fituar dimensione të reja. Ligjërimi ishte më i mbyllur. Ekuivok. Pse shkilej një rrugë e tillë, diheshin arsytet. Kjo bëhej më tepër për shkak të pakënaqësisë me atë që frymonte rreth nesh. Interpretimet ishin të nduarnduarta, varej nga aftësia se ç’mund të tirrej nga fjalët. Shpirti ishte shndërruar në një xixë, se atë që ofronte *koha e ndaluar* ishte e pamundur ta gëlltisje. Jeta më nuk ishte diçka idilike. Në pyetje ishte ekzistenca e një kolektivi njerëzor. Dështimi dhe ndëshkimi i diktaturës, megjithatë, ishte një aventurë, që mund të kushtonte shtrenjtë. Lexuesi ynë tani, kishte mostër *guximin* krijues e intelektual.

Ligjërimi i Murteza (Xajë) Nurës solli shqetësim, trandi shpirtërat e mësuar keq me qejfe e kompromise: zhurmashinjtë e tralalave; burrëroi qyqarllëkun e qysheve dhe kafeneve tona të mjerimit. Jeta u bë protestë: reagim, përgjakje, lëvizje e gjërave - se thyerjet ishin të pranishme jo vetëm në fushën e artit.

Xaja nuk e nisi veprën e vet duke lexuar letërsinë, por duke i rënë mespërmes ferrit shqiptar; në shpirt e lëkurë duke ndërë kafshimin e dhunës; duke bërë sublimimin e kuptimeve, e problemeve; pikën e fundit të energjisë duke shndërruar në *klithje* njerëzore; sy më sy duke u parë me vdekjen, aty në fundin e natës së përgjakur, që në poezinë “*Nata kriminele*”, Besim Bokshi kishte

paralajmëruar dhunën. Nëpër atë ferr plot trauma e ndjekjeje, eksodesh e hakliqjesh. Murteza Nura bën edhe projektimin e ardhmërisë brenda etnisë, duke besuar në sakrifica e dinjitet të pashoq të popullit.

Gati pas katër dekadash mbi tavolinën time shtohen librat e mikut tim. Dhe vërej se Xaja ka mbetur po ai që e njihja në fëmijëri: guximtar, i rreptë, hulumtues i përhershëm i atlantidës shqiptare; farkues i krenarisë dhe i fatit jo vetëm kombëtar; kultivues i shpirtit rrebel, mbamendës i datave e figurave historike, vetëflijuës për kauzën kombëtare.

Dhe i lexoj ato si *libra burgu*; si libra që u vjen era gjak, shtrëngatë, shkumb; si libra të një vetmie të madhe njerëzore, por edhe si libra liric e të një besimi të patundshëm për të ardhmen.

MAJA PATJETËR DUHET PUSHTUAR: Dhe vërej, po ashtu, se vitet e kaluara nëpër kazamate kanë lënë gjurmë të dukshme në ligjërimin e tij. Fjalët pakëz janë të lodhura nga udhë e mundimshme deri te artikulimi. Herë-herë gati të këputshme, të hutuara, të pakapshme.

Mirëpo edhe pse gjuha është bukuri më vete, nuk do të thotë se ajo është vlera më e madhe e poezisë. Ka shembuj sa të doni edhe në letërsinë tonë. Se poezinë e mban gjallë mesazhi, ideja, arkitektura. Arsyetohen edhe sintaksa, struktura, rimat. Ligjërimi çfarë na ofron poeti përmes një teksti të rëndë, sublim, para së gjithash, duhet të shikohet në kontekstin historik pa harruar elementin letrar-estetik.

Kur lexoj librat e mikut, në të vërtetë unë lexoj udhëtimin tonë të mundimshëm. Dhe nuk mund të mos e kujtoj edhe fëmijërinë time, të harruar atje rrëzë Çabratit, me atë qetësinë e thyer e të përgjakur, që përfytyrohet gati në të gjitha librat e mikut.

Maja patjetër duhet pushtuar. Edhe i vdekur. Këtë e paralajmërojnë jo vetëm tronditjet e mëdha të poetit në këtë fundshekull.

(Prishtinë, maj 1994)

JANË ZBUKURUAR PLEHRAT NË ATDHEUN TIM

Shqipërinë ka sa vite që e shoh dhe e lexoj përmes shkrimeve, librave dhe kartpostaleve të miqve të mi. Asgjë nuk është depresive pos kufijve të shumtë që shtohen mes meje dhe saj. Rreziku më rri mbi kokë dhe nuk e kam ndërmend të poshtërohem, duke i kaluar ca kufij nëpër trojet tona. Pra, mjafton të hapësh ndonjë libër a shkrim të sensibilitetit të ri dhe të kuptosh si ecën Shqipëria në këto ndërrime të mëdha. Visar Zhitin, për poezinë *“Janë zbukuruar plehrat”*, të cilën e veçova për shumë arsye nga libri *“Mbjellat e vetëtimave”* (botim i “Flakës”, 1994) dhe autorin e këtyre rreshtave, do t’i shpallë kush tradhtarë të dinjitetit kombëtar. Nga pirgjet e plehut, si mund të përcillet zgjimi i një vendi që nisi nga zeroja?

Paradoksale duket, por plehrat mund të zbukurohen, të ndërrojnë peizazhin dhe përmbajtjen; janë barometër tepër interesant i një shoqërie njerëzore, nga i cili mund të lexosh edhe të pamundshmen. Përmes poezisë së Zhitit unë e shoh Shqipërinë si në shuplakë të dorës, zgjimin e saj dhe tërheq paralele në mes saj dhe vendit mik ku gjendesha. Ku ka bollëk, megjithatë, plehu nuk është fundi. Ka diçka që plehu duhet të ekzistojë dhe të dëshmojë për udhëtimin tonë më se të çuditshëm në jetë; çfarë ishte e nga u nisëm?

Plehu nuk i kërcënohet rrethit, njeriu i kërcënohet vetes, se plehun e hedh aty ku nuk e ka vendin. Në vargun hyrës të poezisë që e përmenda, Zhiti sinjalizon: *Janë zbukuruar plehrat në atdheun tim...*

Buzëqeshjen e tij, sado ironike, lypset kurajo ta kapësh dhe të mos nevríkosesh me fjalën *pleh* se me zbukurimin e tij shfaqet ngazëllimi, optimizmi, por edhe frika për atë ç’ndodh në Shqipëri. Bën me dije se në vendin e tij nuk janë më çështje ekzistenciale gjërat elementare për të gjallëruar: as liria nuk ndodhet tej bunkerëve, aty diku, në realitetin shqiptar, merr këmbë ajo.

Poeti paralajmëron disi tërmet në ekologjinë tonë shpirtërore, se për të jetuar nuk mjafton vetëm hedhja e plehut. I bindur, po ashtu, se ca gjëra që i gëlltiti plehu nuk mund të fshihen nga kujtesa e paformësuar dhe pa u gjetur vendin e vet. Ka diçka aty që poetit ia dridh shpirtin, mbarimin e së cilës e sheh si triumf mbi të keqen, në rastin konkret mbi dhunën e diktaturës: *Kapakët e shqyer të veprave të diktatorit/fotografitë e tij të qeshura dhe pis...* Zhiti me kaq ndahet nga një e kaluar e hidhur, të tashmen duke madhëruar, fytyrën e së cilës ia kishte parë e vizatuar nëpër muret e kazamateve të Burrelit, Spaçit... Plehrat e vendit të tij nuk janë më as plehërishta për njerëz, me emra terribël, ku hidheshin vlera kombëtare pse nuk ishin krijuar brenda kornizave të dekretive drakonike. Në mënyrë të pavetëdijshme seleksionimi negativ i pastrimit ideokombëtar ishte shndërruar në vetëzhdukje të kombit.

Mirëpo në momentin e pikërishtëm, kur kanoset më e keqja, kam dëshirë të ndahem pakëz nga e kaluara dhe të mos merrem me të vdekurit e mi. Le të bëjnë gjumin e tyre se janë të vdekur. Dua të di ku shkel dhe ç'më pret pas çdo kthese e rruge. Në realizimin tim dhe të së ardhmes, sa mund të bëhet? Udhë është e gjatë dhe mund të ketë ndonjë defekt po qe se nuk di të inkuadrohem në mirëqenien time.

Kur lexoj poezinë “Janë zbukuruar plehrat”, në të vërtetë unë lexoj ecjet e Shqipërisë në hapësirën e re, të mundimshme, buzëqeshjen e saj: *Letra çokollatash vizlluese. Ambalazhe gjë e gjëzash, fotografi lakuriqe artistësh të ndaluar...*

Verbi i Zhitit liron imazhin nga hijet e së kaluarës, i bindur se ato që ia kap syri në udhëtimin e ri, ishin të kontrolluara rreptësisht nga Maja. Dhe, kur i bie tekstit në fund, kupton se ke lexuar një metaforë të të sotmes shqiptare. Sheh se fjalët nuk janë një renditje e zakonshme. Çdo gjë ka funksionin e vet në formimin e mozaikut, ku gjërat lëvizin si kokrra e zhivës. Pra, edhe plehu si kategori më e ulët nga nisi fluturimin feniksi ynë.

Se njerëzit i bashkon dhembja dhe i trimëron para ndonjë të keqe të madhe, e kisha veneruar edhe në dy librat e mëparshëm të Zhitit. Kjo është veti e krijuesve që duan paqe e mirëkuptim brenda

racës njerëzore. që e çmojnë lirinë. Dhe, te pak autorë nga Shqipëria kam ndeshur fytyrën e diktaturës, aq të shëmtuar e të pikëlluar, si në tekstet e Zhitit. Aty çdo gjë është e zgjedhur me pedantëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor e krijues. Teksti i tij letrar krahas të mirë ka J. Ricosin me poezitë e tij nga internimi. Por dallimi mes këtyre dy poetëve qëndron se Zhiti është më lirik, ka një sensibilitet të çuditshëm. Më vjen keq që e lexoj me shumë vonesë.

Shkas i këtij shkrimi ishte *plehu*, leximi i tij i parë: Shqipëria vete rrugës së mbarë. Me ne në Kosovë ç'ndodh me plehun tonë? Sëmundjet, vdekjet dhe varfëria alarmojnë se në udhëtimin tonë na përçjell një armë më e rëndë se ç'e ka ëndërruar pushtetari. Kam filluar të frikohem nga plehurat. Qelbëzojnë rëndë kudo. Duhet besuar se do të bëhet mirë. Të pajtohemi me atë që e thotë edhe Zhiti. *Të dëmshtëm më pak*. Pse të mos ndodhë diçka e tillë edhe me plehurat tanë, më të mirë të bëhen. Më njerëzor.

(Këln, 1994)

LIBRI QË NUK MBYLLET

SHQIPTARËT BËNIN VETËSHKATËRRIMIN KOMBËTAR: A ju kujtohet “Qyteti i fundit”? Me të zë fill romani ynë modern. Autori i tij, Petro Marko, legjenda jonë nga Spanja e Lorkës, pas të ashtuquajturës LNSH, regjimi diktatorial e akuzon për agjent të shërbimit amerikan. Dhe, duke parë se krimi kishte filluar t’u hyjë në gjak pushtetarëve, të bëhet “art” i preferuar i shtetit të ri shqiptar dhe truri ynë të bllokojë, shkrimtari nis rebelimin apo, siç thuhet, disidencën, kundërvënien, deri në mbarim të jetës së vet. Rruga e tij nga një disident politik në atë letrar shënon fillimet e para të guximit tonë intelektual.

Dhe djalit, sapo i lindur, i vë emrin *Jamarbër*. Kjo kompozitë do të thotë shumë jo vetëm për Petron - se ishte vetëmbrojtje nga inskenimet e kurdisjet më monstruoze, fyerjet e përlyerjet para të cilave nuk u përul dot. Në të vërtetë, shkrimtari ynë hap dosjen e krimit të shtetit diktatorial, që nuk pranonte as respektonte vlera e dinjitet njerëzor-kombëtar. Ajo dosje tani lexohet, se nëpër të kaloi tërë një popull.

Për arsye të ndryshme, atë që nuk e tha Petro Marko, në mënyrën e vet e thonë më vonë një çetë disidentësh nga “*Promemoria*” (1953) e Kasëm Trebeshinës, qëndrimit burror të klerikëve katolikë, veprave të njohura e të panjohura të autorëve të ndryshëm, që mbetën nëpër kazamate të tmerrit, deri te poezitë “*Nata kriminale*” e “*Kënga e luqatit të ri*” të B. Bokshit dhe teksti “*Vox clamantis in deserto*” të ca guximtarëve, që artin nuk e pranonin në shërbim të diktaturës. Rruga ishte më se e rëndë. Një disident vërtet politik, Maks Velo, do të thotë: *Shqipëria qetbej çdo vit*. Dhe kryesore Shqipëria qetbej për merak, ashtu siç i kishin mësuar ustallarët e krimit.

Gati të njëjtin fat përjetoi edhe Jamarbri; bile pat edhe saltomortale. Një disident i heshtur, i tërhequr në vetmi dhe i

dashuruar në fuqinë e fjalës; urtak, ironik i akullt, i cili në letrat shqipe do të hyjë pa bujë, dinjitoz e individualitet i veçantë, lavdet duke ua lënë simitçinjve e mediokërve. Pakkush do të zbulojë se ai portretizonte fytyrën e vrazhdë të diktaturës, duke e bërë atë me xhelozinë e një artisti të njëmendtë. Përmes poezive të tij plot sarkazmë nuk ka bubullimë fjalësh; vetëtijne sekuenca nga kazamatet e spitalet neuropsikiatrike, ku në mënyrë më të poshtër fyhej e thyhej qenia shqiptare. Se shkatërrimin kombëtar kësaj here e bënin vetë shqiptarët, ata që ëndërronin të shiheshin në fund të katundit.

ATDHEU KONSERVË HERMETIKE PARA UJIT TË MADH: Libri i poezive “*Rastësisht me dashje*”, botim i shtëpisë botuese “Çabej” (1995), shkruar afro njëzet vjet, titull provokues: Pse rastësisht me dashje? Krimi mos ndodhte vërtet me dashje, apo aksidentet e vrasjet pa nishana, burgimet e internimet ishin të rastësishme?

Në veprën e vet, Jamarbër Marko ngre çështjen e moralit politiko-shoqëror dhe atë njerëzor, duke e zhveshur nga dhuna e hipokrizia. Dhe nuk ngurron të shënojë shkaktarët e vetëzhdukjes brenda qenies sonë në baza farefisnore e të njëfarë pastërtie ideologjike, që, më tepër përkon me utopinë e oborreve mesjetare. Po si t'i quajë ndryshe ata pos *xhelatë*; se ata ishin kreatorë të së keqes kombëtare, cungimit të vazhdueshëm, izolimit shpirtëror e shtetëror.

Ju lutem xhelatë

Më buzëqeshni.

Nuk jam fotograf

Jam thjeshtë

Vrasësi juaj.

(Në gjyq)

Rruga e errët e gjaku shpie shpesh edhe nga pragu i shtëpisë së tij, sepse krimin e kishin përjetuar *familjarisht*: nga babai tek i biri - se lirinë e paqen e shikonin pakëz më njerëzore: se popullin e

kombëtare e mbronin më kombëtarisht; se Atdheun nuk mund ta shikonin si një konservë të hedhur nga gjithkushi, aty pranë Ujit të Madh, ku mungonte edhe Bregu, edhe Varka, edhe Gjeniu.

Narratori nuk është lirik. Lirizëm nuk mund të ketë aty ku dhuna poshtëron e rrënon çdo gjë rreth teje. Kemi të bëjmë me një ashpërsi koncize; me një kundërvënie intelektuale e sistemit totalitar, pa shpenzimin e fjalëve. Pra, narratori në poezinë e Jamarbër Markos është i traumatizuar; ka elemente të dramatikës. Flet nga ndërdlija e *Njeriut* të ndjekur, të fyer; gati përçarft flet diç që ka arritur t'i shpëtojë ferrit njerëzor, aty ku “toka digjet si letër”. Ka edhe segmente të tjera, që këtë poezi lypset lexuar si një sintezë mbi dhunën e lirinë e individit. Ato kanë kohën e vet, të shkuar, dhe mund të kapen, para së gjithash, nga rrafshi sociopsikologjik.

Një poezi e tillë, kultivuar në zgur të krimit. sadokudo dezekulibron poetikën tonë; më mirë të themi, e pasuron atë. Para nesh nuk kemi një vargënim banal autorësh që librat i nxjerrin si simita; kemi një poet që të vë në lëvizje me artikulinim karakteristik për të gjetur rrugën e mundshme në jetë, duke prekur edhe në etikë: *E binda vrasësin të buzëqeshë*. Po cili vrasës di të qeshë me viktimën? Ky farë vrasësi jo vetëm i tij, ngriti kazamate e burgje, trekëmbështa e rreshtoi togje pushkatarësh para viktimës; ky farë vrasësi harroi edhe të buzëqeshë, mësoi e ushtroi zanatin e krimit, që ia mësuan më tepër të huajt; se zbulimi i tij i vetëm: Të rrënojnë atë që nuk përkon me të. Një e zezë e tillë na kishte gjetur edhe neve të Këndejmurit. Në ish-Jugosllavinë e në të tashmen, nëse dikush do të duhej të kishte republikën etnikisht të pastër të burgut, ne moti atë e kemi fituar. Prandaj, në të dy anët e Murit, një dorë e padukshme kurdiste mbrapsht orën tonë; dirigjonte ecejaket tona të kërmillit.

Në mes fërkimeve e kundërvënieve, ka dallime. Petro Marko filloi si disident politik dhe përfundoi si disident letrar. Kujtojeni dramën “*Skënderbeu*”, tinëzisht, gati e kishte parë dritën në revistën “Nëntori” dhe ishte ndaluar për: 1) Në Kështjellën e Krujës kishte më shumë frëngji se duhet, nga të cilat të ngujuarit shikonin armikun, që ngushtonte rrethin, 2) Logjika e reduktuar moniste frëngjite i kishte parë si tentim i hapjes së shoqërisë shqiptare, të dalë nga vetërrethimi

e izolimi shpirtëror-shtetëror, dhe 3) Censurës i tërhiqej vërejtja se cenonte vetekzistencën shqiptare. Në të vërtetë, nga një disident politik, Petro Markon e kishin hedhur në atë letrar, që është më shkatërrues se kundërvënia politike. Jamarbëri u përcaktua për rrugën më të tmerrshme. Pak të burgosur mbahen mend për burgjet e tyre, se ata nuk dihen çfarë na ishin e si kanë ndodhur. Por veprat që kanë rënë nuk harrohen dot.

Duke përcjellë diskursin poetik në *“Rastësisht me dashje”*, merr pjesë në shpalosjen e shpirtit dhe mendimit të një krijuesi, i cili di ç’kërkon nga teksti i vet. Ca nga poezitë janë krijime kristale, të pastërta që më vete fshehin edhe ndonjë mesazh që mund ta dijë vetëm poeti. Në to nuk bëhet fjalë vetëm për problemin ekzistencial të *Njeriut*; shtrihen aty edhe shumë çështje, që mund të trajtohen edhe si kategori filozofike. Për t’u çuditur është se *“në përplasjet e rrezimit”*, poeti ka një qëndrim dinjitoz; nuk kërkon profitin as mëshirën nga tragjedia kombëtare. Ai kërkon vetëm: *“Për ta ndrequr gabimin”*, të korrigojëmi, pra, si shoqëri e komb. E thotë këtë në një katrenë, e cila lë hapët edhe ecejaket e shoqërisë shqiptare. Mbetet kjo dhe një sprovë jona e mëtutjeshme. Prandaj libri nuk mbyllet, vazhdon të shkruhet në vetminë e persiatjet njerëzore për atë që ka ndodhur e që poeti beson në kërkimin e tij këmbëngulës: *“U nisa të gjej të ardhmen”*.

Mbi tavolinën time ka kohë që qëndron ky libër. Kisha frikë nga t’ia nis. Prej *“librave shqiptarë”* a kishte ikur ende Ana Karenina, apo duhet pritur ndarjen solemne nga ajo, tamam si në stacionin verior, diku thellë në shkurren e mjegulluar...

(1996)

LEXIMI I TURPIT NACIONAL

A ishte aksident kombëtar rreshtimi ynë nën tutelën e Moskës sllavo-komuniste? Para se të shfletoni librin “Ringjallje” të Uran Butkës, parafytyroni për një çast kurdisjen e sa e sa komplotëve brendajashhtë Atdheut, zhdukjen pa asnjë gjurmë të shumë patriotëve e intelektualëve të shquar të kombit. Dhe mos e qitni menç jetën parlamentare të viteve '20, kujtoni gjestin e Nolit, i cili edhe pse zihej me Konicën, kurrë nuk kishte lejuar që në Parlament ta fyenin atë, rast ky i rrallë edhe sot në analet e demokracisë shqiptare.

Nga erdhi ajo forcë demoniane dhe e tmerrshme? U shfaq si vërshimë pas furtunës, që kishte shkundur çdo gjë tonën, dhe shpuri një popull e kulturë në bastardhim, në vetëzhdukje. Dhe kur t'i bini në fund librit, do të bindeni se keni shfletuar diçka jo të rëndomtë; se keni kaluar nëpër një ferr, që rreth nesh ka frymuar; se lufta e klasave dhe pastrimi ideor ishin bërë në mënyrë të poshtër - kundër qenies kombëtare dhe vetë Shqipërisë.

Padyshim aksidenti ishte fatkeqësi:

1. Për një gjysmë shekulli ishim shkëputur nga qytetërimi perëndimor të cilit i takonim; kishim lënduar edhe ëndrrën e rilindasve, që ardhmërinë tonë e kishin projektuar në veprat e tyre.

2. Disi pa vetëdije, iu bashkuam një dogme dhe utopie, që asgjë të përbashkët nuk kishte me origjinën, kulturën dhe historinë tonë. Ndoqëm një kope që dilte nga e panjohura dhe priste që të na gllabërojë si hapësirë e komb. Kujtoni ministrin e punëve të jashtme të Rusisë cariste, i cili në fillim të shekullit që po e lëmë, kishte thënë: deri në shek. XXI shqiptarët do t'i qesim në det. Me të tillët ne kërkonim fatin kombëtar?!!

3. Përkundër premtimeve të koalicionit antifashist se pas Luftës së Dytë Botërore, që ne e quanim edhe LNC (nuk di pse?), do të

bashkohen trojet shqiptare, e vërteta doli ndryshe; ne mbetëm pikepesë, kusuritje në mes të të mëdhenjve dhe fqinjve tanë; dhe

4. Brenda idealit komunist ndodhi tradhtia: popujt nuk ishin të barabartë, por të manipuluar. Ky tërmet plasi edhe brenda kombit, drithmat e të cilit i ndiejmë ende. Është tmerrues vazhdimi i copëzimit tonë, që pamundëson formimin e shtetit sipas vullnetit të popullit shqiptar si etni. Kjo pjellë e historisë dhe e ndërhyrjeve të të mëdhenjve dëmton edhe demokracinë e re shqiptare.

Intriga, kështu, na u bë dhunti. Pabesia mori përmasa të papërshkrueshme për qenien tonë. U bëmë armiq të vetvetes dhe trojet tona u shndërruan në një teatër tragjik, ku tërë populli i varfër e i fyer u bë aktor; luante rolin që ia përcaktonin forcat e errëta. Na lejonin që të shikojmë vetëm njërin anë të të “vërtetës” së hidhur që ata e zbukuronin, kurse dimensionet e tjera të jetës së njëmendtë për ne ishin të errësuara; nuk guxonim të bënim fjalë as për ëndrrat që na shfaqeshin në vetminë e thellë, sepse:

1. Kasta komuniste-revolucionare kujdesej për shëndetin e popullit, duke i ofruar menynë pa pikë yndyre interesave kombëtare. Qitej në harresë, madje edhe në ndalesë, fakti se edhe tej Malit ekziston diçka shqiptare. Sipas shtetit ideologjik, shpalosja e gjërave shpiente te një kaos i madh, jo vetëm brenda qenies shqiptare.

2. Kreu i Nomenklaturës kujdesej që askush të mos gëzojë lirinë individuale, madje as si liri e përqafjes së kombëtares.

3. Historia kombëtare reduktohej sipas kutit të mediokërve, duke zhdukur figura të tëra historike. “Historia e vërtetë”, sipas tyre, mundësisht të fillonte aty diku me Luftën e Dytë Botërore, apo siç e quanin LNÇ. Dhe kjo është dashur të bëhet edhe për shkak të rehatisë së fqinjve, madje edhe për shkak të popullit, i cili duhej të amnistohet nga të bëmat në të kaluarën, me gjithë ato zavalle e halle që u kishte shkaktuar ballkanasve. Pra, krenaria kombëtare të kapet te perënditë e reja, që na dilnin nga e ashtuquajtura LNÇ.

Luhatjet e shtetit ideologjik lexohen edhe si mungesë e kurajos kombëtare. Shteti ideologjik kishte pranuar turpin - se kryente punët e fqinjve, që edhe ata vetë i kishin lënë për një kohë më të

përshtatshme. Tkurrja e hapësirës jetësore e shpirtërore e Atdheut nisi t'i ngjajë një torzoje të pikëlluar. Kosova dhe Çamëria frymonin diku tjetër. Ndërkaq, krasitja e qenies kombëtare vazhdonte. Dhe shumëçka e vlefshme dhe e pakompensueshme. Shkrimtarët e mendimtarët e formatit të Fishtës, Konicës, Koliqit, Selman Rizës, Mithat Frashërit e shumë të tjerë konsideroheshin të papërshtatshëm për “rendin e ri”. Arsyeja: të tillët donin një Shqipëri dinjitoze kombëtare, ashtu siç e kishte projektuar gjeniu ynë. Por gjymtimi shkoi aq larg sa u fajësuan edhe rilindasit, pse nuk kishin lindur marksistë. Pikëlluese ishte t'i shihje shkrimtarët e kombit, siç dëshironin gogolët e ideologjisë. Me atë petkun e mesazhin kombëtar të tyre nuk u lejohej hyrja në shkollë, që ishte shndërruar në çerdhe ideologjike - se në shtetin ideologjik çdo gjë duhet të jetë ideologji; bile edhe një përqaftim aty diku nën pishat e Atdheut.

“Ringjallja” e Uran Butkës duhet të lexohet jo vetëm si vrragë kujtese, por edhe si simbolikë kthimi në jetën e të përndjekurve dhe të zhdukurve nga diktatura. “Ringjallja” është një metaforë e përgjakur e shpirtit demokratik shqiptar, që nuk prajti së ekzistuari as në kohë të liga.

Duke zbuluar monstrozitetin e diktaturës, zbulon edhe madhështinë e botëkuptimit të ndrydhur demokratik. Dhe autori këtë rrënim e rrymim nuk e sheh vetëm brenda kufijve politikë. Nëpër tekstin e tij të shkruar me mjaft nuancime dhe të mbështetur në dokumenta të bollshëm e të panjohur deri më sot lëvizin ngjarjet dhe gurët e Atdheut, se populli është një. Para lexuesit dhe historisë dëshmohet për një dhembje gjithëkombëtare, tamam si do të vepronte ndonjë rilindës. Mu këtu qëndron edhe vlera e këtij libri.

Deri vonë na ka munduar një pyetje: ata që bënë luftën, a pajtoheshin me atë çka ofronte shteti ideologjik shqiptar? Leximi i vëmendshëm i librit nga kaptina në kaptinë, jep përgjigjen: Dogmën e vrazhdë të Moskës nuk e kishin pranuar një numër i madh i patriotëve e intelektualëve të ndërgjegjshëm, kur ata kuptuan lojën në kurrizin e një populli të varfër me pasoja tragjike: nuk dëshmojnë për këtë vetëm burgjet dhe kampet, por edhe reduktimi i kombëtares. Në koalicionin antifashist, shqiptarët u nisën: së pari për lirinë dhe bashkimin

kombëtar dhe për ndërtimin e shtetit sipas kodit shqiptar; së dyti, shqiptarët bënë luftë edhe për lirinë e të tjerëve, pra për triumfin e njerëzores mbi të keqen, se kjo nuk i kërcënonte vetëm shqiptarët.

Mirëpo ato që ndodhën më vonë ishin ngjarje të dhembshme, zhgënjyese; për pesë para na ishte bërë krenaria dhe dinjiteti ynë, serviliteti e poltronizmi kishin shuar gati edhe atë grimë burrërie që na kishte mbetur. Në emër të ideologjisë despotizmi i egërsuar kishte fshirë edhe besimin në mes njerëzve. Kështu Shqipëria vinteshkonte gjithnjë e më e frikësuar, më e burgosur dhe më e përgjakur, duke humbur vazhdimisht diç udhës.

Dhe këto çarje e tmerre i hasim nëpër faqet e “Ringjalljes”.

Librat e tillë grithin ndërgjegjen jo vetëm kombëtare, këndellin dhe lirojnë qenien nga e keqja, kontribuojnë për rindërtimin e shoqërisë dhe shtetit shqiptar, hapin horizonte të reja të tolerancës e mendimit plural shqiptar; mbrojnë qenien nga shfaqjet e ndryshme ideologjike; ngrisin moralin dhe kurajon qytetare. Po ashtu, realizimi i paqes kombëtare e njerëzore dëshmon më së miri se shteti ideologjik ishte më së paku shtet shqiptar.

Me tekstet mbi masakrat e likuidimet e panumërta në hapësirën shqiptare, me ofrimin e dokumentacionit të bollshëm mbi shkatërrimin e jetës materiale dhe shpirtërore - nga tempujt e besimeve tona e deri te zhdukja e patriotëve e intelektualëve idealistë ndaj kauzës kombëtare si dhe atmosfera e zymtë në to - Uran Butka e lakuriqoi diktaturën, e cila ishte bërë e frikshme mu përmes krimeve, dyshimeve dhe pabesive.

Ky libër, ndoshta, paraqet vetëm një pjesë të vogël të historisë së tmerrshme pesëdhjetëvjeçare të diktaturës. Por edhe nga kjo që shfletojmë, konkludojmë se fatkeqësia kombëtare nuk ka qenë aksident i rastësishëm. Mu për këtë, të bëmat e diktaturës duhen lexuar, para së gjithash, si turp nacional.

Vërtet çfarë ishin themelet e atij shteti ideologjik? Këtë shkrim dua ta mbyll me një ngjarje rrënjëthënëse, që nuk lë vend për iluzione dhe amnistinë aposteriori historike të tipit ‘kohërat dhe rrethanat kanë qenë të tilla’. Këso iluzionesh ende hasen tek-tuk, sidomos në

Kosovë. Krimet nuk vjetrohen. Libri i Butkës dëshmon një ngjarje si vijon: në praninë e vetë shqiptarëve, diku në Devoll, që njihet për burrëri, Dushan Mugosha, i ardhur me mision “internacionalist” nga hapësirat e ish-Jugosllavisë kishte rjepur një djalosh 16-vjeçar. Atë e quanin Ali Mustafa Lumi. Përmes dokumentit, autori i librit na thotë: “Me majën e thikës ai (Dushan Mugosha) ia preu lëkurën në kërcirin e këmbës së majtë, siç bëjnë me berrat kur i rjepin, e më në fund, ia shoi cigaren në bebëza të syrit. S’u ngop, dy plumba kokës mbi trupin e tij të pajetë!” Këtij vëllami të “xhaxhait” e “internacionalisti” të Kominternës do t’i kishin lakmi edhe “tigrat” e sotëm të Arkanit dhe kriminelët e tjerë nga Bosnja.

Pra, e tillë ishte Shqipëria. E prerë në besë...

Libra të tillë do të ketë edhe më shumë për shkak të tërmeteve të mëdha që ndodhin brenda e rreth nesh. Por kam frikë se *skajshmëria* e fakteve mos na shpie tek një diferencim i ri brenda kombit dhe, ndoshta, mundëson shfaqjen e neokomunizmit. Atëherë prapë shtegtim i ri për të gjetur të vërtetën nëpër arkiva e dëshmi të gjallësh e të vdekurish.

Në cilën dritë duhet ta shoh tani figurën e Bajram Currit, kur po del se ata (bajraktarët, ca dhe të nderuar tani) që Plakun e Maleve e kishin shpënë në vetëvrasje, na qenkan pak më ndryshe seç lëvizin të zymtë në poezinë brilante të F. S. Nolit kushtuar tribunit popullor? Apo, tash e pas, a mund të pajtohemi se ajo që është thënë për familjen e Kryezive nga Gjakova, paska qenë lajthitje; rrenë na qenkan edhe dokumentacioni i arkivave të fqinjve? Vërtet, si të shkruhet historia dhe nga të nisemi?

Ndjej se ajo, megjithatë, na është më e plotë: se jeta ndërron në të mirë të kauzës sonë, se është koha për të kapërcyer hendeqet jo vetëm brenda nesh.

(1996)

SHPIRTI YNË I VOGËL

NJERIU-KUKULL: Ndodh që një poezi të mbahet në mend për një varg a nocion, të kthehesh nganjëherë tek ajo për të vjelë edhe ndonjë kuptim tjetër. Kur nuk dihej në zgjohej apo rrënohej Kosova, Milazim Krasniqi kishte botuar një poezi me titull pakëz nevrrik “*Antipoezi*”. E kishte vënë në librin e tij të parë “*Imazhi gri*” (1982), po ashtu me një titull mjaft të zymtë për kohën kur e shihte dritën. Ajo poezi kishte zgjuar asociacione nga më të skajshmet. Të zakonshme, të përditshme, të eksploatuara aq shumë në letrat shqipe, por të qëlluara në një tekst, të dy fjalët *Poeti* (lexo: edhe *kukull*) dhe *Reklama*, jehona e saj pas një recitimi të një antipoezie, që ajo ka mundur të jetë edhe një shqerrje, kishin prekur sedrën e mentalitetit tonë, malokhanen të mësuar me një kreni të rreme. Shqetësuese ishin ato, posaçërisht për mediokrit, të cilët tek bënë alpinizëm letrar.

Në figurën e *Poetit-kukull* “të veshur me seksipallto/farmerka texas e me një këmishë brilantine... me ato duar plastike” receptori, ndoshta veneronte ngecjet, ose lexonte apo vazhdonte të lexojë shkaqet e pakënaqësisë së vet gjatë ngjitjes së tij lartësisë së imagjinuar. Dhe, mbi ato dy fjalë qëndronte një buzëqeshje e ngrirë, e cila u jepte një peshë dhe i dallonte nga përdorimi i tyre i përditshëm. Ç’u desh ajo Kukull-njeri kur në Kosovë rrëshqiste dheu nën këmbë?

“Antipoezia” ishte lexuar si antireklamë e vlerave shpirtërore, jo si një ironi ndaj asaj që zvetënonte jetën nën “shkëlqimin e dritave shumëgjyrëshe”. Pra, poezia ishte, thjesht, një ironi ndaj ekspozimit të të porealizuarve në art e që pudroseshin. Edhe ca poezi të mia kishin përjetuar të njëjtin fat. Keqinterpretimi i tyre më kishte larguar nga ca miq. Mirëpo, madhështia e artit qëndron mu te shtresimi i tekstit, i cili i

mundëson receptorit të vjelë edhe atë që mund ta pikëllojë. “Antipoezia” e Krasniqit, nuk mendoj se është poezia më e mirë nga “Imazhi gri”, ta kujton ai sharmi i dy fjalëve: *Poeti* (lexo: edhe *kukulla*) dhe *Reklama*, që korrespondojnë brenda një teksti prej 14 vargjeve, të mbështjella me një buzëqeshje të ngrirë, pas një recitimi të një antipoezie, e cila ka mundur të jetë, ndoshta, *vetëm* një shqerrje. Se Njeriu-kukull apo Poeti-kukull, ishte apo nuk ishte një trup i pashpirt, plastic - mbetet të kuptohet nga disponimi e kurajoja e receptorit.

Diç e rëndomtë, si mund të prekë sedrën e esnafit dhe pse?

Mbi ato dy fjalë buzëqeshja ishte ngrirë në një kohë, të themi, kritike për Kosovën, kur nuk dihej se njeriu ynë ishte vërtet kukull apo një qenie e gjallë, që mendon e vepron. Nga Kuvendi Federativ i ish-Jugosllavisë, deri te një zyrë fshati, atë mund ta lëvizte kush të dojë; tamam si një figurë shahu. E, çfarë kurajo qytetari mund të kishte “faktori” ynë, që diku në një sallë të atij Kuvendi bënte gjumë ariu? Posaçërisht gjumë të mirë bënte kur çështja shqiptare dhe e Kosovës nëpërkëmbej nga rrugaçëria shovene! Prandaj buzëqeshja e ngrirë mbi atë kreaturë mjerimi, që ishte përpjekur poeti të ironizojë, ishte një realitet i hidhur edhe për receptorin që nuk ishte mësuar të rrëzohet nga karriga. Fjala *Reklamë*, jehonë e asaj antipoezie, e recituar ndoshta në ndonjë hapësirë boshë, ose para karrigave të rreshtuara nga një dorë e padukshme, që pritej të zbriste edhe ndonjë M. Soresk, është produkt i asaj buzëqeshjeje të ngrirë, konceptuar si antireklamë ndaj vlerave të dyshimta, që bënin çmos për të pushtuar Panteonin e Madhështisë. Ja, pra, pse një poezi më se e rëndomtë, me një sharm gati të rëndomtë, me një fjalor të përditshëm, kishte nevrikosur esnafin krijues, që mendonte se kishte shkelur në Panteon.

REVOLTA E POETIT TË RI: Në një tregim Danilo Kish është i mendimit se krijuesit duhet botuar ashtu *bruto*, pa asnjë ndihmë redaktoriale. Në përpëlajtjet shpirtërore e mendore, nuk bën t’u përzihemi as fillestarëve. Shkrimtari i nderuar, me siguri ka pasur parasysh një mjedis pakëz më të kultivuar se një yni, bie

fjala, i Bajgorës apo i Bjeshkëve të Nemuna. Por nuk bën të harrohet: tradita përcakton deri diku edhe nivelin e shkrimit. Në fillim të krijimtarisë sime, nga redaktorët e mi të parë, hyra në fshehtësinë e laboratorit krijues. Përmes një lëvizjeje, apo ndërrimi të një fjale, vëreja se ajo lëvizje apo ai ndërrim fjale nxirrte një kreaturë më të përsosur. Dhe, ajo sa ishte dhunti, ishte edhe fshehtësi që krijuesi e hulumton. Më tepër për hir të artit, lëshohesha nganjëherë në aventurë dhe, posaçërisht, krijuesve të rinj u hapja ndonjë shteg të papritur. Akti i krijimit është punë individuale, por ndihma sado e vogël fillestarëve përcakton edhe fatin krijues, ndoshta të ndonjë gjeniu të ardhshëm.

Një poet i ri, i gjeneratës së Krasniqit, ishte revoltuar pse dorëshkrimi i tij nuk e kishte parë dritën ende. Dhe nga të revoltuarit ç'mund të presësh pos mllëfit: kishte shkruar një poezi ku, për afërsisht thoshte se, ekziston një redaktor që korr vargje. Pse ai redaktor hiqte të zitë e ullirit me dorëshkrimin e tij, e kishte heshtur. Poezinë e botuar e kisha lexuar dhe daktilogruar me retushime se, megjithatë, kishte nevojë. Me atë poezi kisha vendosur ta mbyll librin e poetit të revoltuar, i cili kur kuptoi gjestin tim, kishte kundërshtuar dhe këtë e bënte, si dukej, se ironia e tij nuk më kishte prekur fare.

Në Grevën e Urisë së "Rilindjes" (1993) me poetin e revoltuar, i cili tani është individualitet, kishim mbetur deri në mbarim të protestës - nuk kishim pranuar të na kthejnë në shtëpi para duarve. Kishim pasur kohë të zëmë ngoje edhe kapricin e tij: Pse kishte shkruar poezinë për redaktorin që korr vargje? Pasi më kishte dëgjuar me vëmendje dhe pas shumë kundërshtimeve, ishte pajtuar se krijuesve të rinj u duhen udhëzime.

Nuk di a është ligështi, por kokën në thes shpesh e kam vënë për disa krijues. Këtë nuk e bëja për patriotizëm, e bëja për shkak të dinjitetit njerëzor e krijues. Poeti i ndjerë Jusuf Gërvalla nuk është më në mes nesh, por nuk besoj se kanë harruar kurajon time Mustafë Xhemali, Adem Gashi e ca të tjerë. T'i kisha parë me një sy tjetër, dyert e redaksive vështirë do t'u hapeshin më. Dhe nuk di punë më të shenjtë a ka se sa të mbrosh krijuesin?

Ishte kohë e diktaturës. Nuk kursente as pjellën e vet.

MJERIMI YNË: Shpirti ynë i vogël, lirona nga vetvetja se na bëre qerpaze! Hasmi qenka tjetërkund dhe paska emër e mbiemër. *Mirë do të bëhet*, mashtroja veten në një poezi. Por nga duart shoh se më ik çdo gjë. E, kjo ndodh para syve të botës, para rezolutave ndërkombëtare e protestave të partive tona: Serbizohet Kosova, ngadalë e sigurt. Micsokolët tanë marrin ikën Evropës. Haimeve, stacioneve të metropoleve vazhdojnë të dëgjojnë shqip serbezovskët, ndërkaq krerët e partive tona të na bindin: *Mirë do të bëhet!* Tamam ashtu siç e mashtroja veten në një poezi... Shpirti ynë i vogël, na kthe shpinën, apo...

KUR TË IKIN BARBARËT

NGA TË GJITHA MURET ENDE NJË HIJONTE: Isha gjendur në mes mureve, që rrënoheshin një nga një, aty nën Sharrin antik. Binin ato nga urrejtja. Por një mur atje në fund të horizontit ende hijonte, në drejtim të të cilit isha nisur me vite. Dhe ai bëhej më i rëndë, më tragjik se muret, që binin para meje. Disi hija e tij e rëndë ma zinte frymën; fjalët që i thoja, m'i kthente të shurdhëta.

Muret janë të tmerrshme. Do vite e jetë të ngriten e të rrënohen. Derisa i shikojta ato si binin, isha gjendur para një muri, që nuk lëviz; hija e tij zgjatej nga aty e në Shkodër. Kisha prekur ballin, gishtërinjtë m'u kishin kuqëluar. A ishte ai vetëm gjaku im? Më ishte kujtuar Kavafisi.

SHFAQJA E BARBARËVE: Sipas shkrimeve të vjetra, fiset ilire, veçmas mollosët (nga këta thonë se ishte edhe Leka i Madh) e që shtrihen përgjatë kufirit heleno-ilir, i konsideronin për fise barbare. Me këtë emërtim helenët kishin pagëzuar më vonë secilin armik që shfaqej rreth qytet-shteteve e që nuk përkonte me besimin e tyre. Ashtu i quanin edhe persianët, romakët, turqit. Kuptimi i parë dhe i vetëm i këtij nocioni mbet diçka e *egër*, përbuzëse, shkatërruese.

Poeti i njohur grek Konstandin Kavafis, i lindur në shekullin e kaluar në anën tjetër të Mesdheut, në Aleksandri, në vitin 1904 shkroi poezinë e njohur "*Duke pritur barbarët*", syzheu i të cilës është aktual dhe mundëson interpretime të nduarnduarta edhe në ditët e sotme. Aty nuk më sfidon vetëm qëndrimi kritik i poetit ndaj një pjese të historisë së popullit të vet.

Me përqafimin e bizantit, sidomos "të hibridit ideologjik", siç theksohet nga njohësit e artit të tij, nisi rënia e helenizmit, kohët e lavdishme mitike. Muzgu njerëzor u shfaq: apetitet për të grabitur e shkatërruar çdo gjë që nuk është *imja*. Në momentin e sotëm nga kjo poezi e Kavafisit më intereson emërtimi *barbar*, përmes të të cilit

vijëzgjor edhe barbarët e rinj, që zbritën nga shkurrat e largët dhe në hapësirën e poezisë jo vetëm shqiptare, hynë më të egër - shkatërrues gjati të çdo shenje të autoktonëve. Pra, shfaqje e rëndë e amoralitetit dhe paranojës.

BARBARËT NUK ERDHËN: Atmosfera festive, që jepet në poezinë “Duke pritur barbarët” paralajmëron ndërrime ekzistenciale që priteshin të ndodhnin ndoshta jo vetëm brenda qytet-shteteve greke; vënia e rendit dhe kontakteve në mes njerëzve dhe kulturave. Pritja madhështore, që u bëhej të ashtuquajturve barbarë. Dhe përmes shqetësimit, lëvizjeve dhe hamendjeve të qytetarëve jepet edhe bota shpirtërore e atyre, që priteshin në çdo moment të dukeshin. Ata do të sillnin veset e ligjet e tyre; do të sillnin edhe shumëçka tjetër. Përditshmëria e qytet-shteteve do të pësonte një ndërrim të dukshëm në çdo fushë jetësore.

Por barbarët nuk erdhën. Diku në mes udhe mbetën, apo në ndonjë ep. Prandaj zhgënjimi cazë ironik: *Po vallë tani ç’do të bëjmë ne pa barbarët?* Pyetje kjo që e shtronte gjati çdo qytetar grek, i cili kishte dalë për t’i pritur ata që nuk dukeshin. Një pyetje e tillë mund të shtrohet nga secili, pas çdo cirkusiade njerëzore, në cilëndo kohë. Pritja madhështore e helenëve tek portat e qytetit, lë të kuptohet se barbarët nuk ishin një kolektiv çfarëdo.

Shtresimeve të kohëve, po të zbresim, të ndalemi tek një kohë më e hershme, bie fjala, tek ajo e Homerit, Herodotit apo Eskilit, do të vërejmë se të ashtuquajturit barbarë sillnin brez pas brezi një gjeografi të re e të begatshme kulturo-shpirtërore në hapësirën greke. Toponimet, veshjet, vallet, këngët, perënditë e deri te faltoret e famshme ilire. A mund të harrohet Dodona? Edhe Plaku i Vlorës me vjet kishte treguar interesim për të shpëtuar nga harresa faltoren me namë. Më vonë populli e historia greke do t’i pranojë shumë luftëtarë të “barbarëve” edhe për heronj të vetë kombëtar. Pra, barbarët, që kishin dalë t’i prisnin sa e sa herë para portave të qytet-shteteve, ishin fise dinjitoze, fatkeqësisht fatprerë. E çonin jetën në majë të kalit, duke mbrojtur skajet e Atdheut nga grabitjet e fqinjve.

LIRIMI NGA QYTETËRIMI I SHKURRES: Diçka tjetër tani ndodh me barbarët e rinj. Askush nuk u bëri pritje. Zbritën me topuzë e thika, duke shuar vatra të qytetërimeve të hershme; filozofinë e shkurre duke ua imponuar të shkelurve. Dhe synimi i tyre i vetëm mbeti: shtrirja sa më e thellë në toka të huaja, por dhe dëshmim i rrejshëm para botës se gjoja na janë popull autokton e me një traditë të begatshme kulturo-historike. Kështu, pastrimet etnike, tensionet ndërnacionale, pabesitë, mashtrimet, frikacakllëku, si trimëri e qiellorëve, nga dita kur Car Llazar kishte vendosur të shpërngulet nga dheu i Kosovës, dhe rrena si filozofi jetësore-kombëtare për të ngadhënjyer, janë ca nga “perlat” fisnore të shkurre.

Kavafisi i ardhshëm mund të jetë edhe shqiptar. Në poezinë e tij nuk do të ketë atmosferë festive. Se shkrimi (yni) del nga tymi dhe Njeriu do të vazhdojë leximin e *Librit kushtuar tymit* (Pashku). Me siguri ai do të dëgjojë edhe këngën e një Lili Marleni tjetër. Me të tashmen do të komunikojë dhe pyetja e tij më ekzistenciale, e cila do të jetë: *Barbarët kur do të na lënë të qetë?* Do të bëhet refren ky jo vetëm i leximit të dhunës nga lexuesi shqiptar. Vizioni i tij: Lirimi nga një qytetërim i shkurre.

NDONJË PËLLUMB I EGËR: “Duke pritur barbarët” mirë do të ishte të lexohet në mënyrë kolektive, si nga shqiptarët, ashtu dhe serbët, besa edhe nga ballkanasit e tjerë, të shohin ku ishin e nga shkojnë. Por Kavafisi moti nuk është. Shqetësimi i tij na përcjell në jetë. Vërtet, a gabo i që barbarët nuk i la aty ku ishin, në majë të kalit të ndjekin, ata që ua vjedhnin Atdheun nëpër duar, apo vëllazërinë në mes popujve e shihet si një komunikim të domosdoshëm?

Pas kisha lënë muret e rrënuara nga urrejtja. Pika e gjakut në lule të ballit ma ndriçonte udhën që shpiente te muri i fundit, i cili hijonte mbi gërmadhat e shekullit, qetësinë e të cilit nganjëherë e prish ndonjë pëllumb i egër...

PSE NUK SHKRUAJ POEZI DASHURIE

E kam një mik në Tiranë. Ai është Edi Rama. Sa herë takohemi, më thotë: Po qe se nuk shkruan edhe për dashurinë, nuk të pranoj si poet. Edi është piktor, para së gjithash. Ka një perspektivë të ndritshme. Për herë të parë punimet e tij i pashë në një galeri të arteve në Augsburg të Gjermanisë. Ishin fate të paidentifikuara njerëzish, të thëna përmes një gjuhe simbolike. Ishin ato një simbiozë e çuditshme e postsymbolistëve evropianë. Lëvizjet dhe tonet e ngjyrave ta kujtonin Shagalin. Qasje e re vërej edhe në prozën e tij: një ironi e hollë, asociative nga më të guximshmet. Deri diku ajo fërkon me botën orveliane: personifikimin e njerëzve me kafshët, gjegjësisht me peshqit. Mirëpo, Edi, shquhet edhe për shkrime diskursive: ka një guxim prej intelektual. Është i pakompromis. Ka sharmin e një Konice.

Një ditë sa kisha arritur në Tiranë, dëgjova se Edi ekspozonte. Kushedi e sata ishte ajo ekspozitë. Nxitova të shoh se ç'shpaloste miku im. Ajo që më ra në sy në aktet e ekspozuara, që vizitorët i shikonin me një kërshtëri habitëse, pashë se Shqipëria nuk ishte më vetëm tokë “muskuloze”, e ashpër; kishte nisur të zdeshet, një lirizëm me një dhembje t'ia mbështjellë trupin, por duke ruajtur harmoninë edhe në mes të vijave të reja. Diktatura kishte mbetur vetëm si një hije që dilte nga horizonti. Diçka e tillë ishte pritur. Shqipëria zgjohej nga një ankth, fitimtare dhe, siç thotë Kishi, historinë e shkruajnë fituesit. Nga ata është edhe miku im. Pas bisedave, deri vonë, i them; Kosovën unë nuk mund e zhvesh. I ka të dërrmuara gjymtyrët, buzët të përgjakura, sytë plot tym e lotsjellës. Nuk di ku t'ia nis: për varre të reja e më të reja, apo për një buzëqeshje të vyshkur në buzë të një femre, që digjet diku, duke pritur të dashurin e vet. Për një moment Editiu fik buzëqeshja. E tmerrshme është kur njeriu e humb lirinë.

Shpesh mendoj: në një kohë kafkiane, kur çdo gjë gati është shuar, a mund të jetë poezia një qiell qiqër? A mund të mashtroj veten ende, se jetoj i lirë, kur liria ime nuk vlen më as për pesë para, kur ajo më gëlltit vazhdimisht dhe më tmerron me atë varfërinë e saj? A keni harruar të riun e vrarë para stacionit hekurudhor në Tivar? Në pikë të ditës, në midis të qytetit, pushtetari nxjerr revolen dhe qet në të riun pse ishte shqiptar. Dhe, çfarë coincidence: shqiptari nëse vritet diku në Mal të Zi, ai *patjetër* duhet të jetë Tivari. Po ashtu, di se rrena është kategori filozofike. Në raste të caktuara, ajo arsyetohet (Platoni), por tjerja e saj a mund të vazhdojë në pambarim? Pushtetari përditë na ofron më të keqen nga më të këqijat: vetëshkatërrimin, vetasimilimin, vetëvarrimin. Dhe, çdo gjë ndodh hapur, publikisht, në emër të një ligji që e ka sjellë topuzi. Plaga, pra, është e hapur, kullon, tmerron. Në momentin e pikërishtëm, a mund të jetë arti një kuti e mbyllur, kashelashë, barok?

Para meje ngritet problemi: 1) Përditshmërinë ta pranoj si realitet të vrazhdë; të pajtohem me fatin apo ta grith-pinceta krijuese ç'të zgjedhë nga moçali i tmerrshëm i dhunës dhe 2) Ç'formë t'i jap: e hapët të mbetet poezia apo e mbyllur? Nëse ndjek udhën e mbylljes, do të thotë se protesta ime është e shurdhët, në një farë mënyrë, fsheh krimin dhe padashje, siç do të thoshte Brehti, dal në anën e pushtetarit. Koha është "mishi" i çdo krijimi, ajo nuk bën të kalohet edhe nëse paguhet me kokë. Një detaj sado i vogël në një cep të krijimit, duhet të kapet, se nuk mund të jetosh jashtë asaj që po ndodh.

Vetvetiu hapet çështja e lirisë: *Dashuria* a mund të ekzistojë pa liri? Historia dhe urtia e popullit na mëson se dy gjëra të shenjta e fisnikërojnë njeriun: *Liria* dhe *Dashuria*. Ato nuk mund të jetojnë ndaras. Dhe ai që këndon për lirinë, ka kënduar edhe për dashurinë. Pushtimi i hapësirës së lirisë, mundëson triumfin e dashurisë. Unë a kam liri në momentin e pikërishtëm, historik për qenien shqiptare, do të thosha? Se, përpjekjet e mia të vazhdueshme për të ekzistuar dhe për të dalluar nga kafsha, që ma imponon topuzi i pushtetarit, tregon bindshëm se liria ime është në tetik, pra edhe ekzistenca, jo vetëm e individit. Ndërkaq, kohë e Serembes dhe e Lasgushit nuk mund të

përsëritet më. Dhe a bën të harrohet kërcënimi bizar i ministrit të Punëve të Jashtme të Ruisë Cariste? Ndjenja e inferioritetit pansllav ndaj qytetërimeve të vjetra po bëhet e tmerrshme. Nuk është çudi, që pas një kohe, edhe serbët ta shpallin veten me rrënjë ilire, por për arsye të pazbuluara ende, fisi i tyre hamendet, fatkeqësisht.

Megjithatë, shoh se më ka marrë malli edhe mua të shkruaj poezi dashurie, çfarë ma preferon miku im nga Tirana, Edi Rama. Por ekzistojnë edhe arsye të tjera e, para së gjithash, problem kyç janë *fjalët*: çiltërsia dhe butësia e tyre. Nuk mundem të manipuloj me ndjenja, pra as me idealin tim.

E, një poezi dashurie nuk dëshiroj t'i ngijaj një torzoje në shi, i cili nuk ka të pushuar. Do të ishte edhe një vdekje më shumë.

(Prill, 1994)

KOSOVA NË LINDJE TË SHQIPËRISË

TAKIMI I UDHËVE

Pikërisht kur binte Muri i Berlinit dhe kur katër poetë nga Kosova pëshëndetnim me një telegram Kancelarin Kol për ribashkimin e Gjermanisë, një grup marksist-leninistë kosovarë, para kamerave TV dhe Murit që rrafshohej me tokë, nxirrnin klithmat e fundit të një epoke dinosauri që perëndonte. Kundërshtimi i të gjorëve ishte më se qesharak. Gjermanët mund të shtronin pyetjen: Po ç'do të bënin këta të marrë kur të rrënohet edhe Muri i Arbërit? Të gjorët e mi e kishin humbur veten.

Unë vazhdoj të ballafaqohem me *Murin*, të cilin e lexoj si tragjedi kombëtare dhe i cili më ndan nga çdo gjë imja. Nga dita më ditë, atje nga Maja e Pashtrikut merr pamjen e një përbindëshi nën kthetrat e të cilit vazhdon të rrokulliset koka ime deri atje buzë Llapit. Ndoshta, dikur vonë, pas tërmeteve të mëdha në dheun e çudive, pas shumë e shumë vjetësh, dashnorët e Besianës do ta gjejnë në një lule para se ta këpusë një dorë e panjohur.

Ngritjen e mureve Kavafis e shikonte si diçka të tmerrshme. Fatkeqësi njerëzore: “Nga bota tinëzisht më ndan përgjithnjë” (përkth. Kadare). Shembja e tyre, pra është shembje e fatkeqësive, e ideologjive, e hasmërive, është triumfi i lirisë.

Simboli i së keqes ra, pra, mu në Berlin.

Në njërin nga restorantet e bukura e të shumta që i ka Tërana, aty diku në hijen e pishave e që nuk mund t'i nxjerr nga mendja, pi kafe me ca poetë, të cilët i çmoj dhe i kemi botuar pse e meritojnë. Para nesh ca krijues, siç më tregonin e për të cilët nuk kisha dëgjuar as lexuar gjë, se ç'na prishnin imazhin e demokracisë, duke marrë botën nëpër këmbë e që m'i kujtonin ca skriptorë të kafeneve tona. Nuk ishte hera e parë: përcjellja ishte gati rutinore. Për ne të këndejmurit, vështirë është të gjendesh në një mjedis që sapo zgjohet nga një kllapi gjysmëshekullorë e që për të gjitha të këqijat fajëson edhe vëllain. Gjithë ajo që shpaloj para meje ma kujtonte një thënie të një plakut të urtë: Tre shqiptarë formojnë katër parti, tre anglezë sjellin botën në gisht, ndërkaq tre gjermanë mbajnë një fron, tre italianë ndërtojnë një shtëpi e tre sllavë formojnë një qeveri!

Një të madhi i thashë pastaj: Unë nuk kam aq shumë shqiptarë për të humbur, as nuk mund t'i humb Kadarenë, Agollin, Arapin, Spahiu. Të vetmit gati janë ata që ende kujtojnë Kosovën e dërrmuar. Dhe vëreja se nocioni *demokraci* ishte kuptuar mbrapsht, si hakmarrje. Shumëçka bëhej siç do të bënte një dogmat i përbetuar apo siç veprojnë ca imbecilë të kafeneve të mjerimit tonë. Të gatshëm për të shkelur edhe nëpër kufoma. E dihet: Në mjedise të qytetëruara, vlerat mbrohen, respektohen e avancohen.

Gati më kishte zënë gjumi në një kënd të bibliotekës familjare diçka kur u thye në mua. Në dritaren time m'u bë se dëgjova refrenin e famshëm: *Kurrë më* të "Korbit" të E. Alan Posë që rastësisht e kishte qitur udha sketerrës së Kosovës. Pas përpëlitjeve e hamendjeve mora diku veprën e Adem Demaçit. pastaj të Kasem Trebeshinës. Shpaloja fytyrën e fatumit dhënë nga dy figura mjaft karakteristike të rebelimit tonë e që i kap nga dy skaje: *ekzistencial* dhe ai *kundërdiktatorial*.

DEMAÇI: Është e vërtetë se Demaçi u shfaq në kohën e diktaturës dhe kur dogma na ishte shndërruar në ideal. Por rruga e tij kishte kahje tjetër: *Zgjidhjen e çështjes nacionale*. Hija e ideologjisë mbi kokën e tij i rri si një fatkeqësi që do ta përdornin pushtetarët për kompromitimin e lëvizjes. Të njëjtën gjë e përdor edhe regjimi i sotëm

militar serb ndaj partive tona. të cilat i shpall para botës si parti ekstreme, secesioniste e deri tek ato terroriste (!). Çfarë bindjeje politike dhe se çka e kush është, deri diku enigmën e zgjidh vepra. Nga vepra Demaçin e shoh si personalitet që më vete ngërthen pastërtinë e guximin e njeriut që vinte nga një vis i trazuar e i largët i atdheut, siç është Llapi.

Mbi një tekst kënge mbi Murat Gjakën, thurur nga këngëtari anonim, kisha zbuluar pëllëmbë për pëllëmbë Llapin, kur tërhiqja paralele në mes tij dhe Demaçit. Kontinuiteti ekzistonte, dhe zgjidhja kombëtare nuk është çështje dite. Liria humbet lehtë, por breza c breza duhet ta kërkojnë më pastaj. Rruga e fitores. për Demaçin është udhë e maratonit. Në krye do t'i dalin ata që i mban fryma. Mu për këtë, ai edhe kundërshtohet shpesh. Por lavdia nuk fitohet brenda nate, siç mendojnë ca kameleonë të galerisë: është në kundërshtim me logjikën e rebelimit, idealit. Për rilindësit, moto ishte: Kombi mbi fe e parti. Kësaj udhe vete edhe Demaçi. Rrugë e vetme e popullit tonë është opcioni demokratik, u deklarua haptas ai. Një gjë të tillë me zë të lartë, ende unë nuk e kam dëgjuar nga të kuqtë të themi. Gabimi i Demaçit është se ai vonë e kuptoi lojën e intrigës që është kryesorja në politikë.

TREBESHINA: Ndërkaq, Kasëm Trebeshina kishte probleme të tjera. Rrënimin e diktaturës. Ai nuk është i *paatdhe* si Demaçi. Por edhe Trebeshinës i mungonte liria, paqja shpirtërore e sociale. Dogma sillave ishte bërë aq e shijshme sa kishte depërtuar në të gjitha poret e jetës shqiptare, ishte bërë mënyrë jetese: Çdo gjë duhet të *jetë një*. *Njëshi* nuk bën të jetë plural. Ndikon në prishjen e ekuilibrit kombëtar. Ishte futur frika se shkëlqimi e liria e oksidentit do ta gëlltisë Shqipërinë. Prandaj jeta duhet të fillojë vazhdimisht nga - *njëshi*. Trebeshina e shihte se Atdheu kishte rënë në gjunjë. Protesta, jo vetëm e tij, rritej e bëhej më e tmerrshme për veshin e shurdhët të *Majës*. Udhë prej intelektualit e krijuesit e Trebeshinës shpie tek ajo frika e Faik Konicës, se Shqipëria duhet ruajtur nga shqiptarët.

Të gjitha burgimet e popullit, pra, ishin dyfarëshe, që duhet parë ato, para së gjithash, nga rrafshi i atdhetarisë.

KOMDEMET: Në kohën që po përbirohem me nga një kore buke e fletore nënsjetull, fundi i së cilës nuk po i shihet ende, është kohë ideale për ata që në gjak e kanë mimikërinë. Guximi njerëzor dhe dinjiteti do të *paguben* edhe më. Në të përditshmen “Bujku”, para një kohe lexova vargjet e A. Zenelit, me një pagëzim sinjifikativ *Komdem*. Nënteksti ishte i qartë: Ai që ka vjedhur në kohën e komunizmit, në emër të patriotizmit do të vjedhë edhe në demokraci e nuk do të kesh guxim t’ia tërheqësh vërejtjen nga profesioni “patriot”! Siç shkilet rruga, komdemët janë racë e re e shqiptarisë. Na mbetet ta kërkojmë fatin edhe në Rrethin e Nëntë të Ferrit. Dhe përderisa të hijojë Muri tragjik atje në Majë të Pashtrikut ne gjendemi të mbërthyer. Edhe ky është një rrëfim nga Burgu.

Zoti na pastë në dorë. Fundit a po i afrohemi?

(1994)

SKICË PËR PORTRETTIN E MIKUT

Shpesh kam menduar si të shkruaj për Bekim Fehmiun. Dy janë arsyet kryesore: 1) Ai u shfaq kur rreth nesh ekzistonte një perde e hekurt dhe 2) Talenti i tij prej artisti e njeriu afirmoi qenien tonë kombëtare, pa marrë parasysh se në filmin shqiptar mungoi prania e tij. Një gjë e tillë kishte ndodhur edhe me Aleksandër Moisiun. Por asnjëri nuk kishin hequr dorë nga identiteti e origjina e tyre.

Bekimin e kam edhe mik të moçëm. E njoh pakëz më herët se kur një mik yni i penës kishte shkruar në “Zërin...” e orëve të hershme: *Mbajeni mend këtë emër!...* Aktori ynë bënte hapat e parë në skenën e Teatrit Popullor të Kosovës. Gjatë viteve ‘80, atë e kisha më shumë se mik. Më ishte gjetur në momentin më dramatik kur bëja çmos të shpëtoja Lumin. Katër vjet kishim vrapuar nga spitali në spital, rrugëve të ftohta të Beogradit. Dikur kthenim në shtëpinë e tij aty në Tashmajdan.

Te Bekimi nuk kisha parë vetëm një artist të formatit të madh, një talent që kishte bërë inferior tërë një popull megaloman e idhnak, i cili në mënyrën e vet ushtronte dhunën ndaj të tjerëve që dëshmonin me vlera e guxim qytetari, por edhe njeriun dinjitoz që nuk gjunjëzohej para të papriturave. Bekimi besonte në të ardhmen se në vete kultivonte një filozofi: patjetër duhet ngadhënjyer. Etikë kjo e njerëzve që kanë besim në rrugën e vet, edhe pse në atë udhë mund të jenë vetmitarë.

GJUHA E PENELOPËS DHE E ULIKSIT: Dhe kur biseda na zvetënohej. ndërronte temën se kishte plot ide. Dhe niste e shpaloste një jetë të begatshme filmi: rrëfente për udhëtimet e njerëzit që kishte takuar. Dhe vëreja se ajo që e thoshte, kishte një logjikë të fortë, një krenari edhe kombëtare. Xhirimi i filmave ku e kishte shpënë atë, i kishte mundësuar që jetën të mos e shikojë vetëm nga çatia shqiptare.

Një herë kisha harruar edhe brengën time, për një çast. Më kishte folur për origjinën e Irena Leleku (Lejleku) - Papasi, aktore në zë e viteve '70. Ajo kishte luajtur rolin e Penelopës në filmin-serialin "Uliksi" (1968) të Dino de Laurentisit dhe RAI I, ndërkaq Bekimi rolin e heroit më të shquar të antikitetit, Uliksin. Ky projekt filmor, ndër më grandiozët të kohës, ishte shfaqur e reprizuar disa herë, gati në të gjitha TV-të botërore. Por, se Irena ishte vërtet arvanitase, më kishte bindur edhe me fakte.

Gjatë pauzave të xhirimit të dy aktorët ishin tërhequr anash, kishin pëshpëritur diç në një gjuhë, që ekipin e serialit e bënte më kureshtar: ç'gjuhë flitnin Penelopa dhe Uliksi? Më vonë mjetet e informimit kishin zbuluar se rolet kryesore në "Uliksin" i interpretonin dy aktorë me origjinë shqiptare. Dhe, ndoshta, ata interpretonin një episod nga lashtësia e tyre.

Kjo ishte befasi e dorës së parë. Producenti Dino de Laurentis, në shtypin italian e kishte paralajmëruar si aktor me origjinë greke. Bekimi jo vetëm ndaj shtrembërimit të pahijshëm të këtij emri botëror, kishte kërkuar të demantohet, përndryshe braktiste xhirimin. Kishte ndodhur, po kjo, edhe në shtypin spanjoll. ku aktori ynë ishte prezentuar si jugosllav i amerikanizuar, pastaj ishte korrigjuar se Bekimi na është një shqiptar nga Kosova - Jugosllavia. Kishte pasur edhe kërcënime nga koproducenti i njohur amerikan Louis Gilbert se nëse nuk pranon të ndërrojë emrin dhe origjinën "Paramaunti" mund ta ndërrojë aktorin.

Mirëpo para këtyre kërcënimeve të nduarnduarta që shpeshtoheshin, Bekimi asnjëherë nuk u përlul. Profetizimi i producentëve botërorë se ky, si shqiptar, nuk do të ketë sukses, mbetën vetëm lajthitje të të "mëdhenjve" që kërkonin me çdo kusht të mposhtnin kurajon qytetare e kombëtare të atyre që vinin nga vendet e vogla e të panjohura, siç ishte Kosova. Po Bekimi mbeti ai që ishte: mbajti emrin që ia kishte dhënë babai, bashkëlufëtari i Bajram Currit dhe luftëtar për të drejtat nacionale, sociale e arsimore, nga Gjakova, i dëbuar nga regjimi i atëhershëm serb dhe i internuar në Sarajevë.

Në memoaret e veta, nëse do t'i kryejë ndonjëherë, me siguri mbi këto ndodhi e të tjera me shumë detaje të panjohura ende, ai do të ndriçojë edhe shumëçka tjetër mbi jetën, tepër të bujshme të një artisti. Në intelektin e fuqinë e rrëfimit të tij, unë kam besim dhe duhet të besohet, si në miqësinë e tij pa fije djallëzie. Ai nuk është aktor serial. Ka diç të veçantë, që figurën e tij e bën madhështore.

PUPLAT E FAMËS: Në vitet e '60-ta, kur nuk dihej asgjë për Kosovën e për ne (ndoshta pak gjë për Shqipërinë e brendshme, më tepër si toponim gjeografik - ylli i Kadaresë ende nuk ishte shfaqur), në qiellin e filmit botëror kishte filluar të xixëllonte një yll që ngrihej nga Ballkani i errët. Ai quhej *Bekim Fehmiu*, i cili nuk u shua as pas filmit "*Mbledhësit e puplave*" (1966) e profetizimeve nga më të ndryshmet, që kishin bërë rreth karrierës së tij. Para tij zunë të hapen portat e producentëve botërorë.

Rreth filmit "*Aventurierët*" - xhiruar në Evropë, Amerikë dhe në Amerikën e Jugut, tregohen shumë bëma. Në çdo hap mjetet e informimit kishin ndjekur aktorin tonë - nga flertimi i tij me aktoret e njohura amerikane deri te gjërat më të rëndomta të përditshmërisë së një ylli. Filmi kishte pasur dy premiera dhe të dyja në aeroplan. Të parën në xhamboxhetin 707 TWA - nga Nju Jorku në Los Angeles; të dytën tek kalonte oqeanin për në Evropë, ku çdo gjë ishte paralajmëruar me bujë. Në një lartësi të madhe qiellore, kur kishte filluar të shfaqej filmi, ishte alarmuar personeli përcjellës se në aeroplan ishte montuar një bombë. Bekimi vetëm kishte buzëqeshur, siç buzëqesh sa herë takohemi në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit: Nuk ka gjë, ne shqiptarët nuk na frikëson vdekja... kishte pëshpëritur. Një fat të tillë kishin pasur pas shumë vjetësh edhe poetët kosovarë në *Mbrëmjen e poezisë shqipe* në Shtëpinë "Ivan Cankar" në Lubjanë. Dhe projektimi i filmit kishte vazhduar, siç kishte vazhduar edhe mbrëmja e poezisë shqipe në Lubjanë. Pastaj ishte zbratur edhe shishja e fundit e shampanjës, diku në Evropë.

Në koktejin e mbajtur në hotelin "Pjer" në Nju-Jork për nder të aktorit tonë, ku ishte ftuar elita amerikane para të pranishmëve kishte shkaktuar habi veshja e Bekim Fehmiut alla konicqë; stilizimi i veshjes shqiptare, që të nesërmen gazeta e njohur "New York Post" kishte

bërë pyetje: Çfarë qëllimi kishte paraqitja e Bekim Fehmiut në veshje nacionale?

Në vitin 1992, kur Kosova kishte humbur në hijen e shkurses, Bekimi kreu së xhiruari filmin më të ri “Xhingis Kan”, regjinë e të cilit e bëri i famshmi Ken Eniken, i njohur edhe për filmin “Dita më e gjatë”, ku bëhet fjalë për zbarkimin e forcave perëndimore në Normandinë e pushtuar nga nazifashistët (1944). Reporter i lirë atë kohë kishte qenë Hemingueji, i cili kishte kaluar edhe pranë shtëpisë së Hajnrih Belit aty në Langenbroh. Në bazë të të dhënave të vendasve, në vitin 1994 kisha kërkuar gjurmët e autorit të romanit të njohur “Plaku dhe deti”. Më kot, Enikeni kishte lënë vetëm gjurmët e një filmi grandioz, siç ishte “Dita...” për të kërkuar pastaj me vite ekipin për filmin “Xhingis Kan”.

Tek ikja, për pak, nga zhurma e Alesë së Shpëtimtarëve të Kombit, takoj mikun tim të vjetër. Ne të viteve ‘36, jemi goxha burra, më thotë. Gazin e Bekimit e kisha kapur pa u fikur. Më një qershor mbushte gjashtëdhjetë, gjegjësisht katërdhjetë vjet të interpretimit në disa gjuhë. Ç’i uroj? Më kishte zënë pa tekst. Për afirmimin tonë pakkush bëri siç bëri ai, njëri ndër aktorët më të shquar pas Aleksandër Moisiut. Institucionet e Republikës sonë dhe mjetet e informimit vazhdonin të merreshin me do cikërrima neveritëse, me gjëra pa peshë. Ndërkaq të tjerët mendonin pak më ndryshe; gjermanët, bie fjala, kishin shfaqur një cikël filmash nga opusi i tij e ca radio të huaja kishin bërë fjalë në emisionet e tyre edhe për gjashtëdhjetëvjetorin e aktorit tonë. Mezi kisha shkoqur shikimin nga buzëqeshja e tij e ngrirë. Në “Galery” hymë, dhe në mënyrën tonë kremtuam një përvjetor, që nuk bën të harrohet.

SHKOLLË PËR BREZAT: Fatkeqësisht, gjithë kjo që ndodh në hapësirën tonë lë përshtypjen se pak bëhet për figurat që çmohen e nderohen edhe nga metropolet. Por ne, ndoshta, nuk do të ishim shqiptarë të mos na ndiqte fati tragjik që nga antikiteti ynë. Më 19 prill, presidenti Berisha bëri një gjest dinjitoz. Me “*Nderin e Kombit*” dekoroi tre emra të mëdhenj, që afirmuan qenien tonë kombëtare: Ernesto Sabaton, Ibrahim Kodrën dhe Ismail Kadarenë. Njëri, pra, ishte nga gjaku i shprishur. Megjithatë, simbolika ishte pakëz e zbehtë.

Mungonte ndonjë emër edhe nga Dardania e lashtë. E, në mesin e të dekoruarve mund të gjendej edhe Bekim Fehmiu. Thashë diku më lart se ky ishte një vetmitar në një kohë kur na kishin izoluar në mënyrë mjeshtrërore nga bota dhe i cili ndër të parët çau perden e hekurt rreth nesh.

Po ashtu, qëndrimi kombëtarisht, kodi i moralit të tij mund të jetë *shkollë* për brezat e ardhshëm: si mbrohet identiteti dhe origjina edhe në mes të leukonisë. Ndaluni pakëz te gjashtë mundësit shqiptarë, të veshur në petkun grek; luftojnë për t'ia ngritur namin Greqisë edhe në Lojërat Olimpikë në Atlantë të Amerikës, ku Bekimi nuk kishte lejuar mbi identitetin e origjinën e tij të shembet asnjë hije e keqe. Për të jetuar, thotë një i rebeluar, duhet më shumë forcë sesa për të luftuar.

Pakëz i vonuar është ky shkrim, por e ndiej veten të lumtur që kam edhe një mik si Bekim Fehmiun.

(1996)

VETMITARI I MADH NGA ULPIANA

SLLOGANI: PENDREK-DEMOKRACIA: Pikërisht në mbarim të muajit maj '89 arritëm në Bled. Na kishte ftuar PEN-i sloven në Takimet Ndërkombëtare të Shkrimtarëve: Dr. Ibrahim Rugovën, Shkëlzen Maliqin dhe mua. Na priti Jasha Zlobec, djali i mikut tim, Ciril Zlobecit, përkthyes edhe i dy librave të mi në gjuhën slovene. Imtësisht dija për të. Ai ishte i padëshirueshëm për qeverinë e atëhershme slovene. Disident, poet, estet e përkthyes i njohur. Pranë vetes kishte tubuar një numër intelektualësh, që shprehnin revoltën e vet ndaj çdo gjëje që censuronte lirinë e të menduarit. Me paraqitjet e tij, si në mjetet e informimit sloven, ashtu dhe në tribuna të ndryshme ndërkombëtare, kishte ngritur edhe çështjen shqiptare.

Pranë hotelit "Lev", aty në katin e dhjetë, më duket; i ati na ishte drejtuar tek na dëgjonte: Ti ma infektove djalin, kam frikë se do të humb një mik. Me të birin takoheshim më shpesh. Kishim bërë një udhëtim disaditësh me një grup poetësh edhe nëpër Dalmaci. Në anijen "Galeb", e cila ishte shndërruar në një anijemuze, kishim kaluar më së keqi. Për një fije floku të ndodhte më e keqja. Ditëve të tjera ai ishte fascinuar. I takonim shqiptarët gjithkund. Lobi shqiptar vepron për mrekulli, thoshte në gaz. Në Trogir kishte dëgjuar shumëçka për Andrea Durrsakun, Dalmacia e Dioklecianit tënd nuk jepet aq lehtë, e kishim mbyllur udhëtimin.

Në Takimet Ndërkombëtare të Shkrimtarëve në Bled bisadat ishin mjaft të nxehta. Për herë të parë intelektualët serbë dëgjuan slloganin Pendrek-demokracia serbe. Reagimi i tyre ishte qesharak, fluskë. Aty nuk ishim vetëm për të komunikuar me një botë të qytetëruar, por të mësonim diç edhe për përçarjet që thelloheshin në çdo rrafsh. Po si të dëgjohet protesta jonë rreth asaj që ndodhte në Kosovë?

ÇDO GJË ISHTE E LEXUESHME: Në bisedën e fundit kishim konkluduar sa më parë të botohet një fletushkë opozitare në gjuhën shqipe, ku, para së gjithash, të dominojë jo vetëm liria e fjalës. Në dy gjunj gati gjendej Jugosllavia. Ndërkaq, kroatët e sllovenët na konsideronin për krah të fortë në demokratizimin e shoqërisë. Pra, çdo gjë ishte e lexueshme. Regjimi monist më së paku na konvenonte se çdo gjë te ne përcillej përmes syrit sekret. Ramë dakord fletushka të nisë në Lubjanë. Me ca kundërshtime, atë e pagëzova “*Alternativa*”. Po kë ta vënim në krye? Sllovenët njihnin ca shqiptarë që punonin atje. Dikur u zu ngoje Sali Kabashi, përcjellës trenash - se në Slloveni ç’punë tjetër mund t’u besohej të dënuarve politikë nga Kosova?

JETA PA CENSURË: Pritej numri i parë i fletushkës. Dolën pastaj edhe shumë të tjerë. “*Alternativa*” u bë një abetare, tamam opozitare. Aty nuk kishim dorë vetëm ne, që ishim për opcionin demokratik të shoqërisë. Monopoli nuk ekzistonte, se nuk mund t’i merrej kujt e drejta për të mbrojtur lirinë e vet. Njeriu mund të përshëndetet me të kaluarën, vetëm nuk hiqet dorë nga ajo se nuk ka ekzistuar. Pala sllovene me Jashën, Petar Bozhiqin, Matjazh Hanzhekun, Dane Zajcin e të tjerët dhanë ndihmesë të pakursyeshme. Kështu, “*Alternativa*”, nga numri në numër pushtonte jo vetëm hapësirën shqiptare. Kërkohej nga të gjitha kontinentet, tirazhi i saj rritej. Kishte ide, guxim qytetari e intelektual dhe për herë të parë shqiptari fliste e lexonte pa censurë, ashtu siç e ndiente dhe e mendonte. Më shumë se një vit kisha ndihmuar Redaksinë. Ndjeja një obligim moral jo vetëm ndaj tanëve në Slloveni, që kudo ngritnin zërin për kauzën kombëtare, por edhe për shkak të miqve sllovenë që shtoheshin. Ashtu, ne hymë në një zjarr, të vetëdijshëm se mund të bëheshim edhe hi.

Në kohën kur gati nga të gjitha anët sulmohet, fyhet e etiketohet kultura, historia, etnosi, gjuha dhe qenia kombëtare shqiptare - kisha përshëndetur opozitën sllovene me një letër që mban datën 12.6.1989, Prishtinë - kur terrori i bardhë i unitarizmit bën çmos duke përdorur edhe metodat staliniane për t’ia ngushtuar hapësirën kulturo-historike dhe për ta shndërruar në një oazë të madhe vetmie, lajmi se në atdheun e Preshernit, Cankarit dhe shumë të tjerëve, do t’i

bëjë hapat e parë edhe një fletushkë në gjuhën shqipe, më gëzoi dhe, në këtë moment, nuk munda ta fsheh patetikën time për këtë gjest më se njerëzor.

Për një moment, lajmi më ktheu në kohë të kaluara dhe ma kujtoi Kopitarin e famshëm, i cili rrugëve të Vjenës me ditë e me vite i kishte dëgjuar këngët epike nga kurbetçinjtë e shumë shqiptarë që, si në ditët e sotme, i binin poshtepërpyetë Evropës për të ekzistuar e dëshmuar përkatësinë e tyre kombëtare. Dhe Kopitari nuk ishte i vetmi sloven që interesohej për kulturën, gjuhën, historinë e etnosin e popullit shqiptar. Ja, pra, pas sa e sa dekadash ajo dëshirë e tyre, ndoshta, që duhet kuptuar edhe si triumf të shpirtit demokratik të popullit sloven, bëhet një realitet: njerëzit dhe popujt mund t'i afrojnë vetëm mirëkuptimi ndërnjerëzor e ndërkulturor. Fatkeqësisht, në disa mjedise tona nocioni *demokraci*, shenjë e qytetërimit, u keqkuptua. Pse?

Dalja e kësaj fletushke në gjuhën shqipe më trimëron dhe më bën të besoj në lirinë dhe ekzistencën tonë të përbashkët. Përfundoja ngazëllimin tim se *Dezhela* disi u bë strehimore edhe e shumë refugjatëve tanë, që iknin nga syri sekret. Prandaj dhe respekti nuk mund të mbyllej ndryshe. Ideali, jo vetëm imi, ishte: të lëvizin gjërat, se hiya e kobit shtrihej vrap edhe mbi Kosovë. As sot nuk di për punën e bërë në “Alternativa” a është shpërblyer kush. Mua nuk më shkonte mendja, se lirinë nuk ka gjë që e paguan. Bashkë me Milazim Krasniqin, tërë natën kishim qëndruar në këmbë në “Akropolis”, për të marrë pjesë në përvjetorin e parë të saj. Ishte diç e pabesueshme, ndërronin gjërat brenda natës.

MUSTAKËT E SALIUT ISHIN PAKËZ MË TË MËDHA SE DUHESHIN: Në festën e madhe të organizuar nga “Alternativa” dhe shoqata “Migjeni” në sallën solemne të Lubjanës ishte kallaballëk. Pakkush nga ata përkrahnin opcionin tonë. Me Jashën isha ulur në fund të sallës. Përcillnim kreun që kishte zënë vend. Ca as vetë nuk e dinin si kishin arritur deri aty. Ne ishim përpyetur të bënim diç për rendin e ri dhe të iknim nga pika e vdekjes. Dhe për herë të parë kisha veneruar se Sali Kabashi i kishte rritur mustakët pak më tepër se duhej.

Prapë mbeta ai që isha. Jasha u emërua ambasador i shtetit të ri Slloven në Bruksel. Saliu u martua për herë të dytë dhe diku në Zvicër pret e përcjell koka të kombit, unë bëj luftën time të përditshme për të ekzistuar, aty diku në Ulpianë, i bindur se liria nuk është gjë që blehet as shitet në Pazar të Grave, apo të Kafshëve. Por kam frikë se do të përjetojmë një infarkt kolektiv. Organizmi që nuk lëviz, nuk di a mund t'i shpëtojë të keqes!

FATI I PËRBASHKËT

1.

Afritë e para të poezisë janë fërkimet me arte të tjera, veçmas me pikturën dhe muzikën. Dhe, në pikturat e miqve të mi, ajo që zbuloj është fascinuese: fati ishte i përbashkët. Në ngjyrat e lëvizjet, në tablotë, lexoja mesazhet dhe preokupimet që i thosha dhe më mundonin vazhdimisht, edhe mua, në poezi.

Deformimet shpirtërore e karakteret, nga nokdaunët e kohëve të liga, u bënë shqetësim, jo vetëm yni. Shpesh mendoj ç'iu desh filozofit francez A. Levi, të protestojë e të merret me atë që ndodh në Bosnjë? Por, ai nuk është i vetëm, se krijuesit e njëmendtë nuk i shqetëson rasti as fati vetëm i popullit të vet; se me vetveten merren vetëm mediokërit dhe ata që historinë e vet e shohin ishull.

Në vitin 1982, aty në Rrugën Rambuteau nr. 14 në Paris, në atelenë e mikut tim, Daut Berishës, vëreja se hapësira ishte bërë obsesion i tij i përhershëm. Muret që e rrethonin dhe e ndanin ishin po ato mure që na kishin bërë pikë e pesë në Ballkan. Dhe ngjyrat që i hidhte miku në tablotë, ishin po ai shqetësim, që e artikuloja në poezinë time. Por dallimi qëndronte: si thuhej.

Brenda një kohe të shkurtër, rastësisht ndoshta, në dy kafiteri tona, u hapën dy ekspozita të dy piktorëve tanë: Muslim Mulliqit dhe Engjëll Berishës. Hapjen e tyre e kuptoja si gjallim tonin, pas gjithë asaj që ndodh në hapësirën tonë të shturur. Dhe të dy ekspozitat sillnin një optimizëm para shikuesve, që lexohej më parë si revoltë e tyre intelektuale.

Të dy piktorët e nderuar i njihja ngaherë. Kisha përcjellë me vite lojën e brushës së tyre. Dhe, takimi i parë me ta: thyerjet e mëdha psikoetike të njeriut tonë, në ndërrijen time ishin fiksuar si diç

befasuese. Kujt nuk i kujtohen *Kullat e Junikut* të M. Mulliqit, apo *Medaljonet e Prizrenit* të E. Berishës? Të parat - të lidhura fort për tabanin kombëtar, për ekzistencën e mënyrën e jetesës sonë patriarkale; të dytat - pikasja e shpirtit tonë me plot elemente nga bota e folklorit. Por as Mulliqi, as Berisha jetën nuk e shikojnë nga jashtë, sipërfaqësisht. Trandjet e mëdha brenda e në karakterin e njeriut tonë u kapën, duke e shënuar edhe kohën. Vlera të pakontestueshme janë, po ashtu, *Portretet*. Ti kujtojnë ato të Modilianit të famshëm.

Mirëpo *Portretet* e Mulliqit kanë edhe diç tjetër: ngërçet e kohës sonë, nëpër të cilën kalojmë, shpesh edhe të përgjakur. Ngjyra e kuqe shënon krimin diku në hapësirën tonë. Krijuesi i ndërgegjeshëm nuk mund të shkëputet nga ajo dritë e lemeritshme, se nuk mund të jetohet jashtë fatumit njerëzor, asaj që ndodh; as nuk mund të pajtohet se asgjë nuk ka ndodhur.

Kështu, te të dy piktorët vërehet angazhimi i tyre maksimal rreth vijëzimit të kujtesës kolektive, por dhe të ndriçimit të shkaqeve morbide që na sollën në një situatë absurde. *Kullat e Junikut*, si dhe *Portretet* e Mulliqit, të cilat kanë si “pasion shprehjen e shqetësimeve shpirtërore me tematikë sociale e deri te ato socialo-kolektive”, tërheqin vëmendjen dhe na kujtojnë nga vijnë e shkojmë. Përmes simbolit të kullës dhe skicimeve të portreteve, që mund të jenë fytyrat e të afërmeve të tij, Mulliqi nxjerr zjarminë e brendshëm të njeriut tonë, në një kohë kur vështirë identifikohen gjërat. Ai e potencon këtë me ngjyra mjaft të rënda.

Në *Medaljonet e Prizrenit* të E. Berishës jeta jonë jepet më tepër përmes elementeve të përrallave, në to ka një lirizëm, janë pakëz neoromantike, por një punë filigrani, diç përralore. Disa nga ato u afrohen mjaft vitrazheve tona të hershme. Në kishën e Onufrit, në Berat, kisha parë shumë punime të tilla: si në drugdhendje, ashtu dhe në metalet fisnike.

Ekziston, pra, një fuqi, që i afron krijuesit - ai është fati i përbashkët njerëzor pranë të cilit digjemi dhe na bëhet dritë për ta kërkuar veten aty diku.

2.

Rast tjetër është fotografia. Por çdo fotografi nuk mund të ketë vlerën e vet. Çmohet ajo që ngërthen - shënon çaste vendimtare nga historia njerëzore. Ajo ka vlerë të posaçme, të pakontestueshme, që pushton edhe skajet më të largëta të globit. Se, edhe fotografia ka fatin e piktures: gjuhën universale, leximi është vizuel dhe mundësia për t'u kuptuar më lehtë.

Mesazhet e vjela varen nga përgatitja e receptorit dhe të kamerës, se ç'na ofron nga grumbulli i madh njerëzor. Derisa teksti letrar shënon lëvizjet, trandjet shpirtërore - njerëzore, fotografia ka një fuqi tjetër: alarmon opinionin, shkakton pakënaqësi, nxjerr mllëfin njerëzor.

Shumë të bëma në Kroaci e Bosnjë u zbuluan përmes fotografive, që i bënë fotoreporterët ose emisarët sekretë. Ka ndodhur që çmimi i një fotografie të arrijë çmimin e një pikturë monumentale.

Shtrohet pyetja: A kemi ne shqiptarët traditë të fotografisë? Kemi, por nuk ditëm ta vlerësojmë. Ato mbetën të shkapërderdhura. Pra, mungoi kujdesi ynë. Megjithatë, artisti ynë bëri nam edhe në këtë art më të ri. Nuk mund të harrohen shumë storie filmike nga e kaluara jonë, të cilat i shënoi me kamerë vllehu, Milton Monaki.

Pasuri të madhe na la edhe familja Marubi nga Shkodra, që fiksoi jo vetëm ndërrimin e brezave, por edhe atë që ndodhte në hapësirën tonë. Në vitet e pesëdhjeta, në Evropë e SHBA, bëri nam korçari, Xhon Mili. Shumë fotografi të tij morën dhenë. Ndërkaq, për shikuesin shqiptar mbetën të panjohura deri vonë. Është e dhembshme kjo, që publiku ynë shumë pakëz u kënaq me artin e fotografisë, jo vetëm të Milit.

Pakëz me vonesë, ndoshta, ky artikulum më i ri nisi të lëshojë shtat edhe në Kosovë. Gjenerata e Hazir Rekës, Enver Bylykbashit, Muharrem Mjekut, të prirë nga maestro Afrim Spahiu, bindën jo vetëm mjedisin tonë, se kamera dhe fotografia artistike e tyre bëhet një shqetësim i ri edhe për momentin e pikërishtëm. Vlëra kryesore e *Albumit "555" - kronikë e viteve 1981-1995*, të Ilaz Bylykbashit,

fotoreporter i të përditshmes sonë, qëndron në guximin e autorit, i cili fiksoi çastet më dramatike gjatë këtyre pesëmbëdhjetë vjetëve të historisë sonë më të re.

Libri, është botim i NBG “Rilindja”, hapet me ditën kur filloi rrënimi i Autonomisë së Kosovës, i cili ishte edhe rrënim i ish-Jugosllavisë, vazhdon me demonstratat e dënimit drakonike të studentëve, që u bënë lëvizje e ndëshkim gjithëpopullor. Shënon, pra, ngjarje të rëndësishme të ndërrimeve të sistemeve shoqërore - në kohën e katandisjes diktatoriale të kapura nga syri sogjetar i fotoreporterit. Dhe, shumë nga fotografitë e librit, që janë një klithmë njerëzore, tronditëse, nuk janë thjesht vetëm dokument historik të një kohe tmerri, pavdekësojnë një çast nga lëvizja kombëtare - nga më të mëdhatë në Evropën e Lindjes, kur shkurra ishte shndërruar në gangrenë të padiktueshme për zhdukjen e popujve të vegjël që nga koha e “xhaxhit” Lenin.

Fragmente individuale-kolektive lexohen si një mozaik fatësh të udhëtimit tonë rebelues. Fotografi këto të bëra nga gryka e pushkës. Zatën, të tillat kanë dëshmuar dhe kanë ndërruar opinione e sisteme. Tronditëse janë fotografitë e fëmijëve tanë të vrarë në ushtrinë e “vëllazërim-bashkimit” e nëpër kazamatet e dhunës. Dhe, duke i shikuar ato, njeriu lexon barbarinë e fundshekullit XX, të njeriut fisnor; se deri ku mund të arrijë urrejtja dhe ç’mund të bëjë një popull i pambrojtur, për lirinë e vet.

Kamera e Ilaz Bylykbashit ka shënuar edhe grevat e mëdha: atë të minatorëve të “Trepçës” dhe Grevën e Urisë të “Rilindjes” (kjo ishte e vetmja nga përpjekjet e intelektualëve tanë për të shpëtuar librin e shkronjat e gjuhës shqipe). Gjen në libër edhe fotografi nga shumë protesta popullore kundër dhunës serbe, e cila zbuloi fytyrën e djallit mu në mes të shqiptarëve për të thelluar krimin në Bosnjë e në Kroaci.

Shkallëzimi i dramës sonë është dhënë me sens mjaft mjeshtëror, deri te një politikë e jona paqësore. Të bëhet se Ilaz Bylykbashit asgjë nuk i shpëtoi për të dëshmuar nesër, se ç’ndodhi në

bisht të Evropës. Dhe kur mbyll këtë libër, nuk ke mbyllur dramën e popullit tënd plot klithmë e trauma - ende ajo vazhdon.

Libri është tronditës, siç është historia jonë më e re.

3.

Kam frikë se shek. XX e mbyllim me një imazh trishtues edhe për Evropën. Na josh bunkerizmi më shumë se fluturimi i zogut! Në hapësirën tonë ndodhin vandalizma të papara ndaj çdo gjëje. U shfaqën kapuçonë të natës. Pasionë farefisnore... Tek shikoj piktorin e publicistin e njohur Edi Ramën të përgjakur në foto, më zë ankthi. Nga e kaluara ende nuk qenkemi shkëputur! Në tekstin tim *“Fotografia që flet”* të botuar në “Bota sot” (Cyrih, 29 janar 1997) me dro shënova: Apo kujdes, përgjakesh edhe në demokraci kur prek në sovranitet...

Në shekullin e ri, trokasim athua si fis?

LIBRAT, FËMIJËT DHE DHUNA

KËRKIMI I POETIT: Pak qytete tona meritore kanë poetin e vet. Të kaluarën e tyre të famshme shpesh e mbështjell një boshllëk shpirtëror. Ose fytyrave, që bëjnë historinë, u japin forma e dimensione të qiqeve, që iritojnë çdo individ të mençur. Pse ndodh kjo me shpirtin e historinë tonë?

Udha kur më qet në Prizren, më rrok një ndjenjë e çuditshme: Si një qytet me aq nam në të kaluarën, nuk e ka poetin e vet! Krejt ajo që u tha për të, e thanë udhëtarët e rastit ose imagjinuesit fanatikë për të kaluarën, që nuk pranuan të humbet para sysh as një datë e figurë e historisë sonë. Bënë projekte me fantastike nga fjalët e idetë. Ndërtuan Prizrenin e Abdyl Frashërit, të zambakëve, të kalldrëmeve. Kjo ndjenjë më mundon edhe për Tetovën, që shtrihet përgjatë Sharrit antik deri te Gradeci ku, thonë, kishte lindur Vojsava, nëna e Skënderbeut. Një hapësirë dinamike, me një peizazh mahnitës, i ka munguar poeti i vet me vite, ose ai ishte ngatërruar nëpër fjalë, ëndrra e lëvizje marramendëse të një jete që shpaloste krahët.

Proceset që ndodhin, me plot të papritura, në hapësirën tonë të shturur, nga ndjenja e çuditshme që më frikësonte edhe nga vetvetja, kam filluar të lirohem. Jeta jonë, megjithatë, është plot përmbajtje. Pret një dorë ta latojë, ose poetin e vet ta nxjerrë nga harrimi shekullor. T'i japë formë, shpirt. Ta bëjë të flasë. Veten të shqetësuar nuk e ndiej më, as të humbur në labirinthin kohor. Nata kur më zë diku në Iliridë, e di se aty diku përreth meje do të gjej ndonjë mik të përkushtimit tim. Mjafton t'i lexosh librat e Shazim Mehmetit, Lulëzim Hazirit, Fatmir Sulejmanit, Salajdin Salihut, Teuta Arifit, Shaip Emërllahut; ose të kapësh aty nën Sharr tinguj drithërues të Remzi Salihut, e të tjerëve që derdhen si orteqe Fushës së Pollogut.

Dhe, në këtë fund të shekullit kaotik, nuk mund të mos pajtohesh se arma jote e vetme, më besnike e më tmerruese mbetet *kënga, libri, vepra, arti*. Fjala jonë, pra, le të arrijë atje ku nuk arrin plumbi vdekjeprurës. Fati i një populli shkruhet dhe mund të shkruhet edhe përmes përbirimeve shekullore e dinjitoze drejt Majës.

FAIK KONICA '95: Nuk di a ka gjë më të shenjtë se diku në Iliridë, deri dje të humbur në terrin e injorancës dhe të mjerimit të thellë okupes, të lëshojë shtat një shtëpi e re botuese, që do ta mbajë emrin e të ndjekurit e të përndjekurit e të kthyerit prapë në mes nesh - Faik Konica. Nuk di sa jemi të vetëdijshëm se themelimi i një shtëpie botuese në një mjedis çfarë është Pollogu, do të thotë shumë. E, posaçërisht, kur botuesi i ri premton se do të nderojë emrin me punën e vet gjithëkombëtare. Atëherë bindesh se kur shpërthen shpirti, nuk ka fuqi që e hesht. Në vigjilien e vet botuese "Faik Konica '95" nxori katër libra. Unë do të shfletoj vetëm dy.

DERI NË FUND NUK THUHET ASGJË: "Të kesh shtëpi në Tetovë", rrugëve nervoze të Kosovës e nisi udhëtimin e vet poetik Ramadan Sinani. Dhe, si duket, kishte parandjerë kthimin e tij aty nën madhështinë e Sharrit. Por vetëm kjo poezi nuk m'i kujton "Kavallet e Sharrit", libër ky i parë i tij e që doli në botim të "Rilindjes" (për mosrespektin tonë këtij institucioni kombëtar, tani më i ka mbetur vetëm hija). Desha të vë në spikamë se ne shumë shpejt harroam se dhuna filloi së pari mbi Librin e shkollën shqipe, që pastaj të rrënojë çdo gjë shqiptare." *Emblemë ilire*", titull ekuivok dhe libër i dytë i Ramadan Sinanit, na largon disi nga peizazhi mahnitës i Sharrit; na fut në një botë përpërlitjesh për të ekzistuar me çdo kusht në këto kohë të liga.

Mendoj, po ashtu të shkruash për të përditshmen, nuk është punë e lehtë. Që në fillim janë të mundshme rrëshqitjet po qe se mungon zgjedhja e duhur nga rrëmuja njerëzore. Lypset, pra, një sens i posaçëm, peshim i përmbajtjeve, të asaj që duhet të mbetet në jetë, gjithsesi. Të merresh me të përditshmen do të

thotë se çdo gjë është në zgripç. Duhet ngritur zërin edhe në mbrojtjen e vdekjes. Por nga receptori varet se në çfarë konteksti i sheh gjërat dhe ç'dëshiron të veçojë nga mesazhet e përmbajtjet. Ky krijues disi ngriti perden e një teatri plot ndrydhjeje shpirtërore, atje nën Sharrin antik, që duhen të artikulohen me guxim e dinjitet. Fatkeqësisht, asgjë nuk thuhet deri në fund.

ARTI DHE FËMIJËT: Një libër tjetër, që dua ta veçoj, është "*Fluturim i lirë*" i tetëvjeçares Zyhra Ferizi, libri i dytë i kësaj të reje, që iu bashkua korit burrëror kundër dhunës në një moment tejet kritik për qenien tonë. Pak ëndërrues, fëmijëror është, ku shtrohen gjithfarë pyetjesh bezdisëse. Se tmerri i luftës, se padrejtësitë e dhuna që ushtrohet në hapësirën tonë, nuk i shqetëson vetëm të rriturit. Lodrat e fëmijëve tanë morën forma të gogolëve të krimeve.

Edhe pse nëpër vargje e proza ka gjëra fëmijërore, pakëz naive. Megjithatë - pyetjet, kërkesat. qasjet paralajmërojnë se dhuna zbriti edhe në botën e fëmijëve. Libri i saj shtron: Pse lufta? Pse urrejtja? Pse ndasitë? Pyetje këto të rënda edhe për vetë arkitektët e tmerrit. Shqetësimin e saj e lexojmë si një ankth të të gjithë fëmijëve, të cilëve lodrat u ndërruan me objekte të tjera më tmerruese dhe harruan edhe ditëlindjet e tyre.

MURI NË MIDIS TË NJË SHKOLLE TE KOSOVËS: Duke lexuar librin "*Fluturim i lirë*" më përfytyrohej një tregim i një vajze të një miku tim. Në fshehtësinë më të madhe e kishte shkruar atë. Rastësisht e kishin zbuluar prindërit dhe tinëz saj ma kishin lexuar. Vogëlushja nuk dëshironte t'i bezdiste të tjerët me hallet që e kishin gjetur një shkollë fillore atje në Kosovë. Tregimi titullohej "*Muri*" dhe dëshmonte për një absurditet të fiseve ballkanase që demokracinë e kuptojnë edhe si dhunë. Midis shkollës ishte ngritur një ditë ai dhe kishte ndarë nxënës e klasë. Por unë murin, me atë hije tmerruese, e shihja edhe më të hatashëm seç e kishte parë vajza e mikut tim. Ishte një mur në mes fëmijëve dhe ëndrrave të tyre, që mund ta ngrisin vetëm të çmendurit e një fisi barbar.

Zyhra Ferizi me “*Fluturimin e lirë*” përpiqet të shpalosë botën e moshatarëve të vet ku janë e nuk janë - brengat, ëndrrat, shpresat, ardhmërinë e shfaqur diku në horizontin fëmijëror si një fluturim i lirë. Dhe, ne duhet besuar imagjinatës dhe forcës së fëmijëve tanë; sepse ata janë si të gjithë fëmijët e botës: *të pasherr*... Por këta tanët, si duket, na u rritën shumë më shpejt seç tregojnë vitet e tyre. Lodrat e tyre humbën edhe kuptimin e parë. Tani ato u ngjajnë guacave që, herë pas here, i nxjerrin valët tmerruese brigjeve të panjohura...

FAKSAT, BUZËQESHJA E MIKUT DHE MJERIMI YNË

SHPIRTRAT E KËEQINJ: Kështu e ka: mungojnë “reprezentativcat” dhe zhurmë. Ndiej dhembje për shkak të egos sonë. Qelbemi edhe në midis të Evropës. Prapë e lexoj faksin. Pelim. Dikur marr guxim: Mirë që nuk të kanë shpallur për kinez ose rus. Do të kishim problem më të madh me ty. Vlerat te ne nëpërkëmben në mënyrë fisnore dhe nuk bën të prekesh. Punën me “reprezenativca” duhet lënë për më vonë.

Kuptoj se dhuna pjell të keqen; edhe intrigën e llojit më të rëndë. Por, në këtë tekst dua të shtroj vetëm një pyetje: Pse ne shqiptarët nuk kemi miq më shumë? Mbi tavolinë qëndrojnë ca faksa të ardhur nga të dy anët e Murit tragjik. Secili alarmon diç, që ka të bëjnë me egon personale. Thashethem! Primitivizëm i primitivëve. Nuk dua ta dëshpëroj askë. Çfarë jemi, tepër kemi. Dua të qaj hallin e kombit, në emër të të cilit bëri çudira shumëkush, patriotizmin duke e kuptuar vetëm si *mall* të shitshëm. Pak më parë atje në Norvegji, dora jonë ia mori jetën Beritës, e cila kishte bërë aq shumë për kauzën tonë. Të tjerët filluam t’i shajmë pse bajraku im nuk u hap para tjetrit. Pse atë, e pse këtë? Harrojmë se në Evropë nuk cilësohet asgjë sipas partive apo lidhjeve farefisnore, nga e cila ne ende vuajmë.

Prapë ndalem te një pasus i faksit të datës 31 maj ‘95. E rilexoj turpin shqiptar. “Pika 2) Ardhja jote asht ba pothuaj e domosdoshme për kulturën shqiptare. Botimi i shkrimit tand *Armiq janë ata që veprojnë ndytë*, së pari në *Rilindja* e mandej në *Tribuna demokratike*, ndërsa i ka gëzue shumë njerëz që e duen përnjimend letërsinë shqipe, i ka bind përfundimisht “këlyshët” se ti nuk ekziston dhe se asht dikush tjetër që i shkruen këto shkrime tue i nënshkrue me një “pseudonim gjerman”. Menduem me botue në gazeta një portret tandin, apo një foto ku ke dalë me Podrimjen etj... Por me gjasë çështjen kishe për me e zgjidhë fort bukur ti vetë, sikur të shkrueshe diçka me temën: “Të

dhana bindëse për ekzistimin e identitetit tëm” ose diç të tillë...” Vijnë pastaj emrat e nënshkruesve koxha intelektualë, të cilët nuk dua t’i përmend se kam konsideratë për ta, megjithëse ata shkojnë aq larg mikut nga Gjermania, duke ia caktuar edhe temën e dëshmisë se për çka të shkruajë ai. Kjo disi t’i kujton kohët e errëta të diktaturës. Vërtet, a ikën ato, apo njerëzit mbetën ata që ishin.

Kështu, përmes guximit intelektual të Hans Joachim Lankschit, duan t’i qërojnë hesapet me “armikun” e brendshëm në Shqipëri, tamam siç vepronin agjenturat e fshehta të diktaturës. Ndoshta nuk harrohet zanati aq lehtë, por kjo tmerron se keqpërdorjnë guximin e mikut.

Rreth një pjese të letërsisë shqipe, përkthyesi i nderuar ka mendimin e vet personal. Ka lexuar çdo gjë që i ka rënë në dorë. Bile edhe “reprezentativcat”, të cilët ia kanë dërguar librat nga disa herë, me nënshkrime e fjalë të mëdha miradie. Por Evropa ka kutin e vet. Nuk botohet gjë me dekrete partiake, apo për shkak të sentimentalizmit. Pa marrë parasysh se ç’mendon Hansi për një pjesë të letërsisë shqipe, konkretisht për atë të Realizmit socialist e posaçërisht për vepra ku u madhërua kulti, në një mbrëmje letrare, mbajtur në Munih, në pyetjen e një dëgjuesi se ç’mendim kam për veprën e Kadaresë, përgjigjja ime ishte: Ai ka afirmuar qenien e shtetit shqiptar më shumë se ç’kishte bërë vetë shteti monist gjatë pesëdhjetë vjetëve të ekzistimit të tij... Ky është mendimi im personal, edhe pse hamendshëm flitet për Kadarenë në momentin e pikërisht në të dy anët e Murit tragjik.

PARAFJALA QË U BË AKSIDENT MIQËSIE: Në faksin e cituar aludohej edhe në “armiq” të tjerë, sipas mendjes së “shëndoshë” shqiptare... Pasi i kisha rënë në fund shkrimit, i telefonoj Redaktorit përgjegjës të “Rilindjes” në Tiranë. z. M. Gjata. Pyes a ka dalë një korrigjim, i cili është botuar më parë në “Bujkun” e Prishtinës. Përgjegjja ishte negative. Dëgjothem me poetin Fatos Arapi. Në mes të tjerash, më thotë: Nuk desha të reagoj edhe pse “Rilindja” ma mundësoi. Një me “nam” qysh se isha në Prishtinë më tha: Do e lexosh shpejt reagimin e Fatosit. Vërtet, unë pritja se ç’do të thotë një mik imi i vjetër për një parafjalë që u bë aksident miqësie.

“Në shkrimin që ta lavdërojnë - i shkruaj përkthyesit të nderuar - të është përvjedhur, ose të ka rënë parafjala *nuk...* Fatos Arapi nuk ishte komunist i regjur... Të kishte qenë i tillë, kurrë nuk ia kisha përgatitur tre libra të tij “Kaltërsi”, “Fatet” dhe “Në shi dafina”. Më vonë Hansi më tregoi se ashtu kompjuteri i tij e kishte regjistruar! Sidoqoftë për një parafjalë nuk humben miqtë. Më vjen keq: Hansi vërtet ka rënë në hall të madh me shqiptarë të cilët shkuan aq larg sa të dyshojnë edhe në identitetin e tij kombëtar. Revolta e tij duhet kapur si një buzëqeshje të hidhur të mikut të zhgënjyer: “Nëse zbuluesit e identitetit tim janë dalë diku me shkrim (gazetë, revistë etj.) ju lutem me ma dërgue. Kështu që mund ta falënderoj si duhet. Jam tepër i kënaqun se s’ka nevojë ma me u fshehë mbrapa një pseudonimi të huej”.

KOMUNIKIMI ME MIQTË SHQIPTARË: Studimet Gjuhë e Letërsi Shqiptare, Hans Joachim Lankschi i ndoq në Universitetin e Munihut, ku profesor kishte poetin e intelektualin e shquar shqiptar, Martin Camajn. Është njëri ndër adhuruesit më të flaktë të veprës së tij. Në tekstet e shkruara në gjuhën shqipe të mikut gjerman hetohet e folmja e Veriut dhe temperamentin jo vetëm gjerman. Në reagimin e tij të dërguar gazetës “Tribuna demokratike”: “Kush fshihet pas pseudonimit Hans Joachim Lanksch-it?” me nëntitull më se sarkastik “*Nekrologji për një të ngratë*” lexojmë: “Kohëve të fundit, në faqet e të përditshmes “Rilindja”, “Rilindja demokratike”, “Tribuna demokratike” e gjetiu jemi ndeshur me shkrime të palezetshme e të nënshkruara me emër të trilluar, me pseudonimin idiotesk “Hans Joachim Lanksch - dhe vijon - mund t’i qetësojë ata meqë titulli i dëshmisë sime duhet ndërruar: Kush fshihej pas pseudonimit. Ka një sihariq për të gjithë ata që i zuri inati për atë ndyracak: Turpi i periodikut shqiptar ndërroi jetë. Hans Joachim Lankschi, ky emër i pafytyrë, shkruet i polemikave të pakripë, nuk ekziston më... Ka qenë aq naiv sa mendonte bashkatdhetarët do t’ia besonin trillin torollak të një pseudonimi gjerman... Ky farë përkthyesi me emër aq ekzotik gjerman (H. J. L.) ishte specializuar në përkthimin e poetëve joreprezentativë (Martin Camaj, Ali Podrimja, Azem Shkreli e me radhë)... Vdiq në aksident komunikacioni: duke dëshiruar të

komunikonte me miq shqiptarë... Fjalët e tij të fundit kanë qenë: “Unë nuk jam unë, jam tjetërkush, kurse tjetërkushi nënshkruan me emrin tim që s’jam unë”. Mbyllet dëshmia e tij plot vrer rreth identitetit të tij të “dyshimtë” kombëtar, nënshkruar me emrin e ri Gjon Gjata...

Dhe, duke lexuar revoltën e mikut, mos e lexoja mjerimin tonë?

Të tjerët bëjnë çmos të kenë miq më shumë, të vëjnë lidhje me botën; ne edhe atyre të paktëve që na nderojnë, i marrim nëpërkëmbë si plaçka të hedhura. Ja, pra. pse nuk na shumohen miqtë. Leximin e faksave të tjerë do ta lë për një kohë më të qetë. Gruaja më lajmëron se ka vdekur miku e poet, Mirko Gashi, shqiptari nga Kraleva; boemi ynë më i shquar e më i nënçmuar viteve të fundit, pse nuk pranoi t’i përulet askujt. Do të kem mall t’ia shoh dy gishtërinjtë e ngritur rrugëve të Kosovës. Por fëmijëve të tij të shpërndarë nëpër Gjermani, si t’ua kumtoj lajmin e zi?

(1995)

KOSOVA (MEGJITHATË) NË LINDJE TË SHQIPËRISË

1.

Ernesto Sabato iku pa e ditur, ndoshta, se Shqipëri ka edhe tej kufijve politikë; se në gjuhën e *nënës* së tij, që e konsideron si perëndi, është botuar diç nga veprimtaria e tij. Kam përshtypjen se një manifestim yni madhështor (kombëtar-ndërkombëtar), siç ishte ky, me rastin e dorëzimit të çmimit letrar “*Kadare*” (Tiranë, 20 prill), të mos ketë ndonjë defekt të vogël, është e pamundshme. Mund të na bjerë kush mësysh, ose magjia e zezë rreth nesh të mos pushojë me vite. Defekti mund të kapet edhe nga ndjenja e inferioritetit brendashqiptar.

Divi i letrave, siç u quajt, megjithatë u kthye në Argjentinë, pa e parë veprën e tij në *gjuhën e nënës*, pa e qitur firmën e tij në të. Diç e tillë, te popujt e tjerë nuk bën të ndodhë, është skandal i rëndë. Por ka kohë të korrigjohemi.

Para Korit diplomatik dhe të një numri të madh intelektualësh të ftuar nga të gjitha trojet shqiptare, fatkeqësisht nuk ma zuri syri as mikun tim Mehmet Krajën, e ca të tjerë, që kishin marrë udhën për në Tiranë, mbasi kishin pasur fat të kenë *pasaportë*. Aty nuk pashë as emra të mëdhenj të kulturës sonë dhe nuk di se në manifestime të tilla, duhet të ekzistojnë ndasi në mes krijuesve sipas bindjeve partiake (!). Po ashtu, fyese ishte për Fondacionin “*Velia*” dhe çmimin “*Kadare*” të thuhet: Së shpejti pritet të dalë në shqipet një vepër e Sabatos. Nuk di si e ka ndjerë veten kolosi i “*gjakut të shprishur*” - të dëgjojë diç të tillë nga atdheu i paraardhësve të vet. Qoftë zoti me ne!

Mirëpo, Sabaton e emocionuar, “*Tunel*” e “*Mbi heronjtë dhe varrezat*”, në botim të Shtëpisë botuese “*Rilindja*” (i pari i përkthyer nga Jak Mita më 1981 dhe i dyti më 1987 nga Ramiz Kelmendi), a nuk kanë mundur ta fascinojnë? “*Rilindja*” nuk po u konsideruaka shtëpi botuese gjithëshqiptare, e cila mbet e hapur jo vetëm për gjenium tonë

krijues?! Ideologjia në Shqipëri ishte zot mbi lirinë e mendimin krijues. Gjysma e trurit tonë, pra, ishte e errësuar. Nuk bën tash të lejojmë që inferioriteti të na bëjë qesharakë para vetes e botës. Ne duhet të mësohemi - një popull nuk mund t'i ketë dy kultura, edhe pse këtë e duan të tjerët.

Tekefundit, ç'rëndësi ka kush e ku është botuar më parë vepra e Ernesto Sabatos? Kryesore është se ajo njihet nga lexuesi shqiptar para dy dekadash, dhe nuk ka lexues këndeje *Marit*, që nuk di gjë për origjinën e autorit. Pse atëherë veprat e botuara nga "Rilindja" të mos ceken në një rast solemn me përmasa ndërkombëtare? Ose, pse ato të mos i dorëzohen shkrimtarit të nderuar para Korit diplomatik e mysafirëve të shumtë dhe t'i bëhet me dije se kjo shtëpi botuese, që pat nderin të botojë diçka nga veprimtaria e tij, nuk ekziston më për shkak të dhunës dhe gjestit anticivilizues e çnjerëzor të regjimit totalitar serb?

Në njërin nga takimet e Jurisë. të dy veprat e përmendura, ia kisha dorëzuar Fondacionit "Velia". E kisha parandjerë disi se Sabato nuk di gjë për to dhe do të largohet nga Shqipëria pa e parë veprën e vet në gjuhën e nënës. Po ashtu, dëshiroja t'ua bëj me dije edhe anëtarëve të tjerë të Jurisë, se Sabato është i pranishëm në Kosovë. Verbi i tij vërehet edhe në shkrimet e ca krijuesve tanë.

2.

Meritori kryesor për themelimin e Fondacionit "Velia", padyshim është vetë themelues Vehbi Velia nga Gostivari. Adhures i madh, jo vetëm i kulturës shqiptare. Kontributi i tij gjithnjë e më shumë rritet e çmohet edhe nga intelektualët e shumtë të Shqipërisë - se puna dhe guximi i tij prej patrioti. në një kohë zgjimi gjithëkombëtar, meriton çdo respekt. Unë pak njoh nga bosët tanë, që kanë bërë e bëjnë aq shumë për afirmimin tonë kulturo-kombëtar. Nuk bën tani të nëpërkëmbet një madhështi njerëzore. Për çmimin "Kadare" anëtarët e jurisë, po ashtu, nga Shqipëria e Jashtme, kishin propozuar Sabaton. Mendonim (dhe mendojmë) se kjo nderon jo vetëm kombin e kulturën shqiptare, por i bën nam edhe "gjakut tonë

të shprishur”. Mendimi ynë u përkrah nga të gjithë të tjerët se bëhej fjalë për ndërgjegjësimin tonë si komb. Veprat e botuara nga “Rilindja” mendoja t’i dorëzohen Sabatos me rastin e dhënies së Çmimit. Divi i letrave të mos largohet nga dheu i paraardhësve me bindje se në mes të shqiptarëve nuk dihet gjë për veprën e tij. Fatkeqësisht, në ne ka zënë të çerdhojë shpirti bizantin: smirë dhe pabesi në shkallën më të lartë! Pranojmë vetëm atë që krijohet e përkthehet brenda kufijve politikë. Nuk di sa është e logjikshme, dinjitoze, njerëzore - të çohet dorë nga gjysma e popullit dhe e kulturës sate!

Derisa çështja kombëtare të shikohet në mënyrë parciale, kur brenda e jashtë trojeve tona bëhen përpjekjet për tërësinë etnike e besimin në mes njerëzve e fqinjve, është turp të mendohet se Shqipëria është diçka tjetër, e Kosova e diaspora, diçka tjetër. Një destruksion i tillë shuan edhe ato pakëz shpresa që na mbajnë gjallë.

Pajtohem se të dy veprat e Sabatos të përkthyer tek ne në Kosovë, nuk mund ta kenë bukurinë e përkthimit nga origjinali, mbasi ato u bënë përmes një gjuhe të tretë, megjithatë ato janë të lexueshme dhe për Ernesto Sabaton do të ishte nder i posaçëm, siç ishte ai grusht dhe, që ia kishte sjellë nga fshati i tij arbëresh, poeti Visar Zhiti. Me siguri të dy veprat në gjuhën e nënës do t’i mbante te koka në pleqërinë e tij të thellë.

Integrimi ynë nuk bëhet me nënçmime. Krimbi i inferioritetit duhet të na lërë rehat njëherë e përgjithmonë, nëse duam të na respektojnë edhe të tjerët.

3.

Ç’të bësh, u lëshua një rast i rrallë - Sabato së paku të dinte se rreth tij nuk ishte e tërë Shqipëria. Iku plaku i “gjakut të shprishur” me bindje, ndoshta, se paraardhësit e tij ende nuk ishin liruar nga fataliteti i tyre ballkanik dhe se Kosova, për Shqipërinë, vazhdon të mbetet në Lindje. Së paku të ishte më afër diellit. Na përhëni hëna dhe udhën nuk po mund e gjejmë deri në Kullë.

SOJLINJTË DHE ARAPI

Ra një manifestim letrar kombëtar e nxori në shesh mjerimin tonë intelektual. Tuboheshin poetët, për herë të parë, nga të gjitha skajet e Atdheut, për të nderuar figurën e bardit të poezisë sonë moderne dhe për t'i uruar nismë të mbarë *“Majit të Lasgushit”*, manifestim ky kombëtar, që mund të jetë nesër edhe ndërkombëtar. Dhe që në takimin e parë shqiptarët mbetën shqiptarë. Nuk mundën të përmbahen, edhe kur juria gaboi, ndoshta.

Por ç'ndodhi në të vërtetë? Në mes krijuesve gati elitë kombëtare plasi kokrra e smirës, sapo i kumtuan fituesit e çmimit *“Lasgushi”* për karrierë dhe tjerët për poezi më të dalluara të takimeve. Prapë shqiptarët u ndanë në fise e mëhallë. Dhe, dy ditë, sa zgjati manifestimi buzë liqenit të Poradecit (Liknida), pak fjalë ndërruan në mes veti. Pretenduesit për këto çmime, parashikuar qysh para nisjes (të tillë kishte nga të dy anët e Murit) ishin më të zëshëm. Juria në krye me prof. dr. Gjergj Zhejin, teoricien e prozator, sipas sojlinjeve, kishte gabuar, posaçërisht kur fitues të *Çmimit të Karrierës*, kishte shpallur poetin, prozatorin e kritikun *Fatos Arapi*. Ndërkaq, për çmimin tjetër dhënë poetëve B. Çapriqi, V. Skenderi, V. Antoni, E. Hatipi... kishin përshpëritur.

Për shkak të tekeve bolshevike, u morën me Arapin, dhe jurisë i zihej për të madhe si kishte guxuar ta nderojë.

Për të gjallë të Lasgushit ai na qenka sjellë keq me bardin e poezisë sonë, për poezinë e tij nuk paska shfaqur mendim të mirë. Sojlinjtë ishin përqendruar në *moralin* e Arapit, përmes etikës, ta bënin për pesë para. Por unë më shumë i besoj sinqeritetit të poetit. Ai thotë: “Ajo që nuk kam mundur dot ta them ahëre (e ka fjalën për një studim të vetin të hershëm), është kjo: Lasgush Poradeci është i sojit të atyre poetëve, të cilët janë të ndërgjegjshëm për artin e vet, për vlerat

që ata i kanë dhënë letërsisë, poezisë dhe kulturës shqiptare në përgjithësi.”

Arsyetimi i tij dëshmon një të vërtetë, se në kohën e diktaturës pakdashur ishte trim. Mu për këtë, mendimi i Jurisë është dashur të përsëritet. Në dekadën e shtatë të jetës nderoi një krijues - me vlera të pamohueshme për kulturën shqiptare, nga brezi i artë i viteve '60, kur gjërat vështirë thuheshin. Por bakallhanja jonë nuk do të ekzistonte, po të mos kishte edhe sojlinj, turli!

Pa marrë parasysh se kush ka bërë më shumë a më pak për Lasgushin, për çmimet në manifestime të tilla, shpesh vendosin edhe faktorë të tjerë. Në rastin konkret, fati kishte qëlluar në anën e Arapit dhe poetëve të lauruar. Mendimi i jurisë ka qenë dashur të respektohet edhe për shkak se këto ishin manifestime të para gjithëshqiptare, nismë e integritit shpirtëror edhe në këtë rrafsh.

Gjithashtu, nuk është e thënë se kush ka shkruar e merret me veprën e Lasgushit, patjetër duhet të nderohet. Di shumë shkrime eseistike, të vlefshme në çdo pikëpamje, ku me një qasje moderne e sens, kanë shpalosur botën lasgushiane, por, për arsye të ndryshme, ata kanë mbetur në hije të të tjerëve edhe pse i kanë përfolur. Kujtoni shkrimet e Mitrush Kutelit, Mensur Raifit, Rexhep Ismajlit, Ruzhdi Ushakut... Ata kurrë nuk trumpetuan se e thanë çdo gjë për poetin dhe pas tyre nuk ka kush ç'të thotë, e më së paku, kërkojnë të nderohen. Dihet se *arti* është variant, kërkim autorial. Po ashtu, Lasgushi është poet i papërsëritshëm. Ata që ndjekin rrugën e tij, ekziston mundësia të mbeten *vetëm* imitues, madje nëse atë mund ta imitojnë.

Rreth një manifestimi kombëtar kur dëgjon edhe gjëra të tjera, nuk mund të mos mendosh edhe për kodin tonë njerëzor. Fatos Arapi u nderua dhe ca poetë, por ata mos kishin pikur nga Marsi? Laureati i Çmimit për Karrierë, qysh të nesërmen u detyrua të ikë për në Tiranë dhe për të të heshtet edhe në mjetet e informimit. Kishin mjegulluar gjërat sojlinjtë edhe aty, si duket. Me asgjë nuk arsyetohet një gjest i tillë skandaloz, kishin fyer edhe figurën e Lasgushit, për të cilin ishin tubuar. Aty duhej të tregohej edhe dinjiteti jo vetëm krijues.

Mosrespektimi i njëri-tjetrit zbulon patologjinë tonë, e cila na ha padiktueshëm dhe na bën qesharakë para të tjerëve. Dhe, shtrohet pyetja: Lasgushi vetëm i sojlinjve na ishte?

Në *“Majin e Lasgushit”* isha ftuar, por nuk kisha pasaportë. Kjo i gëzoi ca “miq” të mi, kur mësuam se nuk mund të udhëtoja në Poradec. Pse? Ç’na bëri Fatos Arapi, Basri Çapriqi apo Ervin Hatipi... dhe ç’ua kisha zënë udhën unë?

Mjerimi ynë ka edhe variante më të rënda, nga të cilat duhet të lirohemi, po qe se e duam vetveten dhe të na respektojnë të tjerët.

(1996)

OFIÇINA “SHKRIMTARIA”

Në Vilajetin Kukunënë, ka vite që ka zënë një zanat i ri e tepër levërdisë: kanë luluar ofiçinat e “Shkrimtarisë”. Po të kesh para, brenda natës mund të bëhesh gazetar deri te romansieri me nam. Në krye të kafeneve të mjerimit tonë, ustallarët presin “viktimat”. E turpshme bëhet kjo dukuri, ndoshta një ndër gjërat më të turpshme që mund të ndodhë në letrat shqipe. Mund të “vidhet” zanati ose të mësohet, se shpirti nuk mund të shitet as blihet. Para së gjithash, vepra është punë vetjake dhe ka punë me shpirtin. Por, ja, ndodh që etika të mos respektohet dhe para ofiçinave të “Shkrimtarisë” të rreshtohen snobë e patriotë, ata që duan gjithsesi ëndrrat e shpirtin t’i artikulojnë përmes mjeshtërive të shkrim-këndimit shqip.

Flitet se këto ofiçina sa vinë e shtohen dhe janë mjaft rentabile. Nuk u mungon asgjë: nga letra e ngjyra deri te shpirti. Porositë shtohen e çmimet sillen sipas mundësisë. Kuptohet, ai që jep më shumë do të “shkëlqejë” me ndonjë vepër të madhe. Krejt kjo varet nga xhepi. Ustai i ofron “viktimës” model nga gazetaria, teoriçkat, -içkat e deri tek romani cullakhane, apo, ruana zot, patriotik. Në këto vite krize, të kesh një roman për ndonjë figurë markante martiri nga historia jonë më e re, zbrazen xhepat deri në valutën e fundit: Nuk është lehtë të shkëlqesh ndërmjet kaq “yjesh” dhe të mos e paguash mirë ustain e ofiçinës “Shkrimtaria”.

Dhe ka vite që në Vilajetin Kukunënë nuk kalon ditë pa u promovuar ndonjë libër më i ri i ndonjë “gjeniu” të panjohur, në gallokokteje të mos ndeshësh tërë parinë, në krye të mexhllisit dhe të mos dëgjosh duartrokitjet e lëvdatat e tyre karakteristike për shkrimtarin e ardhmërisë, që na u shfaq para hundëve, pa pritur e kujtuar në një kohë historike.

Tek mendoja se ç’shkruaj dhe a ishte koha të heq dorë nga kritikata ndaj aftësive të partive tona, që nuk na lanë pa atdhe e liri - ra

telefoni. Në anën tjetër dëgjoj njërin ndër ustallarët më në zë të Vilajetit. Promovoheshin librat e Ar Bostonit nga Kungullia e Epërme dhe më ftonte ustai, i cili nuk vonoi e më mori me makinë të tipit më të ri. Në kafenenë “Koha”, te dera na priste në smoking autori, ylli i mbrëmjes. Aty diku zumë vend, se në krye ishte vendosur, dihet, paria. Zgërdhieheshin, tamam si në filmat e Deni Kejit. Mezi merrja frymë nga gazetarët e fotoreporterët me nga dy-tri kamera rreth qafe. Dikur filloi pika më e rëndësishme: kritik pas kritiku, të krekosur e me fjalë më të zgjedhura. Në fund, aktorët e Teatrit të Miletit lexuan fragmente nga veprat më “dinjitoze”, që ishin shkruar ndonjëherë në gjuhën e Buzukut. Unë jetoja diku tjetër. Nuk di, më shumë shkëlqente fytyra e “gjeniu” apo e ustait të oficinës “Shkrimtaria”?

Në të ndarë, ylli i mbrëmjes i futi në xhep diç ustait. Këtij mezi ia kapa fjalët: Për kaq nuk t’i shkruaj më librat. Unë isha akull. Mendoja si të nis tekstin nevrrik dhe a do të më besojë kush se ç’ndodh në letrat shqipe në këtë pis kohë. Nga ajo mbrëmje nuk vete më në mexhlise të tilla as hap librat që reklamojnë kafenetë dhe ofiçina “Shkrimtaria”.

Tekefundit, ky popull ka me çka të argëtohet. Por, kështu e ka kur tërë populli don të bëhet shkrimtar. Apo siç thotë shpesh një mik imi në shaka: Nuk ka shqiptar që nuk është shkrimtar, as shqiptar që nuk di ç’është politika.

RRUGA “REDAKSIA”

Nuk i besoja babait kur më thoshte se ka ekzistuar një kohë, kur njerëzit tanë kryenin shkollimin me nga një fletore. Kur e thoshte këtë, sa nuk shpërtheja me atë fjalorin që ma mësoi xhungla. Më dukej disi absurde. Si të kryesh shkollën vetëm me një fletore? Kap çantën e Petritit tim. Nga librat deri te lektyra shumëçka mungon. Aty në bibliotekën time kanë gjetur vend pak tituj të rinj. Përplas derën. Në Redaksinë *Rruga* bie. Ajo gjendet përballë ish-ngrehinës së famshme të “Rilindjes”, shpërngulur tash me dhunë në një depo duhani ku nuk pushojnë së grimcuari minjtë. Shkurra, si duket, na pushton edhe nga brenda, këndeve të ftohta miqtë e mi të vjetër ushtrojnë artin e heshtjes, pikëllimin, duke e përcjellë me lëvizje të çuditshme, tamam si në teatrin japonez. Rrallë dëgjohet ndonjë fjalë. Dhe çka të flitet? Edhe energjinë e fundit e ruajnë për të mbajtur gjallë *librin shqip*, vetëdijen. Shoh se koha ime vërtet kthen atje ku komiti im thoshte se njerëzit tanë shkollimin mund të kryejnë edhe me një fletore nën qiellin e hapët.

SI MENDOJNË HALABAKËT: Moti e dinim se Libri ishte bërë therrë në syrin e pushtetarit se ne atë e kishim dhe se ky farë pushtetari ëndërron të na shohë ashtu siç dëshiron: pa libër, pa shkollë, pa institucione, pa identitet kombëtar dhe se bën çmos të na garditë edhe atë pikë krenari që na ka mbetur.

E dinim, po ashtu, se Libri e Shkolla anatemoheshin rëndë, por ne silleshim thuajse kjo ndodhte ndër komshinj dhe hapësira jonë vazhdimisht kurthohej brenda gjemborëve. Pas letrës së fundit, e kuptuam se kishim rënë në gjunjë dhe kur pushtetari ndërroi metodat e lojës, e pamë se ishim në gjumë të thellë. Se, nuk mbeti mëhallë pa nxjerrë një gazetë, e rrugë pa pasur një botues. Megjithatë, libra më pak, e nxënës shumë më pak. U kyçën libraritë tona. Kurbeti na mori edhe paranë e fundit. Shija në tetik.

Nga nivelet që kanë botimet tona, është më se i bindur se ne vetë një ditë do të heqim dorë, siç hoqëm nga shumë gjëra më të vlefshme. Deri më tash pushtetarit gati asgjë nuk i shkoi huq. Në mënyrë perfide instaloi edhe kriminalizimin e shpirtit në hapësirën tonë. Atë më së lehti edhe mund ta ndëshkojë. Na topit ndjenjat për gjëra të bukura. Pra, edhe për librin, i cili, për mua, është kujtesë e një populli.

Nëpër punktet e kulturës dikur kalonin më tepër njerëz akulturalë. Ndaj sjelljeve të tyre villnim vrer. Por të dhemb sot kur në shumë vende të qeverisë sonë gjenden njerëz që e duan dhe e çmojnë kulturën dhe tepër pak bëjnë për të. Të dhemb, posaçërisht, qosheve të partive tona rrinë edhe krijues, që i kanë botuar e ribotuar veprat e tyre e nuk mbaj mend a e kanë ngritur zërin ndonjëherë se ç'ndodh me "Rilindjen"! Gazetat na pëlqejnë më shumë, se syreti na shihet më shpesh aty. Dhe mbasi populli heq për bukë, bën edhe pa libër. Le të vdesë, pra, edhe "Rilindja" (!).

Përafërsisht kështu mendojnë edhe halabakët. Nëpër maskenballe e mexhlise vazhdojnë të trumpetojnë se "Rilindja" ishte fajtorë që ata nuk kanë dalë më herët para lexuesve; se "Rilindja" i kishte penguar në veprimtarinë e tyre. Nuk duan ta pranojnë varfërinë e tyre shpirtërore, as intelektuale. Se "Rilindja" i kishte të hapura dyert edhe për ata që dinin pakëz më tepër se 36 shkronjat e alfabetit, bile u mundësonte edhe biografive të "dyshimta". Ndërkaq, pajtohem me ata që thonë se në mozaikun tonë kulturor duhet të kenë dorë edhe botuesit e tjerë. Për këtë shkak, botuesve tek lindin: "Artpenës" dhe "Dukagjinit" ua ofrova dy librat e mi dhe nuk vuaj nga kompleksi se në to gjenden edhe firmat e tyre. Në libra të mi kanë vënë firmën edhe botues të huaj. Mirëkuptimin e ndërsjellë e kam kuptuar si gjest intelektual, por edhe si përpjekje e dyanshme për të zbutur dhunën ndaj librit. Ata që mendojnë ndryshe kanë probleme me vetveten.

Rrënimet të shtëpisë botuese "Rilindja", grusht të rëndë, pa dyshim i dha pushtetari, por nuk bën të harrohen edhe sjelljet tona ndaj kulturës dhe identitetit tonë. Brenda natës duam të jemi ata që nuk ishim as për një gjysmë shekulli e tëhu. Ne jemi të prirë që rrenën, në variante, të lansuar nga kushedi kush dhe për kushedi çfarë

qëllimesh, të blejmë nga disa gazeta, e bibliotekat tona të mos i freskojmë me ndonjë libër të ri. Tragjedia jonë qëndron te nënçmimi dhe megalomania, që janë pjellë e varfërisë shpirtërore. Ne shpresojmë të shpresa, shpresimi nga qielli do të na pikë çdo gjë. Në momentin e tashëm, qeveritarët tanë, librin e kuptuan si gjë luksoze dhe, si duket, e kanë lënë për një kohë më të mirë, kur fletoren prapë do ta kemi Bibël.

USHTRIMI I HESHTJES: Mirëpo, shtëpia botuese “Rilindja” heshtas po vdes. Para syve tanë fiket një institucion që na mbajti gjallë vetëdijen, na ofroi traditën dhe bashkëkohësinë. “Rilindja”, pra, vdes pa fajin e vet. Në mënyrë simbolike ajo na lidhi me të gjitha kohët e ekzistencës sonë. Disa thonë: Kemi botues të tjerë. Dhashtë zoti të shtohen, por shtëpi nacionale mund të jetë *një*. Edhe pse “Rilindjen” e përcollën disa lëshime që më tepër ishin kompromise se, për hir të rilindësve ose të ndonjë libri nga historia kombëtare, botonim edhe libra, ndoshta, me vlera minore nga letërsia e fqinjve.

Thashethemet tash nuk i kap lapsi. Kur ishte parë rrënimi i “Rilindjes” nga të gjitha anët kishin vrapuar të shnduknin diç. Tregohet për një librar nga Mitrovica, i cili kishte bartur libra me kamionë. Dhe pas një kohe, kur zyrtarët e Redaksisë i kishin trokitur në derë, “trimi” ynë u ishte kërcënuar. Nuk ekzistoni më! Do të kem punë me ata që u kanë nxjerrë jashtë. Ky farë “trimi” kishte themeluar pastaj shtëpinë e vet botuese (për këtë asgjë e keqe) dhe kishte filluar veprimtarinë botuese. Por paratë e “Rilindjes”?! Zoti e di.

Se deri ku shkohet, flet barcoleta *Libri dhe qebapet*, që u bë hit nëpër kuloaret tona. Një akuiziter nga Llapi, i cili merret edhe me shkrime, sa herë kishte zbritur në Prishtinë, aty diku në periferi të qytetit, kishte kthyer në një qebaptore. Pas shujtës kishte nxjerrë një libër dhe ia kishte lënë qebapshitësit si kompensim. Dhe ky e kishte marrë librin dhe e kishte vënë në raft, mu nën fotografinë e dashamirit. Por një ditë prej ditësh, qebapshitësi i “Sefasë” ia pret: Or i gëzuar, a ke ndonjë libër më serioz? Akuiziterit i ishte kujtuar se kishte edhe disa vepra të Ismail Kadaresë. Nxjerr një. Po ky libër i meriton edhe dy qebapa më shumë, kishte shtuar i uruari. Me skaj buze kishte buzëqeshur qebapshitësi: Për këtë, pak më duken dy pjata! Një kohë

të gjatë kishte zbritur tek qebaphanja burri i botës nga fundi i Llapit, me toskën e famshëm në çantë dhe ishte kthyer në shtëpi, tërë duke luhatur e kapërcyer fërkemët e Murat Gjakës të devotshëm. Në Redaksinë *Rruga*, thonë të gjirot, asnjëherë nuk i kishte rënë ndërmend se ende ekziston “Rilindja” dhe me paratë që ia kishte, ndoshta, do ta shihte dritën edhe ndonjë libër i ri. Sa të ngjitet dielli edhe pakëz mbi Shkurre, do t’ua tregoj edhe barcoletën për makinën “Gabriela 100”. Do të bindeni se dhunës krah i dhamë edhe ne. Në mënyrë të pavetëdijshme e lëshuam udhën.

Publikisht ndodhi para nesh linçi i librit shqip.

Ushtrimi i heshtjes kishte marrë fund për aktorët.

AJME PËR NE

Tha një akademik se Maqedonia, konkretisht Tetova, na është bërë njëfarë ure në mes Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Ajo na bashkon e na ndan gjatë manifestimeve të ndryshme, qofshin ato letrare apo muzikore. Ne nga Kosova shkojmë atje të kontribuojmë e të takohemi me miqtë, ndërsa ata të Shqipërisë vijnë për të na parë e dëgjuar jo vetëm hallet tona. Kjo që ndodh është disi kaçakçe, të mos them tragjike: brenda hapësirës së vet jetësore-historike një popull nuk mund të komunikojë lirisht e kur të dojë. Deri kur kjo do të vazhdojë, varet kryesisht nga ne: a do të mund të dalim ndonjëherë nga hijja e *Gurit*, që na mbulon në të dy anët e trupit.

Aty nën Sharr bashkohen shqiptarët, çmallen e mësojnë diç se ç'ndodh në të dy gjysmat e Arbërisë. Dhe, shpesh, rast i këtyre takimeve janë, pra, ca data të shënuara nga kultura jonë ose të manifestimeve të rastësishme. Mirëpo ndodh që aty më së paku të tubohen krijues të njëmendtë, sepse ka raste që nuk ftohen ose ftohen e gjysmëshoqatat tona ua dërgojnë emra të tjerë. Kështu, manifestimi nga momenti i parë humb rëndësinë e vet dhe dëshira për të kontribuar në të mirë të kulturës e mysafirët e shumtë, gati dështon. Këto lëshime bëhen, ndoshta, edhe për shkak të organizimit e respektit të nikoqirëve ndaj të ftuarve. Kryesore të mbahen manifestimet e të na kapin mjetet e informimit se jemi gjallë ende dhe nuk ka forcë që na shuan.

Kështu, pranë krijuesve me renome gjenden edhe shumë të tjerë që tek bëjnë hapat e parë, ose që dërgohen nga seksionet e tyre letrare për arsye të ndryshme e besa për të minuar dhe një kremte. Ka raste të tilla që dihen. Por a duhen në manifestime të tilla të datave të shënuara, posaçërisht kur kremtohen përvjetorë të rëndësishëm, si ai i Lasgushit, Naimit apo Fishtës (Shkodra duhet patjetër të ketë një manifestim e seleksionim më fatlum). 1) Për të nderuar personalitetin

që i dedikohet manifestimi dhe 2) Për të nderuar vetë letërsinë tonë e lexuesin e saj. Nuk di sa është e logjikshme në manifestime të tilla të ketë më shumë fillestarë. Të mos keqkuptohem, në anën e të rinjve gjithmonë jam, por duhet të ekzistojë njëfarë rendi. As kjo nuk do të thotë se nuk bën të gjenden ata në mes elitës, vetëm më të talentuarit. Të bëhet kjo edhe për shkak të kontinuitetit të brezave.

Kam pasur rast të marr pjesë në shumë manifestime të datave e krijuesve eminentë të mjediseve të tjera, por seleksionimi ka qenë tepër rigoroz; nikoqirët vërtet dëshironin të jenë edhe të nderuar. Tek ne ndodh diç krejt tjetër, i bëjmë punët shkeleshko, gati angarie; pa kurrfarë përgatitjeje; disi thuajse duam vetëm të dukemi para foltores, ose në një cep gazete. Me një sjellje të tillë, ne kemi nënçmuar vetë kulturën e emrat tanë, i kemi hapur udhë këqulturës dhe mediokritetit.

Disa thonë se në këtë kaos shoqëror nuk ka mundësi për kremtim më të denjë. Në të vërtetë, kur themi kështu, atë që e kemi krijuar me sakrificë e mund, disi e nxjerrim në margjinë dhe në mënyrë të pavetëdijshme (ka edhe me qëllim) lansojmë miqtë e gotës e të bajraqeve. Por, mu për shkak të shturjeve, duhet të ekzistojë *seleksionimi*. Përndryshe, vijnë kohë kur manifestimet tona, qofshin ato edhe për data të shënuara të kulturës sonë, të shndërrohen në karnevale, ku më së paku do të dëgjohet fjala e denjë e krijuesve të njëmendtë.

Kohëve të fundit Tetova na është shndërruar në njëfarë *meka*. Aty takon gjithfarë e kurrfarë krijuesish - shkrimtorë, siç thotë Roland Barti. Nuk di kush si vijnë e kush i ka ftuar. Kryepërkrye aty rreshtohen, anonimitetet defilojnë e fryhen, buzëqeshen para kamerave ose buzë gotave të rakisë. Por nëse vërtet e duam kulturën tonë dhe duam ta nderojmë vetveten, ne duhet të pranojmë arshinin e vlerave. Nuk nderohet Lasgushi, Naimi apo Fishta me kalaveshë e krijues të frustruar, që për dinë e iman kanë intrigën dhe sharlatanizmin.

Kështu, siç mbahen shumë manifestime tona letrare, lë përshtypjen se gjendemi apo hyjmë në një maskenball, ku më së paku do të kemi punë me shpirtin, me artikullimin tonë.

SHQIPTARÇE NË “MBRËMJET E STRUGËS”: Sa jemi konsekuent si *komb* nuk mund të shihet vetëm nga “Mbrëmjet e sivjetme në Strugë”, ku është rezervuar një natë si *Mbrëmje e poezisë sonë nacionale*. Aty do të prezantohen *vetëm* poetët nga Shqipëria. Nocioni *nacionale*, as kësaj here nuk vlen. Palës shqiptare, konkretisht Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, organizatori maqedon ua imponoi atë zgjedhje, që shqiptarët i ndan. Por a duhet ne të pranojmë diç që nuk shkon në favorin e kauzës sonë kombëtare?

Në të dy anët e Murit është detyrë e shenjtë që krijuesit të ngrejnë zërin më shumë kundër ndasive, copëzimit dhe t’u prijnë politikanëve me vizionin e tyre kombëtar. Nëse ne vazhdojmë të paraqitemi *shqiptarçe* nëpër manifestime të tilla ndërkombëtare, atëherë nuk di sa mund të kontribuojmë për integrimin gjithëkombëtar. Paraqitja e poetëve të kësaj apo asaj ane, nuk mund të mbajë epitelin si *Mbrëmje e poezisë nacionale*. Le të gjykojnë për këtë ata, që e duan poezinë dhe që nuk pranojnë ta shohin Shqipërinë xhuxhe.

ABSURDI YNE: Lexon një poezi apo tregim diku në një mjedis më të kultivuar, bile edhe në Bosnjën e përgjakur, me shpërblimin e fituar mund të gjallërosh së paku një kohë. Por ç’ngjet në mjedisin tonë? Për shkak të kauzës kombëtare pranon të lexosh me gjithkë e në çdo mjedis. I lumtur je, po qe se të nderojnë edhe me një libër. Dhe, për shkak të idealit, shpesh duhet të pranosh edhe poshtërimin që të bëhet nga mediokrit. Në të vërtetë, kjo fyen më shumë shoqërinë se krijuesin. Një shoqëri normale nuk bën të lejojë të prostituohet shpirti, arti. Ndryshe, nuk ka të ndalë rrëshqitja jonë. A bën një pulaxhi apo kikirikxhi të heqë më rëndë se një çetë krijuesish?

E, themi: duam liri; duam Atdhe. Ajme për ne!

(1996)

KARTUÇI I KUQ

Shkas për këtë tekst nuk është vetëm miku im Ardian Klosi i cili, pa fajin tim, m'i dërgoi ca karikime përmes "Përpyjekjes" nr. 7, të zotit Fatos Lubonja. Ato më bënë të qeshi këndshëm dhe të hulumtoj defektin mes nesh. Dhe shpreh qëndrimin tim: në mes shqiptarëve është shfaqur një mosrespektim, një nënçmim i vlerave në të dy anët e Murit tragjik, që duhet shikuar edhe nga rrafshi psikoetik. Droj se ky nënçmim po bëhet *dukuri*; se na largon nga problemet më qenësore. Nuk është fjala për individë a bajraqe.

Në Shqipëri, deri më tani, gati çdo gjë imja është botuar. Bile një libër imi është bërë kartuç (1972). Pas njëzet vjetëve, një mik imi poet ma solli një kopje, që kishte shpëtuar nga gërrshërët e bunkerizmit. Kjo do të thotë se neve të Shqipërisë së Jashtme (term i M. Kutelit) as "baci Enver, as baci Ramiz" nuk na kishin në sy të mirë.

Qëllimi i këtij teksti qëndron *si të kuptohemi ne*. Fatkeqësisht, ca intelektualë në Shqipëri zënë në thua gati në çdo gjë që krijohet jashtë kufijve politikë dhe gati asgjë u duket se nuk na qenka e shkruar shqip! Kjo është brengosëse.

Nëse mikun tim, Ardian Klosin, e paskam pezmatuar, siç del nga biseda e tij në "Përpyjekja" nr. 7, mbasi ia paskam shtrembëruar mbiemrin në një tekst timin të botuar në Perëndim, e të cilin nuk e kam parë, por në librin tim "*Tkurja e atdheut*" (1996) qëndron në rregull, nuk është korrekte, për shkak të një gabimi të korrekturës të fyhet një armatë e tërë intelektualësh të Kosovës për punën e të cilëve ka njohuri edhe miku im. Ç'iu desh, pra, mikut tim t'i fyejë edhe intelektualët e tjerë, të cilët rropaten me përditshmërinë e tyre jo aq të lehtë, e që nuk pranojnë të heqin dorë nga ideali i tyre rreth çështjes gjithëkombëtare, etnisë?

Pezmi i mikut tim, nxjerr në shesh edhe akuzat: 1) Kosovarët na qenkan fajtorë për pranimin e Drejtshkrimit të Gjuhës Letrare; 2)

kosovarët paskan hequr dorë (sic!) nga një pjesë e mirë e traditës sonë letrare; 3) kosovarët nuk paskan bërë asgjë rreth botimit të veprave të Camajt, Fishtës, Koliqit e kolosëve të tjerë të traditës, që ishin të ndaluar me dekrete të bunkerizmit ideologjik në të dy anët e Murit; 4) kosovarët nuk e njohin letërsinë bashkëkohore arbëreshe. Ka edhe ca vërejtje cinike që bien ndesh me të vërtetën.

Sa di unë, botuesit kosovarë më shumë u kanë kushtuar kujdes veprave të traditës sesa autorëve të vet; ata janë të parët që botuan veprat e Camajt (1953), Fishtës, Koliqit, Konicës e të tjerëve, që i zë ngjojë miku im; se botuesit kosovarë qenë të parët që ua hapën dyert krijuesve bashkëkohorë arbëreshë, për të cilët bunkerizmi pakëz gjë dinte, ose nuk pranonte atë *grimë* Shqipëri, që kishte mbetur tej Malit, ose në bregun tjetër të Ujit të Madh. Çështje tjetër është Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe. Mund të bëhen vërejtje, se nuk ka gjë të përkryer. Por unë nuk njoh një popull që ka aq drejtshkrime sa ka dialekte. Gaboj, ndoshta. As nuk pajtohem se gjuha është diçka e ngurëzuar, e paprekur; se asgjë nuk mund t'i hiqet as t'i shtohet. Ca idioma e kategori të lëna jashtë mund të trupëzohen. Nuk është logjike të nënçmohen përpjekjet për formësimin e funksionimin e deritashëm të gjuhës sonë letrare. Të sqarohemi, gjuhën nuk e elaboroj si ideologji. Atë e kap si diçka të shenjtë që duhet të na ofrojë e të na kujtojë se kush e ç'jemi. Në ca momente gjuha është edhe *çështje politike*. Këtë e potencojnë edhe ca linguistë bashkëkohorë eminentë. Kjo është një nga arsyet që u pranua norma letrare edhe nga ne në Kosovë. Por çështja mbetet e hapur...

Në asnjë metropol nuk ndodh që intelektualët e mirëfilltë të ngecin me ide e sugjerime pas politikës së ditës të shtetit të tyre rreth çështjeve kombëtare. Edhe pse Gjermania është një kolos në çdo fushë, shumë intelektualë të saj kanë ngritur zërin se, nuk mund të bashkohet Evropa, pa u forcuar kombëtarisht Gjermania. Ne a mund ta shtrojmë një gjë të tillë? Ca intelektualë në Shqipëri lënë përshtypjen se më tepër u pëlqen të merren me çështje "botërore". E shohin afirmimin e lëvërdinë, duke u sjellë margjinave. Harrojnë se Evropa më së paku ka nevojë të imitohet ajo; se është lodhur nga kozmopolitizmi, veti kjo më tepër e mediokërve. Kadareja është diç

tjetër, atë Evropa e pranoi, se shtroi probleme dhe botën tonë materiale-shpirtërore ia hapi pa kompleks se kush është.

Nuk dua të fyej askë e më së paku ca miq të mi, që nuk kanë pikëpamje si të miat. Në mesin e tyre ka edhe gjuhëtarë par excellence. Mu për këtë kam një kërkesë: toponimet e vjetra shqiptare t'i hulumtojnë e t'i kthejnë në vend të atyre sllave, ose toponimet ekzistuese t'i përkthejnë, ashtu siç veproi me emrin e mbiemrin tim, miku im, Ardian Klosi. Përkthimi i tij, fatkeqësisht, nuk ishte i saktë. Këtë pasaktësi le ta hulumtojë vetë zotëria. Kjo nuk do të thotë se të tjerët do të gabojnë. Fatkeqësi imja është ndoshta, por publikisht e them, se me ata që bëj një copë udhë, nuk e kam zakon t'i fyej përmes shtrembërimit të emrit apo të mbiemrit. Kjo nuk është etikë ime.

Ne mund t'i bëjmë qejf vetes, se bëjmë punë të mëdha. Në mes nesh është evident defekti që quhet *nënçmim*. Ne të Shqipërisë së Jashtme, derisa bëjmë përpjekje për një integritim, jo vetëm shpirtëror, ca intelektualë të Shqipërisë lënë përshtypjen se kanë shumë Shqipëri dhe refuzojnë një kërkesë gjithëkombëtare për etni, që ishte edhe ideal i rilindësve. Pse? Mos ekziston frika nga shteti etnik, apo më të sigurt e ndiejmë veten brenda një Shqipërie të rrudhur, të mos them xhuxhe. Ka dogmatë ende në mes nesh, që mund të preken edhe nga një nocion poetik.

Është e turpshme që çështja kombëtare të shtrohet në mënyrë parciale. Edhe pse në kushte të okupimit, ne të Shqipërisë së Jashtme, kulturën, historinë e artet i shohim deri atje ku mbaron shkronja e fundit e alfabetit të gjuhës sonë; pra dhe tej kufijve politikë që na i vunë të huajt. Me këtë ne nuk duam t'ua mohojmë të tjerëve ndjenjën e atdhetarisë. Por tërësia* e ka peshën e vet. Më vështirë lëkundet nga bajlozët.

Por ç'ndodh? Nëpër juritë e ashtuquajtura "gjitëkombëtare", po qe se një vepër letrare e ndonjë kosovari nuk mund të "mposhtet" në rrafshin e vlerësimit, nxirret *kartuqi i kuq*: çalon në gjuhë, fjalía nuk është shqip etj. etj. Gjuha ende shikohet brenda skemave të vjetra: Kryefjala, Kallëzuesi, Kundrina... E, gjuha është diçka e gjallë, lëvizëse; varet se ç'synohet të potencohet në momente të caktuara dhe krijuesi

ç'dëshiron - të mbështetet në formulën tradicionale, apo të krijojë ndonjë mrekulli nga ajo, duke bërë renditje të re brenda fjalisë, periudhës... Mu për këtë të kihet pakëz durim, se ne të Shqipërisë së Jashtme, të mos kishim mësuar asgjë gjatë diktaturës, kemi mësuar së paku diçka nga Gjuha e Ezopit.

Po të pranojmë, siç thonë ca tejmuras - se veprat që shkruhen jashtë kufijve politikë po çaluakan gjuhësisht, ç'ndodh me arte të tjera, kur *gjuha* nuk është kartuç i kuq? Mbahen Javë të Kulturës Gjithëkombëtare nëpër metropole e nuk ftohen as piktorë me namë, si M. Mulliqi, Gj. Gjokaj, D. Berisha, O. Kaleshi, T. Emra; ose nuk i mundësohet kitaristit me famë Ehat Musës të përfaqësojë Shqipërinë! A mos çaluakan edhe pikurat e kitara gjuhësisht; se sintaksa e fjalía nuk na qenka shqip? Fati ynë qenka i tillë: *nënçmimi*, mjeshtri kjo e primitivizmit ballkanik.

Nuk dua ta shqetësoj mikun tim Ardian Klosin me shembuj të tjerë. Kam konsideratë dhe dëshiroj që jo vetëm vepra e tij, të bëjë jehonë më larg se poezia ime, konkretisht "Kush do ta vrasë ujkun", të cilën gabimisht e citon dhe e interpreton. Karikime të tilla siç bën ai, mund t'i bëj edhe unë: nga gjysma e fjalës e deri te doktorantura për veprën e Ivo Andriqit, Nikos Kazantzakisit e Kadaresë dhe hyrjes së zotëriut nëpër gjyqe si përkthyes. Ku na shpie kjo? Ne jemi për korektiva, për dialog civilizues.

Për zënkat tona, mos na është fajtoje Evropa? Ne "gjysmintelektualëve" nga Shqipëria e Jashtme ajo po na bëka qejfin; na i botuaka veprat, lexuesit e krijuesit e saj të mësojnë se si nuk duhet të shkruajnë; ndërkaq veprat e ca intelektualëve të Shqipërisë ua refuzuaka mbasi në metropolet e veta nuk dëshiruaka të krijojë ndjenjën e inferioritetit. Vërtet kriteret na i paska humbur kjo Evropa!

Në mungesë të Atdheut dhe lirisë, ndoshta çështjen kombëtare e shoh pakëz më ndryshe. Mund të jem edhe patetik për ca miq të mi, i demoduar, neveritës në kërkimin e mbrojtjen e identitetit tim, por shtrohet çështja e një gjysmë Shqipërie, dinjitetit kombëtar e të kurajos krijuese... Faleminderit miku im, ditke të karikosh! Do të pijmë kafe prapë diku në Bavari, i përvuajturi i bunkerizmit të xhaxhit Enver. E

shoh se është krizë e humorit. Unë pa të nuk mundem, fatkeqësisht. Ndoshta, më mirë të mos i përlyejmë fjalët. Na duhen për një Shqipëri më kombëtare, më dinjitoze.

Prapë theksoj, ne nuk di sa jemi dakord. Përçarjet e nënçmimet në bazë të mëhallëve, fiseve, bajraqeve, krahinave e besimeve shpien tek copëzimi ynë; pra tek formimi i *Shqipëriçave*, ku përfundon çështja e etnisë. Një lojë të tillë fisi, a pranohet? Ndoshta jam i paqartë, ose i paditur në këto punë të mëdha “botërore”. Dhe nuk prish gjë nëse dikush zë në thua në mua. Por ai *kartuç i kuq* më tmerron. Është ky a thua i vetmi defekt i mos- respektimit të ndërsjellë?

A mund të kuptohemi, zotërinj?

(1996)

KOLLTUKOFAGËT

NJERËZIT QË E DUAN KARRIGEN MË SHUMË SE
ATDHEUN: Kolltukofagët janë racë më vete, më e çuditshmja
që mund të ekzistojë në ndërtimin e një shoqërie. Ata lindin
mbrapsht dhe mbrapsht udhëtojnë. Ëndërrojnë të jenë të rrethuar
e të nderuar nga kurrkushët dhe të dëgjueshmit. Ideali i tyre ka
formën e katërkëmbëshit, të kunjit, ose merr formën e karriges,
ku veten të giorët e ndjejnë më mirë e më të sigurt. Karriga është
zoti i tyre. Ndoshta, i vetmi tempull që kolltukofagët i përuhlen.

Lufta rreth karriges bëhet në mënyrë më të poshtër. Më
parë nisin përruljet, puthadora, qeshja, zgërdhirja e në fund “lufta”
me etiketa, që natë e ditë mund t’i fabrikojë mendja e errët. Nuk
shohin as njohin kë pos karriges, e cila u lëviz nën zuzë nga pesha
e dyshimtë. Dikur, kur fillojnë të bien hijet, kolltukofagët
zgërdhihen, secili nga planeti i vet i vockël, pyesin për shëndetin e
njëri-tjetrit në mënyrë më se gjentile. Bisedat i kanë të gjata,
posaçërisht për të korrura e të qethura nga ofiçina “Shkrimtaria”.
Ato janë dy zejet kryesore që i kultivojnë nga dita e parë kur
ngulin majë “botës”.

Kolltukofagët nuk pranojnë lëvizjen. Ata duan çdo gjë të
jetë statike; të nxejë vetëm dielli i tyre i vockël letrar, nëse është e
mundshme, uji kurrë të mos derdhet në mullirin e fqinjit. Ata më
parë vdesin se rënia e tyre nuk shënon asgjë; janë të papeshë dhe
trupa ku mund të përbirohet edhe bualli.

Mjeshtëria e tyre ka lidhje pakëz me fantastikën. Në mënyrë
të çuditshme përbirohen deri aty ku mbaron ideali dhe fillon
mjerimi i tyre shpirtëror. Dinë për mrekulli lojën e bërrylave,
ndërskamcave këta “nobelistë” të shqiptarisë. Por, humbin kur
zënë të luajnë kapuçash, menjëherë ua gjejnë kokrrën se janë
transparentë. Aq kanë dhe aq mund të bëjnë në një kaos

shoqëror, kur ata paraqiten dhe zënë vend pa e merituar; kur mashtrojnë e rrënojnë se janë grimca të një shoqërie, e cila i harron udhës.

A ka kolltukofagë në mes nesh?

Diç qesharake të shtronim një pyetje të tillë. Ajo vërehet nga hekurosja e mendimeve e shprishja e shpirtrave; nga dirigjimi dhe lindja e suslllovëve të rinj, që dhenë e dhi i ndajnë në pikë të natës me një fanar mesjete. “Vërtetimi” e “dëshmimet” e identitetit të mikut, fisit, farefisit, çatisë, mëhallës, gotës e ku ta di. Kryesore, as në këtë zeje nuk jemi të varfër. Ndoshta dhe mund të prijme, sepse çdo gjë e kuptuam se triumfi i individit më parë varet se çfarë karrige ka: katërkëmbëshe, trekëmbëshe apo kunj.

Nëse baballarët tanë besonin në diell e hënë, kolltukofagët besojnë vetëm në karrige e polemin rreth vetes; kuptohet të zgjedhurit e të fyerit, që një ditë padiktueshëm mund edhe të zhduken. Karrigia është shkaktari i lindjes së forcës së errët, totalitares, krimin. E kolltukofagët janë njerëz egocentrikë, narcisoidë, prej në e qepin në mënyrën më të çuditshme derisa një ditë gërditen edhe nga vetvetja, tamam si ai kërmilli i Marin Soreskut.

Padiktueshëm zhduken ose bien. Kush? Pse? Askush nuk është në gjendje të japë shpjegimin. Në hijen e ndonjë rrapit apo muri kinez, e sheh si luhatet karrigia e gjorë. Të kujtohet mercenari, mizantropi, dallkauku, mashtruesi, hajni, llafazani, injoranti. Dhe, duke shikuar atë karrige si luhatet aty në hijen e rrapit, apo të murit kinez, bindesh se lakmia është tragjike për njerëzit bosh. Çërvish më!...

MOÇALI: Lumi që nuk ecën, shndërrohet në moçal, moçali në myshk. Sipas mjekësisë, myshku është i dëmshëm për shëndetin e njeriut. Historia ka shënuar shumë luftëra që janë bërë për shkak të myshkut. Ndoshta kemi marrë ose marrim pjesë edhe ne në ndonjë luftë kundër tij, se shpirti kur arrin të shndërrohet në një moçal, atëherë pushon çdo gjë.

Në dheun tim moti nuk kanë fryrë erëra. Meteorologët paralajmërojnë se do të ketë ndryshime të mëdha atmosferike. Unë nuk besoj. Ata vështirë se do të zbresin në mes njerëzve.

(1996)

ETËRIT DHE BIJTË

Nga zoti Turgeniev kërkoj falje për titullin e shkrimit. Ja, pra, erdhi koha që brenda qenies kombëtare të mos kuptohemi dhe nyja assesi të zgjidhet. Etërit ngrehin në anë të vet, bijtë kërkojnë të kontribuojnë për ndërtimin e shoqërisë së re shqiptare, pakëz më të hapët e pa kurrfarë cenzure.

Etërit përbehen se vetëm ata janë shtylla e kombit; se tutje, kupto lexues i nderuar, shqiptarët - siç do të thoshte Kadare, e bënë luftën, e bënë Shqipërinë, thanë kënetat vdekjeprurëse, vunë binarët e parë të hekurudhës, ndërtuan uzina, spitale, shkolla, çelën rrugë te huduti, ngritën universitetin, çerdhe, apartamente; vunë gurin ku fillon e mbaron ajo e tyre. Dhe, atë që e bënë nisën ta admirojnë xhelozisht, të betohen e përбетohen, se atë që e kanë bërë askush më parë nuk e kishte bërë. U lidhën për to si anteu për tokë.

Dhe besonin etërit, pak më shumë seç duhej, në të ashtuqajturën *fe komuniste*. Mendonin se parullat ishin me vend dhe si ata mendojnë edhe fqinjët. Shpesh etërit hoqën dorë edhe nga ajo që ishte e tyre *tej gurit*. Ishin të kënaqur me atë që kishin arritur dhe çdo gjë *tej e tej* ishte gati e humbur dhe bijve ua fshihnin të vërtetën. Megjithëse ëndrrat e gjumin ua prishën shpesh ata të cilët e kishin nisur luftën e madhe të komunizmit dhe pa vetëdije kishin pranuar primitivizmin bizantin.

Mirëpo erdhën bijtë, të shkolluar e të ngritur jo vetëm në shkollat e me librat e tyre. Panë se mund të bëhet më shumë e më bukur nga ato që u linin etërit, prandaj shtruan kërkesat para vetes e etërve, se ajo që ishte e tyre duhej inkuadruar edhe në familjen e madhe të Evropës dhe Ballkani nuk mund të mbetet vrimë e fundit e kavallit. Erdhën bijtë e thanë se duan të flasin hapur për çdo gjë shqiptare, madje edhe për ato tema tabu, siç ishin

Çamëria e Kosova. Thanë bijtë se duan të sillen me të tjerët pak më ndryshe se etërit, se nuk është turp ta mbrosh atë që është jotja, është imperativ kohe të hysh në Evropën e re si popull i integruar.

Dhe erdhën bijtë pa kurrfarë kompleksi, të etshëm për të ditur edhe më shumë për vetveten dhe i ngritën perdet edhe mbi atë që etërit frikoheshin të thoshin një fjalë; ose e thoshin, por pak si turpshëm. E, historia nuk shikohet me syrin e një miopi, as nuk mund ta shkruajnë vetëm ata që gjenden në krye të vendit; historia nuk ka “hudute”, as kohë të caktuara, ajo shënon edhe tragjedinë kombëtare.

Dhe, erdhën bijtë, kërkojnë pak më larg ta qesin hapin. Nuk duan të kënaqen vetëm me atë që po ua lënë etërit. Ajo është dialektikë: brezi-brezin plotëson, brezi-brezin e shtyn përpara dhe nuk ka vend frika se atë që e bënë etërit, po zhduket si fluskë sapuni. Përkundrazi, ajo fiton përmbajtje të re, bëhet më madhështore se atë që e gjetën bijtë.

Dhe, erdhën bijtë. Ndryshe duan t'i shikojnë gjërat. Kërkojnë t'i bëjnë më të begatshëm e më sovranë vendin e shpirtin arbëror. Evropiançe të jetojnë e mendojnë. Historinë nuk e duan të ditës, as të gjymtuar, secilit kërkojnë t'i japin vendin meritore. Ç'të keqe mund të ketë në kërkesat e bijve? Asgjë. Pse etërit e bijtë, fitoret e marshimet e reja, të mos i bëjnë bashkë? Pse etërit harrojnë se edhe ata ishin këmbëngulës në kërkesat e tyre? Tashti, pse të mos respektohen bijtë, të cilët popullin shqiptar dhe atdheun nuk duan ta shohin duke vrapuar pas do dogmave të çoroditura, po aty ku e ka vendin - midis familjes së madhe të popujve evropianë?

Një ditë edhe bijtë do të bëhen etër, ndoshta etër edhe më kokëfortë se etërit e tanishëm. Por do të vijnë bijtë e etërve më të rinj e me kërkesa, ide e përmbajtje të reja; do të sjellin ata edhe monumentet e veta: ca do të shkëlqejnë më gjatë e ca do t'i vendosin *vetëm* në muzeume ku ruhet historia...

Etër të nderuar, më mirë t'i kuptoni bijtë tuaj. Burrëri është të pranoni se ata shohin më larg, atdheun e popullin hiç më pak se ju i duan.

Po qe se polarizimet kalohen pa gjakderdhje, pa hakmarrje, pa vandalizëm, vetëm me një shtrëngim dore, si i ka hije një populli antik, çfarë është yni, me një traditë jo aq të vogël të demokracisë, do të thotë se i mençur ka qenë ai që ka bërë pajtimin midis etërve dhe bijve.

(1990)

SHËNIM

Në këtë libër publikohen shkrime të botuara tash e njëzet vjet. Me këtë rast kanë pësuar ndonjë retushim. Libri, megjithatë, nuk mbyllet.

Autori

Prishtinë, 5 shkurt 1997

PËRMBAJTJA

TKURRJA E ATDHEUT	7
Atdheu prej 5x5 m.....	9
PA ATDHE NUK KA EMËR	11
Për kë shkruajmë.....	11
A po i kthehem Mesjetës.....	19
Fëmijët dhe ministrat	28
II.Gjenocidi kulturor më i rëndë se ai fizik.....	31
Demaçi dhe rezistenca paqësore shqiptare.....	33
Jeta nëpër gracka	37
Shqiptarët në mozaikun europian	41
Dalja nga harresa	45
Nuk kam kujt t'ia kushtoj një poezi.....	48
Nënteksti i një testamenti.....	52
Poetët vdesin bashkë me atdheun.....	56
Pa atdhe nuk ka as emër.....	61
MOS KEMI TEPËR ATDHE	64
A je shqiptar?.....	64
Teatri i absurdit.....	69
Kokëqethja e një populli	73
Mos kemi tepër atdhe	77

Kush luan me shqiptari.....	81
Kosova, sy që loton.....	85
Shqipëritë	89
A ka dritë në tunelin tone.....	93
Inserte	96
Dielli lind në Perëndim.....	99
Afirmimi i antijetës.....	104
Poshtërimi nuk është demokraci.....	108
TKURRJA E ATDHEUT.....	112
Terri mbi Gadishullin Ilirik.....	112
Makrotërmeti.....	117
Harta e gjërave të humbura	121
Dëgjo, zhurma nuk është këngë.....	129
A po përsëritet historia?.....	133
Të shqiptarizohemi më parë.....	137
Tkurrja e Atdheut.....	141
SHËNIM.....	145
LIBRI QË NUK MBYLLET	147
KUR PRAN TEKSTI.....	149
Mbrojtja e vdekjes.....	149
Gjuha shenjë e parë.....	154
Ekzistenca si nocion.....	158
Larg pikës së vdekjes.....	167
Vendlindja - preokupim ekzistencial	175
Dalje nga vetmia.....	182
Kur pran teksti.....	191
JANË ZBUKURUAR PLEHRAT NË ATDHEUN TIM.....	196
Një parandjenjë e çuditshme.....	196

Jeta në dy kohë.....	200
Tmerri i ri.....	204
Kur lexoj librat e mikut.....	207
Janë zbukuruar plehrat në atdheun tim	210
Libri që nuk mbyllet	213
Leximi i turpfit nacional.....	217
Shpirti ynë i vogël.....	222
Kur të ikin barbarët	226
Pse nuk shkruaj poezi dashurie.....	229
KOSOVA NË LINDJE TË SHQIPËRISË.....	232
Takimi i udhëve	232
Skicë për portretin e mikut	236
Vetmitari i madh nga Ulpiana	241
Fati i përbashkët	245
Librat, fëmijët dhe dhuna	250
Faksat, buzëqeshja e mikut dhe mjerimi ynë.....	254
Kosova (megjithatë) në Lindje të Shqipërisë.....	258
Sojlinjtë dhe Arapi	261
Oficina “Shkrimtaria”	264
Rruga “Redaksia”	266
Ajme për ne	270
Kartuçi i kuq.....	273
Kolltukofagët	278
Etërit dhe bijtë	281
SHËNIM	284

ALI PODRIMJA

VEPRA

Vëllimi i tetë

Prishtinë, 2013

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Design: ZENI BALLAZHI

Radhitja & faqësja: BURIM REXHEPI

Lektor & korrektor: SHEFQET RIZA

Madhësia: 18 tabakë shtypi

Tirazhi: 500 kopje

Formati A5 (14.8 x 21 cm)

Shtypi: FOCUS-PRINT, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-4

821.18-92

Podrimja, Ali

Vepra = Works / Ali Podrimja. - Prishtina : Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2013. - libra ; 21cm.

Vëllimi 8 : Turrja e atdheut : (ese dhe të paharruarat) ;

Libri që nuk mbyllet : (ese dhe shënime nga esnafë krijues). – 288 f., portreti i autorit

ISBN 978-9951-615-14-3

ISBN 978-9951-615-22-8